

MANUALI I TRAJNUESIT

**HYRJE NË RREGULLAT E NELSON MANDELËS
PROGRAM NDËRKOMBËTAR TRAJNIMI**

MANUALI I TRAJNUESIT PËR KURSIN 4-DITOR TË TRAJNIMIT PËR PERSONELIN
E BURGJEVE PËR ZBATIMIN PRAKTIK TË RREGULLAVE TË NELSON MANDELËS

Ky publikim mund të rishikohet, të përdoren pjesë të tij, të riprodhohet dhe përkthehet lirisht, pjesërisht ose tërësisht, por jo për qëllime shitjeje dhe as për aktivitete që kanë lidhje me motive tregtare. Çdo ndryshim në tekstin e këtij publikimi duhet të miratohet nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Reforma Penale Ndërkombëtare (PRI). Çdo referencë ndaj këtij botimi duhet të evidentohet sipas rregullave.

Mirënjohje

Sharon Critoph, konsulente për të drejtat e njeriut dhe reformën penale, ia dorëzoi draftet fillestare të këtij dokumenti programit të ODIHR-it kundër Torturës dhe Reformës Penale Ndërkombëtare (PRI).

Udhëzuesi i trajnuesit u zhvillua në bashkëpunim të ngushtë me Shërbimin Suedez të Burgjeve dhe Provës (SPPS) dhe Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC).

ODIHR-i u është mirënjohës përfaqësuesve të PRI-së, SPPS-së dhe UNODC-së, të cilët, të gjithë, dhanë këshilla dhe inpute thelbësore gjatë fazës së hartimit.

Publikimi i këtij dokumenti udhëzues u bë i mundur falë fondeve shtesë buxhetore të ofruara për programin e ODIHR-it kundër torturës.

Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)
Miodowa 10
00-251 Varshavë, Poloni
Telefoni: +48 22 520 0600
Faks: +48 22 520 0605
Email: office@odihr.pl
osce.org/odihr

Reforma Penale Ndërkombëtare

Qendra e Humanitetit në Hagë
Fluwelen Burgwal 58
2511 CJ Den Haag Holandë

Email: info@penalreform.org
Twitter: [@PenalReformInt](https://twitter.com/PenalReformInt)
www.penalreform.org

Përkthimi dhe botimi në gjuhën shqipe u mundësuan nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri


Përkthimi në gjuhën shqipe: Mimoza Gjika, Rubin Vojka, Arba Bërdica

Redaktimi ligjor: Alba Jorganxhi

© OSBE ODIHR dhe PRI 2025

ISBN 978-92-9271-361-4 (online)

Grafika nga Zofia Konarska, Ilustrimet nga Alex Valy (alexvalydesign.co.uk)



Kriminalvården



UNODC

United Nations Office on Drugs and Crime

MANUALI I TRAJNUESIT

HYRJE NË RREGULLAT E NELSON MANDELËS PROGRAM NDËRKOMBËTAR TRAJNIMI

MANUALI I TRAJNUESIT PËR KURSIN 4-DITOR TË TRAJNIMIT PËR PERSONELIN
E BURGJEVE PËR ZBATIMIN PRAKTIK TË RREGULLAVE TË NELSON MANDELËS

Hartuar nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR)
dhe Reforma Penale Ndërkombëtare (PRI) në partneritet me Shërbimin Suedez të Burgjeve
dhe Provës (SPPS) dhe Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC).



PËRMBAJTJA

HYRJE	6
METODOLOGJIA E TRAJNIMIT	8
PROGRAMI 4-DITOR	18
HYRJE NË KURSIN E TRAJNIMIT	23
MODULI 1 RREGULLAT E NELSON MANDELËS	
HYRJE	28
OBJEKTIVAT MËSIMORE	28
12 Parimet udhëzuese të Rregullave të Nelson Mandelës	29
1.1 Historiku dhe hyrja në Rregullat e Nelson Mandelës	32
1.2 Rregullat e Nelson Mandelës – Parimet bazë	35
1.3 Fushat tematike që mbulohen nga Rregullat e Nelson Mandelës	36
1.4 Roli i punonjësve të burgut	38
1.5 Grupe të veçanta të personave në burg/ grupet e cënueshme	38
MODULI 2 PERSONAT NË BURG DHE KUSHTET E BURGUT	43
Hyrje	44
Objektivat mësimore	44
2.1 Cilët janë në burg?	45
2.2 Ndarja e kategorive	47
2.3 Kushtet e burgut dhe shërbimet bazë	53
MODULI 3 ORGANIZIMI DHE ADMINISTRATA E BURGJEVE	66
Hyrje	67
Objektivat mësimore	67
3.1 Proceset e pranimit, klasifikimit, vlerësimit të rrezikut dhe të nevojave	68
3.2 Caktimi i të burgosurve dhe ndarja e kategorive	72
3.3 Transferimet e të burgosurve	76
3.4 Menaxhimi i dosjeve të të burgosurve	79
3.5 Të paraburgosurit	83
MODULI 4 MASAT MBROJTËSE	86
Hyrje	87
Objektivat mësimore	87
4.1 Qasja në informacion	88
4.2 Kërkesat dhe ankesat	94
4.3 Kontakti me botën e jashtme	105
4.4 Inspektimet dhe monitorimi (i brendshëm dhe i jashtëm)	111

MODULI 5	PARANDALIMI I INCIDENTEVE DHE REAGIMI NDAJ TYRE.....	118
	Hyrje	119
	Objektivat mësimore	119
5.1	Siguria fizike, procedurale dhe dinamike	120
5.2	Zgjidhja e konfliktit	125
5.3	Kontrollet	127
5.4	Përdorimi i forcës, armëve dhe mjeteve të kufizimit fizik	134
5.5	Hetimet.....	139
MODULI 6	KUFIZIMI FIZIK, DISIPLINA DHE NDËSHKIMET	141
	Hyrje	142
	Objektivat mësimore	142
6.1	Masat dhe procedurat disiplinore	143
6.2	Vendosja në izolim	148
MODULI 7	KUJDESI SHËNDETËSOR.....	151
	Hyrje	152
	Objektivat mësimore	152
7.1	Kujdesi shëndetësor	152
7.2	Shëndeti mendor i të burgosurve	158
MODULI 8	REHABILITIMI I TË BURGOSURVE DHE PËRGATITJA PËR LIRIM	162
	Hyrje	163
	Objektivat mësimore	163
8.1	Aktivitetet, trajnimi, edukimi dhe punësimi i të burgosurve	163
8.2	Përgatitja për lirim dhe mbështetja pas liritimit	166
	ANEKSI 1.....	170
	ANEKSI 2.....	171
	ANEKSI 3.....	172



HYRJE

HYRJE

Ky botim është hartuar për të orientuar trajnuesit që zhvillojnë kurset 4-ditore të trajnimit për personelin e burgjeve të zhvilluara nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Reforma Penale Ndërkombëtare (PRI) në partneritet me Shërbimin Suedez të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës (SPPS) dhe Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC).

Manuali është vendosur në internet me qëllim zhvillimin e programeve të trajnimit lidhur me Rregullat e Nelson Mandelës, ose plotësimin e programeve ekzistuese të trajnimit. Gjithashtu, një kopje do t'u jepet të gjithë pjesëmarrësve në seancat e të ODIHR/PRI-it për trajnimin e trajnerëve.

Personeli i burgut luan një rol thelbësor në garantimin e respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut të njerëzve në burg. Rregullat standarde minimale të rishikuara për trajtimin e të burgosurve (rregullat e Nelson Mandelës)¹ janë standardi kryesor ndërkombëtar që rregullon trajtimin e të burgosurve. Kjo paketë trajnimi është krijuar për të ndihmuar personelin e burgjeve që të kuptojë dhe zbatojë Rregullat në praktikë. Manuali bazohet në Dokumentin Udhëzues të OSBE-ODIHR/PRI mbi rregullat e Nelson Mandelës.²

Kursi i trajnimit organizohet në mënyrë tematike. Aty jepen udhëzime se si të zbatohen standardet minimale për trajtimin e njerëzve në burg, por pa u bërë pengesë për zbatimin dhe zhvillimin e standardeve edhe më të larta në menaxhimin e burgjeve, trajtimin e të burgosurve ose kushteve të burgut. Në raste të veçanta, kursi u referohet rregullisht Rregullave të OKB-së për Trajtimin e Grave të Burgosura dhe Masave Alternative për Gratë që kryejnë Krime (Rregullat e Bangkokut).³

Manuali përmban prezantime, ushtrime praktike dhe shënime udhëzuese që mund të përdoren nga trajnuesit, si dhe informacione bazë dhe burime të tjera që mund të jenë të dobishme në seanca të ndryshme. Për secilin nga pjesëmarrësit në seancat e trajnimit do të përgatitet një paketë e veçantë informacioni.

Ky botim plotëson Kursin e-learning të UNODC-ut⁴ për Rregullat e Nelson Mandelës si dhe përfshin disa nga këta skenarët që gjenden aty. Të gjithë pjesëmarrësit e kursit duhet të përfundojnë mësimin online të UNODC-ut brenda tre muajve nga përfundimi i kursit të trajnimit.

1 Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të burgosurve (Rregullat e Nelson Mandelës), Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC).

2 Dokument udhëzues mbi rregullat e Nelson Mandelës: Zbatimi i Rregullave Standarde Minimale të Rishikuara të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve, OSBE/ODIHR, 9 gusht 2018. Ky shënim udhëzues fokusohet me detaje në rregullat e ndryshuara/shtuar si pjesë e procesit të rishikimit. Ky kurs trajnimi synon të mbulojë të gjitha fushat e përfshira në Rregullat e Nelson Mandelës, dhe jo vetëm ato që janë ndryshuar.

3 Rregullat e Bangkokut, UNODC, UNGA A/RES/65/229, 16 mars 2011.

4 UNODC's e-learning course on the Nelson Mandela Rules.

Një draft i këtij manuali trajnimi u pilotua në Suedi në prill 2022 me pjesëmarrës nga shërbimet e burgjeve gjermane, italiane, rumune dhe suedeze. Kurrikula është ndryshuar për të pasqyruar mendimet e pjesëmarrësve lidhur me zhvillimin në praktikë të përmbajtjes dhe ushtrimeve.

METODOLOGJIA E TRAJNIMIT

Hyrje

Ky seksion i manualit përcakton parimet udhëzuese për kursin e trajnimit dhe ofron informacion se si trajnuesit të organizojnë seancat. Ai, gjithashtu, vë theksin në aspektet praktike dhe jep sugjerime për përgatitjen e trajnerëve përpara trajnimit.

Trajnimi është intensiv - zgjat katër ditë (ose ekuivalent me një kurs katër-ditor trajnimi në korniza kohore të ndryshme) - dhe mbulon një gamë të gjerë çështjesh. Ai bën një prezantim të plotë me Rregullat e Nelson Mandelës dhe u siguron pjesëmarrësve mjetet konkrete për zbatimin e rregullave në praktikë, në kontekste të ndryshme të vendeve të privimit të lirisë.

Objektivat e metodologjisë së trajnimit

Metodologjia e trajnimit është zhvilluar duke pasur parasysh premiset e mëposhtme:

- Interesimin dhe angazhimin e pjesëmarrësve për përmbajtjen e kursit dhe aftësinë e tyre për të përshtatur punën e tyre në funksion të objektivave të trajnimit.
- Trajnimi u përgjigjet nevojave të jetës reale të pjesëmarrësve dhe lidhet me sfidat në institucionet dhe vendet e tyre.
- Të gjithë pjesëmarrësit janë të hapur për të diskutuar përvojat e tyre pa pasur frikë se mund të gjykohen apo akuzohen.
- Pjesëmarrësit pranojnë të drejtat e njeriut si një qasje të vlefshme dhe të dobishme dhe kuptojnë rolin e tyre në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Pjesëmarrësit e kuptojnë mënyrën si qasja e të drejtave të njeriut në menaxhimin e burgjeve ka potencialin t'u shërbejë jo vetëm njerëzve në burg, por edhe për personelit të burgut dhe institucionit/komunitetit në një rrafsh më të gjerë.
- Pjesëmarrësit dhe trajnuesit mësojnë të kuptojnë dhe të trajtojnë paragjykimet dhe stereotipitë e tyre rreth njerëzve në burg, grupeve minoritare dhe të tjerëve.
- Pjesëmarrësit identifikojnë hapur dhe diskutojnë se cilat aftësi, duke përfshirë 'aftësitë e buta' nevojiten për të lehtësuar zbatimin e Rregullave të Nelson Mandelës dhe se si ata i përdorin këto aftësi në praktikë.
- Trajnimi rrit motivimin e individit për të kryer mirë punën e tij.
- Trajnuesit mësojnë nga seancat dhe ndajnë e diskutojnë përvojat e tyre me personat e tjerë në radhët e të trajnuarve.

Parimet e trajnimit

Parimet mësimore për të rriturit dhe lidhja konstruktive

Ky trajnim bazohet në gjashtë parimet mësimore për të rriturit. Në këtë kontekst, kjo do të thotë:

- a. Të trajnuarit e kuptojnë pse është e rëndësishme që ata të dinë më shumë rreth Rregullave të Nelson Mandelës;
- b. Trajnimi është ndërtuar duke njohur përvojat dhe kompetencat e personelit të burgjeve, por në të njëjtën kohë i vë ato në provë;
- c. Të trajnuarit mund të bëjnë zgjedhje në procesin e të mësuarit;
- d. Të trajnuarit motivohen nga fakti se trajnimi mund t'i ndihmojë në jetën profesionale;
- e. Të trajnuarit fokusohen në përdorimet praktike të trajnimit; dhe
- f. Të trajnuarit kanë prirjen natyrore për të mësuar.

Ky trajnim bazohet, gjithashtu, në konceptin e lidhjes konstruktive - të trajnuarit i ndëtojnë vetë njohuritë e tyre nga aktivitetet që ofrohen. Trajnuesi siguron që mjedisi mësimor të mbështesë aktivitetet dhe që të gjithë komponentët e trajnimit të jenë të orientuara drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara si dhe të gjithë të jenë në një linjë me njëri-tjetrin. Çdo modul ka qëllime të përcaktuara qartë krahas aktiviteteve përkatëse mësimore. Të trajnuarit inkurajohen të shprehin mendimet e tyre për efikasitetin e kursit dhe, veçanërisht, lidhjen midis rezultateve të synuara mësimore dhe aktiviteteve ku ata angazhohen.

Zhvillimi i njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe sjelljeve

Qëllimi i këtij kursi trajnimi nuk është thjesht të japë njohuri rreth Rregullave të Nelson Mandelës. Pjesëmarrësit do të mësojnë, gjithashtu, se si ta transferojnë dijen në sjelljen e duhur si dhe të zhvillojnë aftësi praktike se si të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut, duke përfshirë zhvillimin e 'aftësive të buta' si komunikimi, empatia dhe toleranca.

Trajnimi, gjithashtu, do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të zhvillojnë qëndrimet e tyre ndaj burgimit dhe të përmirësojnë mënyrën se si ata ndërveprojnë me njerëzit në burg. Pjesëmarrësit do të inkurajohen të promovojnë në mënyrë aktive të drejtat e njeriut në jetën e tyre të përditshme dhe në detyrat profesionale brenda konteksteve, vendeve dhe mjediseve të burgjeve të ndryshme.

Kursi do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë se zbatimi efektiv i Rregullave të Nelson Mandelës jo vetëm që u sjell përfitime njerëzve në burg, por gjithashtu do të përmirësojë kushtet e punës dhe aftësitë e tyre profesionale, si dhe mund të çojë në një sistem të burgjeve më të sigurt, më efektiv dhe eficient në përgjithësi.

Përdorimi i përvojës

Ky trajnim është i bazuar në përvojë dhe vendos në qendër personin që mëson. Pjesëmarrësit mbartin shumë vite përvojë pune në sistemet e burgjeve dhe ka të ngjarë të jenë ndeshur me shumë nga çështjet e ngritura në këtë trajnim. Ata kanë krijuar këndvështrimet dhe idetë e tyre bazuar në skenarët me të cilët përballen çdo ditë dhe sfidat praktike me të cilat përballen. Këto kanë dobi të jashtëzakonshme për trajnimin.

Trajnuesi do të duhet të krijojë një ekuilibër midis respektimit të kurrikulës së trajnimit dhe përdorimit të përvojave të pjesëmarrësve. Kjo gjë do të sjellë përshtatjen me dinamikën e grupit. Pjesëmarrësit duhet të inkurajohen të ndajnë ekspertizën dhe

përvojën e tyre sa më shumë që të jetë e mundur, dhe prandaj duhet të ndihen sa më mirë në mënyrë që të veprojnë kështu. Në të njëjtën kohë, trajnuesi duhet të sigurojë që çdo ndërhyrje të ketë vlerë për trajnimin dhe të mos dëmtojë mesazhet kryesore, standardet ndërkombëtare dhe thelbin e përgjithshëm të kurrikulës.

Ndërveprimi

Kursi i trajnimit është krijuar për të qenë sa më ndërveprues, me një sërë rolesh për t'u luajtur, raste studimore, diskutime në grupe të vogla, seanca për zgjidhjen e problemeve dhe rrahje mendimesh. Pjesëmarrja aktive lehtëson të mësuarit dhe i pajis më mirë pjesëmarrësit për ta transferuar atë që mësojnë në mjediset e tyre të punës. Trajnimi me pjesëmarrje, ose 'të mësuarit duke vepruar', i ndihmon njerëzit të mbajnë mend mesazhet kryesore, u mundëson të kuptojnë, reflektojnë dhe analizojnë sjelljet e tyre dhe të zhvillojnë strategji të ardhshme për veprim. Këto qasje inkurajojnë, gjithashtu, të mësuarit nga kolegët.

Motivimi

Trajnimi synon të motivojë pjesëmarrësit për të përmirësuar promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në vendin e punës dhe në sistemin e burgjeve të vendit të tyre, në përgjithësi. Pjesëmarrësit duhet të kuptojnë se si një kuptim më i mirë i të drejtave të njeriut në burgje mund të sjellë dobi edhe për punën dhe mjedisin e tyre të punës. Prezantimet dhe ushtrimet praktike mbajnë parasysh pikërisht këtë dhe synojnë të nxisin krenarinë profesionale për punën e oficerëve të burgut. Pjesëmarrësit duhet të përgëzohen për çdo koment dhe kontribut të dobishëm që bëjnë.

Trajnuesit

Ky kurs trajnimi është krijuar për t'u udhëhequr nga tre trajnerë:

- Të paktën një grua dhe një burrë
- Së paku një ekspert për të drejtat e njeriut dhe reformën penale
- Një ekspert vendas me njohuri për sistemin e burgjeve.

Do të ishte ideale që eksperti vendas të jetë nga shërbimi i burgjeve, por të gjithë trajnuesit duhet të kenë njohuri të hollësishme rreth Rregullave të Nelson Mandelës dhe standardeve të tjera ndërkombëtare që lidhen me qëndrimin në burg.

Nëse trajnimi është rajonal, mund të ketë nevojë për ekspertë shtesë vendas. Aty ku është e mundur, duhet të përfshihen trajnerë që e kanë përfunduar kursin e OSBE/PRI-së për Trajnimin e Trajnerëve.

Trajnuesit duhet të vendosin se kush do të drejtojë seancat dhe kush do të bëjë lehtësimin, në varësi të fushave të tyre të ekspertizës dhe duke siguruar drejtpeshimin e ngarkesës së punës. Ndërrimi i prezantuesve kryesorë me njëri-tjetrin shërben për t'i mbajtur pjesëmarrësit të fokusuar dhe u jep mundësi trajnerëve të pushojnë.

Nëse nuk është e mundur të sigurohen tre trajnerë, të shihet mundësia e përfshirjes së pjesëmarrësve në organizimin dhe mbajtjen e disa prej seancave të trajnimit. Kjo i fuqizon pjesëmarrësit dhe u përforcon vetëbesimin si mbrojtës të reformës dhe si trajnerë të mundshëm në të ardhmen.

Pjesëmarrësit

Ky kurs trajnimi është kryesisht për personelin e vijës së parë në burgje. Këtu mund të përfshihen edhe punonjësit në role administrative dhe mbështetëse. Në disa raste, mund të jetë e dobishme të përfshihen edhe punonjësit me funksione mbikëqyrëse. Ky kurs është projektuar për afërsisht 15 deri në 20 pjesëmarrës për të siguruar kohë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha temat dhe për t'u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për t'i aktivizuar plotësisht.

Rekomandohet që pjesëmarrësit të kenë nivele të ndryshme përvojash, detyra dhe specializime sa më të ndryshme, si dhe të jenë nga IEVP të ndryshme. Për shembull, do të ishte me dobi përfshirja e personelit të burgjeve të sigurisë së lartë, të mesme dhe të ulët dhe atyre që punojnë në burgun e vetëm për gratë. Është e rëndësishme që punonjëset gra të kenë akses të barabartë në trajnim - përqindja e grave që ndjekin kursin duhet të pasqyrojë, të paktën, përqindjen e personelit femër brenda shërbimit.

Shënime udhëzuese

Merrni kohë për t'u siguruar që pjesëmarrësit t'i kuptojnë konceptet kryesore.

- Bëjini pjesëmarrësit të ndihen rehat. Kërkoni vullnetarë për çdo detyrë.
- Jini të vetëdijshëm për dinamikën e grupit, veçanërisht nëse në dhomë ka më shumë zyrtarë/mbikëqyrës të lartë.
- Ndiqni strukturën dhe afatet e kurrikulës sa më shumë që të jetë e mundur duke lejuar një shkallë fleksibiliteti.
- Respektoni pikëpamjet e të gjithë pjesëmarrësve dhe lejojini ata të udhëheqin diskutimet – trajnuesit duhet të flasin më pak se pjesëmarrësit.
- Mbajini pjesëmarrësit aktivë. Shumë nga seancat janë krijuar për t'i bërë ata të lëvizin dhe të ndërveprojnë me njëri-tjetrin. Mund të jetë, gjithashtu, e dobishme t'i inkurajoni njerëzit që të ndërrojnë vendet rregullisht gjatë trajnimit në mënyrë që të ulen pranë njerëzve të ndryshëm. Trajnuesi duhet, gjithashtu, të përzgjedhë disa ushtrime 'energizuese' gjatë trajnimit, kur nivelet e energjisë bien.
- Mos lini jashtë vëmendjes nivelin e energjisë dhe pjesëmarrjes dhe bëni pushime kur është e nevojshme. Koha e pushimeve mund të lëvizë.
- Trajnuesi duhet të ketë parasysh se shembujt apo videot specifike nga një vend i caktuar duhen përdorur për të ilustruar një problem që ndeshet në një sërë vendesh.⁵

⁵ Kursi i trajnimit synon të përfshijë një sërë shembujsh nga vende dhe rajone të ndryshme; megjithatë, ai nuk synon t'u referohet të gjitha 57 shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. Edhe pse qëllimi është një qasje gjeografike përfaqësuese, kjo nuk është gjithmonë e mundur të arrihet. Shembujt janë ilustrues dhe jo shterues dhe përdorimi i tyre synon të bashkëndajë informacione rreth sfidave, masave dhe praktikave, dhe jo të shenjojë ndonjë vend të caktuar.

Shënime për përmbajtjen e kursit

COVID-19

Moduli 1 përfshin një diskutim mbi ndikimin e COVID-19 në burgje dhe personelin e burgjeve. Ky modul u jep mundësinë pjesëmarrësve që të flasin në përgjithësi për ndikimin e pandemisë tek ta dhe në punën e tyre. Është e rëndësishme të thuhet se disa burgje u prekën më rëndë se të tjerat dhe, në disa vende, mund të ketë pasur situata të tjera krize që pjesëmarrësit dëshirojnë t'i diskutojnë, të tilla si fatkeqësitë natyrore ose konfliktet. Trajnuesi duhet t'i lehtësojë këto diskutime sa herë është e mundur.

Të paraburgosurit

Moduli 3 përmban një seancë specifike për të paraburgosurit për të theksuar situatën dhe nevojat e tyre të veçanta. Trajnuesi duhet ta bëjë të qartë se shumica e Rregullave të Nelson Mandelës janë njëlojtë të zbatueshme si për të paraburgosurit, ashtu edhe për personat e dënuar me burg.

Grupet e cënueshme/popullsia shumicë në burg

Manuali i trajnimit u referohet në tërësi çështjeve specifike për grupet e cënueshme, të tilla si gratë, të burgosurit e moshuar, personat LGBTI, shtetasit e huaj dhe personat me aftësi të kufizuara. Ndonëse është e rëndësishme të theksohen çështjet me të cilat përballen këto grupe, kjo nuk duhet të sjellë lënien pas dore të situatës së shumicës së popullsisë së burgosur, shpesh të përbërë nga burra të rinj, të cilët mund të jetojnë në kushte më të këqija dhe të përballen me më shumë probleme se grupet e tjera. Manuali e trajton këtë aspekt, por trajnuesi duhet ta sjellë në vëmendje këtë pikë rregullisht gjatë trajnimit.

Është ide e mirë që në fillim të trajnimit të zgjidhen personat përfaqësues nga radhët e pjesëmarrësve për llojet e ndryshme të grupeve vulnerabël të identifikuar në vendin/et e tyre (në varësi të kontekstit). Këta individë mund të mbledhin çështjet që lindin gjatë trajnimit për këto grupe dhe të japin komentet e tyre në momente të ndryshme kohore. Përndryshe, trajnuesit mund të evidentojnë çështjet për çdo grup vulnerabël në momentin kur ato lindin në fletë të bardha të vendosura mur.

Klasifikimi dhe individualizimi

Çdo person në burg ka prejardhjen dhe karakteristikat e veta, dhe çdo popullatë burgu përbëhet nga një grup i ndryshëm njerëzish me nevoja të ndryshme. Njohja e këtij fakti është një nga parimet kyçe të menaxhimit efektiv të burgjeve. Kështu, ndërsa është e rëndësishme të identifikohen nevojat e grupeve të veçanta të të burgosurve, manuali thekson gjithashtu, në të gjitha modulet, nevojën për klasifikimin efektiv dhe planifikimin individual në përputhje me dënimin e çdo të burgosuri. Trajnuesi, gjithashtu, duhet ta përsërisë sa më shpesh këtë parim. Megjithatë, trajnuesit duhet të jenë të vetëdijshëm se shumë vende nuk kanë mjetet e duhura për vlerësimin e rrezikut/nevojave ose planifikimin e vuajtjes së dënimit për cdo të burgosur, prandaj duhet t'i përshtatin mesazhet e tyre në përputhje me rrethanat.

Përshtatja e kurrikulës

Manuali pranon se, në praktikë, kërkesat për trajnim janë të ndryshme nga një vend në tjetrin, në varësi të njohurive dhe përvojës ekzistuese të pjesëmarrësve dhe dinamikës së grupit. Nevojat për trajnim dhe përvojat e pjesëmarrësve ndryshojnë, gjithashtu, sipas kontekstit kulturor, historik, social dhe ekonomik. Kjo do të thotë se kohëzgjatja e seancave të ndryshme, po ashtu, mund të ndryshojë.

Orari mund të ketë nevojë të përshtatet me orarin e punës të vendit (p.sh., nëse dita e punës zakonisht fillon më herët), ose me kohët e lutjes apo me festat fetare. Trajnuesit duhet të përcaktojnë mënyrën më të mirë për të organizuar kursin e trajnimit në çdo vend; për shembull, në disa vende mund të jetë më e lehtë për të zhvilluar trajnimin një ditë në javë për disa javë.

Materialet e trajnimit janë krijuar për të qenë fleksibël. Ka më shumë material dhe më shumë ushtrime sesa mund të mbulohen me kohën në dispozicion. Disa seksione janë dhënë si jo të detyrueshme, në varësi të rëndësisë së tyre dhe kohës në dispozicion. Për të pasqyruar ndryshimet e mundshme në dinamikën e grupit, janë dhënë opsione të ndryshme për ushtrimet/ videot në grup për disa nga ushtrimet praktike. Trajnuesit mund të zgjedhin atë që funksionon më mirë në një kontekst të veçantë trajnimi.

Edhe pse trajnuesit inkurajohen të përdorin gjykimin dhe maturinë e tyre kur përshtatin kurrikulën për kontekstin lokal, por edhe për një seancë të veçantë trajnimi, ata duhet t'i përmbahen sa më shumë që të jetë e mundur kurrikulës. Disa seanca mund të kenë nevojë për shkurtim ose përshtatje, por trajnuesit nuk duhet të devijojnë nga mesazhet kryesore të secilit modul. Trajnuesit duhet të theksojnë qartë rregullat përkatëse dhe parimet kryesore për çdo seksion dhe t'u kthehen detajeve specifike të këtyre rregullave/parimeve kryesore gjatë diskutimeve për t'u siguruar që ato të respektohen gjatë gjithë kohës.

Përkthimi/interpretimi

Ky manual trajnimi është i disponueshëm në anglisht dhe rusisht. Aty ku është e mundur, materialet mbështetëse janë tashmë të disponueshme në shumë gjuhë, por disa do të kenë nevojë për përkthim përpara kursit të trajnimit, ose mund të kërkohen shërbime përkthimi gjatë zhvillimit të kursit.

Materialet

Faqet në PowerPoint

Për të shoqëruar këtë kurs trajnimi në gjuhët angleze dhe ruse, ofrohet një grup i dedikuar slajdesh në PowerPoint të cilat mund të përkthehen sipas nevojës. Trajnuesi mund t'i përdorë slajdet sipas dëshirës, në varësi të dinamikës së grupit. Manuali tregon se ku mund të paraqiten slajdet ose ku mund të përdoren për të siguruar një diskutim sa më dinamik në grup. Trajnuesit duhet të kenë një telekomandë për faqet në PowerPoint në mënyrë që ata të mund të lëvizin lirshëm nëpër dhomë.

Materialet për afishim dhe shpërndarje

Modulet përmbajnë materiale që duhen ekspozuar (në mure) ose shpërndarë. Për çdo modul, duhet të ketë printime të mjaftueshme për t'i vendosur në paketat e trajnimit të pjesëmarrësve, ose për t'i ekspozuar në sallën e trajnimit. Çdo faqe e printuar duhet të ketë të shënuar qartë në krye të faqes modulin dhe numrin e ushtrimit.

Materialet video

Kursi i trajnimit përfshin disa video. Trajnuesit duhet të sigurohen që të kenë në dispozicion pajisje audio-vizuale në gjendje pune për të shmangur çdo vonesë. Trajnuesit duhet të familjarizohen me videot përpara se të fillojnë trajnimin.

Përgatitja

Mjedisi i trajnimit

Kur zgjedhin një mjedis për trajnimin, trajnuesit duhet të marrin në konsideratë që hapësirat që t'i lejojnë njerëzit të lëvizin dhe ku është e mundur që letrat dhe tabelat të ngjiten lehtësisht në mure, në mënyrë që pjesëmarrësit të mund të ecin përreth për t'i parë e riparë. Aty ku është e mundur, rekomandohet edhe sigurimi i dhomave të tjera për ushtrime në grupe të vogla.

Vendosja e karrigeve duhet të nxisë pjesëmarrjen, për shembull, duke i vendosur tavolinat në formë gjysmërrethi ose U-je. Kjo duhet të merret parasysh kur zgjidhni dhomën/at e trajnimit. Të gjithë pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje të dëgjojnë dhe të shohin qartë. Parapëlqehen sallat me dritë natyrale dhe dritare që mund të hapen për shkak se shtojnë humorin, energjinë dhe nivelin e vëmendjes së pjesëmarrësve.

Informacioni për pjesëmarrësit

Trajnuesit duhet të njihen me informacionin për pjesëmarrësit përpara kursit, përfshirë numrin e pjesëmarrësve që do të jenë të pranishëm. Ky informacion mund të mblidhet nëpërmjet një pyetësoi që administrohet si pjesë e vlerësimit të para-trajnimit (shih më poshtë). Informacioni mund të përfshijë:

- Emrin dhe mbiemrin
- Gjininë
- Titullin dhe gradën, duke përfshirë detajet e çdo funksioni mbikëqyrës
- Emrin, llojin dhe vendndodhja e burgut ku janë të punësuar
- Vjetërsinë në shërbim
- Detaje për çdo specializim
- Kurset e mëparshme të trajnimit që kanë përfunduar
- Çështjet për të cilat kanë interes të mësojnë më shumë

Vlerësimi përpara trajnimit

Para fillimit të kursit, trajnuesit duhet të kryejnë një vlerësim të njohurive bazë përpara trajnimit. Këtë detyrë trajnuesit mund ta kryejnë nga vendi i tyre i punës bazuar në informacionet e dhëna nga zyrat e OSBE-së dhe/ose organizatat partnere në vend. Trajnuesit duhet të kërkojnë informacion mbi:

- Numrin e objekteve të burgjeve në vend, të ndara sipas llojit të objektit (p.sh., për gra, fëmijë, paraburgim, nivel sigurie etj.)
- Kapacitetet e çdo burgu dhe popullsinë totale të burgjeve, të ndara aty ku është e mundur (sipas gjinisë, moshës, përkatësisë etnike; sipas rastit, shtetasve/të huajve ose kategorive të tjera përkatëse) dhe statistikën për çdo institucion
- Raportin e personelit të burgut ndaj të burgosurve
- Kopje të ligjit të burgjeve dhe ligjeve dhe rregulloreve të tjera përkatëse
- Strukturën organizative të shërbimit të burgjeve
- Kushtet bazë të burgjeve dhe çështjet që kanë më shumë gjasa të dalin si fusha problematike
- Shqetësimet kryesore të të drejtave të njeriut apo çështje të tjera shqetësuese që lidhen me shërbimin e burgjeve

Vlerësimi para trajnimit duhet, gjithashtu, të sigurojë informacione specifike për secilin modul, si p.sh.

- Llojet e organeve të monitorimit të brendshëm/të jashtëm, përfshirë ato që janë pjesë e Mekanizmit Parandalues Kombëtar (MKP) dhe organe të tjera
- Niveli i ofrimit të kujdesit shëndetësor në burgje
- Masat e marra për COVID-19 në burgje dhe çdo shqetësim lidhur me të drejtat e njeriut
- Informacion mbi sistemet për trajtimin e kërkesave/ankesave të të burgosurve dhe të dhënat e fundit
- Sistemet dhe dokumentet e klasifikimit (formularët e pranimit, formularët e vlerësimit të rrezikut dhe nevojave, modele të dosjeve të të burgosurve)
- Llojet e armëve dhe mjeteve të kufizimit fizik që përdoren në burgje
- Llojet e masave disiplinore të përdorura në një institucion/vend të caktuar
- Mënyrën e organizimit të vizitave (duke ditur që kjo mund të jetë e ndryshme nga një objekt në tjetrin)

Nga trajnuesit nuk pritet që të gjithë të bëhen ekspertë për sistemin e burgjeve të një vendi të caktuar: duhet të ketë trajnerë lokalë të njohur tashmë me sistemin e burgjeve dhe fokusi duhet të jetë në standardet ndërkombëtare, jo në përvojat lokale. Megjithatë, do të jetë e dobishme për trajnuesit që të kenë në dispozicion disa informacione bazë përpara fillimit të kursit, në mënyrë që ata të mund të parashikojnë dhe të përgatiten për pyetjet që mund të lindin.

Nëse vlerësimi i para-trajnimit ose pyetësorët nxjerrin ndonjë çështje të rëndësishme, ODIHR-i dhe trajnuesit mund të vendosin të bëjnë rregullime në kurrikulë. Megjithatë, në këtë fazë nuk duhet të ketë ndryshime të rëndësishme. Disa tema mund të jenë më të rëndësishme dhe kërkojnë më shumë kohë, por trajnimi duhet të mbulojë të gjitha modulet. Pjesëmarrësit duhet të njihen me të gjitha aspektet e Rregullave të Nelson Mandelës, edhe me ato që mund të jenë më pak të rëndësishme në burgun e tyre.

Terminologjia

Aty ku është e mundur, trajnuesit dhe përkthyesit duhet të shmangin përdorimin e fjalës ‘i burgosur’. Në vend të kësaj, ata mund t’u referohen ‘njerëzve në burg’. Kur përshkruhen grupe ose individë të veçantë, është më mirë të flasim për njerëzit (p.sh., gra, të rinj, të moshuar, njerëz me probleme të shëndetit mendor etj.) pa iu referuar statusit të tyre si ‘të burgosur’. Kjo do t’i ndihmojë pjesëmarrësit të mendojnë për karakteristikat individuale dhe nevojat e njerëzve me të cilët punojnë.

Trajnuesit duhet, gjithashtu, të kenë parasysh se shumë njerëz në burg nuk janë dënuar ende për një vepër penale. Prandaj, përveç rasteve kur u referohen në mënyrë specifike personave të dënuar, ata mund të flasin për ‘njerëz të akuzuar’, ‘autorë të dyshuar’ ose ‘të paraburgosur’.

Përgjigjet ndaj pyetjeve të vështira dhe diskutimet

Fushat ku trajnuesit mund të kenë nevojë për udhëzime të mëtijshme janë vënë në dukje në të gjithë kurrikulën. Të gjitha udhëzimet shtesë janë shënuar qartazi me fontin në ngjyrë vjollcë dhe me një shigjetë për t’i ndihmuar trajnuesit në përgjigjet ndaj pyetjeve të ndërlikuara. Pjesëmarrësit mund të kenë idetë dhe sugjerimet e tyre për të dhënë, por trajnuesit duhet t’u referohen gjithmonë standardeve ndërkombëtare kur u përgjigjen pyetjeve ose zgjidhin dallimet në këndvështrime. Nëse lindin çështje që trajnuesit nuk ndihen të aftë t’u përgjigjen aty për aty, mund të thonë se do t’u duhet të rishikojnë udhëzimin dhe do të japin përgjigje ditën tjetër.

Në çdo mjedis trajnimi duhet të ketë një kënd për të shënuar çdo pikë të diskutueshme, diskutimet e zgjatura ose pyetjet e ndërlikuara. Këto pika mund të diskutohen më vonë/ gjatë pushimeve për kafe ose, në pamundësi, ato mund të përfshihen në raportin që do përmbledhë opinionet e pjesëmarrësve rreth trajnimit.

Trajnuesit duhet të ndërhyjnë nëse diskutimet nxehen, ose kur ka komente të papërshtatshme, duke u përpjekur të mos shënjestrojnë njerëz të veçantë. Në këto situata, është e rëndësishme t’i kujtoni grupit rregullat bazë të dakordësuara në fillim të kursit të trajnimit.

Përgatitja e rekomanduar për pjesëmarrësit

Të paktën dy javë përpara kursit të trajnimit, pjesëmarrësit duhet të marrin një kopje të agjendës 4-ditore (me kohën e fillimit dhe mbarimit të çdo seance) me adresat në internet të dokumenteve përkatëse, si dhe informacione të tjera praktike (p.sh., informacione për vendin/udhëtimet/hartat). Pjesëmarrësit duhet, gjithashtu, të njihen paraprakisht me Rregullat e Nelson Mandelës dhe Rregullat e Bangkokut.

Në ditën e parë të trajnimit, pjesëmarrësit do të marrin një paketë materiale, duke përfshirë kopje të Rregullave të Nelson Mandelës, Rregullave të Bangkokut, materiale burimore për trajnimin dhe botime të tjera të PRI-së dhe ODIHR-it.

Ky trajnim shërben si plotësues i kursit të të mësuarit elektronik të UNODC-së mbi Rregullat e Nelson Mandelës. Disa nga modulet mësimore të UNODC-së janë të përfshira në kurs, por pjesëmarrësit do të inkurajohen të përfundojnë një pjesë ose të gjithë kursin e mësimit elektronik të UNODC-së. Nëse kjo nuk është e mundur, do t'u kërkohet pjesëmarrësve të përfundojnë kursin e plotë të mësimit elektronik të UNODC-së brenda 3 muajve nga përfundimi i trajnimit dhe do t'u kërkohet të japin opinionet e tyre.

Kodi i veshjes

Pjesëmarrësit duhet të këshillohen paraprakisht se në trajnim duhet të jenë me veshje civile. Qëndrimi në mjediset e trajnimit duhet të jetë i lirshëm pavarësisht gradave dhe të gjithë pjesëmarrësit duhet të ndihen të mirëpritur të shprehin mendimet e tyre.

Pijet freskuese

Çdo ditë në fillim të kursit, në momentin e ardhjes së pjesëmarrësve dhe në pushime duhet të ofrohet kafe/çaj/ pije joalkoolike dhe pije të tjera freskuese.

Opinionet dhe vlerësimi

Pjesëmarrësve do t'u shpërndahet një pyetësor para trajnimit për të shënuar pritshmëritë e tyre nga kursi dhe për të identifikuar fushat e Rregullave të Nelson Mandelës për të cilat ata do të donin të mësonin më shumë. Kjo është pjesë e vlerësimit para trajnimit. Pjesëmarrësit duhet të mbajnë një kopje dhe ta sjellin me vete në kurs, pasi do t'i referohen në Ditën 1.

Në fund të kursit, pjesëmarrësit do të plotësojnë formularët për opinionet e tyre, komentet mbi rëndësinë, cilësinë dhe zhvillimin e trajnimit, dhe sa dhe si u përmbushën pritshmëritë e tyre. Të dy formularët mund të plotësohen në mënyrë anonime.

Gjashtë muaj pas përfundimit të kursit të trajnimit, pjesëmarrësit duhet të plotësojnë një formular vlerësimi. Ata do të vlerësojnë shkallën në të cilën kanë qenë në gjendje të zbatojnë në vendin e punës ato që mësuan në trajnim, sfidat me të cilën janë përballur dhe rezultatet pozitive.

Pyetësori i para-trajnimit dhe formularët e vlerësimit mund të gjenden në anekse.

Si ta përdorim Manualin

Çdo modul ndjek një strukturë të ngjashme:

- Lista e materialeve për pjesëmarrësit
- Hyrje dhe objektivat mësimore
- Përmbajtja, përfshirë materialet për prezantim, ushtrime individuale dhe në grup (USHTRIME), informacion për trajnuesit (me shigjetë vjollcë dhe me font vjollcë) dhe materiale shtesë (OPSIONALE)
- Burime të mëtejshme

Çdo modul është i ndarë në seanca. Oraret jepen në fillim të çdo seance së bashku me oraret e propozuara për “elementet” individuale në margjinën e majtë.

Rregullat përkatëse të marra nga rregullat e Nelson Mandelës janë shënuar në margjina. P.sh., **NMR 58-66**. Rregullat e marra nga Rregullat e Bangkok-ut po ashtu janë shënuar në margjina. P.sh., **BKK 26-28**.

Materialet ose aktivitetet shtesë shënohen qartë se janë për përdorim nëse e lejon koha dhe nëse janë të rëndësishme në një kontekst të caktuar. I gjithë materiali tjetër duhet të konsiderohet si material/aktivitete ‘të detyrueshme’.

PROGRAMI 4-DITOR

Oraret tregojnë se sa duhet të zgjasë çdo modul dhe çdo seancë brenda një moduli, në mënyrë që të sigurohet që trajnuesit të mbulojnë të gjitha modulet. Orari i mëposhtëm është marrë nga trajnimi pilot (4-ditor) në Suedi, por orët do të duhet të përshtaten me realitetet e secilit kurs dhe mund të kenë nevojë të ndryshohen edhe gjatë zhvillimit të kursit.

DITA 1	SEANCA E HYRJES
13:30–14:00	Regjistrimi
14:00–14:15	Hyrje në kursin e trajnimit
14:15–14:45	Pritshmëritë nga kursi
14:45–15:15	Njohja me përvojat e njëri-tjetrit – COVID-19
15:15–15:35	Pushimi i kafes
MODULI 1	RREGULLAT E NELSON MANDELËS
15:35–15:45	Hyrja dhe objektivat mësimore
15:45–16:30	1.1 Historiku dhe hyrja në Rregullat e Nelson Mandelës
16:30–17:00	1.2 Rregullat e Nelson Mandelës – Parimet bazë
17:00–17:15	Përmbyllje/Opinione nga pjesëmarrësit

DITA 2	
8:15–8:30	Mirë se ardhja dhe përmbledhja e ditës së mëparshme
MODULI 1 vazhd.	RREGULLAT E NELSON MANDELËS
8:30–9:00	1.3 Fushat tematike që mbulohen nga rregullat e Nelson Mandelës
9:00–9:30	1.4 Roli i punonjësve të burgjeve
9:30–10:10	1.5 Grupe të veçanta njerëzish në burgje
10:10–10:30	Pushim për kafe
MODULI 2	TË BURGOSURIT DHE KUSHTET NË BURGJE
10:30–10:40	Hyrja dhe objektivat mësimore
10:40–11:30	2.1 Cilët janë në burg?
11:30–12:10	2.2 Ndarja e kategorive
12:10–13:10	Dreka
MODULI 2 vazhd.	TË BURGOSURIT DHE KUSHTET NË BURGJE
13:10–14:25	2.3 Kushtet në burgje dhe shërbimet bazë
14:25–15:10	Hyrje në sigurinë dinamike
15:10–15:30	Pushim për kafe
MODULI 3	ORGANIZIMI DHE ADMINISTRATA E BURGJEVE
15:30–15:40	Hyrja dhe objektivat mësimore
15:40–16:50	3.1 Proceset e pranimit, klasifikimi, vlerësimi i riskut dhe nevojave
16:50–17:10	Përmbledhje/Opinione nga pjesëmarrësit

DITA 3

8:15-8:30	Mirë se ardhja dhe përmbledhja e ditës së mëparshme
MODULI 3 vazhd. ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I TË BURGOSURVE	
8:30-9:10	3.2 Shpërndarja e të burgosurve dhe ndarja e kategorive
9:10-10:10	3.3 Transferimet e të burgosurve
10:10-10:30	Pushim kafeje
10:30-11:10	3.4 Menaxhimi i dosjes së të burgosurit
11:10-11:40	3.5 Të paraburgosurit
11:40-12:40	Drekë
MODULI 4 MASAT MBROJTËSE	
12:40-12:50	Hyrje dhe objektivat mësimore
12:50-13:50	4.1 Qasja në informacion
13:50-15:20	4.2 Kërkesat dhe ankesat
15:20-15:50	Pushim kafeje
15:50-16:30	4.3 Kontaktet me botën e jashtme
16:30-16:55	4.4 Inspektimet dhe monitorimet
16:55-17:15	Përmbledhje/Opinione nga pjesëmarrësit

DITA 4	
8:15–8:30	Mirë se ardhja dhe përmbledhja e ditës së mëparshme
MODULI 4 vazhd.	MASAT MBROJTËSE
8:30–9:15	4.4 Inspektimet dhe monitorimi (vazhdim)
MODULI 5	PARANDALIMI DHE KUNDËRVEPRIMI NDAJ INCIDENTEVE
9:15–9:25	Hyrje dhe objektivat mësimore
9:25–9:55	5.1 Siguria fizike, procedurale dhe dinamike
9:55–10:15	Pushim kafeje
10:15–10:55	5.2 Zgjidhja e konflikteve
10:55–12:00	5.3 Kontrollat
12:00–13:00	Dreka
13:10–14:10	5.4 Përdorimi i forcës, armëve dhe mjeteve të kufizimit fizik
14:10–14:20	5.5 Hetimet
MODULE 6	KUFIZIMET, DISIPLINA DHE SANKSIONET
14:20–14:40	Hyrja dhe objektivat mësimore
14:40–15:05	6.1 Sanksionet dhe procedurat disiplinore
15:05–15:25	Pushim kafeje
15:25–16:05	6.1 (vazhd.) Sanksionet dhe procedurat disiplinore
16:05–16:50	6.2 Izolimi
16:50–17:10	Përmbledhje/Opinione nga pjesëmarrësit

DITA 5

8:15-8:30	Mirë se ardhja dhe përmbledhja e ditës së mëparshme
-----------	---

MODULI 7**KUJDESI SHËNDETËSOR**

8:30-8:40	Hyrja dhe objektivat mësimore
-----------	-------------------------------

8:40-9:40	7.1 Kujdesi shëndetësor në burgje
-----------	-----------------------------------

9:40-10:25	7.2 Shëndeti mendor i të burgosurit
------------	-------------------------------------

10:25-10:45	Pushim kafeje
-------------	---------------

MODULI 8**REHABILITIMI DHE PËRGATITJA E TË BURGOSURIT PËR LIRIMIN**

10:45-10:55	Hyrja dhe objektivat mësimore
-------------	-------------------------------

10:55-11:30	8.1 Aktivitetet, trajnimi, arsimi dhe puna e të burgosurit
-------------	--

11:30-12:00	8.2 Përgatitja për lirin dhe mbështetja pas lirit
-------------	---

12:00-12:45	Përmbllja dhe përfundimet
-------------	---------------------------

Nëse koha e lejon, mund të jetë e dobishme të organizohet një ekskursion gjysmëditor në natyrë, ose të paktën një aktivitet në mbrëmje për të gjithë pjesëmarrësit.

Në fillim të çdo seance në mëngjes dhe pasdite, pjesëmarrësve duhet t'u kërkohet të mendojnë për rregullën e tyre të preferuar nga seanca e mëparshme; një ose dy njerëz duhet të lexojnë rregullën e tyre të preferuar dhe të shpjegojnë pse.

Regjistrimi

Pjesëmarrësit duhet të mbërrijnë në kohë në mënyrë që të regjistrohen dhe të marrin paketat e tyre me materiale.

HYRJE NË KURSIN E TRAJNIMIT

- MATERIALET**
- Agjenda e trajnimit
 - Stilolaps dhe bllok
 - Rregullat bazë
 - Lista shitesë e leximeve/burimeve: COVID-19

15 MINUTA Në këtë periudhë, do të prezantohen trajnuesit dhe personeli tjetër mbështetës si dhe përkthyesit. Urojuni mirëseardhjen pjesëmarrësve dhe shpjegoni kontekstin e trajnimit dhe rolin e ODIHR-it, PRI-së, SPPS-së dhe UNODC-ut.

Gjatë kësaj hyrjeje, trajnuesit duhet, gjithashtu, të japin informacion praktik mbi organizimin e kursit. Këtu duhet të përfshihen:

- Procedurat e evakuimit emergjent
- Vendndodhja e tualeteve
- Vendi ku gjendet uji dhe pijet e tjera freskuese
- Vendi i drekës
- Ambientet e interpretimit
- Çdo informacion tjetër të nevojshëm

Trajnuesit duhet të shpjegojnë objektivat e përgjithshme të kursit dhe të përmbledhin parimet kryesore të metodologjisë siç janë përcaktuar më sipër: zhvillimi i njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe sjelljeve, mbështetur në përvojën e punës, në mënyrë ndërvepruese dhe motivuese. Pjesëmarrësit duhet të inkurajohen të marrin pjesë në mënyrë aktive që në fillim dhe të bëjnë pyetje, nëse diçka është e paqartë.

30 MINUTA **Pritshmëritë nga kursi**

Rregullat bazë

Trajnuesi mund të prezantojë rregullat bazë të kursit, ose të kërkojë nga pjesëmarrësit sugjerimet e tyre për rregullat bazë. Duhet të bëhet e qartë se këto vlejnë si për trajnuesit ashtu edhe për pjesëmarrësit.

Rregullat bazë duhet të përfshijnë:

- Të qenit të përpiktë
- Telefonat celularë pa zile
- Të gjithë inkurajohen të marrin pjesë
- Dëgjoni dhe respektoni pikëpamjet e njëri-tjetrit
- Mos ndërprisni kolegët që janë duke folur
- Drejtojuni njëri-tjetrit me gjuhë të sjellshme
- Respektoni traditat, besimet dhe vlerat kulturore dhe fetare të njëri-tjetrit

Pritshmëritë e pjesëmarrësve

USHTRIM Shkrija e akullit

Kërkojini secilit pjesëmarrës të shënojë në mënyrë anonime tri gjëra që i pëlqejnë në punën e vet, tri gjëra që i duken të vështira dhe tri gjëra për të cilat do të donin të mësonin më shumë gjatë kursit (pritsmëritë). Ata mund t'i referohen pyetësorit të para-trajnimit ose të zgjedhin diçka të ndryshme.

Tregojuni pjesëmarrësve se trajnuesi do të mbledhë listat e shkruara të pritshmërive në fund të ushtrimit për t'i përdorur për vlerësimin e kursit.

Kërkojuni pjesëmarrësve të qarkullojnë nëpër dhomë për t'u njohur me të tjerët, duke thënë emrin, burgun/institucionin ku punojnë dhe pozicionin e tyre. Qëllimi është që çdo pjesëmarrës të prezantohet me gjithë të tjerët.

Herë pas here përplasni duart. Me këtë sinjal, pjesëmarrësit duhet t'i drejtohen personit/njerëzve afër tyre. Ata duhet të prezantojnë veten dhe të ndajnë një nga gjërat e mëposhtme: diçka që u pëlqen në punën e tyre, diçka që e kanë të vështirë ose diçka për të cilën dëshirojnë të mësojnë më shumë.

Ky ushtrim është krijuar për të ndarë pritshmëritë për kursin, por është gjithashtu një mënyrë e dobishme që pjesëmarrësit të njihen me njëri-tjetrin. Ata tashmë kanë pasur mundësinë të shkruajnë pritshmëritë e tyre në pyetësorin e para-trajnimit.

Ky ushtrim mund të kryhet edhe me muzikë, ku pjesëmarrësve u kërkohet të ndalojnë dhe të vazhdojnë prezantimin kur muzika pushon. Trajnuesit, gjithashtu, duhet të marrin pjesë në këtë ushtrim në mënyrë që pjesëmarrësit të mund t'i njohin edhe ata.

Objektivat e përgjithshme të kursit

Objektivat mësimore

Kursi është një hyrje në Rregullat e Nelson Mandelës. Pas përfundimit të kursit, pjesëmarrësit do të:

- Kuptojnë pse Rregullat e Nelson Mandelës dhe standardet e tjera ndërkombëtare që rregullojnë trajtimin e të burgosurve janë të rëndësishme dhe pse personeli i burgut është kyçi i zbatimit të suksesshëm;
- Vlerësojnë pse respektimi i Rregullave është i dobishëm për personelin e burgjeve, sistemet e burgjeve dhe shoqërinë në tërësi, si dhe për njerëzit në burg dhe familjet e tyre;
- Njihen me të gjitha fushat tematike të mbuluara nga Rregullat, përfshirë edhe grupet e veçanta të njerëzve në burg;
- Identifikojnë mënyrat në të cilat sistemet e burgjeve në vendin e tyre, ose në objektet e veçanta, nuk përputhen me Rregullat e Nelson Mandelës dhe kuptojnë se çfarë duhet bërë për ta korrigjuar këtë;

- Përshtatin qëndrimet dhe sjelljet e tyre për t'iu përgjigjur më mirë të drejtave dhe nevojave njerëzore të njerëzve në burg;
- Sensibilizohen dhe do t'u përgjigjen situatave dhe nevojave të individëve në burg; dhe
- Pajisen me njohuri praktike për të zbatuar Rregullat në objektet e tyre dhe për të nxitur të tjerët që të bëjnë të njëjtën gjë.

Pjesëmarrja në këtë kurs trajnimi do të ndihmojë sistemin e burgjeve t'u përmbahet Rregullave të Nelson Mandelës. Nga ana tjetër, kjo do të:

- Ndihmojë në mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të të gjithë njerëzve në burg;
- Minimizojë dallimet ndërmjet jetës në burg dhe jetës në liri;
- Krijojë një mjedis pune më të sigurt dhe më pozitiv për personelin e burgjeve dhe mundësojë marrëdhënie më të mira midis personelit dhe të burgosurve;
- Lehtësojë rehabilitimin dhe riintegrimin e të burgosurve, do të mbrojë shoqërinë nga krimi dhe do të ulë nivelin e recidivizmit;
- Rrisë besimin e publikut në drejtësinë dhe efektivitetin e sistemit të burgjeve; dhe
- Do të përmirësojë perceptimin publik për sistemin e burgjeve, personelin e burgjeve dhe njerëzit në burg, duke iu kundërvënë stereotipive.

USHTRIM
30 MINUTA

Ndarja e përvojave – COVID-19

Ndani pjesëmarrësit në grupe më të vogla me 4-5 persona dhe kërkojuni të diskutojnë:

- Fushat e punës së tyre më të prekura nga COVID-19
- Si ka ndikuar puna e tyre në burgje gjatë COVID-19 tek ata dhe familjet e tyre
- Ndikimi i COVID-19 tek njerëzit që mbahen në objektin e tyre

Pas diskutimit, kërkon nga secili grup të bëjë një prezantim të shkurtër për të gjithë pjesëmarrësit.

→ Ky ushtrim i lejon personelit të ndajë përvojat për COVID-19 në burgjet e tyre dhe të njihen më mirë me njëri-tjetrin. Ky ushtrim ofron mundësi për një diskutim më të përgjithshëm se si COVID-19 ndikoi tek ata dhe në punën e tyre, dhe për t'i ndihmuar të kuptojnë pse promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut është kritike në kohë krizash. Ushtrimi, gjithashtu, ndihmon trajnuesit të identifikojnë shqetësimet e mundshme për të drejtat e njeriut që lindën nga reagimi ndaj COV-ID-19 në vende/burgje specifike.

BURIME SHITESË COVID-19 dhe burgjet**Reforma Penale Ndërkombëtare (PRI)**

Raporti i PRI-së: Coronavirusi: Parandalimi i dëmtimit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut në sistemin penal të drejtësisë (korrik 2020)

Shënim informues i PRI-së: Coronavirusi: Kujdesi shëndetësor dhe të drejtat e njeriut të personave të burgosur (Mars 2020)

Raporti i PRI-së: Trendet Globale të Burgjeve 2021

Raporti i PRI-së: Qeverisja e mirë në kohë krize

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh)


Përgatitja, parandalimi dhe kontrolli i COVID-19 në burgje dhe vende të tjera të paraburgimit: Udhëzim i Ndërmjetëm (shkurt 2021)

Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC)

Shënim udhëzues për COVID-19: Masat e parandalimit dhe kontrollit të infeksionit në burgje (2021)

Shënim udhëzues për COVID-19: Lirimet emergjente të të burgosurve (2021)

Parandalimi dhe kontrolli i COVID-19 midis njerëzve që punojnë në burg (Prill 2020)



MODULI 1

RREGULLAT E NELSON MANDELËS

1 RREGULLAT E NELSON MANDELËS

MATERIALET

- Kopje e Rregullave të Nelson Mandelës
- Publikimi i PRI-së – Udhëzues i shkurtër për Rregullat e Nelson Mandelës (NMR)
- Kopje e Rregullave të Bangkokut
- Publikimi i PRI-së – Udhëzues i shkurtër për Rregullat e Bangkokut (BKK)
- Kopje e Rregullave të Havanës
- Kopje e Konventës kundër Torturës
- Slajdet 5–15 të Prezantimit në PowerPoint të printuara
- Ngjithës/stilolapsa me ngjyra (2 ngjyra)
- Dy kopje të listës së fushave tematike që trajtohen nga Rregullat e Nelson Mandela (shih seksionin 1.3)
- Lista e burimeve të mëtejshme

10 MINUTA **HYRJE**

Ky modul i njeh pjesëmarrësit e kursit me Rregullat e Nelson Mandelës, duke theksuar parimet themelore që duhet të zbatohen në të gjitha fushat e trajtimit të njerëzve në burg dhe menaxhimit të burgjeve. Moduli vazhdon me përvijimin e fushave kryesore tematike që mbulohen nga Rregullat e Nelson Mandelës dhe më pas diskuton kategori të veçanta të të burgosurve. Ai gjithashtu prezanton standarde të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë ato që zbatohen për grupe të veçanta njerëzish në burg, si gratë dhe fëmijët.

OBJEKTIVAT MËSIMORE

Pas përfundimit të Modullit 1, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë kontekstin dhe qëllimin e Rregullave të Nelson Mandelës, duke përfshirë arsyen e përditësimit dhe standardet e tjera ndërkombëtare që lidhen me to;
- Kuptojnë parimet që qëndrojnë në themel të Rregullave të Nelson Mandelës dhe rolin e personelit të burgut për të siguruar që këto parime të zbatohen në të gjitha aspektet e menaxhimit të burgut;
- Identifikojnë temat kryesore të mbuluara nga Rregullat e Nelson Mandelës – këto tema do të trajtohen më në detaje në modulet vijuese;
- Kuptojnë se si rregullat e Nelson Mandelës zbatohen në detyrën specifike që ata kryejnë dhe se si të identifikojnë boshllëqet në zbatim; dhe
- Diskutojnë nevojat e ndryshme të kategorive të veçanta të njerëzve në burg dhe grupeve të cënueshme.

➔ Pas prezantimit të objektivave, është mirë të zhvilloni një seancë aktive. Kjo seancë prezanton parimet themelore të Rregullave të Nelson Mandelës në fillim të kursit dhe ndihmon për të identifikuar çdo fushë problematike që në krye të herës. Secili prej këtyre parimeve bazë, bashkë me udhëzimet përkatëse, (shih më poshtë) duhet të printohet dhe të afishohet në një vend të dukshëm në sallën e trajnimit.

USHTRIM Kërkojuni pjesëmarrësve të caktuar të shkojnë te parimet specifike, të prezantojnë veten (emri, shteti, pozicioni në shërbimin e burgut) dhe me zë të lartë të lexojnë parimin. Shtoni më shumë detaje rreth kuptimit të parimeve në praktikë, nëse janë të dobishme.

➔ Pjesëmarrësit mund të ndiejnë dhe të vënë në dukje gjatë trajnimit se Rregullat e Nelson Mandelës përmbajnë pika dhe parime të cilat janë 'të vetëkuptueshme' ose 'dihen nga të gjithë.' Gjatë diskutimeve për secilën fushë tematike, gjatë gjithë kursit, përsëritni se, megjithëse Rregullat duken 'të vetëkuptueshme', ato nuk janë gjithmonë aq të thjeshta për t'u zbatuar në praktikë.

12 Parimet udhëzuese të Rregullave të Nelson Mandelës

NMR: 1 **1. Të gjithë të burgosurit duhet të trajtohen me respekt për shkak të dinjitetit dhe vlerës së brendshme si qenie njerëzore.**

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- “Të gjitha qeniet njerëzore lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta” (Neni 1 – DUDNJ).
- Njerëzit në burg janë qenie njerëzore, meritojnë jo më pak respekt dhe nuk kanë më pak dinjitet dhe vlerë se çdo qenie tjetër njerëzore, pavarësisht nga krimi që mund të kenë kryer.
- Po kështu, punonjësit e burgjeve janë qenie njerëzore.
- Dinjiteti nuk është diçka që e fitojmë gjatë gjithë jetës sonë. Është diçka me të cilin lindim të gjithë. Duke qenë njerëz, ne të gjithë meritojmë respekt, pavarësisht nga mosha, gjinia, klasa, 'raca', feja, aftësitë ose ndonjë faktor tjetër përveç të qenit njerëz.
- Për të mbrojtur dinjitetin e njerëzve në burg, autoritetet duhet të sigurojnë kushtet minimale të përcaktuara në rregullat e Nelson Mandelës.

NMR: 1 **2. Asnjë i burgosur nuk do t'i nënshtrohet torturave dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese dhe të gjithë të burgosurit do të mbrohen prej tyre.**

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Tortura dhe keqtrajtimi janë gjithmonë të paligjshme dhe nuk mund të justifikohen kurrë.
- Autoritetet e burgjeve duhet të bëjnë gjithçka që kanë mundësi për t'i parandaluar ato dhe kushdo që i kryen duhet të ndëshkohet.
- Torturë është çdo veprim me të cilin shkaktohet qëllimisht dhimbje ose vuajtje e rëndë, qoftë fizike apo mendore. Kushtet e paraburgimit, ose keqtrajtime të tjera, mund të përbëjnë torturë

NMR 1 **3. Në çdo kohë duhet të garantohet siguria dhe mbrojtja e të burgosurve, personelit, ofruesve të shërbimeve dhe vizitorëve.**

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Çdo aspekt i menaxhimit të burgut duhet të ketë si prioritet sigurinë dhe mbrojtjen e gjithkujt në institucion.
- Këtu përfshihet sigurimi i shëndetit fizik dhe mendor i të gjithëve.
- Shembujt përfshijnë marrjen në konsideratë të rreziqeve të arratisjes, dhunën ndaj personelit dhe vizitorëve, dhunën e të burgosurve ndaj të burgosurve të tjerë, dhunën e personelit ndaj të burgosurve, shantazhin dhe shtrëngimin.

Mund të përfshihet, gjithashtu, siguria e infrastrukturës dhe, p.sh., mbrojtja kundër zjarrit, përmbajtjeve ose fatkeqësive të tjera natyrore.

NMR 2 (1)

4. Nuk do të ketë diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimit politik ose bindjeve të tjera, origjinës kombëtare ose shoqërore, pronës, origjinës në lindje ose ndonjë statusi tjetër.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Është e rëndësishme që autoritetet e burgut të njohin dallimet ndërmjet të burgosurve dhe të marrin parasysh kërkesat e tyre të ndryshme individuale.
- Megjithatë, nuk duhet të ketë diskriminim ndaj asnjë të burgosuri bazuar në këto dallime.
- Autoritetet e burgut kanë për detyrë të monitorojnë dhe luftojnë diskriminimin dhe të përforcojnë parimet e mosdiskriminimit.

NMR: 2 (2)

5. Administratat e burgjeve duhet të marrin parasysh nevojat individuale të të burgosurve, veçanërisht kategorive më të cenueshme në mjediset e burgjeve.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Çdo i burgosur duhet të pranohet si individ dhe të trajtohet si i tillë.
- Çdo i burgosur duhet të ketë një plan individual dënimi dhe të gjitha programet, aktivitetet dhe shërbimet duhet të ofrohen në përputhje me planet individuale të trajtimit.
- Autoritetet e burgjeve kanë detyrimin pozitiv për të përmbushur në mënyrë aktive nevojat e veçanta që mund të kenë disa kategori njerëzish në burg. Këto masa të veçanta nuk duhet të konsiderohen si diskriminuese.

NMR: 4

6. Burgimi duhet të përdoret për të garantuar riintegrimin e të burgosurve në shoqëri pas lirimit, në mënyrë që ata të mund të jetojnë duke respektuar ligjin dhe kujdesuar për veten. Qëllimi i dënimit me burgim është kryesisht mbrojtja e shoqërisë nga krimi dhe ulja e shkallës së recidivizmit.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Qëllimet e burgimit janë mbrojtja e shoqërisë nga krimi dhe parandalimi i recidivizmit duke i pajisur të burgosurit për një jetë të respektueshme dhe konstruktive pas lirimit.
- Kjo duhet të merret parasysh në të gjitha aspektet e menaxhimit të burgut.
- Këtu përfshihet zhvillimi i trajnimeve dhe aktiviteteve në mjediset e burgut për të ndihmuar të burgosurit të përballojnë jetën pasi të lirohen nga burgu duke i pajisur ata me aftësitë dhe kapacitetin për të gjetur punë, si dhe për të mbajtur veten dhe familjet e tyre pas lirimit.

Puna në burg është një shërbim i rëndësishëm publik. Objektivi kryesor është mbrojtja e sigurisë së shoqërisë nga krimi, duke promovuar paralelisht mirëqenien e njerëzve në burg dhe duke u ofruar shërbime dhe programe për t'i larguar nga krimi në të ardhmen. Administratat e burgjeve duhet të ofrojnë arsim, trajnim profesional, punë dhe forma të tjera ndihme në përputhje me nevojat individuale të trajtimit të të burgosurve.

NMR: 3 7. Sistemi i burgjeve nuk duhet të përkeqësojë vuajtjet që janë të natyrshme në një situatë të tillë.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Kur njerëzit dërgohen në burg ata humbasin disa të drejta, më e dukshmeja të drejtën e lirisë.
- Ky është një dënim i rëndë në vetvete dhe të burgosurit nuk duhet t'u nënshtrohen ndëshkimeve shtesë ose t'u kërkohet të humbasin të drejta të tjera, si e drejta për siguri ose për një standard të përshtatshëm jetese.
- Nuk është roli i autoriteteve të burgjeve të vendosin kufizime shtesë për të burgosurit.

NMR: 5(1) 8. Regjimi i burgut duhet të synojë të minimizojë çdo dallim midis jetës në burg dhe jetës në liri.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Autoritetet e burgjeve duhet të bëjnë gjithçka që është e mundur për të minimizuar këto dallime.
- Kjo do ta bëjë shumë më të lehtë për njerëzit që të rifillojnë jetën në shoqëri pas vuajtjes së dënimit.

NMR 5 (2) 9. Të burgosurit me aftësi të kufizuara fizike, mendore, ose të llojeve të tjera, duhet të kenë akses të plotë dhe efektiv në jetën e burgut mbi baza të barabarta.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Njerëzit duhet të caktohen në objektet më të përshtatshme për nevojat e tyre.
- Duhet të bëhen rregullimet e nevojshme në mënyrë që ata të kenë akses në shërbimet dhe mjediset në baza të barabarta me të burgosurit e tjerë.

NMR: 87 10 Duhet të merren masa për t'u siguruar të burgosurve rikthimin gradual të jetës në shoqëri.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Vendosja në burg duhet të konceptohet dhe përdoret për t'i përgatitur njerëzit për lirin eventuale.
- Kjo duhet të përfshijë konsiderata praktike të tilla si pajisja e tyre me aftësi për të gjetur një vend për të jetuar dhe një punë, duke u siguruar edhe një rrjet të sigurt të mbështetjes sociale.
- Përfshin, gjithashtu, konsiderata të shëndetit fizik dhe mendor.

- Që kjo të bëhet e mundur, administrata e burgut duhet të ketë lidhje të ngushta me agjencitë e tjera të shërbimeve publike të cilat do të përfshihen në mbështetjen e të burgosurit pas lirit.

NMR: 88 11. Trajtimi i të burgosurve duhet të theksojë jo përjashtimin e tyre nga komuniteti, por rolin e tyre të vazhdueshëm brenda tij.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Pranimin se burgjet dhe të burgosurit janë pjesë e shoqërisë, jo të ndarë prej saj.
- Është e rëndësishme që të burgosurit të ndjejnë se në vazhdimësi janë pjesë e komunitetit të tyre dhe kjo do të ndihmojë në rehabilitimin e tyre.
- Kontakti me botën e jashtme është pjesë e pandarë e kësaj qasjeje.

NMR: 89 12. Përmbushja e këtyre parimeve kërkon individualizimin e trajtimit dhe një sistem fleksibël të klasifikimit të të burgosurve në grupe. Është e dëshirueshme që të sigurohen shkallë të ndryshme sigurie sipas nevojave të grupeve të ndryshme.

Çfarë do të thotë kjo në praktikë?

- Një nga parimet më të rëndësishme të menaxhimit me sukses të burgjeve është njohja e faktit se çdo individ në burg ka historinë e tij, karakteristikat dhe nevojat e veta.
- Klasifikimi i saktë i tyre është i nevojshëm për të siguruar plotësimin e nevojave të tyre.
- Mënyra se si klasifikohet i burgosuri përcakton në një shkallë të madhe jetën e tij në burg, mund të ndikojë në aksesin në programe, aktivitete dhe shërbime dhe mund të komprometojë përpjekjet rehabilituese.
- Klasifikimi duhet të rishikohet rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në sjellje, etj.

1.1 HISTORIKU DHE HYRJA NË RREGULLAT E NELSON MANDELËS

45 MINUTA

Shfaqni një nga dy videot në vijim.

Hyrje e animuar e PRI-së në rregullat e Nelson Mandelës (2:22 minuta)

E disponueshme në anglisht, arabisht, spanjisht, rusisht, portugalisht, gjeorgjisht dhe armenisht në faqen e internetit të PRI-së.

Video e animuar e UNODC rreth Rregullave të Nelson Mandelës (2:49 minuta)

Anglisht

Nëse asnjë nga videot nuk është e disponueshme në gjuhën e trajnimit, zëvendësojini ato me **faqet 6 dhe 7** në vijim. Nëse shikoni një nga videot, shkoni te **faqja 8**.

Bëni një përmbledhje të disa prej standardeve më poshtë, duke vënë në dukje se ka edhe standarde të tjera që lidhen me to (duke u fokusuar më pak në **faqet 6 dhe 7** nëse shfaqni një nga videot).

SLAJDI 6 **Cilat janë rregullat e Nelson Mandelës?**

- Emër i shkurtër për Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuara të rishikuara për Trajtimin e të Burgosurve (SMR).
- Për herë të parë u miratuan në 1955, por 60 vjet më vonë ato ishin vjetëruar dhe në pjesë të caktuara ishin bërë kontradiktore; rrjedhimisht, kishin nevojë për përditësim.
- U zhvilluan pas një procesi shqyrtimi ndërqeveritar që zgjati katër vjet.
- Janë 122 rregulla në total, që mbulojnë të gjitha aspektet e menaxhimit të burgut.
- Janë emërtuar për të nderuar trashëgiminë e Nelson Mandelës, Presidentit të ndjerë të Afrikës së Jugut, i cili kaloi 27 vjet në burg dhe mbrojti të drejtat e të burgosurve.

SLAJDI 7 **Cili është qëllimi i tyre në praktikë?**

- Përvijojnë standardet minimale të pranuar universalisht për trajtimin e të gjithë të burgosurve – në paraburgim apo me dënim të formës së prerë.
- Përcaktojnë elementët thelbësorë të asaj që përgjithësisht pranohet si praktikë e mirë, së bashku me parimet përkatëse, në trajtimin e të burgosurve dhe menaxhimin e burgjeve.
- Konsolidojnë standardet e drejtësisë penale dhe të drejtave të njeriut — mbrojnë të drejtat e të burgosurve dhe ofrojnë udhëzime të përditësuara për personelin dhe administratat e burgjeve.
- Nuk janë detyruese për shtetet (njihen si ligj i butë), por janë standardi kryesor ndërkombëtar që rregullon trajtimin e të burgosurve. Disa pjesë të Rregullave të Nelson Mandelës, p.sh., ndalimi i torturës, pasqyrojnë ligjin detyrues.
- Sigurojnë një kuadër të rëndësishëm për organizmat e jashtme mbikëqyrëse të përfshira në monitorimin dhe inspektimin e burgjeve.

SLAJDI 8 **Pse janë të rëndësishme këto Rregulla?**

- Nëse zbatohen plotësisht, Rregullat sigurojnë që të drejtat e njeriut të të burgosurve të respektohen dhe që ata të trajtohen me dinjitet.
- Rregullat ofrojnë garanci të rëndësishme kundër torturës dhe keqtrajtimeve të tjera.
- Zbatimi do të çojë në mjedise më të sigurta që personeli i burgjeve të kryejë detyrat e tyre në mënyrë efektive, si dhe në tërësi në një mjedis më të mirë pune për personelin e burgjeve.
- Zbatimi i plotë do të thotë gjithashtu se autoritetet e burgjeve mund të arrijnë më mirë qëllimin parësor të burgimit – mbrojtjen e shoqërisë nga krimi dhe uljen e recidivizmit nëpërmjet rehabilitimit dhe riintegrit të sigurt të të burgosurve.
- Kjo do t'i shërbejë shoqërisë në tërësi dhe do të përmirësojë të kuptuarit dhe qëndrimet e publikut dhe medias ndaj burgjeve dhe njerëzve në burg.

SLAJDI 9 **Si mund të zbatohen rregullat në vende të ndryshme?**

- Rregullat nuk synojnë të përshkruajnë një sistem model të burgjeve për t'u zbatuar në të gjitha vendet dhe në çdo kohë.

- Rregullat pranojnë se ekzistojnë kushte të ndryshme ligjore, sociale, ekonomike dhe gjeografike në botë që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në menaxhimin e burgjeve.
- Këto janë standardet minimale të pranuar botërisht. Ato nuk janë ligjërish të detyrueshme dhe e drejta kombëtare ka përparësi. Megjithatë, shtetet pjesëmarrëse nuk mund të devijojnë nga parimet detyruese të Rregullave të Nelson Mandelës, siç është ndalimi i torturës.
- Rregullat ofrojnë udhëzime për zbatimin e standardeve minimale për trajtimin e të burgosurve dhe përfaqësojnë bazat absolute të menaxhimit të mirë të burgjeve. Ato nuk duhet të pengojnë zbatimin dhe zhvillimin e standardeve më të larta.

SLAJDI 10 Standarde të tjera të rëndësishme

Rregullat e Havanës (mbrojtja e të miturve të privuar nga liria)

- Rregullat e Nelson Mandelës nuk rregullojnë menaxhimin e burgosjes së fëmijëve, kështu që personeli i burgut duhet të jetë gjithashtu i vetëdijshëm për këto rregulla dhe të tjera që lidhen me fëmijët e burgosur (përfshirë Rregullat e Pekinit dhe Udhëzimet e Riadit).
- Ato vendosin standardet minimale për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria.
- Heqja e lirisë së të miturit duhet të përdoret si mjeti i fundit.
- Rregullat synojnë, gjithashtu, të kundërpeshojnë ndikimet e dëmshme të privimit të lirisë tek fëmijët.

Konventa e OKB-së kundër Torturës

- Qëllimi i saj është parandalimi, eliminimi dhe vënia përpara përgjegjësisë për aktet e torturës dhe keqtrajtimit të tjera; bën përkufizimin e torturës.
- Shtetet duhet të raportojnë mbi zbatimin e saj çdo katër vjet.
- Protokolli Opsional (OPCAT) plotëson Konventën kundër Torturës. Parimi themelor i OPCAT-it është se sistemi i vizitave të rregullta dhe të pavarura në vendet e kufizimit të lirisë mund të shërbejë si një masë e rëndësishme kundër abuzimit dhe parandalimit të torturës dhe çdo keqtrajtimi tjetër.

Rregullat e Bankokut (trajtimi i të burgosurve)

- Plotësojnë boshllëkun në standardet ndërkombëtare për trajtimin specifik gjinor të “autoreve dhe të burgosurve gra” — sistemet e burgjeve rregullisht i anashkalojnë nevojat e tyre specifike.
- Shumë gra dhe vajza në burg kanë qenë viktime të dhunës dhe vetëm një numër i vogël janë dënuar për vepra të dhunshme. Në nivel global, popullsia femërore e burgjeve po rritet me një ritëm më të shpejtë se popullsia meshkuj.
- Gjithashtu, japin udhëzime për fëmijët e prindërve/kujdestarëve të burgosur dhe fëmijët që jetojnë në burg me njërin prind/kujdestarin.
- Ofrojnë udhëzime për kategori të veçanta të veçanta të grave në burg, duke përfshirë të paraburgosurat, vajzat, shtetaset e huaja, gratë nga minoritetet dhe popujt indigjenë.

1.2 RREGULLAT E NELSON MANDELËS – PARIMET BAZË

30 MINUTA

NMR:

PARIMET BAZË 1-5

Kjo seancë trajton më në detaje parimet bazë të Rregullave të Nelson Mandelës, të cilat u prezantuan në fillim të Modulit 1.

Ky ushtrim është i dobishëm për të kuptuar se cilat nga parimet nuk zbatohen mirë në një vend/juridiksion të caktuar dhe ndihmon për të informuar diskutimet në modulet që pasojnë.

Në vendet/juridiksionet ku për pjesëmarrësit nuk është e lehtë të identifikojnë haptazi parimet që janë të vështira për t'u zbatuar (përfshirë rastet kur trajnimi ndiqet edhe nga drejtuesit e tyre), pjesëmarrësit mund t'i shkruajnë përgjigjet e tyre në një copë letër në mënyrë anonime dhe më pas t'i vendosin në një shportë.

Parimet bazë

USHTRIM

Kërkojuni pjesëmarrësve që për 10 minuta të lexojnë përsëri në heshtje Parimet Bazë 1-5 të Rregullave të Nelson Mandelës dhe Parimet Udhëzuese 86-90, si dhe të reflektojnë për mënyrën e zbatimit në vendin/juridiksionin e tyre.

Kërkojuni pjesëmarrësve t'u rikthehen parimeve të afishuara në sallën e trajnimit (Parimet 1-12 që u përdorën më herët) dhe të shënjojnë (mund të përdorin ngjitëse me ngjyra të ndryshme) 5 parime (në një ngjyrë) të cilat ata mendojnë se janë të vështira për t'u zbatuar në vendin/juridiksionin e tyre dhe 5 parime (në një ngjyrë tjetër) të cilat ata mendojnë se janë më të lehta për t'u zbatuar.

OPSIONAL

Nëse parime të veçanta marrin shumë 'vota' sepse janë veçanërisht të lehta/të vështira në vend/rajon, dhe nëse funksionon për dinamikën e grupit dhe ka kohë, kjo mund të pasohet nga një diskutim në grup se pse pjesëmarrësit mendojnë se parimi është veçanërisht i lehtë/i vështirë për t'u zbatuar.

1.3 FUSHAT TEMATIKE QË MBULOHEN NGA RREGULLAT E NELSON MANDELËS

30 MINUTA

Rregullat e Nelson Mandelës ndahen në dy pjesë:

Pjesa I mbulon menaxhimin e përgjithshëm të njerëzve në burg dhe është e zbatueshme për të gjitha kategoritë, duke përfshirë ato të renditura në Pjesën II. Këtu mbulohen fushat tematike të mëposhtme të menaxhimit të burgjeve, të cilat do të trajtohen të gjitha më në thellësi gjatë trajnimit:

Menaxhimi i dosjes së të burgosurit (RREGULLAT 6-10)
 Ndarja e kategorive (RREGULLA 11)
 Akomodimi (RREGULLAT 12-17)
 Higjiena personale (RREGULLA 18)
 Veshjet dhe shtresat (RREGULLAT 19-21)
 Ushqimi (RREGULLA 22)
 Edukimi fizik dhe sporte (RREGULLA 23)
 Shërbimet shëndetësore (RREGULLAT 24-35)
 Kufizimet, disiplina dhe sanksionet (RREGULLAT 36-46)
 Mjetet e kufizimit fizik (RREGULLAT 47-49)
 Kontrolli i të burgosurve dhe qelive (RREGULLAT 50-53)
 Informimi i të burgosurve dhe ankesat e tyre (RREGULLAT 54-57)
 Kontaktet me botën e jashtme (RREGULLAT 58-63)
 Librat (RREGULLA 64)
 Feja (RREGULLA 65)
 Mbajtja e sendeve të të burgosurve (RREGULLA 67)
 Njoftimet (RREGULLAT 68-70)
 Hetimet (RREGULLAT 71-72)
 Transferimi i të burgosurve (RREGULLA 73)
 Personeli i institucionit (RREGULLAT 74-82)
 Inspektimet e brendshme dhe të jashtme (RREGULLAT 83-85)

Kërkojuni pjesëmarrësve të mendohen për 10 minuta se për cilat fusha janë më të interesuar të mësojnë më shumë gjatë trajnimit. Kërkojuni t'i shënojnë në të dy kopjet e listës që u është dhënë në materialet e Modullit 1. Një fletë duhet t'u jepet trajnerëve (në mënyrë anonime). Tjetra mbahet për t'iu referuar kur të vlerësojnë trajnimin.

Zgjidhni 4 ose 5 nga Rregullat paraprakisht dhe kërkojuni pjesëmarrësve të gjejnë secilën prej tyre në kopjen e tyre të Rregullave të Nelson Mandelës. Pjesëmarrësit mund të lexojnë çdonjërin prej Rregullave. Ju gjithashtu mund të lexoni një fragment teksti nga disa prej Rregullave dhe t'u kërkonit pjesëmarrësve të gjejnë nga cili rregull vjen teksti. Kjo do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të familjarizohen me strukturën e Rregullave të Nelson Mandelës dhe si të gjejnë informacionin që u nevojitet.

OPSIONAL Nëse koha lejon, pyetini pjesëmarrësit pse u pëlqen një rregull i caktuar, ose pse ai u intereson, ose çfarë do të thotë në praktikë?

Pjesa II përmban rregulla të zbatueshme për kategoritë e veçanta të përmendura:

(A) Të dënuarit me vendim gjykate (RREGULLAT 86-108)

Edhe pse këto Rregulla e bëjnë të qartë se vlejnë vetëm për të dënuarit me vendim gjykate, ato zbatohen në mënyrë të barabartë për kategoritë e tjera, me kusht që të mos bien ndesh me rregullat specifike për kategoritë në fjalë dhe të jenë në dobi të tyre.

Të dënuarit me vendim gjykate përfshihen si një kategori më vete, sepse disa Rregulla që zbatohen për ta mund të mos zbatohen, për shembull, për të paraburgosurit, kryesisht për shkak se këta të fundit duhet të prezumohen të pafajshëm.

(B) Të burgosurit me sëmundje mendore dhe/ose probleme shëndeti (RREGULLAT 109)

Pjesa e parë e Rregullës 109 trajton përgjegjësinë penale të personave me sëmundje të rënda mendore dhe/ose probleme shëndetësore dhe shkon përtej kompetencave të autoriteteve të burgut (kjo është përgjegjësi e zyrtarëve gjyqësorë). Rregulla kërkon krijimin e kushteve të veçanta për personat me sëmundje mendore/probleme shëndetësore.

(C) Personat me arrest në burg ose në pritje të gjykimit (RREGULLAT 111-120)

Këto rregulla zbatohen vetëm për personat nën masën e sigurisë arrest në burg, ose në pritje të gjykimit dhe kanë lidhje me prezumin e pafajësisë.

(D) Të burgosurit civilë (RULE 121)

dhe (E) Personat e arrestuar apo të ndaluar pa akuzë (RREGULLA 122)

Këto rregulla konfirmojnë se masat mbrojtëse që sigurohen nga Rregullat e Nelson Mandelës duhet të zbatohen edhe për këto kategori njerëzish në burg. Siç e pamë në Modulin 1, kjo thuhet qartazi edhe në Vëzhgimin Paraprak 3, i cili thotë se Pjesa I e Rregullave zbatohet për të gjitha kategoritë e të burgosurve.

Hapni diskutimin për pyetje ose komente.

1.4 ROLI I PUNONJËSVE TË BURGUT

30 MINUTA

USHTRIM

Roli i punonjësve të burgut

Ndani pjesëmarrësit në grupe prej tre deri në katër veta. Ky ushtrim mund të kryhet edhe në formën e një seance për rrahje mendimesh me të gjithë pjesëmarrësit. Kërkojuni pjesëmarrësve si grup të shkruajnë disa fjali të shkurtra që përshkruajnë:

- Rolin e tyre si punonjës të burgut. Cilat janë përgjegjësitë e tyre kryesore?
- Kushtet e punës së personelit të burgut dhe si mund të ndikojë kjo në menaxhimin e burgjeve
- Gjërat më shpërblyese në punën e tyre
- Gjërat më sfiduese në punën e tyre
- Çfarë do t'i ndihmonte ta bënin më mirë punën e tyre?

Më pas, një person nga secili grup ftohet të japë sqarime në seancë për të gjithë pjesëmarrësit, duke përdorur një tabak letre nëse është e nevojshme.

Nëse pjesëmarrësit e kanë të vështirë të identifikojnë sfidat/problemet kryesore që ndeshin në kulturën institucionale (p.sh., sepse drejtuesit e tyre janë në sallën e trajnimit), atëherë kërkojuni pjesëmarrësve të përqendrohen në përgjegjësitë e tyre kryesore dhe elementët më shpërblyes të punës së tyre.

Ju mund t'u ktheheni përgjigjeve më vonë gjatë trajnimit dhe gjatë vlerësimit, veçanërisht kur konstatooni se hollësitë e Rregullave të Nelson Mandelës mund ta ndihmojnë personelin të kapërcejë sfidat dhe t'i ndihmojë ta bëjnë punën e tyre më mirë.

Gjatë gjithë trajnimit, diskutoni, kur është e nevojshme, në lidhje me kushtet e punës së personelit të burgut, përfshirë sesi këto kushte mund të ndikojnë tek personeli.

OPSIONAL

Bullizmi mes punonjësve të burgut - video.

Nëse koha dhe dinamika e grupit ju lejojnë, shfaqni këtë video nga Zelanda e Re për bullizmin në radhët e personelit dhe kulturën institucionale. Më pas, kërkojuni grupit të reflektojë mbi videon dhe të diskutojë aspektet negative dhe pozitive të kulturës institucionale në institucionin/vendin e tyre dhe se si ajo ndikon në menaxhimin e burgjeve në përgjithësi.

<https://www.stuff.co.nz/national/119934358/bullying-in-prisons-is-so-bad-some-staff-have-become-suicidal> (4:13 minuta)

1.5 GRUPE TË VEÇANTA TË PERSONAVE NË BURG/GRUPET E CENUESHME

40 MINUTA

Kjo seancë prezanton kategori të veçanta/grupe të cenueshme të personave në burg. Trajtimi i këtyre grupeve është i integruar në të gjithë kurrikulën, por është parë e dobishme t'i prezantojmë shkurtimisht edhe këtu. Shpjegoni ndryshimin midis grupeve të veçanta të njerëzve/grupeve të cenueshme të identifikuar këtu dhe kategorive të veçanta në Pjesën II të Rregullave të Nelson Mandelës.

Përforconi se, megjithëse është e rëndësishme të theksohen çështjet me të cilat përballen grupe të veçanta, kjo nuk duhet të ulë vëmendjen ndaj situatës së shumicës së popullsisë në burgje, shpesh e përbërë nga burra në moshë të re. Shpjegoni se çdonjëri në burg ka një histori unike dhe nevoja individuale dhe, ndonëse është thelbësore të njihen nevojat e grupeve të cënueshme, këto grupe nuk janë homogjene. Do të ketë, gjithashtu, shumë individë në popullatën kryesore të të burgosurve që kanë nevoja specifike bazuar në historitë dhe rrethanat e tyre në burg.

Mund të identifikohen personat përgjegjës për llojet e ndryshme të grupeve të cënueshme të identifikuara në vendin/et e tyre (në varësi të kontekstit). Kërkojuni atyre të mbledhin momentet përkatëse që dalin gjatë kursit të trajnimit për këto grupe dhe të bëjnë sqarime në pika të ndryshme të trajnimit. Mund të vendosni që në fillim fletë tabakësh në mur për secilin grup të cënueshëm dhe gjatë trajnimit shtoni çështjet përkatëse kur ato shfaqen.

Marrja në konsideratë e cënueshmërive

Siç e kemi parë tashmë, Rregullat e Nelson Mandelës bëjnë thirrje që administrata e burgjeve “të marrë në konsideratë nevojat individuale të të burgosurve, veçanërisht të kategorive më të cënueshme në mjediset e burgjeve”. Prandaj, është e rëndësishme që personeli i burgut të jetë i vetëdijshëm se cilat mund të jenë këto kategori të cënueshme dhe të jetë në gjendje të identifikojë individët potencialisht të cënueshëm në burg. Personeli i burgut, gjithashtu, duhet të jetë i vetëdijshëm se do të ketë shumë individë të cënueshëm që nuk bëjnë pjesë në një kategori të caktuar.

Cënueshmëritë

- Të gjithë njerëzit në burg janë të cënueshëm, por disa grupe mund të jenë më të cënueshme se të tjerët.
- Shumë faktorë mund të shtojnë cënueshmërinë e një individi dhe këta mund të kryqëzohen me njëri-tjetrin. Ata, gjithashtu, mund të ndryshojnë me kalimin e kohës.
- Kjo është arsyeja pse vlerësimet individuale dhe të vazhdueshme të rrezikut dhe nevojave janë kaq të rëndësishme.
- Qasjet dinamike ndaj sigurisë në menaxhimin e burgjeve mund të ndihmojnë personelin të identifikojë këto cënueshmëri.

Pse është e rëndësishme kjo? Në cilat fusha të menaxhimit të burgjeve duhet t'i kemi parasysh këta faktorë?

- Në të gjitha aspektet e menaxhimit të burgjeve (siç do të shohim gjatë pjesës tjetër të kursit), por fushat më të dukshme përfshijnë:
 - Kujdesin shëndetësor
 - Akomodimin
 - Kontaktet me familjen dhe miqtë
 - Kontrollat personale
 - Procedurat disiplinore
 - Qasjen në informacion
 - Rehabilitimin

Faktorët e rrezikut

Shoqata për Parandalimin e Torturës (APT) i klasifikon faktorët e riskut që përforcojnë cenueshmërinë si personale, ambientale ose social-kulturorë.

Faktorët personale

Ku përfshihen, për shembull:

- Gjinia
- Mosha
- Orientimi seksual dhe identiteti gjinor
- Niveli i arsimimit
- Kombësia, etnia ose 'raca'
- Natyra e veprës penale (p.sh. krime kundër fëmijëve, krime të kryera në kontekstin e dhunës, veprat politike)
- Historia e burgosjes dhe koha e kaluar në paraburgim
- Shëndeti fizik dhe mendor
- Situata ligjore
- Prejardhja social-ekonomike
- Feja ose kultura
- Niveli i vetëvlerësimit dhe faktorë të tjerë të sjelljes/personalitetit
- Lidhjet me sistemin e drejtësisë penale
- Trauma në të kaluarën ose të tashmen (përfshirë torturën, dhunën në familje dhe dhunën seksuale)
- Përvoja të tjera jetësore (përfshirë varësinë nga të tjerët/substancat, përfshirjen në punë seksuale)

Faktorët e ambientit

Ku përfshihen:

- Qëndrimi i personelit të burgut
- Raporti i burgosur/personel
- Qëndrimet e të burgosurve të tjerë
- Prania e bandave/lidhjet me bandat
- Aksesit dhe cilësia e kujdesit shëndetësor (përfshirë kujdesin për shëndetin mendor), shërbimet ligjore dhe sociale
- Sistemet informale të privilegjeve të përdorura në vend të sistemeve zyrtare të privilegjeve
- Sistemi i burgut (p.sh. akomodimi në qeli apo në fjetore të përbashkëta)
- Mungesa e lidhjeve familjare /kontaktit me botën e jashtme
- Mbipopullimi i burgjeve
- Përbërja e popullsisë së burgut (kultura dhe kombësi të ndryshme, etj.)

Faktorët social-kulturorë

Ku përfshihen, për shembull:

- Qëndrimi i shoqërisë dhe medias ndaj personave të privuar nga liria
- Stigmatizimi dhe përjashtimi social
- Fakti që janë jashtë syve të publikut
- Qëndrimet ndaj minoriteteve
- Korrupsioni

OPSIONAL
USHTRIM

COVID-19 dhe personat e cenueshëm në burg

Kërkojini grupit të mendojnë për llojet e njerëzve në burg të ndikuar në mënyrë të veçantë nga COVID-19 dhe pse. Pjesëmarrësit duhet të mbajnë parasysh ndikimet pozitive dhe negative.

Idetë mund të jenë si më poshtë dhe shërbejnë vetëm si shembuj për të nxitur diskutimin, nëse është e nevojshme. Pjesëmarrësit me shumë gjasa kanë idetë e tyre bazuar në përvojat që kanë kaluar.

Shtetasit e huaj – më pak vizita nga familjarët, por përdorimi i teknologjisë ka zgjeruar mundësitë për komunikim me të afërmit; më pak mundësi për t'u transferuar në vendin e tyre për të vuajtur dënimin/pas liritimit.

Të burgosurit e moshuar/ata me sëmundje kronike - më shumë gjasa për t'u izoluar për rreziqet ndaj shëndetit; shtimi i rasteve të problemeve mendore; disa vende mund t'i kenë liruar me kusht për shkak të COVID-19.

Gratë — më shumë gjasa të kenë vuajtur nga kufizimi i vizitave familjare, veçanërisht gratë me fëmijë në rritje.

Personat me sëmundje mendore – problemet e shëndetit mendor mund të jenë përkeqësuar nga pandemia, edhe për shkak të forcimit të izolimit/mungesës së vizitave nga familjarët.

OPSIONAL

Nëse koha e lejon, përmbliidhni Modulin 1. Kërkojuni pjesëmarrësve të mendojnë për nevojat individuale të njerëzve në burg dhe t'i mbajnë parasysh këto nevoja gjatë moduleve të ardhshme. Nevoja për të njohur grupet e cenueshme dhe për të përshtatur planet e dënimit me nevojat individuale do të trajtohet sërish në Modulin 2 dhe gjatë gjithë kursit.

BURIME
SHITESË

PRI/ODIHR


Dokument udhëzues mbi rregullat e Nelson Mandelës: Zbatimi i rregullave standarde minimale të rishikuara të Kombeve të Bashkuara për trajtimin e të burgosurve

UNODC

Manual për të burgosurit me nevoja të veçanta

ODIHR

Parandalimi dhe adresimi i dhunës seksuale dhe me bazë gjinore në vendet e privimit të lirisë: standarde, qasje dhe shembuj nga rajoni i OSBE-së



MODULI 2
PERSONAT NË BURG
DHE KUSHTET E BURGUT

2 PERSONAT NE BURG DHE KUSHTET E BURGUT

MATERIALET

- Faqet 16–21 të prezantimit në PowerPoint të printuara
- Lista e burimeve të mëtejshme
- Printime të materialit ‘Izolimi mjekësor dhe karantina në kontekstin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera infektive’ (shih faqet 52–53)
- Printime nga pesë përkufizimet e sigurisë dinamike (shih faqet 63–64)

10 MINUTA

HYRJE

Ky modul trajton kategoritë e ndryshme të njerëzve në burg dhe ofron më shumë detaje rreth grupeve specifike që mund të kenë nevoja të veçanta. Moduli, gjithashtu, mbulon kushtet minimale fizike të burgut dhe shërbimet bazë që shteti duhet t’u ofrojë të gjithë njerëzve në burg, duke vënë theksin tek nevojat individuale dhe përshtatjet e arsyeshme. Këto përfshijnë sigurimin e duhur të akomodimit, ndriçimin e përshtatshëm, ngrohjen dhe ajrosjen, kushtet higjienike, veshjet dhe shtratin, ushqimin, pijen dhe mundësinë për të kryer aktivitet fizik.

OBJEKTIVAT MËSIMORE

Pas përfundimit të Modulit 2, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë profilin e popullsisë së burgjeve në institucionin/vendin e tyre dhe grupet që kanë nevojë për vëmendje të veçantë;
- Diskutojnë pse është e rëndësishme të ndahen grupe të caktuara njerëzish në burg dhe se si personeli mund të lehtësojë vendosjen e të burgosurve në grupin e duhur;
- Shpjegojnë standardet bazë për kushtet e burgimit/shërbimet bazë dhe vlerësojnë se në ç’skallë përmbushen këto standarde në objektin/vendin e tyre dhe çfarë duhet përmirësuar;
- Diskutojnë pasojat për të burgosurit, personelin e burgjeve, administratën e burgjeve dhe komunitetin më të gjerë kur shteti nuk përmbush detyrën e tij të kujdesit për standardet minimale të burgimit, duke përfshirë kushtet çnjerëzore të burgimit dhe rrezikun që ato të shkaktojnë incidente dhe të ndikojnë në sigurinë dhe shëndetin në institucion;
- Të kuptojnë se si kushtet e burgimit, në disa rrethana, mund të përbëjnë keqtrajtim apo edhe torturë;
- Përcaktojnë se çfarë mund të bëjë personeli i burgut për të siguruar përmbushjen e standardeve fizike bazë në ambientet ku ata punojnë, duke përfshirë kujdesin specifik për grupe të veçanta të burgosurish; dhe
- Të kuptojnë rolin e tyre individual në identifikimin e rreziqeve dhe nevojave individuale të të burgosurve.

→ Këto dy parime thelbësore mund të printohen dhe të afishohen në vende të dukshme në sallën e trajnimit gjatë gjithë seancave:

“Kategoritë e ndryshme të të burgosurve duhet të mbahen në institucione të veçanta ose pjesë të veçanta të institucioneve, duke marrë parasysh gjininë, moshën, dosjen penale, arsyen ligjore të burgimit dhe nevojat e trajtimit të tyre”. — **Rregulla 11**

“Të gjitha akomodimet e parashikuara për përdorim nga të burgosurit dhe, në veçanti, të gjitha vendet e fjetjes duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat shëndetësore, duke u kushtuar vëmendjen e duhur kushteve klimatike dhe veçanërisht vëllimit të ajrit, sipërfaqes minimale të dyshemesë, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrosjes.” — **Rregulla 13**

2.1 CILËT JANË NË BURG?

50 MINUTA

→ Qëllimi i kësaj seance është të nxiten pjesëmarrësit të mendojnë për nevojat individuale të të burgosurve/grupeve të cënueshme që në fillim të trajnimit.

Seanca do të tregojë se sa të njohur janë pjesëmarrësit me parimet bazë të ndarjes së të burgosurve në kategori dhe nevojat e tyre për trajtim të individualizuar. Gjithashtu, do të ndihmojë në identifikimin e grupeve kryesore të të burgosurve të veçantë / të cënueshëm në institucionin/vendin/juridiksionin e tyre dhe se si situata mund të jetë e ndryshme nga një institucion në një tjetër. Këto do të shërbejnë si tema të diskutimeve gjatë ditëve në vijim.

USHTRIM

Filloni seancën me rrahje mendimesh në grupe të vogla për të identifikuar kategoritë kryesore të të burgosurve/grupeve të veçanta/të cënueshme në institucionin/vendin/juridiksionin e tyre. Pjesëmarrësit duhet të krijojnë një listë dhe t'i paraqesin ato në seancë. Pyetini ata:

1. Cilat grupe kryesore njerëzish në burg duhet të mbahen të ndara nga njëri-tjetri sipas Rregullave të Nelson Mandelës?
2. A ka grupe njerëzish në burg në objektin/vendin/juridiksionin e tyre që kanë nevojë për vëmendje të veçantë/që janë më të cënueshëm nga trajtimi i dobët apo dhuna (për shembull)?

Pas kësaj, zhvilloni një diskutim 10-minutësh të udhëhequr nga trajnuesi për grupet që nuk u identifikuan në diskutimin e hapur të pjesëmarrësve. Prezantoni grupe të tjera që nuk janë identifikuar dhe diskutoni nëse ato janë të rëndësishme në rrethanat përkatëse (p.sh., në disa juridiksione shtetasit e huaj mund të mos marrin vëmendjen e nevojshme, në të tjera mund të ketë shumë të burgosur të moshuar, etj.)

→ Grupet që duhet të identifikohen gjatë rrahjes së mendimeve:

1. **Ndarja e kategorive** — Burra/Gra; të rritur/fëmijë; të paraburgosur/të dënuar; dhe ndarja bazuar në nevojat e individualizuara dhe analizat e riskut.

2. **Grupet që mund të kërkojnë vëmendje të veçantë** – kumtoni qartë se këto janë grupe që mund të kenë nevojë për vëmendje të veçantë (dhe në disa situata mund të dalë nevoja për ndarjen e tyre), por që janë të ndryshme nga grupet në pikën 1, ku ndarja kërkohet në mënyrë eksplicite nga Rregullat e Nelson Mandelës. Në varësi të kontekstit dhe me qëllim nxitjen e diskutimeve, grupet potenciale mund të përfshijnë, por jo të kufizohen, në:

- shtetas të huaj
- grupet e pakicave etnike
- personat indigjenë
- punonjësit e seksit
- personat e moshuar
- të rinjtë
- Personat me aftësitë të kufizuara
- personat që identifikohen ose perceptohen si LGBTI
- personat me probleme të shëndetit mendor
- personat me probleme të caktuara të shëndetit
- njerëz nga grupe të ndryshme fetare/kulturore
- Individë të profilit të lartë
- persona të akuzuar ose të dënuar për vepra të lidhura me terrorizmin

OPSIONAL **Loja e cenueshmërive**

Ndajini pjesëmarrësit në grupe më të vogla dhe formoni një rreth. Lehtësuesi i jep secilit pjesëmarrës nga një kartë, të cilën ata e mbajnë të fshehur nga të tjerët. Çdo kartë përmban një ose dy karakteristika specifike për një person të burgosur. Lehtësuesi i hedh një top njërit prej pjesëmarrësve. Pjesëmarrësi që kap topin shpjegon pse ai/ata (personi/at në kartë) përballen me sfida të veçanta gjatë burgimit dhe cilat janë nevojat e tyre specifike, pa përmendur karakteristikat që shënohen në kartë. Pjesëmarrësit e tjerë duhet të marrin me mend se cilat janë këto karakteristika. Pasi të tjerët ta kenë marrë me mend, pjesëmarrësi ia hedh topin dikujt tjetër dhe loja vazhdon derisa secili pjesëmarrës të ketë luajtur të paktën një herë.

→ Mund të jetë e dobishme që në diskutim të prezantohen disa konsiderata të lidhura me COVID-19.

2.2 NDARJA E KATEGORIVE

40 MINUTA

Prezantoni rregullat e Nelson Mandelës në lidhje me ndarjen e kategorive dhe shpjegoni pse janë të rëndësishme.

25 MINUTA

NMR: 11

DHE 93

Pse është e rëndësishme ndarja e kategorive?

- Për t'u kujdesur më mirë për nevojat individuale të njerëzve në burg, duke përfshirë shëndetin, arsimimin dhe rehabilitimin e tyre;
- Për të arritur me efektivitet qëllimet e dënimit me burgim në të gjitha rastet; pra, për të mbrojtur shoqërinë nga krimi dhe për të ulur shkallën e recidivizmit me fokus në rehabilitimin dhe riintegrimin.
- Për të mbrojtur sigurinë/shëndetin e personelit, njerëzve në burg dhe vizitorëve — nivele të ndryshme sigurie parandalojnë arratisjen ose kërcënimet ndaj sigurisë së burgut dhe sigurisë publike;
- Për të minimizuar rreziqet dhe ndikimin e keq të mundshëm të grupeve të ndryshme të të burgosurve;
- Për ta bërë më të lehtë për drejtuesit/personelin e burgut menaxhimin e jetës së përditshme në burg (përfshirë, për shembull, kohën jashtë qelisë ose aktivitetet rekreative);
- Të ulë shpenzimet për administratat e burgjeve për sa i përket kostove të personelit dhe masave të sigurisë, etj.; dhe
- Ndarja e grupeve të ndryshme të njerëzve në burg duhet të zbatohet edhe gjatë transferimeve të të burgosurve.

Ndarja e kategorive të përcaktuara në Rregullat 11 dhe 93 ka të bëjë me grupe të gjera, të cilat duhet të ndahen në përputhje me rregullat e Nelson Mandelës, por mund të lindë pyetja nëse grupet e tjera që kanë nevojë për vëmendje të veçantë, ose grupet veçanërisht të cënueshme, duhet gjithashtu të mbahen veçmas. Nëse lindin këto pyetje, më poshtë jepen këshilla dhe burime shtesë.

Nëse këto pyetje nuk lindin, ju mund të zgjidhni t'i prezantoni këto tema për diskutim. Nëse është e nevojshme, çështjet mund të trajtohen më në detaje edhe në seanca të tjera që kanë lidhje me to. Mbuloni sa më shumë nga këto rrethana për aq sa lejon koha dhe sipas rëndësisë që kanë në institucionin/vendin përkatës, por seanca duhet të kufizohet në 25 minuta.

A ka rrethana të tjera që mund të kërkojnë ndarjen e grupeve të tjera të të burgosurve? Për shembull:

- **A duhet të mbahen veçmas nga të tjerët shtetasit e huaj/ata nga pakicat e veçanta etnike ose grupet indigjene?**

Shtetasit e huaj nuk duhet të caktohen nëpër burgje vetëm në bazë të kombësisë. Vendosja e të gjithë njerëzve në burg duhet së pari të përcaktohet nga gjinia, mosha, dosjet penale, arsyeja ligjore e burgimit të tyre dhe kërkesat e trajtimit/rehabilitimit social të tyre (**RREGULLAT 11 dhe 93**). Shtetasit e huaj nuk janë një grup homogjen dhe për këtë arsye duhet të klasifikohen dhe të ndahen sipas niveleve të përshtatshme të sigurisë në burgje, bazuar në vlerësime të plota dhe individuale të rrezikut dhe nevojave. Megjithatë, duhet t'u kushtohet vëmendje edhe nevojave të veçanta të shtetasve të huaj, duke përfshirë aksesin e tyre të barabartë në informacion, shërbimet e burgut dhe mundësitë e rehabilitimit.

Nëse shtetasit e huaj plotësojnë kriteret për t'u mbajtur së bashku, dhe nëse kjo nuk paraqet rrezik, mund të ketë kuptim logjistik të mbahen së bashku shtetasit e huaj ose ata nga të njëjtat grupe etnike ose indigjene, veçanërisht nëse ata flasin të njëjtën gjuhë, kanë prejardhje kulturore të ngjashme, ose të njëjtat besime fetare. Mund të jetë, gjithashtu, e dobishme t'i vendosni shtetasit e huaj me dikë që mund t'u mësojë atyre gjuhën vendase për të lehtësuar komunikimin me autoritetet e burgut dhe për t'i ndihmuar ata të përfshihen në jetën e burgut.

Gjithashtu, duhet t'i kushtohet vëmendje vendosjes së shtetasve të huaj në burgjet e kryeqytetit për të lehtësuar kontaktin me përfaqësuesit konsullorë ose, në rastin e të burgosurve nga vendet fqinje, nëse është e përshtatshme, mund të ketë kuptim vendosja e tyre në burgje pranë kufirit për të lehtësuar kontaktet me familjet dhe komunitetet e tyre.

- **A duhet të mbahen veçmas të moshuarit në burg?**

Sic thuhet më sipër, ndarja parësore duhet të jetë në përputhje me Rregullën 11 dhe të bazohet në vlerësimet individuale të rrezikut dhe nevojave, pasi çdo i moshuar ka nevoja specifike. Megjithatë, mund të jetë praktike që të moshuarit të strehohen së bashku në burg, nëse kjo nuk paraqet rrezik, dhe veçanërisht nëse kanë nevoja të ngjashme fizike ose mjekësore dhe kërkojnë monitorim më të shpeshtë mjekësor (p.sh., për shkak të problemeve me lëvizjen, demencën, humbjen e shikimit, dëgjimit, etj.). Ekzistojnë modele të ndryshme për akomodimin e të moshuarve dhe kjo mund të varet nga përbindja e të moshuarve në popullatën e përgjithshme të burgjeve dhe nga mjediset/buxheti i disponueshëm. Disa burgje kanë seksione të veçanta të projektuara posaçërisht për nevojat e të moshuarve.

- **A duhet të mbahen personat e sëmurë në burg veçmas nga të tjerët? (Kjo pyetje mund të lindë veçanërisht në kontekstin e COVID-19).**

Kjo është përgjegjësi e personelit të kujdesit shëndetësor - Rregulla 30 (d) i Rregullave të Nelson Mandelës e bën të qartë se punonjësit e kujdesit shëndetësor janë përgjegjës për sigurimin e izolimit klinik dhe trajtimin e duhur në rastet kur të burgosurit dyshohen se kanë sëmundje ngjitëse gjatë periudhës infektive për të parandaluar rrezikun e përhapjes së infeksionit. Ata që kërkojnë trajtim të specializuar duhet të mbahen në ambientet shëndetësore të burgut ose të transferohen në institucionet shëndetësore të komunitetit. Ata me sëmundje terminale duhet të akomodohen në një mjedis të rehatshëm nën kujdesin e personelit të kujdesit shëndetësor.

- **A duhet të mbahen veçmas në burg personat LGBTI?**

Ekzistojnë modele të ndryshme për akomodimin e personave LGBTI në burg dhe kjo mund të varet nga burimet/mjetet, statusi ligjor/social i personave LGBTI brenda vendit dhe shkalla në të cilën personat LGBTI janë të gatshëm të vetëidentifikohen si të tillë në kushtet e burgut. Disa vende kanë objekte krejtësisht të veçanta ose seksione të posaçme për personat LGBTI.

Personat LGBTI në burg kanë rrethana dhe nevoja individuale. Pikëpamjet dhe shqetësimet e tyre duhet të merren parasysh gjatë përcaktimit të qelive duke i vendosur në ato mjedise që garantojnë më mirë sigurinë e tyre. Ata që janë vetë-identifikuar si LGBTI mund të preferojnë të strehohen me persona të tjerë LGBTI nëse ndjehen të rrezikuar nga abuzimi. Të tjerë preferojnë të mos e zbulojnë orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor. Kur personat LGBTI ndahen nga

pjesa tjetër e popullsisë së burgjeve, është e rëndësishme që ata të trajtohen njësoj si të tjerët sa i takon qasjes në mallra dhe shërbime.

Në disa raste, mund të jetë nevoja që personat LGBTI të vendosen në një segregacion mbrojtës për sigurinë e tyre. Megjithatë, nëse izolimi konsiderohet si rruga e vetme e mundshme, ai duhet të përdoret vetëm për kohën e nevojshme dhe nuk duhet të çojë në izolim individual.

Vendosja e personave transgjnorë në burg duhet të bëhet në konsultim me ata vetë dhe rast pas rasti.

Parimet e Xhakartës, Parimi 9 (a dhe b):

Shtetet duhet të “[s]igurojnë që vendosja në burg të shmangë marginalizimin e mëtejshëm të personave në bazë të orientimit seksual ose identitetit gjinor ose ekspozimin e tyre ndaj rrezikut të dhunës, keqtrajtimit ose abuzimit fizik, mendor ose seksual; [...]”. Shtetet duhet të sigurojnë “për aq sa është e mundur, që të gjithë të burgosurit të marrin pjesë në vendimmarrjen lidhur me vendin e përshtatshëm në burg për orientimin e tyre seksual dhe identitetin gjinor”.

• A duhet të mbahen veçmas në burg personat me probleme të shëndetit mendor?

Të burgosurit me probleme të shëndetit mendor duhet të mbrohen nga abuzimi dhe dhuna e të burgosurve të tjerë dhe duhet të strehohen në një mjedis të përshtatshëm për nevojat e tyre specifike, i cili duhet të jetë sa më pak kufizues që të jetë e mundur dhe duke marrë parasysh nevojat për kujdes mjekësor. Ata që kanë sëmundje të rënda të shëndetit mendor duhet të transferohen në institucione të specializuara të shëndetit mendor. Duhet të shmangen periudhat e gjata të izolimit.

Pyetje të tjera të mundshme lidhur me vendosjen e të burgosurve

• Po sikur thjesht të mos ketë hapësirë të mjaftueshme për të ndarë kategoritë (p.sh. qelitë për fëmijë janë plot, por ka hapësira në ambientet e të rriturve; ambientet e paraburgimit plot, por ka hapësira në qelitë për të burgosurit e me vendim gjykatë; qelitë e sigurisë së lartë janë plot, por ka hapësirë në qelitë e sigurisë së ulët, etj.).

Ndarja e kategorive sipas Rregullës 11 mbetet prioriteti absolut në këto situata. Në vend të kësaj, autoritetet mund të marrin në konsideratë se çfarë masash të tjera mund të vendosen për të lehtësuar mbipopullimin e përkohshëm dhe për të zvogëluar kohën që njerëzit në burg kalojnë në qelitë e tyre. Kjo mund të përfshijë kohë shtesë jashtë qelisë, akses shtesë në aktivitetet rekreative/profesionale, ndryshimin e orarit të rregullt, përmirësimin e përdorimit të hapësirave të përbashkëta dhe rishikimin e rregullt të vlerësimeve të nevojave/rrezikut.

• Po vajzat? A mund të mbahen në të njëjtat qeli me gratë e rritura?

Për shkak se ka qark pak vajza në burgje, ato shpesh mbahen së bashku me gratë të rritura, por rregullat e Nelson Mandelës janë të qarta që vajzat duhet të mbahen të ndara nga gratë e rritura. Në disa raste, mund të ketë vetëm një ose fare pak vajza në një institucion. Në këto raste, është e rëndësishme që autoritetet e burgut

të shqyrtojnë mënyra të tjera për të mbështetur vajzat dhe për t'u ofruar atyre ndërveprim social. Kjo mund të përfshijë vizita shtesë nga familjarët ose mbështetje nga OJQ-të lokale, vizita në shtëpi dhe akses shtesë në programet e dëfrimit dhe trajnimit. Në disa raste, mund të jetë e përshtatshme të transferohen vajzat në institucione ku ka vajza të tjera, në mënyrë që të kenë shoqëri, por kjo duhet të balancohet me nevojën për t'i vendosur pranë shtëpisë dhe familjes së tyre.

- **Cila është hapësira e përshtatshme personale e rekomanduar/sipërfaqja minimale e dyshemesë për çdo të burgosur?**

Rregullat e Nelson Mandelës nuk i përcaktojnë këto në terma numerikë, por Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq rekomandon të paktën 5.4 m² për person në një qeli të vetme dhe 3.4 m² për person në qeli të përbashkët ose në fjetore si hapësirën minimale të nevojshme për një të burgosur për të fjetur i pashqetësuar, për të mbajtur gjërat personale dhe për të ardhur vërdallë (duke mos përfshirë hapësirat e tualetit dhe dushit)⁶. Brenda rajonit të Këshillit të Evropës, standardi minimal i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës për hapësirën personale të banimit është 6 m² për çdo qeli të vetme banimi dhe 4 m² për çdo të burgosur për qelitë e përbashkëta, duke përjashtuar mjediset sanitare në të dyja rastet.⁷⁸

Kjo është e rëndësishme sepse është shumë e zakonshme që burgjet të jenë shumë të mbipopulluara. Në disa burgje njerëzit nuk kanë as hapësirën e mjaftueshme për t'u shtrirë të gjithë në të njëjtën kohë dhe janë të detyruar të flenë me radhë. Hapësira e përshtatshme personale është gjithashtu jashtëzakonisht e rëndësishme për dinjitetin njerëzor dhe ruajtjen e shëndetit të mirë fizik dhe mendor. Në të njëjtën kohë, ka faktorë të tjerë që duhen marrë parasysh gjatë përcaktimit të hapësirës adekuate personale, duke përfshirë gjendjen fizike të ndërtesave, sasinë e kohës së lejuar jashtë qelisë për çdo person, sasinë e dritës dhe ajrosjes, dhe aktivitete të tjera që mund të duhet të zhvillohen në mjediset e brendshme (kjo ndonjëherë përfshin gatimin dhe lavandinë). Disa njerëz në burg, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, ka të ngjarë të kenë nevojë për më shumë hapësirë personale se të tjerët.

Çfarë hapash praktikë mund të ndërmarrë personeli i burgut në lidhje me vendosjen/caktimin e të burgosurve?

- Të sistemojë vlerësimet e rrezikut dhe të nevojave në procesin e pranimit të të burgosurve;
- Të sigurojë kryerjen e rishikimeve/rivlerësimeve të rregullta për të kontrolluar nëse të burgosurit vazhdojnë të jenë në vendin e duhur;
- Të komunikojë rregullisht me të gjithë të burgosurit dhe t'u kushtojë vëmendje të veçantë individëve vulnerabël, për të kuptuar më mirë problemet me ndarjen e qelive;
- Të diskutojë ndarjen e të burgosurve në burgje me individët në burg, lidhur me marrjen parasysh të afërsisë me shtëpinë/vendin e rehabilitimit social të tyre dhe nëse ka një vend tjetër që mund të mbështesë më mirë rehabilitimin e tyre;

6 Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (2012): Water, Sanitation, Hygiene and Habitat in Prisons – Supplementary Guidance, chapter 3. Living Quarters and Capacity

7 <https://rm.coe.int/pc-cp-2018-1-e-rev-2-epr-2006-ëith-changes-and-commentary-22-may-2018/16808add21>

8 *Mursic v. Croatia* App. No 7334/13 (20.10.2016).

- Të marrë parasysh vendndodhjen e familjarëve ose kontakteve të tjera kur diskutohen transferimet e mundshme të të burgosurve me zyrtarët gjyqësorë duke theksuar rëndësinë e vendosjes së tyre afër familjes;
- Të mbajë shënime të sakta dhe marrë masat e duhura për të garantuar kalimin pa probleme dhe në kohë nga një status në tjetrin (p.sh., nga paraburgimi në burgim, nga një nivel sigurie në një tjetër); dhe
- Të sjellë në vëmendjen e drejtuesve të burgut çështjet e mbipopullimit të të burgosurve dhe problemet e lidhura me to.

→ Përmendja e të dhënave është një mundësi e mirë për të nxjerrë në pah disa praktika të mira në lidhje me privatësinë dhe menaxhimin e të dhënave, në përputhje me Rregullën 9. E një rëndësie të veçantë për çdo sistem të menaxhimit elektronik të të dhënave — por edhe në sistemin e bazuar në letër - është çështja se kush ka akses në të dhënat dhe në çfarë rrethanash. Rregulla 9 mbulon procedurat që duhet të kryejnë të burgosurit për të kërkuar të dhëna që kanë lidhje me ta.

Fëmijët përbëjnë një grup veçanërisht vulnerabël dhe menaxhimi i të dhënave për fëmijët (qoftë kur janë të privuar nga liria, kur qëndrojnë me njërin prind apo kur bëjnë vizita) kërkon kujdes të shtuar. Personeli duhet të jetë veçanërisht i kujdesshëm lidhur me llojin e informacioni që kërkon dhe nëse është e nevojshme që ky informacion të ruhet.

USHTRIM I REKOMANDUESHËM

Administratat e burgjeve dhe ndarja e kategorive — sfida praktike

Nëse e lejon koha, do të ishte e dobishme të kishte disa diskutime pragmatike mbi sfidat praktike me të cilat përballen administratat e burgjeve në lidhje me ndarjen e kategorive.

Ose:

Vendosni skenarët e mëposhtëm në mur dhe kërkojuni pjesëmarrësve të ecin përreth dhe të ngjisin shënime me ide se si do ta trajtonin situatën.

1. Ambientet e caktuara për të paraburgosurit janë plot dhe së shpejti vjen një grup i madh të paraburgosurish.
2. Shtretërit në seksionin e shëndetësisë janë plot, por ka edhe të burgosur të tjerë që kanë nevojë për kujdes mjekësor.
3. Nuk ka më hapësirë në seksionin e fëmijëve në konflikt me ligjin.
4. Qelitë që janë të pajisura posaçërisht për të strehuar personat me aftësi të kufizuara janë të gjitha plot, por priten dy persona të tjerë që kanë nevojë për qeli të tilla.

Më pas, lehtësoni një diskutim se çfarë duhet bërë/mos bërë në këto situata; cilat janë rreziqet; çfarë masash mbrojtëse mund të merren; dhe kush duhet të jetë përgjegjës për marrjen e vendimeve në këto raste. Kur është e nevojshme, pjesëmarrësit duhet të mbështeten në përvojat e tyre.

Ose:

Shfaqni skenarin e UNODC-së për akomodimin e të burgosurve për të nxitur diskutimin.

Izolimi mjekësor dhe karantina në kontekstin e COVID-19 dhe sëmundjeve të tjera infektive.

Në dritën e pandemisë COVID-19, është e rëndësishme të jemi të qartë për dallimet midis termave “karantinë” dhe “izolim mjekësor”, dhe se si këto lidhen me izolimin në burg. Ky shpjegim është, gjithashtu, i rëndësishëm për mënyrën se si përdoren këto terma në kontekstin e sëmundjeve të tjera infektive.

‘**Karantina**’ përfshin kufizimin e lëvizjes, ose ndarjen nga pjesa tjetër e popullatës, të njerëzve të shëndetshëm që mund të jenë ekspozuar ndaj virusit [koronavirus], me objektivin për të monitoruar simptomat e tyre dhe për të siguruar zbulimin e hershëm të rasteve.⁹ Në burgje, karantina është përdorur kryesisht për pranimet e reja në burg ose për personat që kthehen nga aktivitetet e jashtme.

“**Izolimi mjekësor**” është termi që përdoret për izolimin e personave që kanë simptoma të sëmundjeve infektive ose atyre me diagnozë paraprake të sëmundjeve infektive që janë ende simptomatikë. Siç e bën të qartë OBSH-ja, vendimet për vendosjen e njerëzve në izolim mjekësor duhet të bazohen në nevojën mjekësore për shkak të një vendimi klinik.¹⁰ Nënkomiteti për Parandalimin e Torturës (SPT) u ka kërkuar Shteteve Palë të “[para]ndalojnë përdorimin e izolimit mjekësor në formën e izolimit disiplinor; izolimi mjekësor duhet të bëhet në bazë të një vlerësimi mjekësor të pavarur, proporcional, me kohë të kufizuar dhe sipas masave mbrojtëse procedurale.”¹¹

“**Izolimi**” përkufizohet si izolimi i njerëzve në burg për 22 orë, ose më shumë në ditë, pa kontakt njerëzor kuptimplotë (RREGULLA 44). Izolimi në vetmi duhet të përdoret vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe si mjeti i fundit, për një kohë sa më të shkurtër të jetë e mundur, dhe duhet të jetë objekt i rishikimit të pavarur. Izolimi në vetmi ndalohet për disa kategori të burgosurish (RREGULLA 45), duke përfshirë gratë shtatzëna, gratë me foshnja dhe nënat që kanë fëmijë në gji në burg (RREGULLA 22 i BANGKOK-ut). Izolimi i zgjatur” (izolim për 15 në vetmi ditë ose më shumë (RREGULLA 44) është tërësisht i ndaluar (RREGULLA 43).

Nëse individët mbahen në karantinë ose masa të izolimit mjekësor për 22 orë ose më shumë në ditë pa kontakt njerëzor kuptimplotë, kjo do të rezultojë në izolim në vetmi *de facto*. Duhet të merren masa për të siguruar që kjo të mos ndodhë. Kjo mund të arrihet duke respektuar masat e mëposhtme:

- Çdo formë mbylljeje, izolimi ose karantine duhet të vendoset vetëm si mjeti i fundit dhe bazuar në vlerësime të pavarura mjekësore. Së pari duhet të merren mjete alternative për parandalimin e infeksioneve.
- Çdo mbyllje, bllokim, izolim ose karantine duhet t’u përmbahet standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, si dhe duhet të merren masa për të zbutur ndikimet negative.
- Çdo kufizim i tillë duhet të vendoset për kohën më të shkurtër të mundshme dhe të rishikohet rregullisht nga personeli i kujdesit shëndetësor.

9 Considerations for quarantine of individuals in the context of containment for coronavirus disease (CoviD-19)”, OBSH, 19 mars 2020.

10 https://www.euro.who.int/data/assets/pdf_file/0020/438041/Covid19-PrisonsChecklist-eng.pdf.

11 [Advice of the Subcommittee on Prevention of Torture to States Parties and National Prevent Mechanisms relating to the Coronavirus Pandemic, SPT, 25 mars 2020.](#)

- Çdo masë e vendosur për shkak të sëmundjeve infektive (dhe arsytet për ta bërë këtë) duhet t'u komunikohen në mënyrë transparente dhe të qartë personave të prekurve.
- Çdo mbyllje ose formë veçimi nuk duhet të përbëjë izolim të zgjatur, siç përcaktohet dhe rregullohet nga Rregullat e Nelson Mandelës.
- Çdo vendim për të izoluar dikë bazuar në baza mjekësore duhet t'i përmbahet etikës mjekësore, Rregullave të Nelson Mandelës dhe standardeve të tjera ndërkombëtare, dhe në mënyrë specifike t'u përmbahet parimeve të ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.
- Çdo veçim, izolim ose karantinë duhet (i) të përdoret vetëm sipas nevojës bazuar në arsye mjekësore, (ii) të kryhet në kushte që janë sa më afër regjimit të rregullt dhe (iii) të jetë qartësisht i dallueshëm nga kushtet e izolimit në vetmi.
- Një person i infektuar duhet të strehohet në një institucion të përshtatshëm mjekësor; izolimi në qeli individuale nuk është kujdes i duhur shëndetësor.
- Duhet të merren masa proaktive për të zbutur dhe lehtësuar ndikimet negative të mbylljeve ose veçimit të njerëzve të caktuar për arsye shëndetësore, duke përfshirë kontaktet e përditshme me personelin e kujdesit mendor dhe lehtësimin e kontakteve njerëzore kuptimplote.
- Personat e veçuar duhet të kenë akses të lirë në komunikim me familjet e tyre, televizionin, materialet për lexim, etj.
- Në rastet kur merren masa për kufizimin e kontakteve me botën e jashtme, ato duhet të kufizohen në kohë dhe të rishikohen rregullisht.
- Personat në burg duhet të kenë kontakte me përfaqësuesit e tyre ligjore, nëse jo personalisht, përmes mjeteve të tjera, pa kufizime dhe me nivelin e përcaktuar të privatësisë për të përmbushur parimin e privilegjit avokat-klient (konfidencialiteti).
- Organeve monitoruese duhet t'u jepet akses i plotë dhe i papenguar në vendet e burgimit, duke përfshirë njerëzit në izolim, ku duhet të merren masa parandaluese për të siguruar respektimin e parimit “mos bëj dëm”.

2.3 KUSHTET E BURGUT DHE SHËRBIMET BAZË

1 ORË 15 MIN
NMR 12-23

Kur autoritetet privojnë një individ nga liria, ata marrin përsipër përgjegjësinë për të siguruar nevojat e tij themelore dhe për të mbrojtur dhe promovuar shëndetin e tyre fizik dhe mendor. Në mënyrë që të përmbushë detyrën për kujdes dhe detyrimin për të respektuar dinjitetin njerëzor të të burgosurve, shteti duhet të plotësojë kërkesat më themelore të kushteve humane të burgut dhe ofrimit të mallrave dhe shërbimeve bazë. Këto aspekte të jetës së burgut janë shpesh më të rëndësishmet për të burgosurit dhe mund të shënjojnë jetën e tyre në burg. Kjo vërtetohet nga fakti se shumë ankesa të të burgosurve kanë të bëjnë me cilësinë e ushqimit, ujin, sipërfaqen e hapësirës dhe pastërtinë, etj.

Shumë aspekte të kushteve të burgimit/ofrimit të shërbimeve përcaktohen nga dizajni/arkitektura e burgut si dhe buxheti i institucionit dhe janë jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë të personelit të burgut, p.sh., madhësia e qelive, nivelet e mbipopullimit, cilësia e ushqimit ose qasja në ujë të freskët. Megjithatë, mbeten edhe shumë gjëra praktike që personeli i burgut mund të bëjë për të lehtësuar këto probleme.

Kur mendojmë për gjërat themelore të akomodimit të të burgosurve, duhet të kemi parasysh sa vijon:

➔ Kjo listë mund të jetë rezultat i rrahjes së mendimeve.

- Lloji, madhësia dhe hapësira minimale e qelisë për të burgosur
- Ndriçimi
- Ngrohja dhe ftohja
- Ventilimi
- Kushtet e tualetit
- Instalimet e banjës dhe dushit
- Pastërtia e godinave
- Higjiena personale
- Veshja
- Shtrati dhe shtresat e fjetjes
- Ushqimi
- Uji
- Sportet dhe ushtrimet

Të gjitha këto shërbime bazë mund dhe duhet të përshtaten me nevojat specifike të individëve. Gjithashtu, duhet të ketë edhe analiza të asaj që ofrohet bazuar në standardet në fuqi për këtë komunitet.

USHTRIM
15 MINUTA

Cilat janë çështjet kryesore (nga sa më sipër) për të cilat ankohen njerëzit në burg në institucionet tuaja dhe pse? Këto mund të jenë ankesa formale ose joformale. A korrespondojnë këto çështje me problemet e identifikuara nga personeli i burgut? Cilat janë implikimet për sigurinë? A ndikojnë ato edhe në rehabilitimin me sukses të të burgosurve? Si janë shërbimet dhe mallrat që ofrohen në burg në krahasim me ato të komunitetit?

➔ Nëse grupi ka nevojë për energji ose nëse njerëzit nuk janë në favor të diskutimeve të hapura në grup, ky ushtrim mund të bëhet edhe duke shkruar këtë listë në copa letre të veçanta të shpërndara nëpër sallë dhe duke u kërkuar pjesëmarrësve të shënojnë çështjet për të cilat ankohen të burgosurit.

- Pjesëmarrësit nuk duhet të kufizojnë përgjigjet e tyre në ankesat zyrtare, por duhet të marrin në konsideratë llojet e çështjeve për të cilat njerëzit në burg ankohen në mënyrë joformale në baza të rregullta, ose që ata mund të kenë vërejtur si të pakënaqshme/të këqija.
- Mos harroni se kushtet e jetesës së personelit, veçanërisht ata që jetojnë në mjediset e burgut, mund të jenë të ngjashme me kushtet e jetesës së të burgosurve. Për shembull, personeli mund të hajë të njëjtin ushqim si të burgosurit dhe mund të ketë probleme të ngjashme me ngrohjen, ndriçimin, ventilimin, etj. Kjo duhet të përfshihet në diskutime.
- Jini të vetëdijshëm edhe për standardet e përgjithshme të jetesës në komunitet si dhe kushtet klimatike. Për shembull, lloji i shtratit dhe shtresave të përdorura ndryshojnë nga vendi në vend, kështu që lloji i shtratit të ofruar duhet të jetë i ngjashëm me atë që përdoret nga komuniteti.

20 MINUTA **Çfarë thonë rregullat?**

USHTRIM Kërkojuni pjesëmarrësve të gjejnë dhe të përmbledhin informacionin përkatës në Rregullat e Nelson Mandelës dhe Rregullat e Bangkok-ut në lidhje me disa nga çështjet që vijnë:

- | | |
|----------------------------------|----------------------------------|
| • Akomodimi | • Higjiena personale |
| • Dritaret | • Veshjet |
| • Drita | • Shtrati dhe shtresat e fjetjes |
| • Mjediset sanitare | • Ushqimi |
| • Instalimet e vaskës dhe dushit | • Uji i pijshëm |
| • Pastrimi | • Ushtrimet dhe sporti. |

Kërkojuni pjesëmarrësve të lexojnë me zë ato që gjetën në Rregulla.

→ Nuk do të ketë kohë për të mbuluar të gjitha këto fusha, kështu që zgjidhni atë që keni kohë. Ushtrim mund të zhvillohet si në formën e konkursit për të aktivizuar pjesëmarrësit dhe për të parë se kush mund ta gjejë rregullën përkatëse më parë. Ata që e gjejnë Rregullën të parë mund t'u jepet një "çmim". Përgjigjet duhet të përfshijnë:

Akomodimi - të gjitha akomodimet, dhe në veçanti të gjitha vendet e fjetjes duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat shëndetësore.

Dritaret – duhet të jenë mjaftueshëm të mëdha për t'u mundësuar njerëzve në burg të lexojnë ose të punojnë në dritë natyrale dhe të jenë ndërtuar për të lejuar hyrjen e ajrit të pastër.

Drita – duhet të sigurohet dritë artificiale e mjaftueshme që të burgosurit të lexojnë ose të punojnë.

Objektet sanitare - të përshtatshme për t'i mundësuar çdo personi në burg që të përmbushë nevojat e natyrës kur është e nevojshme dhe në mënyrë të pastër dhe të denjë.

Instalimet e vaskës dhe dushit – duhet të sigurohen ambiente të përshtatshme në mënyrë që çdo person në burg të mund të ketë një vaskë ose dush, në një temperaturë të përshtatshme për klimën, atëherë shpesh sa është e nevojshme për higjienën e përgjithshme.

Pastrimi – të gjitha pjesët e një burgu që përdoren nga njerëzit në burg duhet të jenë të mirëmbajtura dhe të mbahen pastër gjatë gjithë kohës.

Higjiena personale – njerëzit në burg duhet të pajisen me ujë dhe sende tualeti për të qenë në gjendje të mbahen pastër dhe të shëndetshëm; duhet të sigurohen ambiente për kujdesin e duhur të flokëve dhe mjekrës dhe burrat duhet të jenë në gjendje të rruhen rregullisht. Rregullat e Bangkokut thonë se strehimi i grave të burgosura duhet të sigurojë pajisje dhe materiale për të përmbushur nevojat specifike të higjienës së grave, përfshirë peceta higjienike falas dhe furnizim të rregullt me ujë për kujdesin personal të fëmijëve dhe grave, veçanërisht atyre që merren me gatim dhe atyre që janë shtatzënë, me fëmijë në gjë ose me menstruacione.

Veshjet – të gjithë njerëzit në burg që nuk lejohen të veshin rrobat e tyre duhet të pajisen me veshje të përshtatshme për klimën dhe të përshtatshme për t'i mbajtur ata në gjendje të mirë shëndetësore. Veshjet në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë degraduese

apo poshtëruese. Të gjitha veshjet duhet të mbahen të pastra dhe në gjendjen e duhur. Veshjet e brendshme duhet të ndërrohen dhe lahen aq shpesh sa është e nevojshme.

Shtrati – çdo person në burg duhet të pajiset me një shtrat të veçantë dhe me shtresa të veçanta, të mjaftueshme dhe të pastra, të mbajtura në rregull, të cilat duhet të ndërrohen shpesh për të siguruar pastërtinë.

Ushqimi – çdo personi në burg duhet t'i sigurohet nga administrata e burgut, në orët e zakonshme, ushqim me vlera ushqyese të përshtatshme për shëndetin dhe fuqinë, me cilësi të pacenuar dhe të përgatitur e të servirur mirë.

Uji i pijshëm – uji i pijshëm duhet të jetë i disponueshëm për çdo person në burg sa herë që ka nevojë.

Ushtrimet dhe sporti - çdo person në burg që nuk është i punësuar në mjedis të hapur, duhet të kryejë të paktën një orë ushtrim të përshtatshëm në ajër të pastër çdo ditë nëse e lejon moti.

Pse janë të rëndësishme këto?

Shëndeti i të burgosurve

Sigurimi i nevojave themelore shëndetësore të personave në burg; mbrojtja nga sëmundjet e rënda apo edhe vdekja dhe reduktimi i pabarazive shëndetësore.

Dinjiteti i të burgosurve

Kushtet nuk duhet të nënvlerësojnë respektin për dinjitetin e të burgosurve si qenie njerëzore; mbrojtja nga kushtet e jetesës që përbëjnë trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtërues.

Respekti i të burgosurve për vetveten

Kushtet e mira të burgut dhe aksesit në mallrat dhe shërbimet bazë janë thelbësore për ruajtjen e vetërespektit dhe respektit të të burgosurve për njëri-tjetrin.

Shëndeti i komunitetit

Nëse shëndeti i të burgosurve nuk mbrohet, ata mund të përbëjnë kërcënim për shëndetin publik kur të lirohen nga burgu dhe të jetojnë në komunitet.

Siguria e burgut

Kushtet e këqija të burgimit dhe problemet me ofrimin e shërbimeve bazë mund të çojnë në trazira në burg dhe në marrëdhënie të acaruar midis të burgosurve dhe personelit. Përmirësimi i kushteve çon në kushte më të mira dhe më të sigurt pune për personelin.

Rehabilitimi

Sigurimi i shëndetit dhe mirëqenies bazë të të burgosurve është një element thelbësor i rehabilitimit dhe riintegritit të tyre të ardhshëm.

Buxheti

Rritja e pjesës së buxhetit për kushtet e burgut dhe shërbimet bazë në afat të shkurtër mund të çojë në kursime buxhetore afatgjata lidhur me shëndetin e të burgosurve, mirëqenien dhe sigurinë e burgjeve.

USHTRIM

Si mund të ndikojnë në shëndetin e të burgosurve kushtet bazë/ofrimi i shërbimeve në burg:

Pyesni për çështjet e mëposhtme dhe rreziqet që ato paraqesin.

- **Mbipopullimi dhe ventilimi i dobët:** përhapja e sëmundjeve infektive si COVID-19 dhe tuberkulozi
- **Mungesa e ambienteve sanitare, shtratit dhe veshjeve të pastra:** përhapja e parazitëve dhe sëmundjeve të lëkurës
- **Klima e ftohtë/mungesa e shtratit/veshjes:** pneumoni/hipotermi. Kur ka pak njerëz në një bllok të madh qelish, kjo mund të nënkuptojë se është shumë ftohtë në qeli
- **Klima e nxehtë/mungesa e ajrosjes:** sëmundje/vdekje të lidhura me nxehtësinë
- **Privimi nga ushtrimet fizike/drita e diellit/ajri i pastër:** humbja e tonit të muskujve dhe mungesa e vitaminave
- **Mungesa e ujit të pijshëm:** dehidratim dhe dëmtim serioz i shëndetit
- **Kushtet e këqija të burgimit/mungesa e aksesit në shërbime në përgjithësi:** mund të çojnë në probleme serioze të shëndetit mendor
- **Mungesa e sendeve (adekuate ose të pastra) sanitare dhe aksesit në ujë për gratë me menstruacione:** mund të çojë në infeksione dhe probleme të tjera shëndetësore

COVID-19 dhe ofrimi i shërbimeve/kushteve bazë të burgimit

Gjatë diskutimeve mbi kushtet e burgimit/ofrimit të shërbimeve bazë, prezantoni disa debate se si COVID-19 ndikoi në aftësinë e administratave të burgjeve/personelit të burgjeve për të përmbushur këto nevoja bazë. Mblidhni opinionet e pjesëmarrësve se si burgjet mundën të kapërcenin sfidat e krijuara nga COVID-19 dhe mësimet e nxjerra për të ardhmen.

Idetë për diskutim mund të përfshijnë:

- Disinfeksimi i njësive të akomodimit të të burgosurve
- Higjienizimi i zonave të përbashkëta, duke përfshirë ato që përdoren nga personeli
- Ventilimi i hapësirave të brendshme, duke përfshirë automjetet e transportit të të burgosurve
- Furnizimi me sapun, dezinfektues të duarve dhe sende të tjera higjienike
- Furnizimi me ujë

Kushtet e paraburgimit që mund të përbëjnë trajtim çnjerëzor ose poshtërues apo edhe torturë

Nëse ngrihet çështja, shembujt përfshijnë:

- Izolimi në vetmi, veçimi i zgjatur, krahas kushteve të këqija materiale (p.sh. mungesa e ajrosjes, qelitë e vogla, mungesa e privatësisë) mund të përbëjnë keqtrajtim apo edhe torturë
- Mbipopullimi i kombinuar me kushte të këqija materiale dhe/ose kujdes të papërshtatshëm mjekësor
- Kushte burgimi që nuk plotësojnë nevojat e njerëzve me probleme të veçanta mjekësore (p.sh., kur ata nuk mund të shkojnë lehtësisht në tualet ose të ruajnë higjienën personale)

USHTRIM
15 MINUTA

Kushtet e burgimit

Në varësi të zonave të identifikuara më herët si problematike në juridiksionin e caktuar, Përdor një ose dy nga skenarët përkatës në trajnimin e UNODC-së (mbi akomodimin e të burgosurve, higjienën dhe pastërtinë, ushqimin dhe ujin e pijshëm, veshjet dhe shtratin) [UNODC e-learning course](#) dhe diskutoni.

Ose:

Ndani pjesëmarrësit në grupe dhe kërkojuni të identifikojnë një problem të jetës reale që kanë përjetuar në lidhje me një nga fushat e mësipërme, për të shqyrtuar se si e trajtuan situatën dhe diskutoni me të gjithë grupin.

➔ Nëse grupet e kanë të vështirë të gjejnë një skenar të jetës reale, jepuni atyre një nga skenarët e mëposhtëm dhe kërkojuni të identifikojnë hapat që mund të ndërmarren personeli i burgut.

- **Ushqimi.** Njerëzit në burg ankohen se nuk kanë ushqim të mjaftueshëm me vlera ushqyese. Personeli i burgut është dakord, por kjo lidhet me buxhetin ditor për ushqimin e të burgosurve. A ka ndonjë gjë që mund të bëjë personeli?
- **Pastrimi.** Akomodimi dhe ambientet e përbashkëta të të burgosurve nuk janë mjaftueshëm të pastra. Çfarë mund të bëjë personeli i burgut për të ndryshuar situatën?
- **Drita dhe ajrimi.** Dritaret e qelisë janë shumë të vogla dhe nuk lejojnë shumë dritë ose ajër. Çfarë mund të bëjë personeli?
- **Veshje dhe mbulesat për fjetje.** Në burg nuk ka ambiente lavanderie dhe të burgosurit nuk i lajnë rrobat e tyre aq shpesh sa duhet. Çfarë mund të bëjë personeli i burgut?

Zgjidhje specifike që mund të ngrihen/mund të shtohen për të lehtësuar shkëmbimet e mendimeve dhe diskutimet

Të përgjithshme

- Dëgjoni dhe bisedoni me njerëzit në burg për të kuptuar plotësisht problemet e tyre dhe për të diskutuar idetë lidhur me çfarë mund të përmirësohet (qasjet dinamike ndaj sigurisë).
- Sigurohuni që të kenë marrë të gjithë informacionin dhe të kuptoni të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me kushtet e burgut dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve.
- Vizitoni shpesh qelitë dhe pjesët e tjera të burgut për të vlerësuar kushtet e burgimit si cilësia e ajrit, drita, ngrohja, ajrimi dhe pastërtia.
- Shqyrtoni rregullisht të dhënat zyrtare të ankesave dhe rekomandimet nga organet monitoruese.
- Ngrini shqetësimet me pjesën tjetër të personelit dhe tërhiqni vëmendjen e drejtuesve të burgut për zgjidhjen e tyre.

Ushqimi

- Flisni me personelin/të burgosurit përgjegjës për përgatitjen dhe shpërndarjen e ushqimit për të identifikuar problemet dhe zgjidhjet e mundshme.
- Bisedoni me zyrtarët shëndetësorë të burgut për cilësinë e ushqimit dhe mundësitë për ushqim më të pasur me vlera ushqyese.

- Ngrini çështjen e mungesës së ushqimit me drejtuesit e burgut dhe diskutoni nëse ka ndonjë mundësi për ri-shpërndarjen e zërave të buxhetit në funksion të sigurimit të ushqimit të përshtatshëm për të burgosurit.
- Flisni me njerëzit në burg për cilësinë e ushqimit dhe higjienën; vëzhgoni nëse të gjithë njerëzit në burg marrin të njëjtën sasi ushqimi.
- Vëzhgoni zakonet e të ngrënit të njerëzve në burg - a shpërdorohet ushqimi? A varen ata nga ushqimi që sjellin familjarët?
- Diskutoni nëse mund të bëhet ndonjë ndryshim në oraret e vakteve?
- Diskutoni me drejtuesit nëse është e mundur të prodhohet më shumë ushqim nga të burgosurit dhe nëse të burgosurit mund të përfshihen më shumë në rritjen/prodhimin/planifikimin dhe gatimin e ushqimit.
- Lejoni familjet/komunitetet/OJQ-të të dhurojnë ushqim për të burgosurit nëse autoritetet nuk mund të mbulojnë nevojat e tyre bazë; hiqni pengesat e panevojshme për dhurimin e ushqimit (përfshirë kërkesat për të paguar).
- Të trajtohet çdo çështje korrupsioni lidhur me sigurimin e ushqimit.

Pastrimi

- Flisni me njerëzit në burg për pastrimin për të kuptuar pse akomodimi/zonat e përbashkëta të burgut nuk mbahen të pastra/shpjegoni pse pastërtia është e rëndësishme.
- Diskutoni nëse pjesë të veçanta të objektit mund të kenë nevojë për një pastrim të thellë dhe të plotë për të mundësuar mbajtjen e rregullit e të pastërtisë.
- Sigurohuni që njerëzit në burg të jenë të vetëdijshëm për përgjegjësitë e tyre në lidhje me ruajtjen e pastërtisë së mjediseve/zonave të tjera dhe që të jenë të qartë rreth ndarjes së përgjegjësisë midis personelit dhe të burgosurve në këtë fushë.
- Sigurohuni që ata që janë përgjegjës për pastrimin të kenë materialet që u nevojiten dhe të kenë marrë çdo trajnim të nevojshëm.
- Shikoni mundësinë e një liste pastrimi dhe caktoni të burgosurit në detyrat specifike
- Diskutoni stimujt për të shpërblyer dhe inkurajuar sjelljet pozitive dhe jo ndëshkimet për sjellje negative.
- Jepni shembullin pozitiv duke i mbajtur të pastra hapësirat e personelit/mjediset e përbashkëta.

Drita dhe ajrosja

- Kaloni kohë në dhomat e të burgosurve për të kuptuar problemet me të cilat përballen njerëzit në burg sa i takon dritës dhe ajrosjes.
- Sigurohuni që njerëzit në burg të kenë njëfarë kontrolli mbi ndriçimin dhe ajrosjen në qelitë e tyre. A janë çelësat e dritës brenda qelive? A kanë mundësi të burgosurit të hapin dhe mbyllin dritaret dhe grilat e tyre? (Vini re se kjo mund të jetë objekt i mosmarrëveshjeve midis të burgosurve në dhomat e përbashkëta dhe personelit të burgut mund t'i duhet të ndërmjetësojë).
- Sigurohuni që personeli i kujdesit shëndetësor të përfshihet, gjithashtu, në inspektimet e rregullta të niveleve të dritës dhe ajrimit dhe në diskutimet për çdo problem me drejtuesit e burgut.

- Shqyrtoni mënyrat për të përmirësuar ndriçimin dhe ajrosjen në qeli, duke përfshirë përmirësimin e dritës/ajrimit natyror ose instalimin e dritës artificiale dhe ventilimit mekanik.

Veshjet dhe shtresat e fjetjes

- Sigurohuni që të gjithë njerëzit në burg të kenë shtrat dhe veshje të pastra, të përshtatshme dhe në gjendje të mirë që në ditën e parë të pranimit në institucion.
- Flisni me ta për të kuptuar ndonjë problem specifik me të cilin përballen në lidhje me veshjen dhe shtratin.
- Nëse në burg ka lavanderi, mësoni për oraret e të burgosurve për të ditur nëse kanë ndonjë problem; nëse i lajnë vetë rrobat e tyre, zbuloni se kur janë në gjendje ta bëjnë këtë dhe nëse ka ndonjë problem në lidhje me oraret e caktuara/qasjen në lavatriçe, ujë, etj.
- Nëse ka probleme të rëndësishme, bisedoni me drejtuesit e burgut për të parë nëse rrobat mund të jepen për t'u larë me kontratë, ose nëse mund të ndihmojnë organizatat e komunitetit lokal.
- Nëse nuk ka uniforma të mjaftueshme burgu që të gjithë të burgosurit të kenë veshje të pastra, diskutoni me kolegët dhe drejtuesit e burgut nëse njerëzit në burg mund të veshin rrobat e tyre dhe nëse familjet e tyre mund të ofrojnë veshje të pastra.

Konsiderata të veçanta — kushtet e burgut, mallrat dhe shërbimet bazë

Në varësi të dinamikës së trajnimit, ky ushtrim mund të kryhet në grupe të vogla. Secilit grup do t'i kërkohet të mendojë për konsiderata të veçanta për grupe të ndryshme dhe më pas t'u prezantojnë këto në seancë me të gjithë pjesëmarrësit.

Gjatë vlerësimit të cilësisë së kushteve të burgut dhe shërbimeve bazë, personeli i burgut duhet të jetë i vetëdijshëm se çdo person në burg, ose grupe të veçanta njerëzish në burg, mund të kenë nevoja specifike në lidhje me mbipopullimin dhe aksesin në mallrat dhe shërbimet bazë, duke përfshirë kërkesat dietike të grupeve të veçanta të të burgosurve. Për shembull:

Gratë dhe vajzat në burg – vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet nevojave higjienike dhe ushqimore të grave dhe vajzave në burg dhe në veçanti grave shtatzëna dhe nënave me fëmijë në gji. Gjithashtu, duhet t'i kushtohet vëmendje nevojave shëndetësore dhe higjienike të të burgosurave femra që kanë menstruacione dhe grave që kalojnë menopauzën. Kjo mund të përfshijë:

- Qasje të sigurt dhe të rregullt në ujë të nxehtë, ose të paktën qasje në ujë të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e tyre higjienike
- Qasje më e shpeshtë në ambientet e tualetit dhe dushit
- Qasje pa pagesë në artikujt e higjienës, duke përfshirë pecetat higjienike dhe masat e sigurta të asgjësimit të artikujve të përdorur
- Ushqimi suplementar për gratë shtatzëna, ato që sapo kanë lindur dhe nënat që ushqejnë fëmijët me gji
- Mundësi të përshtatshme të rregullta për t'u ushtruar dhe një mjedis të përshtatshëm për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji. Mundësi të sigurta për gratë për t'u ushtruar,

veçanërisht nëse ato janë të vendosura në një seksion/pjesë të burgut të burrave dhe ambientet sportive janë të përbashkëta.

Referojuni Rregullave të Bangkokut - në veçanti Rregullave 5 dhe 48.

Të burgosurit e moshuar ose me aftësi të kufizuara fizike - është e rëndësishme të sigurohet që të moshuarit në burg ose ata me aftësi të kufizuara fizike të jenë në gjendje të ushtrohen rregullisht dhe në mënyrë të përshtatshme në ajër të pastër dhe që të kenë akses në mallrat dhe shërbimet bazë. Nëse nuk janë në gjendje të ushtrohen në natyrë për shkak të paaftësisë ose shëndetit duhet të sigurohen kushte ose aktivitete rekreative alternative. Konsiderata të tjera për këto grupe mund të përfshijnë:

- Pajisjen e tyre me shtretër njëkatësh (është e vështirë për ta të ngjiten në katin e sipërm);
- Sigurimi i aksesit pa probleme në tualete dhe mjediset e banjave/dusheve;
- Sigurimi i komodimit të aksesueshëm (p.sh., pa shkallë) dhe pranë infermierisë së burgut apo shërbimeve të tjera;
- Sigurimi i dritës shtesë në rast të problemeve me shikimin;
- Ndërmarrja e rregullimeve strukturore si vendosja e parmakëve, rampave, etj.; dhe
- Monitorim më i shpeshtë i pastërtisë së qelisë/veshjeve/krevateve dhe dhënia e ndihmës nëse është e nevojshme (për shembull, kjo mund të jetë pasojë e humbjes së kujtesës).

Është e rëndësishme të theksohet se të gjithë njerëzit në burg janë të ndryshëm. Nuk duhet të supozohet se të gjithë të burgosurit e moshuar ose ata me aftësi të kufizuara fizike kanë nevojë të ngjashme. Disa prej tyre janë fizikisht dhe mendërisht po aq të aftë sa të rinjtë në burg dhe mund të mos kenë nevojë të veçanta që lidhen me moshën e shtyrë.

Konsiderata kulturore/fetare — Në disa burgje njerëzit janë të kombësive dhe kulturave të ndryshme. Disa ndjekin dieta ushqimore të caktuara për arsye fetare ose kulturore. Këto konsiderata mund të shtrihen edhe në kërkesat për veshje dhe shtratin, higjienën personale dhe pastrimin, duke përfshirë, për shembull, kujdesin për mjekrën dhe mundësinë për t'u rruar rregullisht.

Të burgosurit me probleme të shëndetit mendor — është e rëndësishme të mbahet parasysh se kushtet e shëndetit mendor të njerëzve në burg ndryshojnë shumë, prandaj dhe nuk duhet supozuar se nevojat do të jenë të ngjashme. Ka persona në burg me probleme të shëndetit mendor që nuk janë plotësisht në gjendje të kujdesen për veten dhe mjedisin përreth. Për rrjedhojë, personeli i burgut duhet të tregojë kujdes të veçantë që:

- Të burgosurve me probleme të shëndetit mendor t'u jepet ushqimi i duhur dhe që ata të konsumojnë ushqimin që u ofrohet;
- Ata të monitorohen më shpesh në lidhje me pastërtinë e qelive/krevateve/rrobave për t'u ardhur në ndihmë nëse është e nevojshme;
- Individët me probleme të shëndetit mendor të kenë mundësi për ushtrime fizike në ajër të pastër; dhe
- Të sigurohen nëse janë të aftë të kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me mallrat dhe shërbimet bazë.

Të burgosurit me probleme shëndetësore fizike — vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe aksesit në mallrat dhe shërbimet bazë personave me probleme shëndetësore fizike, përfshirë të burgosurit në objektet shëndetësore të burgjeve. Këta të burgosur mund të kenë nevoja specifike ushqimore për shkak të gjendjes së tyre. Mund të jetë e nevojshme që ngrohja dhe ajrimi i brendshëm i objekteve shëndetësore të burgut të menaxhohet me kujdes dhe po ashtu edhe mundësia për ushtrime fizike për personat me probleme shëndetësore fizike.

➔ Më shumë informacion për kujdesin shëndetësor në burgje do të jepet në modulin e posaçëm të trajnimit për kujdesin shëndetësor (seksioni 7.1)

Konsiderata të veçanta - çfarë mund të bëjë personeli i burgut?

- Të monitorojë nga afër aksesin e individëve/grupeve të caktuara në mallrat dhe shërbimet bazë;
- Të punojë me personelin e kujdesit shëndetësor për harrimin e një plani dhe për rishqyrtimin e shpeshtë të regjimit; të marrë në konsideratë ushqimin, furnizimin me barna, etj.;
- Të konsultohet me kolegët që mund të kenë më shumë njohuri për nevojat e personave të caktuar në burg (p.sh., anëtarët e personelit nga grupet minoritare, ata që janë trajnuar për kujdesin ndaj shëndetit mendor); dhe
- Të nxisë krijimin e grupeve mbështetëse midis të burgosurve dhe të bashkëpunojë me grupet mbështetëse komunitare që ofrojnë mbështetje me mallra dhe shërbime bazë për grupe të veçanta (p.sh., OJQ-të që mbështesin gratë shtatzëna).

➔ Për më shumë informacion mbi konsideratat e veçanta për të burgosurit me nevoja të veçanta, mund t'i referoheni edhe: UNODC Handbook on Prisoners with Special Needs.

Konsiderata të veçanta — Rregullat, standardet dhe rekomandimet përkatëse

Të burgosurat gra

RREGULLA 5 “Në mjediset e të burgosurave gra duhet të ketë sende dhe materiale të nevojshme për të plotësuar nevojat specifike të higjienës së grave, përfshirë pecetat higjienike falas dhe furnizim të rregullt me ujë për kujdesin personal të fëmijëve dhe grave, veçanërisht grave që punojnë në kuzhinë, shtatzëna, që kanë fëmijë në gji ose që janë me menstruacione.”

RREGULLA 48 “1. Të burgosurat shtatzëna ose me fëmijë në gji do të mbështeten me këshilla për shëndetin dhe dietën, në bazë të një programi që do të hartohet dhe monitorohet nga një mjek i specializuar për këtë qëllim. Ushqimi adekuat dhe në kohë, mjedisi i shëndetshëm dhe mundësitë e rregullta për ushtrime fizike ofrohen pa pagesë për gratë shtatzëna, foshnjat, fëmijët dhe nënat që ushqejnë fëmijët me gji.

2. Gratë e burgosura nuk duhet të nxiten të shkëpusin fëmijët nga gjiri, përveç rasteve kur ka arsye të veçanta shëndetësore për ta bërë këtë.

3. Në programet e trajtimit do të përshihen edhe nevojat mjekësore dhe ushqimore të grave të burgosura që kanë lindur kohët e fundit, por foshnjat e të cilave nuk janë me të në burg.”

Të burgosurit e moshuar ose ata me aftësi të kufizuara fizike

Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

NENI 14 (2) “Shtetet Palë duhet të garantojnë që, nëse personat me aftësi të kufizuara dënohen me burgim, ata të gjenden në kushte të barabarta me të tjerët, të gëzojnë të gjitha garancitë sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe të trajtohen në përputhje me objektivat dhe parimet e kësaj Konvente, përfshirë sigurimin e akomodimit të arsyeshëm.”

Rekomandimi Nr. R (98) 7 i Këshillit të Evropës, Komiteti i Ministrave, lidhur me Aspektet Etike dhe Organizative të Kujdesit Shëndetësor në Burgje

“50. Të burgosurit me të meta të rënda fizike dhe ata të moshuar duhet të akomodohen në mënyrë të tillë që t'u mundësohet një jetë sa më normale dhe nuk duhet të ndahen nga popullata e përgjithshme e burgjeve. Duhet të bëhen ndryshime strukturore për të ndihmuar personat në karrige me rrota dhe personat me aftësi të kufizuara në linja të ngjashme me ato në mjedisin e jashtëm.”

Konsiderata kulturore/fetare

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD) Rekomandimi i Përgjithshëm XXXI për parandalimin e diskriminimit racor në administrimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë penale

“38. Kur personat që u përkasin grupeve të përmendura në paragrafin e fundit të preambulës vuajnë dënimin me burg, shtetet palë duhet:

(a) Të garantojnë për këta persona gëzimin e të gjitha të drejtave të të burgosurve sipas normave ndërkombëtare përkatëse, në veçanti të drejtat e përshtatura posaçërisht me situatën e tyre: të drejtën për respektimin e praktikave të tyre fetare dhe kulturore, të drejtën për respektimin e zakoneve të tyre për sa i përket ushqimit, të drejtën për marrëdhënie me familjet e tyre, të drejtën për t'u ndihmuar me përkthyes, të drejtën për përfitimet themelore të mirëqenies dhe, sipas rastit, të drejtën për ndihmë konsullore. Shërbimet mjekësore, psikologjike ose sociale që u ofrohen të burgosurve duhet të mbajnë parasysh prejardhjen e tyre kulturore;”

Bëni një përmbledhje të shkurtër të materialit në Modulin 2. Kërkojuni pjesëmarrësve të mendojnë për grupet e veçanta të njerëzve në burgun e tyre, të cilët kanë nevoja specifike, dhe të reflektojnë nëse burgu i ka të gjitha mjetet e nevojshme për të përmbushur këto nevoja. Në veçanti, kërkojuni atyre të reflektojnë mbi rolin e tyre në identifikimin dhe trajtimin e nevojave individuale.

5 MINUTA

Hyrje në sigurinë dinamike

Përpara se të filloni Modulin 3, prezantoni konceptin e sigurisë dinamike - një koncept që përshkon të gjithë kursin e trajnimit

Kini parasysh se disa vende kanë përkufizime të ndryshme për kuptimin e sigurisë dinamike.

Çfarë është siguria dinamike? Përkufizime

Shpërndani përkufizimet që keni nxjerrë dhe printuar nga materialet e modulit dhe në

mënyrë rastësore kërkojuni pjesëmarrësve të ngrihen në këmbë dhe t'ua lexojnë të tjerëve duke vënë në dukje **frazat** kryesore:

- personel vigjilent që njeh të burgosurit
- marrëdhënie pozitive me të burgosurit
- dijeni për ato që ndodhin në burg
- angazhimi me të burgosurit
- ndërveprim proaktiv dhe i shpeshtë

1. Rregullat Evropiane të Burgjeve Rregulla 51 (2):

*“Siguria nga barrierat fizike dhe mjete të tjera teknike duhet të plotësohet me sigurinë dinamike që ofrohet nga një **personel vigjilent që njeh të burgosurit** që kanë në kontroll.”*

2. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës Rec(2003)23, 18. a.

*“Ruajtja e kontrollit në burg duhet të bazohet në përdorimin e sigurisë dinamike, që është zhvillimi nga personeli i **marrëdhënieve pozitive me të burgosurit** bazuar në vendosmëri dhe drejtësi, duke kombinuar të kuptuarit e situatës së tyre personale dhe çdo rreziku që vjen nga të burgosurit individualë.”*

3. Manuali i UNODC-së për Sigurinë Dinamike dhe Shërbimin Informativ të Burgjeve (f.37)

*“Siguria varet, gjithashtu, nga personeli vigjilent që ndërvepron dhe i njeh të burgosurit në burgun e tyre; personeli që zhvillon marrëdhënie pozitive staf-i burgosur; personeli që **ka dijeni për atë që ndodh** në burg; trajtimi i drejtë dhe një ndjesi “mirëqenieje” ndër të burgosurit; si dhe personeli që merr masa që të burgosurit të jenë të angazhuar në aktivitete konstruktive dhe të kuptimshme, të cilat kontribuojnë në riintegrimin e tyre të ardhshëm në shoqëri.”*

4. Manuali i UNODC-së për drejtuesit e burgjeve (f.106)

*“**Angazhimi me të burgosurit** dhe njohja me ta mund t'i japë mundësi personelit të parashikojë dhe të përgatitet më mirë për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive çdo incidenti që mund të kërcënojë sigurinë e burgut dhe sigurinë e personelit dhe të të burgosurve.*

5. Reforma Penale Ndërkombëtare dhe ODIHR-i - Dokument Udhëzues mbi Rregullat e Nelson Mandelës (f.78)

*“Qasjet e sigurisë dinamike përfshijnë **ndërveprim proaktiv dhe të shpeshtë** ndërmjet personelit të burgut dhe të burgosurve. Kjo i lejon personelit të vëzhgojë të burgosurit dhe të mbledhë informacion. Një ndërveprim i tillë i rregullt siguron shenja paralajmëruese për incidente të mundshme dhe i lejon personelit të burgut të parashikojë dhe parandalojë problemet përpara se ato të shfaqen”.*

40 MINUTA

Siguria dinamike: cilësitë dhe aftësitë personale të personelit të burgut

Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe kërkojuni të diskutojnë për cilësitë dhe aftësitë personale që i nevojiten personelit të burgut për të kryer punën në mënyrë efektive, përfshirë edhe qasjet e sigurisë dinamike. Mendimet e tyre mund t'i shkruajnë në tabakë të bardhë. Kërkojini një personi nga secili grup të shpjegojë për grupin kryesor. Shtoni ndonjë cilësi të rëndësishme që ata nuk arrijnë të identifikojnë.

→ **Lexoni me zë RREGULLËN 74 (1)** që tregon se Rregullat e Nelson Mandelës e njohin natyrën sfiduese dhe të rëndësishme të punës në burg.

“Administrata e burgut duhet t'i përzgjedhë me kujdes punonjësit e çdo niveli, pasi administrimi i duhur i burgjeve varet nga **integriteti, humaniteti, kapaciteti profesional dhe përshtatshmëria** e personit për punën.”

RREGULLA 74 thekson, gjithashtu, se puna e personelit të burgut është një **shërbim social i një rëndësie të madhe** dhe se përfitimet dhe kushtet e shërbimit duhet të jenë të favorshme në përputhje me natyrën kërkuese të punës.

RREGULLA 76 (C) pranon rëndësinë e sigurisë dinamike dhe thekson në mënyrë eksplicite se ajo duhet të përfshihet në trajnimin e personelit.

SHITESË

Shfaq një ose më shumë video të shkurtra mbi aftësitë/cilësitë e nevojshme për personelin e burgut:

<https://www.youtube.com/watch?v=TRM4-aLKOdg> (1:30 minuta)

BURIME SHITESË

UNODC, Handbook on Dynamic Security and Prison Intelligence

Reforma Penale Ndërkombëtare, Global Prison Trends 2016, Special Focus. Prison Staff: Over- worked and Underpaid?

Reforma Penale Ndërkombëtare, Mental health in prison: A short guide for prison staff.

ICRC, Handbook on ageing and detention



MODULI 3
ORGANIZIMI DHE ADMINISTRATA
E BURGJEVE

3 ORGANIZIMI DHE ADMINISTRATA E BURGJEVE

MATERIALET

- Stilolaps dhe bllok shënimesh
- Faqet 22-32 në PowerPoint të printuara
- Lista e leximeve/burimeve shtesë
- Kopje e modelit të dosjes së të burgosurit, e përshtatur me rrethanat vendase sipas nevojës (shih faqen 71)
- Kopje e skenarit/rasteve imagjinare (shih faqen 73)
- Lista e rreziqeve gjatë transportimit të të burgosurve (shih faqet 76-77) e cila shpërndahet si fletëpalosje vetëm pas ushtrimit
- Përditësimi i dosjes model të të burgosurit (shih faqet 81–82)

10 MINUTA

HYRJE

Ky modul paraqet me hollësi rëndësinë e klasifikimit të të burgosurve dhe vlerësimeve të individualizuara të rrezikut dhe nevojave. Moduli nxjerr në pah se planet e dënimit duhet të bazohen tek nevojat, aftësitë dhe natyrat individuale. Për më tepër, moduli mbulon ndarjen e personave në burg dhe grupet që duhen ndarë nga njëri-tjetri. Gjysma e dytë e modulit trajton masat mbrojtëse që duhet të jenë në funksion gjatë transferimeve të të burgosurve dhe rëndësinë e menaxhimit të mirë të dosjeve. Pjesa e fundit trajton në mënyrë të posaçme situatën e të paraburgosurve.

OBJEKTIVAT MËSIMORE

Pas përfundimit të Modullit 3, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Përkrahin idenë që vlerësimet e rrezikut dhe nevojave si dhe planifikimi i dënimit duhet të jenë të individualizuara;
- Identifikojnë problemet në caktimin e të burgosurve dhe këshillojnë për ndarjen e duhur të tyre;
- Artikulojnë pse vendosja është kaq e rëndësishme në rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm të të burgosurve;
- Dëshmojnë se i kuptojnë mirë rreziqet e veçanta dhe ndikimet negative që lidhen me transportin e të burgosurve;
- Shpjegojnë pse menaxhimi i mirë i dosjeve të të burgosurve është kaq i rëndësishëm;
- Artikulojnë parimet kryesore që kanë të bëjnë me paraburgimin dhe konsideratat e veçanta; dhe
- Kuptojnë rolin e tyre në organizimin e përgjithshëm të burgjeve dhe se si kjo ndikon në trajtimin e personave në paraburgim.

3.1 PROCESET E PRANIMIT, KLASIFIKIMIT, VLERËSIMIT TË RREZIKUT DHE TË NEVOJAVE

1 ORË 10 MINUTA

NMR: 89, 93 DHE 94

RREGULLAT 89, 93 dhe 94 bëjnë të gjitha pjesë në Kapitullin II(A) të Rregullave të Nelson Mandelës (Rregullat e zbatueshme për të burgosurit që po vuajnë dënimin). Kjo për shkak se vlerësimi dhe klasifikimi i të paraburgosurve është i ndryshëm: ata duhet të prezumohen të pafajshëm dhe, edhe nëse janë dënuar tashmë, mund të mos i dinë ende detajet ose kohëzgjatjen e dënimit të tyre me burg.

Megjithatë, siç bëhet e qartë në Vëzhgimin Paraprak 2 të Rregullave, Rregullat në Kapitullin II (A) janë të zbatueshme njëloj për të paraburgosurit, me kusht që ato të mos bien ndesh me Rregullat që zbatohen për këto kategori dhe të jenë në dobi të tyre. Në vijim të këtij moduli do të paraqiten më shumë detaje në lidhje me paraburgimin, por ndërkohë më poshtë mund të gjeni disa parime:

- Të paraburgosurit duhet gjithashtu t'u nënshtrohen klasifikimeve dhe vlerësimeve të kujdesshme dhe të vazhdueshme të rrezikut dhe nevojave.
- Të paraburgosurit nuk duhet të përjashtohen nga programet arsimore dhe profesionale, por pjesëmarrja e tyre në këto programe nuk është e detyrueshme.
- Të paraburgosurit nuk duhet të mbahen në kushte më të këqija se të burgosurit e dënuar.

USHTRIM
20 MINUTA

Mbërritja në burg

Një e burgosur, Ronja Gustafsson, sapo ka mbërritur në burg. Kërkojini njërit prej pjesëmarrësve të luajë rolin e Ronjës dhe një tjetri të marrë rolin e zyrtarit që e shoqëron në burg. Ata largohen nga salla. Kur ata të jenë jashtë sallës, kërkojini grupit të rrahin idetë në lidhje me veprimet që duhet të kryhen me hyrjen në burg ose sa më shpejt të jetë e mundur pas pranimit. Caktojini pjesëmarrësve të tjerë secilin nga veprimet e identifikuar. Ndërsa Ronja futet në sallë, ajo do të takojë njerëz të ndryshëm dhe secili prej tyre do t'i shpjegojë asaj një veprim që do të ndërmerret sa më shpejt që të jetë e mundur pasi ajo të ketë hyrë në burg.

Bëni ndryshime në elementët e dosjes së të burgosurës dhe identitetin e Ronja Gustafsson në mënyrë që emri dhe kombësia e saj, etj., të jenë më të përshtatshme për kontekstin vendas.

Veprimet që duhet të përfshini (por jo domosdoshmërisht vetëm këto) janë si më poshtë. Në rast se ka pika, të cilat nuk janë identifikuar, paraqitini edhe ato:

- **Kontrolloni vlefshmërinë e urdhrit të ekzekutimit** —çdo urdhër ekzekutimi të cilit i mungon informacioni i kërkuar sipas përcaktimeve të RREGULLËS 7 duhet të konsiderohet i pavlefshëm (RREGULLA 7).
- **Kërkoni të dhënat e personit të kontaktit në rast urgjence dhe të afërmve** —i burgosuri i sapoardhur duhet të jetë në gjendje të informojë familjen ose personin tjetër të kontaktit për burgosjen e vet (RREGULLAT 68-69).
- **Pranimi regjistrohet në sistemin e regjistrimit të burgjeve** (RREGULLA 26).
- **Kryhet një inventar i sendeve në pronësi së individit** dhe çdo gjë që ai nuk lejohet ta mbajë me vete **duhet të ruhet në një vend të sigurt** (RREGULLA 67).
- Çdo person që pranohet në burg duhet të shihet dhe **ekzaminohet nga mjeku sa**

më shpejt të jetë e mundur pas pranimit (RREGULLA 30).

- **Kontrolli i të burgosurve** (nëse gjykohet i nevojshëm) (Ka të bëjë me RREGULLAT 50-52) i cili duhet të regjistrohet në mënyrën e duhur (RREGULLA 51).
- Të gjithë personave në burg duhet t'u jepen **informacione në lidhje me Rregullat, rregulloret, procedurat** dhe informacione të tjera sa më shpejt që të jetë e mundur pas pranimit.
- Vlerësimi fillestar i rrezikut dhe nevojave, dhe plani i dënimit (për ta përfshirë në planin e rehabilitimit) (RREGULLAT 89, 93, 94).
- **Klasifikimi i duhur dhe ndarja e përshtatshme** (RREGULLA 89).
- Krijimi i **dosjes individuale të të burgosurit** sa më shpejt të jetë e mundur (RREGULLA 26).
- Krijimi i **dosjes individuale mjekësore** (RREGULLA 30).

Veprime të tjera mund të përfshijnë:

- Ndonjë kërkesë apo shqetësim që ata/ato mund të kenë
- Ndonjë problem që mund të kenë me të tjerët në objektin ku ndodhen
- Testimi i drogës dhe alkoolit

10 MINUTA **Vlerësimet e rrezikut dhe nevojave**

Rreziqet

Kjo duhet të mbulojë rrezikun ndaj vetes, të tjerëve dhe ndaj sigurisë së përgjithshme të burgut.

Elementët që duhet pasur parasysh:

- Historiku kriminal dhe krimi për të cilin janë burgosur (p.sh., një historik krimesh seksuale ose dhune ndaj të tjerëve)
- Rreziku i kryerjes së një vepre tjetër penale
- Raste të mëparshme të vetëvrasjes/vetëlëndimit
- Rreziku i arratisjes
- Qëndrimet ndaj të burgosurve të tjerë/anëtarëve të personelit
- Mënyra e jetesës brenda burgut (p.sh., kontaktet sociale, sjellja e tërhequr)
- Personaliteti (p.sh., sjellja në burg, agresioni, raste të dhunës/sjelljes shpërthyesë, aftësia për t'u përshtatur me mjedisin e burgut dhe rregullat e burgut)
- Varësia nga droga ose alkooli
- Anëtarësimi/përkatësia në banda
- Përkatësia/lidhja me grupet ekstremiste të dhunshme

Nevojat

Vlerësimet duhet të kenë për qëllim të identifikojnë dhe adresojnë nevojat dhe dobësitë specifike të një individi, si për shembull:

- Kushtet e shëndetit mendor dhe fizik
- Rastet e mëparshme të viktimizimit, duke përfshirë raste të përdhunimit dhe dhunës seksuale
- Mbrojtja nga dhuna
- Parandalimi i vetëvrasjes dhe vetëlëndimit

- Çrregullime nga përdorimi i substancave
- Përgjegjësitë prindërore dhe për të tjera përkujdesjeje
- Nivelet e arsimit dhe shkrim-leximit
- Nevojat për mbështetje në kuptimin e gjuhës
- Ndihma e nevojshme për të kuptuar procedurat, rregullat dhe rregulloret e burgut

Pika të rëndësishme që stafi duhet t'i ketë parasysh në lidhje me nevojat dhe vlerësimet e rrezikut:

Rregullat e Bangkokut e bëjnë të qartë se administratat e burgjeve duhet të “zhvillojnë dhe zbatojnë metoda klasifikimi që adresojnë nevojat dhe rrethanat specifike gjinore të grave të burgosura” (RREGULLA 40 e Bangkokut). Për më tepër, këto vlerësime dhe klasifikime duhet “të marrin parasysh rrezikun që paraqesin gratë e burgosura për të tjerët, i cili përgjithësisht është më i ulët, si dhe efektet veçanërisht të dëmshme që masat e sigurisë së lartë dhe nivelet e larta të izolimit mund të kenë tek gratë e burgosura”. (RREGULLA 41 e Bangkokut).

Pika të tjera të rëndësishme për t'u pasur parasysh përfshijnë:

- Vlerësimet nuk duhet të bazohen asnjëherë vetëm në veprën e kryer ose në kohëzgjatjen e dënimit.
- Mjetet e vlerësimit duhet të standardizohen dhe të zbatohen në mënyrë të vazhdueshme.
- Duhet treguar kujdes i veçantë për të mos keqinterpretuar nevojat e një individi si faktorë rreziku (p.sh., kushtet e shëndetit mendor).
- Vlerësimet duhet të bazohen në të gjitha informacionet e disponueshme për personin e burgosur, duke përfshirë intervistat me vetë individët.
- Vlerësimet e rrezikut për të burgosurit që mund të klasifikohen me rrezik të lartë do të jenë domosdoshmërisht më të thelluara dhe do të zgjasin më shumë se vlerësimet e shumicës së autorëve të tjerë të krimeve.
- Thellësia e çdo vlerësimi duhet të përcaktohet nga niveli i rrezikut ose nevojave.
- Të gjitha vlerësimet e rrezikut dhe nevojave duhet të përsëriten, rishikohen dhe përditësohen rregullisht.
- Ato duhet të kryhen nga stafi që ka formimin e duhur dhe me kontributin e profesionistëve të specializuar, sipas nevojës.
- Vlerësimet duhet të bazohen në gjetje objektive - ata që kryejnë vlerësimet nuk duhet të ndikohen nga paragjykimet ose stereotipitë. Prandaj, sistemet duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit dhe rishikimit.
- Personat e burgosur duhet të jenë në gjendje të sfidojnë vlerësimet dhe klasifikimet e tyre.

Ekzistojnë kategori të ndryshme të rrezikut që lidhen me klasifikimin:

- Dëmtimi i vetvetes, i të burgosurve të tjerë, ose i njerëzve që punojnë ose vizitojnë burgun (rreziku i lidhur me dëmtimin)
- Kërcënimi ndaj rendit të mirë në burg (rreziku i lidhur me rendin)
- Mundësia e arratisjes (rreziku i lidhur me sigurinë)

- Rreziku i kryerjes së një vepre tjetër të rëndë gjatë lejes ose lirit nga burgju (rreziku i recidivizmit)
- Rreziku i nxitjes së kryerjes së veprave penale në komunitet në bashkëpunim me bashkëpunëtorë në botën e jashtme (rreziku i lidhur me krimin)

USHTRIM
15 MINUTA

Model i dosjes së të burgosurit

Ndajini pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe kërkojini që të identifikojnë cilat janë informacionet e rëndësishme që mungojnë në dosjen model të të burgosurve si më poshtë (kopje në grupet e tyre të pjesëmarrësve).

Qëllimi i këtij ushtrimi është që pjesëmarrësit të identifikojnë informacionet më të rëndësishme që duhen përfshirë në dosje. Trajnuesi duhet të shpjegojë se dosjet dhe sistemet e dosjeve të të burgosurve ndryshojnë nga një vend në tjetrin dhe shembulli i mëposhtëm nuk përfaqëson një 'dosje të përsosur'. Trajnuesi mund të dëshirojë të përshtatë elementët e dosjes së të burgosurit dhe identitetin e Mira Shpendit në mënyrë që emri dhe kombësia e saj, etj., të jenë më të përshtatshme për kontekstin vendas.

Ushtrimi lidhet gjithashtu me informacionin fillestar që duhet përfshirë në dosje - do të ketë një ushtrim pasues në vijim të modulit për të përcaktuar se çfarë lloj informacionesh duhet t'i shtohen dosjes në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë kohës së paraburgimit.

MODELI I DOSJES SË TË BURGOSURIT: BURGJU I GRAVE NË SHQIPËRI

Të dhënat personale

- Numri i të burgosurit / burgosurës: 716
- Emri: Mira Shpendi
- Gjinia: Femër
- Kombësia: Shqiptare
- Profesioni: Shitëse
- Numri i të burgosurit / burgosurës: 716
- Vendbanimi: Tiranë

Klasifikimi dhe caktimi

- Kategoria e sigurisë: Siguri e zakonshme

Familja

- Statusi familjar – E martuar (bashkëshorti i vdekur)

Vepra penale dhe statusi juridik

- Statusi juridik: E dënuar
- Vepra penale për të cilën është dënuar: Vrasja e bashkëshortit të saj
- Kohëzgjatja e dënimit: 20 vjet

Kontakti i jashtëm

- Të dhënat e kontaktit të avokatit: Irista Pëllumbi, ipëllumbi@gmail.com, +355 686868686
- Të dhënat e kontaktit me përfaqësuesit konsullorë
- Inventari i pasurisë personale
- Çdo lëndim i dukshëm ose ankesë për keqtrajtim të mëparshëm.

Informacione të rëndësishme që mund të shtohen në dosje:


- Mosha/datëlindja
- Gjuha kryesore e folur
- Data dhe ora e pranimi
- Caktimi në qelinë dhe bllokun e burgut
- Të afërmit dhe të dhënat e kontaktit në rast urgjence
- Të dhënat e kontaktit të familjarëve
- Fëmijët? Mosha, vendndodhja e fëmijëve, të dhënat e kujdestarisë ose mbrojtjes dhe të dhënat e kontakteve
- Data, ora dhe vendi i arrestimit dhe të dhënat e autoritetit që ka kryer arrestimin
- Data e dënimit
- Data e parashikuar e lirimit
- Precedentë penalë të mëparshëm
- Të dhëna në lidhje me apelimet
- Emri i përfaqësuesit konsullor dhe të dhënat e kontaktit
- Kontaktimi me përkthyesin (nëse nevojitet)

3.2 CAKTIMI I TË BURGOSURVE DHE NDARJA E KATEGORIVE

40 MINUTA

NMR: 11 DHE 59

Shpjegoni shkurtimisht konceptet e barazisë dhe paanësisë duke përdorur imazhin e ilustruar më poshtë: <https://interactioninstitute.org/illustrating-equality-vs-equity/>



Vendimet për caktimin e të burgosurve në ambiente specifike zakonisht nuk merren nga autoritetet e burgut. Ky vendim shpesh merret nga autoritetet gjyqësore, në bazë të identitetit të të burgosurve, statusit ligjor, kategorisë së sigurisë, krimit të kryer, nevojave rehabilituese dhe kohëzgjatjes së dënimit. Ndonjëherë personat dërgohen në burgun më të afërt me vendin ku janë arrestuar, ose në burgun që ndodhet më afër shtëpisë së tyre, por ndonjëherë ata thjesht dërgohen në cilindo burg që ka hapësirë për ta në momentin e arrestimit/dënimit. Megjithatë, personeli i burgut mund të luajë një rol kyç në këshillimin e agjencive të tjera për sa i përket caktimit të të burgosurve, sidomos në rastet specifike kur merren parasysh transferimet e të burgosurve.

USHTRIM
25 MINUTA

Caktimi

Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe jepini skenarët e mëposhtëm. Kërkojuni të diskutojnë se cilat gjëra duhet të merren parasysh kur vendoset për caktimin e personave në burg, në rastet A, B, C, D dhe E. Përdorni aq skenarë sa ju lejon koha. Zgjidhni skenarët që janë më të përshtatshëm për kontekstin e vendit tuaj.

Vendi X është një vend i vogël me 51 burgje:

- Një burg për secilin prej 44 juridiksioneve të veta lokale,
- Katër burgje në kryeqytet (një për burra, një për gra, një për të miturit dhe një për të paraburgosurit) dhe
- Tre burgje të mëdha në zonat rurale që janë projektuar për qëllime rehabilitimi për të burgosurit burra dhe gra që po i afrohen përfundimit të dënimit të tyre.
- Përpos ambienteve për burra, gra dhe të mitur në kryeqytet, nuk ka ambiente të tjera të veçanta për gratë dhe të miturit apo të paraburgosurit, por ka godina më vete në të gjitha burgjet lokale për gratë dhe të miturit si dhe për të paraburgosurit.
- Të gjitha burgjet në vend vuajnë nga mbipopullimi.

Skenarët

- A.** Një vajzë 20-vjeçare e cila është shtatzënë dhe vjen nga një shtet fqinj është arrestuar në kufi teksa tentonte të kontrabandonte sasi të vogla droge në vend. Ajo është dënuar me tre vjet burg dhe po mbahet në një burg të sigurisë së ulët.
- B.** Një djalë 16-vjeçar nga një provincë rurale, i cili jetonte dhe punonte në kryeqytet, u arrestua pasi kishte vjedhur një celular. Ende nuk është dhënë dënimi për të dhe ndodhet në paraburgim.
- C.** Një burrë 60-vjeçar me origjinë nga një vend i largët u arrestua në aeroport duke kontrabanduar një sasi të madhe droge të klasit A në vend. Ai u dënua me 25 vjet burg dhe deri më tani ka vuajtur 15 vite të dënimit të tij. Ai po mbahet në një objekt të sigurisë së lartë. Ai ka kërkuar që të transferohet në një burg më të vogël lokal ku ndodhet një burrë tjetër i cili ka të njëjtin vend origjine. Megjithatë, ky burg nuk ka një bllok të sigurisë së lartë.
- D.** Një grua 35-vjeçare me tre fëmijë është drejt fundit të vuajtjes së dënimit 5-vjeçar me akuzën e mashtrimit. Ajo po mbahet në një burg të sigurisë së zakonshme.
- E.** Një vajzë 15-vjeçare u arrestua në fshatin e saj pasi dyshohej për vjedhje. Ajo është dënuar me një vit burg dhe tashmë ka vuajtur 6 muaj të dënimit në burgun e zonës. Ajo aktualisht po mbahet në një qeli në një bllok të sigurisë së ulët me gra në moshë madhore.

➔ **Gjërat për t'u marrë parasysh/pyetjet që mund të bëni** — nuk ka domosdoshmërisht një përgjigje të saktë apo të gabuar, por pjesëmarrësit duhet të përgjigjen si më poshtë (dhe çdo tjetër që mund t'u vijë në mendje):

Në të gjithë skenarët, autoritetet duhet të konsultohen me individët në lidhje me shtëpitë e tyre ose vendet ku ata ndodhen për rehabilitim social për sa i përket caktimit fillestar të tyre dhe çdo vendimi të mëvonshëm për transferim.

Skenari A.

- A duhet të mbahet vajza në burgun që ndodhet më afër kufirit, më afër qytetit të saj, apo në burgun qendror të grave?
- Si janë mjediset mjekësore në burgun lokal në krahasim me burgun qendror?
- A ka gra të tjera shtatzëna apo gra që jetojnë me fëmijët e tyre në burg?
- Cilat janë rregullat që lejojnë fëmijët të qëndrojnë me nënën e tyre në burg?
- A e flet vajza gjuhën vendase?
- A ka persona të tjerë nga vendi i saj në burgun lokal?
- Cila është situata e saj familjare? A ka fëmijë?
- A ka ndonjë mundësi për ta transferuar në vendlindjen e saj për të vuajtur dënimin atje?

Skenari B.

- A duhet të mbahet në burgun më afër fshatit të tij të lindjes apo në një burg qendror në kryeqytet për të miturit në konflikt me ligjin?
- Nëse do të mbahet në një burg në kryeqytet, a duhet të mbahet në burgun e fëmijëve në konflikt me ligjin apo në burgun e të paraburgosurve?
- Nëse shpallet fajtor, a duhet të zhvendoset në një institucion tjetër pas dënimit?
- Cila është gjendja e tij familjare?
- Çfarë lloj aktiviteteve rikrijuese, arsimore dhe formime profesionale janë të disponueshme për të miturit në institucione të ndryshme?
- Çfarë lloj shërbimesh mbështetëse janë të disponueshme në institucione të ndryshme?

Skenari C.

- A duhet të dërgohet në burgun lokal apo të qëndrojë në kryeqytet?
- Cilët janë faktorët e rrezikut? A mund të ulët niveli i tij i sigurisë në atë të zakonshme?
- Çfarë lloj mbështetjeje merr ai nga përfaqësuesit e vendit të tij?
- Si është gjendja e tij shëndetësore? Si janë mjediset shëndetësore në burgjet e ndryshme?
- A e flet gjuhën vendase?
- A ka persona të tjerë nga vendi i tij apo zona nga ku ai vjen në burgun kryesor?

Skenari D.

- A duhet të dërgohet në burgun e rehabilitimit për gratë duke qenë se është drejt përfundimit të dënimit?
- Cila është situata e saj familjare? A mundet të presë aktualisht vizita të rregullta nga familja e saj, përfshirë fëmijët e saj?
- A do të mund të priste ndonjë vizitë familjare në institucionin e rehabilitimit?
- Çfarë lloj masash rehabilitimi do të ishin të dobishme posaçërisht në rastin e saj?

Skenari E.

- A duhet të mbahet në burgun lokal, apo të dërgohet në burgun qendror për të mitur?
- A ka vajza të tjera në burgun lokal? Sa vajza të tjera ka në burgun qendror?
- Çfarë mundësish dhe shërbimesh ka në dispozicion për vajzat në të dy institucionet?
- Cila është situata e saj familjare? A mund të presë vizita të rregullta nga familjarët apo miqtë?

Pse është kaq i rëndësishëm caktimi në mjediset specifike në rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm të të burgosurve?

- Është e rëndësishme që rehabilitimi dhe riintegrimi i suksesshëm i të burgosurve të merret parasysh që kur nis periudha e tyre e burgimit dhe ky element duhet të luajë një rol kyç në përcaktimin se ku do të vendosen të burgosurit.
- Ata që caktohen pranë familjeve, miqve dhe komuniteteve kanë perspektiva më të mira riintegrimi sepse mund të mbajnë kontakte të rregullta dhe do të ndihen më pak të izoluar. Po ashtu, është më e lehtë të menaxhohen vizitat më të gjata dhe ndoshta vizitat në shtëpi kur po i afrohen lirit.
- Rehabilitimi ka më shumë gjasa të jetë i suksesshëm nëse individët vendosen në një strukturë që mund të ofrojë shërbime mbështetëse në bazë të nevojave të tyre individuale (p.sh., trajtime për çrregullime për shkak të abuzimit me alkoolin apo substanca të tjera, kujdesi i duhur shëndetësor fizik dhe mendor, një nivel i përshtatshëm sigurie, programet e duhura të punës dhe trajnimit, përshtatshmëria e mjediseve për personat me aftësi të kufizuara fizike).
- Fokusi i punës dhe programet e trajnimit kanë gjasa të jenë më të përshtatura në rast se një person është i burgosur afër vendit ku do të jetojë pas lirit. Programet e trajnimit mund të çojnë gjithashtu në mundësi specifike pune pas lirit.
- Caktimi në një institucion afër vendbanimit gjithashtu e bën më të lehtë punën e administratave të burgjeve që të përgatisin personat për lirim dhe që të sigurojnë që shërbimet e duhura mbështetëse do të ofrohen pas lirit.
- Ata që marrin mbështetje nga OJQ-të lokale ose organizatat e komunitetit gjatë kohës që janë në burg mund të përfitojnë nga mbështetja dhe shërbimet e vazhdueshme pas lirit në zonën ku ata jetojnë.

Gratë

RREGULLA 4 e Rregullave të Bangkokut:

“Gratë e burgosura caktohen, për aq sa është e mundur, në burgje afër shtëpisë së tyre ose vendit të rehabilitimit social, duke marrë parasysh përgjegjësitë e tyre të kujdesit, si dhe preferencën individuale të gruas dhe disponueshmërinë e programeve dhe shërbimeve të përshtatshme”.

Caktimi i duhur i grave të burgosura ka një rendësi të veçantë sepse ato janë zakonisht kujdestaret kryesore të fëmijëve. Për shkak të numrit të vogël të burgjeve të grave në shumë vende, ato kanë më shumë gjasa të caktohen larg familjeve të tyre. RREGULLA 4 i Rregullave të Bangkokut u jep autoriteteve të burgut përgjegjësinë për t'i kushtuar më shumë vëmendje caktimit të grave në burg.

Çfarë mund të bëjë personeli?

Edhe nëse personeli i burgut nuk është përgjegjës për caktimin fillestar të të burgosurve dhe transferimet e mëvonshme, ka hapa të tjerë praktikë që ata mund të ndërmarrin në lidhje me caktimin e duhur, si p.sh. të përfshihen në diskutimet për transferimet e mundshme, të sigurohen që caktimi i burgut të përfshihet në vlerësimet e vazhdueshme të rreziqeve dhe nevojave, dhe t'i mbajnë dosjet e të burgosurve të sakta dhe të përditësuara.

3.3 Transferimet e të burgosurve

1 ORË

NMR: 1, 7,
26 (2), 68, 73

Vini në dukje se, përveç rregullave specifike të përmendura më lart, të gjitha mbrojtjet themelore në Rregullat e Nelson Mandelës zbatohen për të gjithë njerëzit në burg në çdo kohë, përfshirë gjatë transferimit dhe transportimit.

USHTRIM
15 MINUTA

Kërkojini grupit të mendojnë për të gjitha arsyet që mund t'i duhen një personi në burg për t'u transferuar/transportuar.

Pjesëmarrësit duhet të identifikojnë sa më poshtë:

- Transportimi për në spital/qendër shëndetësore të specialiteteve
- Transportimi për në seancën gjyqësore
- Transportimi për arsye personale (p.sh., për të marrë pjesë në një ngjarje familjare që mund të jetë një funeral)
- Transferimi në një objekt tjetër për shkak të ndryshimit në klasifikimin e sigurisë
- Transferimi në një objekt tjetër për shkak të rreziqeve/nevojave/arsyeve specifike të sigurisë
- Evakuimi urgjent për shkak të fatkeqësive natyrore ose trazirave në shkallë të gjerë në burg
- Kalimi në aeroport/kufi etj., në rast të transferimeve ndërkombëtare të të burgosurve

Gjëra të tjera për të vënë në dukje:

- Transportimi i të burgosurve mund të kryhet me lloje të ndryshme automjesh në varësi të distancës që do të udhëtohet, llojit të udhëtimit dhe qëllimit të udhëtimit (p.sh., makinë, autobus, furgon, tren, mjet lundrues, aeroplan, helikopter).
- Në disa vende, transportimi nga një institucion i vuajtjes së dënimit në tjetrin mund të zgjasë me ditë, jo orë, në varësi të distancës, transportit në dispozicion dhe cilësisë së rrugëve.
- Në disa vende, transportimi i të burgosurve kryhet nga agjenci të tjera qeveritare ose nga kompani private.
- Gjatë transportimit të të burgosurve, sa i përket masave të sigurisë, duhet marrë parasysh edhe koha e pritjes - p.sh. zonat e pritjes në sallat e gjyqit, spitale, aeroporte.

USHTRIM
15 MINUTA

Cilat janë rreziqet e veçanta dhe ndikimet e mundshme negative që lidhen me transportimin/kalimin e të burgosurve dhe pse?

Zgjidhni dy pjesëmarrës për të shkruar idetë në tabelë : Rreziqet dhe Arsyet për rreziqet

RREZIQET

- Tortura/keqtrajtimi nga personeli, përfshirë dhunën seksuale
- Zhdukjet e të burgosurve
- Transferimi përdoret si mënyrë për të ndëshkuar individët
- Abuzimi/dhuna nga të burgosurit e tjerë
- Abuzimi nga pjesëtarë të publikut
- Rrezik për personelin
- Rreziku i vetëvrasjes/vetëdëmtimit
- Ndikimi në shëndetin mendor
- Rreziqet e arratisjes/sulmeve ndaj automjeteve
- Aksidentet në trafikun rrugor ose lëndime të tjera personale
- Rreziqet për shëndetin
- Futja e mallrave kontrabandë
- Mundësitë e humbura për arsimim/trajnim
- Humbja e seancave gjyqësore
- Humbja e kontakteve me familjarët/avokatët
- Korrupsioni / mitëmarrja / zhvatja

ARSYET PËR RREZIQET

- Nuk ka shqyrtim të pavarur ose është i kufizuar
- Nuk ka kontakt me botën e jashtme ose është i kufizuar
- I burgosuri/familjarët/avokati nuk janë njoftuar paraprakisht për transferimin
- Raporti staf/të burgosur është i ulët dhe masat e sigurisë janë të papërshtatshme
- Nuk ka zinxhir komandues
- Nuk ka dëshmitarë për ndonjë abuzim të kryer/dhunë të ushtruar
- Mungesa e procedurave/rregullave që rregullojnë transportimin e të burgosurve
- Personeli përgjegjës për transportin nuk është verifikuar/trajnuar në nivelet e duhura/janë të punësuar nga një agjenci tjetër qeveritare/kompani private
- Nuk ofrohet mundësia që individët të bëjnë ankesa për kushtet e transferimit/incidentet specifike
- Personeli përgjegjës për transportin nuk disponon informacionin përkatës për personin/at që po transportohen
- Kategoritë e të burgosurve nuk janë të ndara siç duhet
- Periudhë e ngarkuar me stres për të burgosurit (p.sh., seancat e ardhshme gjyqësore, vizita në spital, dërgimi në një vend të panjohur, largësia nga familja)
- Automjete të papërshtatshme, të keqpajisura dhe të rrezikshme
- Automjete të mbipopulluara

USHTRIM
20 MINUTA

Lojë me role për transportimin e të burgosurve

Kërkojuni pjesëmarrësve të marrin rolin e punonjësit përgjegjës të ekipit që transporton të burgosurit. Vendosni gjashtë rastet e mëposhtme studimore në mur. Kërkojuni pjesëmarrësve të mendojnë për masat të cilave do t'u jepnin përparësi nëse do të kishin për detyrë organizimin e transferimeve. Pjesëmarrësit kanë përgjegjësinë për të garantuar sigurinë, shëndetin, dinjitetin dhe të drejtat njerëzore të të gjithë njerëzve që transferohen, dukë mbrojtur ndërkohë sigurinë e personelit dhe komunitetit. Pjesëmarrësit duhet t'i shkruajnë masat në letrat *post-it* dhe t'i ngjitin ato në fletën e tabelës të vendosur në mur.

1. Një grua shtatzënë po transferohet në spital për të lindur
2. Një i burgosur po transferohet në një institucion të sigurisë më të lartë pasi sulmoi së fundmi një roje burgu
3. Një grup prej pesë burrash dhe grash po dërgohen në gjykatë për seancat e tyre të apelit
4. Një evakuim urgjent gjatë natës i pesë qelive (në njërin prej tyre ka fëmijë) për shkak të përmytjeve
5. Një grua e moshuar me disa nevoja të ndryshme shëndetësore po transferohet në një burg më afër familjes së saj
6. Një djalë 20-vjeçar po transferohet në një institucion që mund të kujdeset më mirë për nevojat e tij për rehabilitim

➔ Masat për menaxhimin e transportimit të të burgosurve

Kjo listë duhet t'u shpërndahet pjesëmarrësve pas ushtrimit.

- Verifikimi dhe trajnimi i personelit përgjegjës për transportimin e të burgosurve
- I burgosuri merr njoftim paraprak për transferimin, duke përfshirë kur dhe ku
- Personeli i transportit të informohet për çdo shqetësim në lidhje me sigurinë/shëndetin/të tjera
- Vlerësimet individuale të rrezikut dhe nevojave përpara transportimit të të burgosurve
- Ndarja e plotë e kategorive siç përcaktohet në Rregullën 11 të Rregullave të Nelson Mandela
- Dosja e të burgosurit dhe dosjet mjekësore të transferohen në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale me të burgosurin
- I burgosuri mund të njoftojë familjen/avokatin/kontaktet e tjera për transferimin
- Çdo personi që transferohet i jepet informacion në një gjuhë/format që ata e kuptojnë
- Sendet personale transferohen në mënyrë të sigurt me të burgosurin dhe mbrohen nga humbja/dëmtimi
- Detajet e transferimit duhet të shtohen në dosje, duke përfshirë datën dhe orën e transferimit
- Transferimi bëhet vetëm gjatë ditës. Transferimet gjatë natës duhet të shmangen kur është e mundur (përjashtim mund të përbëjnë evakuimet emergjente)
- Automjetet u nënshtrohen kontrolleve të plota dhe periodike të sigurisë
- Automjetet janë të pajisura në mënyrë të përshtatshme për transportin e të burgosurve, duke përfshirë ajrimin, dritën dhe temperaturat e përshtatshme
- Të burgosurit kanë ushqim dhe ujë të mjaftueshëm dhe të sigurt
- Gjatë udhëtimeve të gjata, të burgosurve u mundësohet të rrinë në ajër të hapur dhe të kryejnë ushtrime fizike, si dhe të përdorin sendet/ambientet sanitare
- Transporti nuk është i mbipopulluar - të burgosurit kanë hapësirën e duhur personale
- Gratë dhe vajzat mbikëqyren vetëm nga punonjëset gra
- Ata që kanë nevojë për kujdes shëndetësor shoqërohen nga personeli shëndetësor nëse është e nevojshme
- Të burgosurit ekspozohen sa më pak që të jetë e mundur në syrin e publikut dhe ekzistojnë masa mbrojtëse për t'i mbrojtur të burgosurit nga fyerja, kurioziteti dhe publiciteti

- Automjetet kanë një çantë të ndihmës së parë dhe pajisje të tjera të nevojshme mjekësore
- Çdo mjekim transferohet në mënyrë të sigurt bashkë me të burgosurin
- Të burgosurve nuk u kërkohet asnjëherë të paguajnë për shpenzimet e transportit
- Pushime të përshtatshme përgjatë udhëtimit, duke përfshirë ndalesat e tualetit
- Automjetet duhet të jenë të pajisura në mënyrë të përshtatshme për të burgosurit me nevoja të veçanta, p.sh. rampat për karriget me rrota për të burgosurit me aftësi të kufizuara
- Instrumentet e kufizimit përdoren vetëm kur gjykohet e nevojshme si masë paraprake kundër arratisjes
- Qasja në organet monitoruese, transporti i të burgosurve është subjekt i shqyrtimit dhe rishikimit
- Mbajtja e duhur e të dhënave të të gjitha udhëtimeve të të burgosurve
- Transferimi i të burgosurve nuk përdoret kurrë për të ndëshkuar apo diskriminuar të burgosur të caktuar
- Të burgosurit nuk mbahen në automjete më gjatë nga sa është e nevojshme
- Kontrollat kryhen para/gjatë/pas transportit, sipas nevojës
- Ka procedura/rregulla të plota në lidhje me transportimin e të burgosurve dhe i gjithë personeli dhe të burgosurit janë në dijeni të këtyre rregullave
- Të burgosurit mund të bëjnë kërkesa dhe ankesa në lidhje me transportin e të burgosurve

3.4 MENAXHIMI I DOSJEVE TË TË BURGOSURVE

40 MINUTA

NMR: 6 –10

Pse është kaq i rëndësishëm menaxhimi i mirë i dosjeve të të burgosurve?

Nëse dëshironi, përdorni faqet në PowerPoint

Masat mbrojtëse për personat në burg

Menaxhimi i mirë i dosjeve të të burgosurve mund të ndihmojë në mbrojtjen e personave në burg kundër:

- Torturës, zhdukjeve, vrasjeve pa gjyq dhe arrestimit të paligjshëm
- Periudhës së tepruar të paraburgimit
- Paraburgimit përtej datës së lirimit, ose humbjes së mundësisë për të aplikuar për ulje të dënimit ose falje
- Humbjes së seancave gjyqësore ose datave të tjera të rëndësishme
- Ndërhyrjes në privatësinë e informacionit
- Dënimit më shumë se një herë për të njëjtën shkelje disiplinore

Menaxhim efektiv i burgjeve

Menaxhimi i mirë i dosjeve të të burgosurve mund të:

- Lehtësojë menaxhimin efektiv të burgjeve dhe planifikimin strategjik
- Ndihmojë autoritetet e burgjeve të planifikojnë dhe caktojnë burime në bazë të nevojave të popullatës së të burgosurve, duke përfshirë burimet buxhetore dhe ato njerëzore
- Ndihmojë autoritetet që të rregullojnë përdorimin e masave disiplinore, forcës, armëve dhe kufizimeve

- Lehtësojë dhe përmirësojë punën e punonjësve të burgjeve
- Ndërtojë besim në sistemin e burgjeve

Përmbushja e nevojave individuale

Menaxhimi i mirë i dosjeve të të burgosurve u lejon autoriteteve të përmbushin nevojat individuale përmes:

- Klasifikimit/shpërndarjes së duhur të të burgosurve—duke krijuar një mjedis më të sigurt për të gjithë
- Planifikimit individual të dënimeve, rehabilitimit, mbështetjes personale, programeve të trajnimit
- Lehtësimit të kontaktit me avokatët, familjet dhe kontakte të tjera

Mbikëqyrja dhe Vlerësimi

Menaxhimi i mirë i dosjeve të të burgosurve gjithashtu:

- Lejon organet e inspektimit të brendshëm dhe monitorimit të jashtëm të kryejnë punën e tyre në mënyrë efektive; dhe
- U mundëson autoriteteve të gjenerojnë informacione në lidhje me prirjet brenda sistemit të burgjeve më gjerësisht dhe të zhvillojnë politika në përputhje me rrethanat.

Cilat janë gjërat kryesore që duhen marrë parasysh për çdo sistem dosjesh të të burgosurve?

Masat mbrojtëse

- Sistemet e dosjeve mund të jenë në formë elektronike ose në letër, por sistemi duhet të jetë i standardizuar. Aty ku është e mundur, sistemet duhet të jenë të centralizuara për të lejuar që transferimet e individëve të gjurmohen më mirë.
- Duhet të ekzistojnë procedura për të siguruar një gjurmë të sigurt auditimi.
- Duhet të ekzistojnë masa mbrojtëse për të siguruar që informacioni është i saktë dhe se asnjë informacion i rëndësishëm nuk është hequr ose futur gabimisht.
- Duhet të ketë masa mbrojtëse kundrejt ndryshimeve të paautorizuara në dosjet e të burgosurve.
- Të gjitha dosjet, qoftë manuale apo elektronike, duhet të ruhen në kopje rezervë në rast se humbasin, dëmtohen apo shkatërrohen.

Qasja në dosje

- Të gjitha dosjet e të burgosurve duhen kyçur mirë në një vend të sigurt dhe duhet siguruar konfidencialiteti.
- Vetëm personeli i autorizuar dhe i trajnuar duhet të ketë qasje në dosjet e të burgosurve - ato duhet t'u vihen në dispozicion vetëm atyre personave të cilëve u nevojitet qasja në dosje për të përmbushur përgjegjësitë profesionale.
- Personeli që përdor sistemet e dosjeve të të burgosurve ose hedh informacione në këto sisteme duhet trajnuar se si t'i hedhë informacionet dhe t'i ruajë ato në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.
- Të burgosurit duhet të kenë të drejtën e qasjes në dosjet e tyre nëse dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë dhe kanë të drejtë të marrin një kopje të dosjes pas lirim të tyre.

- Organet monitoruese duhet të kenë qasje në dosjet e të burgosurve, por u kërkohet të respektojnë konfidencialitetin e informacionit.

Përmbajtja e dosjeve

- Informacioni që përmbajnë dosjet e të burgosurve duhet të rishikohet dhe përditësohet rregullisht.
- Niveli i hollësive në dosje do të varet nga sa gjithëpërfshirës janë raportet individuale të vlerësimit dhe klasifikimit.

Vëmendje e veçantë për grupe të caktuara të burgosurish:

Gratë

- Numri dhe të dhënat personale të çdo fëmije duhet të regjistrohen, duke përfshirë emrat, moshën, vendndodhjen dhe statusin e kujdestarisë ose mbrojtjes së tyre. Të gjitha informacionet duhet të mbahen konfidenciale.
- Gratë mund të kenë arsye për të mos zbuluar informacione rreth fëmijëve të tyre dhe ato nuk duhet të detyrohen ta bëjnë një gjë të tillë.

Personat LGBTI në burg

- Informacioni në dosje duhet të respektojë gjininë e vetë-identifikuar të personit (RREGULLA 7A). Kjo shërben për të ndihmuar në informimin e caktimit të personave transgjinorë në objektet e zgjedhjes së tyre dhe për të siguruar që nevojat e veçanta të personave transgjinorë të merren parasysh.
- Individëve nuk duhet t'u kërkohet të vetëidentifikohen nëse nuk dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë.

Shtetasit e huaj në burg

- Dosja duhet të përmbajë informacione rreth nevojave të tyre gjuhësore ose për përkthim.
- Dosja duhet të përmbajë gjithashtu informacione rreth kontaktit me përfaqësuesit konsullorë dhe të dhënat përkatëse të kontaktit.

USHTRIM
25 MINUTA

Rrahje mendimesh në grup

Nëse jeni shkurt me kohën, pjesëmarrësve mund t'u kërkohet të marrin ushtrimin si detyrë shtëpie.

I rikthehemi dosjes së Ronja Gustafsson. Tashmë ajo ka pesë vite që është në burg. Çfarë lloj informacionesh duhet të ishin shtuar në dosjen e saj personale gjatë kësaj kohe?

- Numri i të burgosurit: 716
- Emri: Ronja Gustafsson
- Datëlindja: 15/04/1970 Mosha: 50
- Gjinia: Femër
- Kombësia: Suedeze
- Profesioni: Shitëse
- Numri i të burgosurit: 716
- Vendbanimi i zakonshëm: Streha e grave në Oslo
- Gjuha e folur: suedisht

Klasifikimi dhe caktimi

- Data dhe ora e pranimit: 11 paradite, 24 janar 2020
- Kategoria e sigurisë: B
- Caktimi në qelinë dhe bllokun e burgut: Blloku C, Qelia 7

Familja

- Statusi familjar – E martuar (bashkëshorti i vdekur)
- Të afërmit: Motra Anna Gustaffson tel - 8 8765432
- Kontakti në rast urgjence: Si më sipër
- Fëmijët - 2 fëmijë, një vajzë [emri] 5 vjeç dhe një djalë [emri] 7 vjeç, aktualisht jetojnë me motrën në Suedi

Krimi dhe gjendja juridike

- Data, ora dhe vendi i arrestimit: ora 17, 24 gusht 2019. Në shtëpinë e familjes (adresa)
- Autoriteti arrestues: policia qendrore e Oslos
- Gjendja juridike: E dënuar
- Krimi për të cilin është dënuar: Vrasja e bashkëshortit të saj
- Kohëzgjatja e dënimit: 15 vjet
- Gjoha: 10,000 Euros
- Data e dënimit: 14 nëntor 2019
- Data e parashikuar e lirimit: 23 gusht 2034
- Precedentë penalë të mëparshëm: Nuk ka dënime të mëparshme
- Të dhëna në lidhje me apelimet: Dënimi nuk është apeluar

Kontakti i jashtëm

- Të dhënat e kontaktit të avokatit: Julia Berstrom, jberstromn@internet.com, + 8 8542765

Të dhënat e kontaktit me përfaqësuesit konsullorë

- Kontakti me përfaqësuesin konsullor: +8 0090562
- Përkthyesi: +8 6514262

Inventari i pasurisë personale

- Çdo lëndim i dukshëm ose ankesë për keqtrajtim të mëparshëm.

Përgjigjet e sugjeruara:

- Informacione të mëtejshme për procesin gjyqësor ose kohëzgjatjen e qëndrimit në burg - çdo seancë tjetër gjyqësore, seanca dëgjimore e komisionit të lirimit me kusht dhe aplikime për lirim të parakohshëm
- Raportet e vazhdueshme të vlerësimit dhe klasifikimit
- Informacione në lidhje me sjelljen dhe disiplinën, duke përfshirë çdo sanksion disiplinor
- Të dhënat e çdo transferimi, duke përfshirë datën dhe orën
- Ndryshime të dukshme në sjellje
- Sjellje e mirë e dukshme
- Kërkesat dhe ankesat, duke përfshirë pretendimet për torturë dhe keqtrajtim
- Informacione në lidhje me rrethanat dhe shkaqet e çdo dëmtimi

- Të dhënat e mbajtura nga kontrollet, në veçanti kontrollet me shirita dhe në zgavrat e trupit
- Rastet e përdorimit të forcës, armëve ose instrumenteve të kufizimit
- Ndryshimet në rrethanat familjare/të afërmit/të dhënat e kontaktit të urgjencës
- Vizitat nga përfaqësuesi ligjor
- Vizitat nga zyrtarët konsullorë
- Pjesëmarrja në programe arsimore, trajnime, apo çdo lloj programi tjetër
- Kërkesat e regjimit ushqimor
- Nevoja të tjera, duke përfshirë nevojat e shkrim-leximit dhe gjuhës

Shënim. Me përjashtim të informacionit për lëndimet specifike, të gjitha informacionet mjekësore duhet të ruhen në një dosje të veçantë mjekësore (që do të mbulohet në Modulin 7).

Kjo mund të jetë gjithashtu një mundësi e mirë për të nxjerrë në pah çështjet e sigurisë që lidhen me menaxhimin elektronik të dosjeve:

- Kush ka qasje?
- A janë vetëm personat që kanë nevojë për qasje?
- Çfarë masash mbrojtëse ekzistojnë për të mbrojtur të dhënat veçanërisht të ndjeshme (p.sh. të dhënat mjekësore) dhe a janë të mjaftueshme këto masa??

Tani jepuni pjesëmarrësve mundësinë të bëjnë pyetje ose të komentojnë në lidhje me menaxhimin e dosjeve të të burgosurve.

3.5 TË PARABURGOSURIT

30 MINUTA

NMR: 111–120

Parimet kryesore

(vendosini në një vend të dukshëm në sallën e trajnimit gjatë këtij sesi)

- Të paraburgosurit duhet të prezumohen të pafajshëm derisa të provohet fajësia e tyre
- Paraburgimi duhet të përdoret si masë e fundit dhe vetëm kur justifikohet siç duhet

Shfaqni një të dyja videot

Fair Trials International — [A Measure of Last Resort](#) — 5:15 minuta

OSJI “Presumption of Guilt” Infographic — 2:36 minuta

USHTRIM
15 MINUTA

E vërtetë apo e gabuar

Lexoni fjalitë e mëposhtme për të paraburgosurit. Kërkojuni pjesëmarrësve të shënojnë se cilat mendojnë se janë të vërteta dhe cilat janë të gabuara. Më pas, lexoni përgjigjet dhe jepni një shpjegim të shkurtër.

→ Kjo shërben si një përmbledhje e disa prej parimeve themelore të mësuara në modulet e mëparshme. Gjithashtu ndihmon për të vlerësuar deri në ç’masë e kanë kuptuar pjesëmarrësit kursin deri tani.

1. “Të paraburgosurit duhet të mbahen gjithmonë veçmas nga të burgosurit e dënuar.”

E VËRTETË –Ky është një parim themelor i Rregullave të Nelson Mandelës (**RREGULLI 11 (B)**). Është një masë që ruan parimin e prezumimit të pafajësisë së personave të pagjykuar. Gjithashtu, u mundëson autoriteteve të burgut të menaxhojnë në mënyrë më efektive regjimet e ndryshme të burgjeve që zbatohen për të paraburgosurit dhe të burgosurit e dënuar.

2. “Të paraburgosurve nuk mund t’u ofrohet mundësia për të punuar ose për të marrë pjesë në programe arsimore ose formimi profesional.”

E GABUAR –Të paraburgosurve duhet t’u ofrohet mundësia të punojnë dhe të marrin pjesë në programe arsimore ose trajnimi, por nuk duhet t’u kërkohet si detyrim një gjë e tillë. Për shkak se të paraburgosurit nuk janë shpallur fajtorë, nuk duhet të supozohet se ata kanë nevojë për rehabilitim. Megjithatë, përjashtimi nga programe të tilla mund të përkeqësojë situatën e tyre në paraburgim. Është shumë e rëndësishme që të paraburgosurve t’u ofrohet mundësia të punojnë ose të marrin pjesë në programe kur ata janë të paraburgosur për periudha të gjata kohore.

3. “Nuk ka kuptim të bëhet një vlerësim i hollësishëm i rrezikut dhe nevojave për të paraburgosurit.”

E GABUAR –Të paraburgosurit gjithashtu duhet t’i nënshtrohen vlerësimeve dhe klasifikimeve të kujdesshme e të vazhdueshme. Këto vlerësime do të jenë të ndryshme nga ato që u bëhen të burgosurve të dënuar sepse ata duhet të prezumohen të pafajshëm, por nevojat dhe rreziqet individuale duhet të njihen dhe të trajtohen në mënyrën e duhur.

4. “Të paraburgosurit duhet të jenë në gjendje të veshin rrobat e tyre.”

E VËRTETË – RREGULLA 115 përcakton që një të burgosuri të pagjykuar i duhet lejuar të veshë rrobat e veta nëse janë të pastra dhe të përshtatshme. Nëse ata veshin rroba burgu, këto rroba duhet të jenë ndryshe nga ato që veshin personat e dënuar. Kjo bëhet për t’i dalluar ata nga personat e dënuar. Mund të ketë një rëndësi të veçantë që të paraburgosurit të lejohen të veshin rrobat e tyre në gjyq, sepse uniforma e burgut mund të shkaktojë paragjykitime tek gjyqtari ose paneli i gjyqtarëve.

5. “Të paraburgosurit duhet të kenë të njëjtat të drejta kontakti me botën e jashtme si të burgosurit e dënuar.”

E VËRTETË –Në parim, të paraburgosurit duhet të kenë të njëjtat të drejta për të kontaktuar me botën e jashtme si personat e dënuar dhe ky kontakt mund të jetë me rëndësi sidomos në fazat e hershme të paraburgimit. Mund të ketë rrethana të jashtëzakonshme kur nevojiten kufizime ose mbikëqyrje për të mbrojtur një hetim penal në vazhdim (p.sh., për të mos lejuar që ata të ndikojnë tek dëshmitarët apo të pengojnë drejtësinë), por çdo kufizim i tillë duhet të bazohet në një vlerësim të plotë individual të rreziqeve.

6. Të paraburgosurit nuk mund të ndahen sipas kategorisë së sigurisë sepse nuk janë shpallur fajtorë.

E GABUAR – Është e vërtetë që nivelet e sigurisë së personave të padënuar nuk duhet të paracaktohen sepse ata ende nuk janë shpallur fajtorë, por nuk ka kuptim që ata që janë në pritje të gjyqit për krime të lehta të mbahen në të njëjtat qeli me ata që akuzohen për krime shumë të rënda. Çaktimi i qelive duhet të bazohet tek vlerësimet e individualizuara të rrezikut. Të paraburgosurit gjithashtu duhet të ndahen sipas gjinisë dhe moshës së tyre në të njëjtën mënyrë siç ndahen personat e dënuar.

7. Të paraburgosurit duhet të marrin të njëjtat lloje informacionesh si të burgosurit e dënuar.

E VËRTETË – Informacioni duhet t'u jepet të gjithë të burgosurve të sapoardhur, pavarësisht statusit të tyre ligjor.

8. Vetëm të paraburgosurit e kanë të nevojshme qasjen në këshillim ligjor.

E GABUAR – Ndërsa të paraburgosurit kanë nevojë për këshilla ligjore para dhe gjatë gjyqimit, të dënuarit mund të kenë nevojë gjithashtu të kenë mundësinë të marrin këshilla ligjore për apeline ose çështje të tjera pas gjyqimit, ose në lidhje me procedurat civile.

Në përfundim të këtij moduli, kërkojuni pjesëmarrësve të reflektojnë në lidhje me elementët kryesorë të qasjeve dinamike të sigurisë të identifikuara në fillim të modulit:

- Personel vigjilent që i njeh personat në burg
- Marrëdhënie pozitive me personat në burg
- Të qenët i informuar për atë që po ndodh në burg
- Angazhimi me njerëzit në burg
- Ndërveprim proaktiv dhe i shpeshtë

Kërkojuni pjesëmarrësve të marrin në konsideratë se si këto metoda mund të ndihmojnë personelin e burgjeve në fushat e menaxhimit të burgjeve të diskutuara gjatë këtij moduli (klasifikimi i të burgosurve, vlerësimet, ndarja, menaxhimi i dosjeve të të burgosurve dhe paraburgimi).

**BURIME TË
MËTEJSHME**

UNODC

Handbook on the Classification of Prisoners (Manual për klasifikimin e të burgosurve)
Handbook on the Management of High-Risk Prisoners (Manual për menaxhimin e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë)

Handbook on Prisoner File Management (Manual për menaxhimin e dosjeve të të burgosurve)



MODULI 4
MASAT MBROJTËSE

4 MASAT MBROJTËSE

MATERIALET

- Stilolaps dhe fletore
- Faqet 33-42 në PowerPoint të printuara
- Lista e burimeve shtesë
- Materiali për të paraburgosurit për shpërndarje
- Grafiku për nivele të ndryshme ankesash (shih faqen 95)
- Rastet studimore për kontaktet me botën e jashtme (shih faqet 106–109)
- Printimet e ushtrimit për monitorimin (shih faqet 112)
- Grafiku për monitorimin (shih faqen 110)

10 MINUTA **HYRJE**

Në këtë modul prezantohen të drejtat specifike të përcaktuara në Rregullat e Nelson Mandelës, të cilat janë elemente kyçe të menaxhimit të mirë të burgjeve dhe ofrojnë gjithashtu masa mbrojtëse specifike për njerëzit në burg kundër torturës, keqtrajtimit dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut. Ashtu si me Rregullat e tjera, zbatimi efektiv i këtyre parimeve arrihet më së miri duke përdorur qasje dinamike ndaj sigurisë dhe duke marrë parasysh rrethanat individuale të personave të burgosur, duke u kushtuar vëmendje të veçantë atyre që janë më pak të aftë për t'iu qasur këtyre masave mbrojtëse.

OBJEKTIVAT MËSIMORE

Në përfundim të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë pse këto masa mbrojtëse janë mjetë të rëndësishme për menaxhimin e burgjeve, edhe në lidhje me sigurinë e personelit dhe sigurinë e institucionit;
- Shtjellojnë se si këto mjete mund të veprojnë edhe si masa mbrojtëse të rëndësishme kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të lehtësojnë rehabilitimin e personave të burgosur;
- Diskutojnë së si mund të zbatohen këto masa mbrojtëse në mënyrë më efektive të mundshme;
- Identifikojnë arsyet pse disa të burgosur janë më pak të aftë ose të gatshëm për t'iu qasur këtyre masave mbrojtëse dhe vlerësojnë se çfarë mund të bëhet për t'u siguruar që të gjithë të kenë qasje njësoj në këto masa;
- Identifikojnë pasojat e mundshme negative në rastet kur këto masa mbrojtëse nuk zbatohen mirë;
- Përcaktojnë se çfarë mund të bëjë personeli individual i burgut për të lehtësuar zbatimin e këtyre masave mbrojtëse për të gjithë;
- Kuptojnë rolin e tyre në parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit të tjera; dhe
- Shpjegojnë ndryshimet ndërmjet inspektimeve/monitorimit të brendshëm dhe të jashtëm, qëllimin e vizitave inspektuese/monitoruese dhe rolin e personelit të burgut kundrejt organeve të inspektimit/monitorimit

4.1 QASJA NË INFORMACION

1 ORË

USHTRIM 10 MINUTA

NMR: 54 DHE 55

Pse është kaq e rëndësishme qasja në informacion?

Kërkojuni pjesëmarrësve të diskutojnë idetë se pse është kaq e rëndësishme qasja në informacion.

Diskutimi duhet të përfshijë pikat e mëposhtme, dhe jo vetëm. Nëse ndonjë nga këto ide nuk është përmendur nga pjesëmarrësit, atëherë shtojeni për diskutim.

- Personat e burgosur duhet të dinë se çfarë të presin nga jeta e tyre në burg në një fazë të hershme - kjo mund të ndihmojë në pakësimin e ndjenjave të pafuqisë dhe t'i lejojë ata të jenë më të angazhuar në jetën e burgut.
- Nëse sigurojmë që të gjithë personat e burgosur të kenë qasje në rregullat dhe rregulloret e burgut dhe që këto të jenë shumë të dukshme, atëherë kjo mund të ndihmojë gjithashtu në parandalimin e zhvillimit të rregullave/vetëqeverisjes informale të burgut nga të burgosurit.
- Njohuritë e të burgosurve, për rregullat e burgut etj., mund të mbrojnë gjithashtu kundër thashethemeve, pretendimeve për sjellje diskriminuese, moszbatimit të rregullave apo mospajtimit me to, vendimeve *ad hoc* dhe korrupsionit.
- Përcjellja e informacionit që u nevojitet tek të burgosurit mund të zvogëlojë nivelet e stresit dhe të ndihmojë në parandalimin e problemeve të shëndetit mendor, vetëvrasjes dhe dëmtimit të vetvetes, veçanërisht në fazat e hershme të paraburgimit.
- Personat e burgosur kanë më pak gjasa të thyejnë rregullat dhe rregulloret e burgut nëse janë të vetëdijshëm për pasojat e këtij veprimi, dhe nëse i dinë detyrimet e tyre, të drejtat e tyre dhe si t'i ushtrojnë ato.
- Qasja në kohë në informacionin përkatës mund të parandalojë gjithashtu trazirat e burgjeve, veçanërisht në kohë ndryshimi ose pasigurie.
- Qasja e të burgosurve në informacion mund t'i bëjë gjërat më të mira dhe më të lehta për personelin e burgut dhe menaxhimin e burgjeve në përgjithësi.

Përmendni këtu se, gjatë pandemisë COVID-19 dhe në kriza të tjera, rregullat dhe procedurat e burgut mund të ndryshojnë dhe qasja në informacion mund të jetë më e kufizuar.

Përsëritni se çdo ndryshim në rregulla/informacion tjetër të rëndësishëm duhet t'u komunikohet menjëherë të gjithë të burgosurve dhe se duhet të zhvillohen mënyra të tjera për të komunikuar informacionin nëse është e nevojshme.

Inkurajoni zhvillimin e një diskutimi të hapur rreth mënyrë se si qasja në informacion ndryshoi gjatë pandemisë COVID-19.

USHTRIM
20 MINUTA

Rregullat dhe Rregulloret

Ndani pjesëmarrësit në dy grupe duke i dhënë secilit me radhë numrin 1 ose 2. Të gjithë pjesëmarrësit lexojnë RREGULLAT 54 dhe 55 të Nelson Mandelës, duke vënë në dukje në veçanti RREGULLËN 54 (d).

Pjesëmarrësit me numrin 1 do të ndërmarrin këndvështrimin e dikujt që është dërguar së fundmi në burg. Kërkojuni që të shkruajnë llojet më të rëndësishme të informacionit që mendojnë se do t'u nevojiten për t'i mundësuar që të përshtaten me jetën në burg.

Pjesëmarrësit me numrin 2 janë personeli ose drejtuesit e burgut. Kërkojuni atyre të shkruajnë llojet më të rëndësishme të informacionit që duhet t'u japin personave të burgosur për të siguruar funksionimin e qetë dhe të sigurt të mjedisit të burgut. Më pas, pjesëmarrësit me numrin 1 dhe 2 do të formojnë çifte në të cilat drejtuesit e burgut u tregojnë personave të burgosur të gjitha informacionet që planifikojnë t'u japin, ndërsa të burgosurit u tregojnë ndonjë gjë që nuk është përfshirë në këto informacione.

Në fund, pjesëmarrësit me numrin 1 mund t'i tregojnë të gjithë grupit çdo informacion që nuk i ka ardhur në mendje pjesëmarrësve me numrin 2.

→ Ky ushtrim është krijuar për të treguar se dhënia në kohë dhe e saktë e informacionit ndihmon një të burgosur të përshtatet me jetën në burg. Paralelisht, kjo ndihmon për të siguruar funksionimin e qetë dhe të sigurt të burgut.

**Pjesëmarrësit duhet të përfshijnë (të paktën) informacionin e mëposhtëm:
Informacioni i përfshirë shprehimisht në RREGULLËN 54**

- Ligji për burgjet, rregullat dhe procedurat e burgjeve
- Çfarë ndodh nëse shkel një rregull - sanksione disiplinore
- Si të kërkon informacion
- Si të merrni këshilla ligjore
- Procedurat për të bërë kërkesa apo ankesa

Të gjitha çështjet e tjera për t'i mundësuar ata të përshtaten me jetën në burg:

- Oraret ditore të burgut, përfshirë edhe kohën jashtë qelisë
- Informacion rreth seksionit të burgut /mjedisit që e rrethon
- Orari i vakteve, informacion për kërkesat e veçanta ushqimore dhe qasjen në ujë të pijshëm
- Qasje në dushe, lavanderi dhe informacione për veshjet
- Si të kenë qasje në shërbimet mjekësore (përfshirë kujdesin dentar), duke përfshirë edhe rastet e urgjencave mjekësore. Si të marrin ilaçet?
- Udhëzime për parandalimin e sëmundjeve, pastërtinë, higjienën dhe kujdesin vetjak
- Si të keni qasje në shërbimet e mbështetjes së shëndetit mendor dhe mbështetjes për parandalimin e vetëvrasjeve/vetëdëmtimit (përfshirë linjën telefonike). Informacion për rritjen e ndërgjegjësimin për shëndetin mendor/vetëvrasjen/vetëlëndimin.
- Të dhëna rreth shërbimeve mbështetëse në dispozicion (p.sh., trajtimi për çrregullimet nga përdorimi i substancave, mbështetje për viktimat e dhunës seksuale)
- Informacion rreth shërbimeve të mbështetjes familjare në dispozicion
- Orari i hapjes së bibliotekës
- Orari dhe procedurat e vizitave në burg
- Grupet mbështetëse ndërmjet personave të burgosur, nisma kundër bullizmit dhe nisma të tjera mbështetëse pozitive që janë në dispozicion
- Informacion për shërbimet fetare dhe qasjen tek përfaqësuesit fetarë
- Qasja në telefona/internet/mjete të tjera komunikimi dhe sa shpesh u lejohet të kontaktojnë familjen/miqetë e tyre dhe me çfarë mjetesh
- Qasja në këshilla ligjore
- Informacion në lidhje me arsimimin, trajnimin dhe mundësitë e punës (përfshirë informacionin për shpërblimin e të burgosurve)

- Procedurat e emergjencave (p.sh. evakuimi nga zjarri, shqetësimet rreth sigurisë, emergjencat mjekësore) duke përfshirë vendndodhjen e zileve/alarmeve të urgjencës
- Informacion se si të kërkohet transferimi në një institucion tjetër
- Ambientet rikrijuese në dispozicion dhe oraret e përdorimit
- Informacion rreth qasjes në ritet dhe festat fetare si dhe aktivitetet kulturore
- Qasja konsullore për shtetasit e huaj
- Lista e emrave dhe përgjegjësive të drejtuesve dhe personelit
- Informacion se si të aplikoni për falje/lirim të parakohshëm etj.
- Si mund të ketë një i burgosur qasje në dosjen/dosjen e tij mjekësore nëse dëshiron
- Çfarë ka ndodhur me sendet e tyre personale
- Një listë e sendeve të ndaluara
- Informacion në lidhje me ndonjë skemë ekzistuese sa i përket incentivave/privilegjeve
- Informacion në lidhje me përdorimin e lejuar të parave/sistemeve të pagesave brenda objektit
- Të dhënat e organizatave të të drejtave të njeriut/organeve monitoruese të paraburgimit (numrat e telefonit të linjës telefonike, kutitë konfidenciale të ankesave etj.) dhe qasja në raportet publike nga grupet e monitorimit
- Qasja në informacionet për të drejtat e njeriut, duke përfshirë se çka duhet bërë në rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut, rrugët dhe procedurat për paraqitjen e ankesave
- Të burgosurit duhet të marrin gjithashtu lajme/përditësime të rregullta në lidhje me jetën në burg. Kjo mund të kryhet në forma të ndryshme (p.sh., një buletin i rregullt/njoftime në radio e burgut) për të përfshirë informacione rreth çdo ndryshimi në ligje, rregulla, procedura ose orare, punë të ardhshme të mirëmbajtjes dhe çdo ndryshim në kufizime, etj.).

SLAJDI 34 **Kur dhe si duhet të komunikohet informacioni?**

- Informacioni përkatës duhet t'u jepet të gjithë të burgosurve të sapoardhur, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor. Siç u përmend më lart, të paraburgosurit duhet të marrin të njëjtin informacion si të burgosurit e dënuar.
- Informacioni duhet t'u jepet personave sapo të mbërrijnë në burg. Kjo mund të mos jetë gjithmonë praktike, veçanërisht nëse ka grupe të mëdha të burgosurish të rinj.
- Arritja në burg është gjithashtu një moment çorientues dhe mund të jetë e vështirë për personat që të përtypin shumë informacione. Nëse nuk është e mundur që informacioni të jepet menjëherë pas pranimit në burg, atëherë duhet bërë sa më shpejt që të jetë e mundur.
- Informacioni gjithashtu duhet të jetë i dukshëm/i aksesueshëm dhe të përditësohet rregullisht gjatë dënimit/paraburgimit.
- Të burgosurit duhet të kenë mundësinë të bëjnë pyetje nëse janë të paqartë për ndonjë nga informacionet që u jepen ose nëse kërkojnë më shumë informacion.
- Personeli i burgut duhet të trajnohet për hollësitë e informacionit dhe se si t'ua shpjegojë këtë informacion në mënyrë sa më efektive të burgosurve.

SLAJDI 35

Mënyrat e ndryshme të komunikimit të informacionit

Kjo është një fushë shumë interesante për pjesëmarrësit që të ndajnë idetë/përvojat e tyre, veçanërisht nëse vijnë nga vende të ndryshme. Kjo faqe në PowerPoint mund të zëvendësohet me një diskutim në grup.

Informacioni mund të komunikohet në mënyra të ndryshme. Autoritetet e burgut mund të përdorin të gjitha mjetet në dispozicion në mënyrë që informacioni të arrijë tek të gjithë personat në burg. Ata duhet të marrin parasysh se si mund të ofrojnë rikujtesa/përditësime të rregullta dhe jo thjesht të japin informacion vetëm pas mbërritjes. Këtu mund të përfshihen sa më poshtë:

- Shpërndarja e paketave të informacionit në momentin e mbërritjes. Këto do të duhet të përditësohen sa herë që të bëhen ndryshime.
- Të burgosurit mund të mos kenë nevojë për të gjitha hollësitë e ligjeve dhe rregulloreve, por një përmbledhje të pikave më të rëndësishme. Për ata që duan informacion më të hollësishëm, tekstet e plota duhet të jenë të disponueshme në bibliotekë.
- Ekspozimi i informacioneve kyçe në mënyrë të dukshme në pjesë të ndryshme të institucionit (p.sh. procedurat në rast emergjence, linjat telefonike të ndihmës, të dhënat e grupeve mbështetëse, rregullat dhe rregulloret).
- Pamflete të disponueshme në hapësirat e përbashkëta
- Postera dhe materiale vizuale, si dhe materiale të shkruara
- Prezantime verbale, audio dhe video për grupet e sapoardhura
- Shpjegime dhe biseda individuale me personat në burg
- Vënia në dispozicion e informacionit në çdo platformë *online* për personat në burg
- Njoftimet *Tannoy* - kjo mund të jetë e dobishme sidomos kur informacioni duhet t'u jepet shpejt të gjithë personave në burg
- Radioja e burgut
- Buletinet e rregullta të burgjeve shpërndahen për të gjithë të burgosurit, të disponueshme në ambientet e përbashkëta
- Informacione të ndara ndërmjet personave në burg, nga grupet e diskutimit dhe sesionet e pyetjeve dhe përgjigjeve
- Anëtarëve të familjes dhe kontakteve të tjera duhet t'u jepet gjithashtu informacioni i nevojshëm (përfshirë oraret e vizitave, rregullat dhe procedurat, procedurat e kontrollit etj.) Kjo jo vetëm që do të jetë e dobishme për ta, por edhe do t'i ndihmojë ata t'ua shpjegojnë informacionin personave në burg.

SLAJDI 36

Të sigurohet që informacioni të jetë i disponueshëm për të gjithë

Rregullat e Nelson Mandelës e bëjnë të qartë se të gjithë personat në burg duhet të marrin informacionin në një gjuhë dhe format që ata kuptojnë. Në praktikë, kjo do të thotë se:

- **Shtetasve të huaj dhe personave të tjerë që nuk e flasin gjuhën** që përdoret më shpesh në institucion duhet t'u jepet informacion në një gjuhë që ata mund ta kuptojnë. Materialet e shkruara duhet të përkthehen në gjuhë të tjera. Autoritetet mund të kenë nevojë të përdorin një përkthyes (përkthim fizikisht ose me telefon). Në disa raste, mund të jetë e nevojshme të kërkonin ndihmë nga një punonjës ose një

i burgosur tjetër që flet gjuhën e tyre. Përfaqësuesit e ambasadës ose konsullatës gjithashtu mund të ndihmojnë.

- Mund të ketë boshllëqe në komunikim dhe të kuptuarit ndërmjet personelit të burgut dhe personave në burg nga **pakicat etnike dhe racore dhe popujt indigjenë**, për shkak të gjuhës apo normave të ndryshme kulturore ose ato të sjelljes. Kujdesuni të shpjegoni informacionin në gjuhë ose koncepte që kapërcejnë çdo lloj boshllëku kulturor. Autoritetet mund të mendojnë të kërkojnë mbështetjen e kolegëve dhe përfshirjen e organizatave të komunitetit. Autoritetet e burgut gjithashtu duhet të përpiqen të punësojnë njerëz me formime të ndryshme, me aftësi të ndryshme gjuhësore etj.
- **Personat e verbër ose ata me shikim të dëmtuar** duhet të marrin informacion verbalisht dhe informacioni me shkrim duhet të jetë në alfabetin Braj (Braille).
- **Personat me humbje të dëgjimit ose ata me dëgjim të dëmtuar** duhet t'i marrin të gjitha informacionet me shkrim ose autoritetet duhet të përdorin gjuhën e shenjave (ata mund të konsiderojnë trajnimin e disa punonjësve në përdorimin e gjuhës së shenjave)
- **Personave analfabetë ose atyre me shkallë të ulët të shkrim-leximit** duhet t'u jepet informacion verbalisht ose edhe përmes pamjeve vizuale. Sigurimi i informacionit me "shoku-shokun" mund të jetë gjithashtu i dobishëm.
- **Personat me aftësi të kufizuara intelektuale** mund të kenë nevojë për informacion në një format të përshtatshëm, gojarisht ose me përdorimin e pamjeve, duke përfshirë një përmbledhje të informacionit më të rëndësishëm. Mund të lindin nevoja që specialistët të ndihmojnë në komunikim.
- Personat me **probleme të shëndetit mendor** mund ta kenë të vështirë të kuptojnë rregullat e burgut dhe informacione të tjera si dhe mund të kenë nevojë për ndihmë të veçantë. Kjo mund të përfshijë specialistë ose grupe mbështetëse të bashkëvuajtësve.
- **Fëmijët në burg** duhet të marrin informacion në një format miqësor për fëmijët dhe është e rëndësishme sidomos të sigurohet që ata e kanë kuptuar plotësisht.
- **Personat e moshuar** në burg mund të kenë nevojë gjithashtu për mbështetje shtesë për të kuptuar informacionin.
- Të gjithë të burgosurit duhet të marrin informacion rregullisht dhe po ashtu përditësimet. Këtu përfshihen **ata që i nënshtrohen procedurave disiplinore dhe ata që mbahen të veçuar ose të izoluar për arsye mjekësore**.

USHTRIM
OPSIONAL

Çfarë lloj informacioni mund të jetë i rëndësishëm veçanërisht për grupe specifike të burgosurish?

Shumica e këtyre informacioneve i duhet dhënë të gjithë personave në burg, por mund të kenë një rëndësi të veçantë për grupe të caktuara. Shënoni këto tre grupe - Gratë, Personat me aftësi të kufizuara dhe Shtetasit e huaj - në fletët në mur dhe kërkojuni pjesëmarrësve të shkruajnë idetë e tyre në secilën fletë. Tek përgjigjet mund të përfshihen sa më poshtë:

Gratë

- Informacion për të drejtat e tyre dhe çfarë të presin nga kontrollet fizike
- Informacion për të drejtën e tyre për t'u ekzaminuar nga një profesioniste femër e kujdesit shëndetësor
- Shërbimet mbështetëse për viktimat e abuzimit në familje, përdhunimit dhe formave të tjera të dhunës seksuale, dhe informacion se si të kërkojnë ndihmë nga autoritetet gjyqësore
- Informacion për qasjen në kujdesin shëndetësor posaçërisht për gjininë e tyre, duke përfshirë masat parandaluese të kujdesit shëndetësor
- Informacion dhe mbështetje për shëndetin riprodhues, përfshirë sëmundjet seksualisht të transmetueshme
- Informacion dhe mbështetje për shtatzëninë dhe kujdesin ndaj fëmijëve
- Informacion mbi organizimin e vizitave që përfshijnë fëmijët
- Qasja në shërbimet mbështetëse vetëm për gratë, duke përfshirë programet e specializuara të trajtimit për gratë
- (Për ato që kanë fëmijët me vete në burg - informacion në lidhje me qasjen në kujdesin shëndetësor për fëmijët, shërbime dhe programe të tjera)

Personat me aftësi të kufizuara

- Informacion për arsyet e kontrolleve fizike dhe si do të kryhen ato
- Përgatitjet për vlerësimet fizike për të kontrolluar përshtatshmërinë për punë në burg
- Informacion për grupet mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara në dispozicion
- Si të kërkojnë mbështetje nëse një person me aftësi të kufizuara është objekt i bullizmit ose dhunës
- Informacion rreth mënyrës se si burgu është përshtatur për të lejuar personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në programe dhe shërbime në mënyrë të barabartë me të tjerët
- Si të bëjnë një kërkesë ose ankesë në lidhje me aftësinë e kufizuar

Shtetasit e huaj

- Si të marrin ndihmën e nevojshme për të kuptuar regjimin e burgut
- Si të marrin mbështetje për interpretim/përkthim
- Informacion rreth kontaktit me ambasadat dhe qasjes në ndihmën konsullore
- Komunikimi me familjen në vendin e tyre të origjinës
- Informacion për shërbime të tjera specifike për shtetasit e huaj
- Qasja tek përfaqësuesit fetarë (kur feja e personit ndryshon nga ajo që praktikohet nga shumica)
- Qasje në mbështetje të jashtme (vullnetarë individualë, bamirësi lokale etj.)
- Informacion për çka do të ndodhë pas lirimit (p.sh. dëbimi nga vendi)

USHTRIM **Moduli 4.1 Përsëritje**

Si mund të sigurohet personeli i burgut që personat në burg e kanë marrë të gjithë informacionin që u nevojitet?

- Personeli duhet të kontrollojë nëse e kuptojnë të gjithë informacionin që ata duhet t'i japin personave në burg, përfshirë çdo ndryshim/përditësim. Personeli duhet të trajnohet për mënyrën se si të japë informacionin, duke përfshirë grupet e veçanta.
- Merrni kohën e duhur për t'i shpjeguar rregullat dhe informacionin përkatës secilit të burgosur më vete dhe t'i trajtoni me respekt dhe dinjitet – kështu ka më shumë gjasa që ata t'ju dëgjojnë dhe t'ju kuptojnë.
- Shpjegoni informacionin në mënyrë të ndjeshme dhe të qartë dhe sigurohuni që ata të kenë kuptuar të gjitha pikat.
- MOS u mjaftoni thjesht duke ua lexuar rregullat - shpjegoni pse janë të rëndësishme dhe cilat janë pasojat e mosrespektimit të tyre.
- Kushtojini vëmendje të veçantë atyre që mund të kenë vështirësi në kuptimin e informacionit.
- Jepuni të burgosurve mundësinë të bëjnë pyetje në lidhje me informacionin në çdo kohë.
- Diskutoni me personat në burg nëse kanë nevojë për ndonjë informacion tjetër, nëse ndonjë informacion është i pasaktë, ose nëse ata mendojnë se ka mënyra më të mira se si mund të jepet informacioni.
- Sigurohuni që materialet të jenë të përditësuara dhe që materialet e ekspozuara të mos jenë të dëmtuara/të jenë ende të dukshme për të gjithë dhe të jenë të ekspozuara kudo në të gjithë godinën.
- Sigurohuni që të kenë gjendje të mjaftueshme të fletëpalosjeve të ndryshme.
- Sigurohuni që të gjithë mund t'i qasen informacionit, duke përfshirë ata në izolim të veçuar ose izolim për arsye mjekësore, ata që marrin kujdes mjekësor dhe ata që i nënshtrohen procedurave disiplinore, duke përfshirë izolimin në vetmi.
- Sigurohuni që grupe të veçanta të kenë informacionin specifik që u nevojitet dhe që informacioni të paraqitet në një format që ata mund ta kuptojnë.
- Punoni me njerëzit në burg për ofrimin e informacionit ndërmjet të burgosurve dhe përfshijini ata në nisma për të zhvilluar mënyra të reja të komunikimit të informacionit.
- Sigurohuni që drejtuesit e burgut të jenë në dijeni të çdo problemi që ka të bëjë me dhënien e informacionit.

4.2

1 ORË 30 MINUTA

NMR:8 (D), 56
DHE 57

USHTRIM 15
MINUTA

KËRKESAT DHE ANKESAT

Jepuni pjesëmarrësve 15 minuta kohë për të lexuar rregullat përkatëse përpara se të prezantoni skenarin në faqen e UNODC-së në lidhje me ankesat e të burgosurve

Si kontribuojnë kërkesat dhe ankesat në menaxhimin e sigurt dhe efektiv të burgjeve?

Kërkojini grupit të mendojë se si kontribuojnë kërkesat dhe ankesat në menaxhimin e sigurt dhe efektiv të burgut dhe se si kjo mund të ndihmojë në punën e personelin të burgut.

➔ Përgjigjet duhet të përfshijnë pikat e mëposhtme dhe jo vetëm. Nëse ka ndonjë pikë që nuk është ngritur në rrahjen e ideve, atëherë shtojeni.

- Personave në burg duhet t'u ofrohen mënyra të sigurt për të bërë kërkesa dhe ankesa - ata mund të mos kenë asnjë mënyrë tjetër për t'i zgjidhur problemet me të cilat përballen.

- Ato mund të ndihmojnë të burgosurit të mposhtin ndjesitë e pafuqisë dhe të ndiejnë se mund të kontribuojnë në përmirësimin e jetës në burg.
- Mekanizmat janë një masë mbrojtje e rëndësishme kundër torturës, keqtrajtimit dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut dhe veprojnë në mënyrë parandaluese.
- Përmes tyre bëhet e mundur që autorët e shkeljeve të të drejtave të njeriut të frenohen nga kryerja e këtyre shkeljeve ose në rast të kundërt të identifikohen dhe të mbajnë përgjegjësi, dhe po ashtu që abuzimi të mos përsëritet.
- Këto sisteme u lejojnë autoriteteve të burgut të identifikojnë problemet brenda institucionit të cilat nuk do të mund t'u vinin në dijeni ndryshe. Këto mund të jenë çështje relativisht të vogla, praktike ose mosfunksionime sistematike të një shkalle më të gjerë.
- Ato mund të parandalojnë përshkallëzimin e problemeve të vogla në çështje më të mëdha (përfshirë trazirat e të burgosurve), duke kursyer kohë dhe burime në afat të gjatë.
- Ata mund të ndërtojnë besim midis stafit dhe të burgosurve, të ulin tensionet brenda komunitetit të burgut dhe të sjellin si rezultat kushte më të sigurt për të gjithë.
- Ata i fenojnë personat në burg që ta marrin vetë situatën në dorë, gjë e cila mund të çojë në sjellje përçarëse dhe në vendosjen e rregullave jozyrtare.
- Sistemet që funksionojnë mirë mund të mbrojnë gjithashtu personelin nga akuzat e padrejta.
- Ata mund të ndihmojnë drejtuesit e burgut të identifikojnë nevojat për trajnim të personelit ose problemet me rekrutimin e personelit.
- Ato gjithashtu mund të ndihmojnë në ndërtimin e besimit tek sistemet e burgjeve në radhët e personave në burg dhe komunitetit më të gjerë.

Nivelet e ndryshme të ankesave

Ankesat duhet të trajtohen në forma të ndryshme, në varësi se sa të rënda janë. Rregullat e Nelson Mandelës nxjerrin në pah nivele të ndryshme të mekanizmave të kërkesave dhe ankesave.

Ankesat mund t'i bëhen:

- drejtorit/ose përfaqësuesit të burgut
- inspektorit të burgut
- administratës qendrore të burgut
- një autoriteti gjyqësor ose autoriteti tjetër kompetent
- një organi të pavarur kombëtar

Në realitet, shumë kërkesa dhe ankesa i bëhen personelit në mënyrë joformale. Kjo mund të funksionojë mirë kur personat në burg kanë një marrëdhënie të mirë me personelin dhe ndihen rehat duke kontaktuar me ta për probleme specifike. Edhe në raste të tilla, është sërish shumë e rëndësishme që të ketë një sistem zyrtar kërkesash/ ankesash, pasi jo gjithçka mund të zgjidhet në mënyrë joformale.

Kërkesat dhe ankesat e përditshme	Ankesat më serioze	Pretendimet për torturë ose keqtrajtime të tjera
Ngrihen përmes procedurave jozyrtare të ankesave	Kërkojnë zgjidhje përmes mekanizmave zyrtar të ankesave	Duhet të hetohen edhe nëse nuk ka asnjë ankesë
Mund të zgjidhen pa iu drejtuar procedurave zyrtare	Kërkojnë hetime dhe përgjigje zyrtare	Duhet të trajtohen dhe të hetohen sa më shpejt dhe në mënyrë të paanshme
Nëse nuk zgjidhen, mund të kalojnë në një kërkesë/ankesë zyrtare	Nëse refuzohen ose vonohen, mund t'i kalojnë një autoriteti gjyqësor ose ndonjë autoriteti tjetër	Hetim dhe ndjekje penale zyrtare. Duhet ndërmarrë hapa për të mbrojtur viktimën dhe çdo dëshmitar

Kërkesat dhe ankesat e përditshme

- Me shumë gjasa shumica e kërkesave/ankesave në një institucion janë të këtij lloji të cilat mund të prekin shumë nga personat në burg.
- Ndër shembujt mund të përmendim cilësinë e ushqimit, erën e cigareve, humbjen ose vjedhjen e sendeve personale, problemet me telefonat ose nivelet e zhurmës.
- Këto probleme mund të duken të vogla, por ka të ngjarë të jenë tepër të rëndësishme për të burgosurit pasi mund të kenë një ndikim të madh në jetën e tyre të përditshme.
- Këto probleme duhet të jenë relativisht të lehta për t'u zgjidhur shpejt dhe me pak burime nga autoritetet e burgut.
- Nëse zgjidhen shpejt dhe në mënyrë efektive, përgjigja mund të ketë një ndikim pozitiv të një pjesë e madhe e të burgosurve, të ulë shkallën e zemërimit dhe stresit dhe të çojë në një mjedis pune më të sigurt për personelin.
- Këto lloj kërkesash/ankesash zakonisht mund të ngrihen dhe trajtohen “së brendshmi” dhe pa iu drejtuar procedurave zyrtare.

- Ata mund të ngrihen në mënyrë joformale, gjatë bisedave me personelin (nëse të burgosurit ndihen të sigurt/rehat në këtë formë), nëpërmjet përfaqësuesve të të burgosurve ose duke përdorur kutitë konfidenciale të ankesave.
- Këto probleme mund të ngrihen edhe në nivele të tjera - p.sh., tek zyrtarët më të lartë, tek inspektorët e burgjeve, institucioni i Avokatit të Popullit ose organe të tjera.
- Nëse nuk zgjidhen, këto kërkesa/ankesa mund të zgjidhen përmes procedurave më zyrtare.

Ankesat më serioze

- Ka gjasa që këto të jenë ankesa që nuk mund të zgjidhen në mënyrë joformale dhe mund të kërkojnë ndërhyrje të jashtme.
- Këtu mund të përfshihen ankesat për punonjës të caktuar ose për probleme në menaxhimin e burgut që kërkojnë shqyrtim/ndërhyrje të pavarur.
- Nëse autoritetet e burgut nuk ia dalin t'u përgjigjen ose të zgjidhin kërkesat e përditshme, ato bëhen më serioze dhe mund të përshkallëzohen nëpërmjet procedurave më formale.
- Këto lloj ankesash ka të ngjarë të kërkojnë përgjigje dhe burime më komplekse.
- Këtu mund të përfshihen mosfunksionimi i sistemeve ose çështje që prekin individët, të cilat nuk zgjidhen lehtësisht ose në mënyrë të sigurt 'së brendshmi'.
- Ankesa të tilla përfshijnë akuzat për trajtim diskriminues, zbatimin e padrejtë të procedurave disiplinore, përdorimin e tepruar të forcës ose raste të bullizimit.
- Të burgosurit mund të përdorin edhe procedura formale për kërkesat/ankesat e përditshme, sidomos nëse nuk ndihen të sigurt/rehat me procedurat më pak formale ose 'të brendshme'.

Pretendimet për torturë dhe keqtrajtime të tjera

- Përgjigja ndaj këtyre pretendimeve kërkon procedura të veçanta në përputhje me Konventën e OKB-së kundër Torturës dhe duhet trajtuar menjëherë.
- Duhet ndërmarrë një hetim sa herë që ka baza të arsyeshme për të besuar se mund të jetë kryer një akt torture ose keqtrajtimi.
- Hetimi për aktet e mundshme të torturës ose keqtrajtimit duhet kryer edhe nëse nuk është paraqitur asnjë ankesë.
- Hetimet duhet të jenë të shpejta, të paanshme dhe të pavarura.
- Duhet të ndërmerren veprime të menjëhershme për të mbrojtur viktimën, dëshmitarët dhe çdo person tjetër potencialisht të përfshirë, nga dëmtimi dhe hakmarrja e mëtejshme.

USHTRIM

Pengesat që hasin grupe të veçanta të burgosurish në bërjen e kërkesave/ankesave.

→ Kërkojuni pjesëmarrësve të sugjerojnë se cilat mund të jenë pengesat dhe veprimet zbutëse për secilin grup.

GRATË

Pengesat

- Gratë mund të kenë shkallë më të lartë analfabetizmi.
- Kutitë e ankesave mund të jenë në seksionet e burgut për burra.
- Gratë mund të ndihen më pak të fuqizuara për të bërë kërkesa/ankesa.
- Ata mund të kenë më shumë arsye për të pasur frikë nga hakmarrja, sidomos në rastet e akuzave për dhunë seksuale.

Veprimet zbutëse

- Të sigurohet që grave t'u ofrohen të njëjtat mundësi si burrave për të bërë kërkesa/ankesa.
- Gratë të lejohen t'i raportojnë problemet punonjëseve gra të institucionit nëse ndihen më rehat në këtë formë.
- Të vendosen masa të veçanta mbrojtëse për ato që ngrenë akuza për dhunë seksuale.
- Të inkurajohet dialogu ndërmjet grave në burg për proceset e kërkesave/ankesave.

TË RINJTË NË BURG

Pengesat

- Shkalla e analfabetizmit tek të rinjtë në burg mund të jetë e lartë.
- Aftësia e tyre për të kuptuar procedurat e kërkesave/ankesave mund të jetë e mangët.
- Të rinjtë mund të kenë më shumë frikë nga pasojat e ankesave.
- Personeli mund të ketë prirjen që mos t'i marrë seriozisht ankesat e tyre.

Veprimet zbutëse

- Të komunikohet informacioni në lidhje me procedurat e kërkesave/ankesave dhe të sigurohet që çdo përgjigje të jetë në një gjuhë/format të përshtatshëm për të miturit.
- Të lejohen të tjerët të bëjnë kërkesa/ankesa në emër të tyre.

SHTETASIT E HUAJ

Pengesat

- Ata mund të mos i kuptojnë procedurat dhe do të kenë nevojë për ndihmë me përkthimin në momentin që bëjnë një ankesë.
- Duke qenë se janë një grup pakicë, ata mund të mendojnë se kërkesat/ankesat e tyre nuk do të shqyrtohen në mënyrën e duhur.
- Ata mund të kenë kërkesa/ankesa krejt të ndryshme nga personat e tjerë në burg.
- Gjasat që ata të kenë afër anëtarë të familjes që mund të bëjnë ankesa në emër të tyre janë më të pakta.

Veprimet zbutëse

- Të sigurohet që informacioni rreth procedurave të jetë i disponueshëm në gjuhë të tjera ose që ato të jenë shpjeguar nëpërmjet përkthyesve.
- Të vihen në dispozicion shërbimet e përkthimit për ankesa, seanca dëgjimore dhe përgjigje.

- Të lejohen përfaqësuesit e ambasadës ose konsullatës që të ndihmojnë me kërkesa/ankesa specifike.

PERSONAT ANALFABETË OSE ATA ME NJOHURI TË PAKTA NË SHKRIM-KËNDIM

Pengesat

- Ata mund të mos i kuptojnë procedurat dhe nuk janë në gjendje të bëjnë kërkesa/ankesa me shkrim.
- Ata gjithashtu do të hasnin vështirësi për të kuptuar çdo përgjigje që marrin me shkrim.
- Ata mund të ndihen të pafuqishëm brenda komunitetit të burgut.

Veprimet zbutëse

- Të sigurohet që informacioni rreth procedurave të shpjegohet gojarisht.
- Të lejohet që ankesat të regjistrohen dhe që përgjigjet të jepen edhe ato gojarisht.
- Të përfshihen shoqatat përfaqësuese të të burgosurve për të ndihmuar personat në burg që nuk janë në gjendje të bëjnë kërkesa/ankesa.

TË BURGOSURIT ME PROBLEME TË SHËNDETIT MENDOR APO AFTËSI TË KUFIZUARA INTELEKTUALE

Pengesat

- Ata mund të kenë vështirësi për të kuptuar procedurat e ankesave.
- Kërkesat/ankesat e tyre në bazë të nevojave personale mund të jenë mjaft ndryshe nga ato të personave të tjerë në burg.
- Personeli mund të ketë prirjen të mos i marrë seriozisht ankesat e tyre.

Veprimet zbutëse

- Të përfshihen shoqatat përfaqësuese të të burgosurve për të ndihmuar personat në burg që nuk janë në gjendje të bëjnë kërkesa/ankesa.
- Të sigurohet që informacioni rreth procedurave të shpjegohet qartë dhe të marrë parasysh nevojat individuale.

TË BURGOSURIT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Pengesat

- Ata mund të kenë të vështirë të kenë qasje në mjetet fizike për të bërë ankesa (p.sh. kutitë e ankesave).
- Kërkesat/ankesat e tyre në bazë të nevojave personale mund të jenë mjaft ndryshe nga ato të personave të tjerë në burg.

Veprimet zbutëse

- Të sigurohet që të gjithë personat në burg të mund të kenë mundësi fizikisht të përdorin mjetet e nevojshme për të bërë kërkesa/ankesa.
- Të vihen në dispozicion procedurat në alfabetin Braj (Braille) për personat e verbër ose me shikim të dëmtuar dhe në gjuhën e shenjave për personat e shurdhër ose me vështirësi në dëgjim.

PAKICAT ETNIKE DHE RACORE DHE POPUJT INDIGJENË

Pengesat

- Barrierat gjuhësore mund t'i pengojnë ata të bëjnë kërkesa/ankesa.
- Disa grupe mund të mos jenë të mësuar të bëjnë kërkesa/ankesa individuale.
- Këta persona mund të ndeshën me njëanshmërinë në gjykimin i ankesave të tyre në burg.
- Duke qenë grup pakicë, ata tashmë mund të ndihen të pafuqishëm me komunitetin e burgjeve.

Veprimet zbutëse

- Çdo kërkesë/ankesë duhet të shqyrtohet në bazë të meritës që ka.
- Sigurohet që informacioni rreth procedurave të jetë i disponueshëm në gjuhë të tjera ose që ato të jenë shpjeguar nëpërmjet përkthyesve.
- Të lejohen kërkesat ose ankesat kolektive ose të deleguara.
- Duhet ngritur sisteme për të monitoruar çdo anshmëri në përgjigjet ndaj kërkesave/ankesave.

PERSONAT LGBTI NË BURG

Pengesat

- Ata mund të kenë frikë nga pasojat e bërjes së kërkesave/ankesave, veçanërisht nëse kjo ka të bëjë me orientimin e tyre seksual/identitetin gjinor.
- Ata tashmë mund të ndihen të pafuqishëm me komunitetin e burgjeve.

Veprimet zbutëse

- Të sigurohet konfidencialiteti i mekanizmave të ankesave dhe të lejohet që ankesat të bëhen në mënyrë anonime.
- Të vendosen masa të veçanta mbrojtëse për ata që ndiejnë frikë sa i përket sigurisë së tyre në lidhje me një kërkesë/ankesë.

Prisons and Probation Ombudsman video (Videoja e Avokatit të Popullit për Burgjet dhe Shërbimin e Provës - 10 minuta).

→ Në video janë paraqitur tri ankesa. Ndalon video pas çdo ankese për të lejuar grupin të ndajë mendimet dhe reagimet e tyre.

USHTRIM
20 MINUTA

Ankesat

Ndajini pjesëmarrësit në dy grupe, A dhe B. Personat në Grupin A marrin përsipër rolin e të burgosurve ndërsa Grupi B janë drejtuesit e burgut. Të gjithë pjesëmarrësve në grupin A u jepen nga dy fletë. Në njërin do të shkruajnë se si shpresojnë që të trajtohet/zgjidhet kërkesa/ankesa e tyre. Rasti mund të jetë një shembull i një ankese reale me të cilën ata janë marrë, ose një situatë imagjinare.

Çdo person në grupin B zgjedh një nga ankesat dhe punon në çift me personin që e ka paraqitur atë ankese. Drejtuesi i shpjegon të burgosurit se si do ta trajtonte ankesën. Dyshja më pas diskuton nëse bien dakord për mënyrën se si trajtohet ankesa.

dhe/ose

USHTRIM
OPSIONAL
20 MINUTA

Shkruani citimet e mëposhtme në tabakët e vendosur në tabelë dhe kërkojuni pjesëmarrësve të shkruajnë mendimet/sugjerimet e tyre se çfarë mund të bëjnë administratorët e burgut.

Pas çdo citimi jepet edhe një lloj konteksti për të ndihmuar në nxitjen e diskutimit nëse është e nevojshme. Në varësi të dinamikës së grupit dhe kohës në dispozicion, ju mund të pyesni se çfarë mund të bëjnë administratat e burgut për çdo situatë. Pas çdo citimi, përmbledhni pikat kryesore që duhet të ishin ngritur.

Shënim: Në disa vende, personat në burg nuk kanë mundësi të bëjnë kërkesa apo ankesa, ose sistemet janë thjesht shumë joefektive.

Ky ushtrim mund të bëhet edhe në formën e faqeve në PowerPoint.

Cilat janë arsyet që të burgosurit nuk bëjnë kërkesa apo ankesa dhe çfarë mund të bëjë administrata e burgut për të lehtësuar këto barriera?

1. Frika nga reprezaljet/pasojat e tjera

“Jam jashtëzakonisht i frikësuar sepse nuk guxon të hapësh gojën për asgjë”

“Nuk bëj më ankesa sepse i njoh mirë pasojat e ankesave”

Zakonisht ndodh që të burgosurit të kenë frikë nga hakmarrja ose reprezaljet ose të kenë frikë se do të ndëshkohen për ankesën që kanë bërë. Këto reprezalje mund të vijnë nga persona të tjerë në burg ose personel i burgut. Të burgosurit mund të etiketohen apo të veçohen si ngatërrestarë dhe të përjashtuar, dhe stafi mund t'i trajtojë ndryshe, t'u heqë privilegjet ose të gjejë mënyra të tjera për t'i ndëshkuar për arsye se janë ankuar.

Personat në burg mund të jenë gjithashtu të shqetësuar se do të ketë pasoja të tjera negative që vijnë si rrjedhim i ankesave të tyre (p.sh., ata mund të transferohen në një institucion tjetër me qëllim mbrojtjen e tyre, por kjo mund të sjellë për pasojë kushte më të këqija të qëndrimit në burgim ose ata mund të dërgohen më larg familjeve të tyre).

Çfarë mund të bëjnë administratat e burgjeve për ta lehtësuar këtë situatë?

- Të sigurohen që njerëzit të mund të bëjnë ankesa në konfidencialitet të plotë.
- Të sigurohen që personat në burg të dinë se si të përdorin mekanizmat e pavarur të ankesave.
- Të lejojnë që ankesat të bëhen në mënyrë anonime.
- Nëse ankesat janë bërë publikisht, të ndiqet situata me individin në fjalë dhe çdo dëshmitar për të kontrolluar se nuk ka pasur pasoja negative.
- Të lejohen palët e tre të bëjnë ankesa në emër të personit në burg.
- Të sigurojnë mbrojtje nga sinjalizuesit për personelin që bën ankesat.
- Të sigurojnë mbrojtje e menjëhershme për personat që kanë raportuar raste abuzimi. Duhet të përcaktohen procedura të posaçme për ankesat për sjellje të pahijshme të ngritura ndaj individëve të personelit.
- Të sigurojnë që personeli të ketë marrë trajnimin e duhur për trajtimin e ankesave.
- T'u jepet informacion i plotë të burgosurve në lidhje me procesin e kërkesave/ ankesave, duke përfshirë masat që merren për të garantuar konfidencialitetin.

2. Mungesa e besimit tek procedurat e kërkesave/ankesave

“Punonjësit dhe përdoruesit e tjerë, persona të tjerë kanë qasje në këto procedura, modifikojnë ankesat, ndryshojnë çfarë të duan dhe disa nga ankesat as që dërgohen”

“Ata thjesht kanë kthyer këtë përgjigje me shkrim: “Ankesa juaj është regjistruar. Ne do t’ju kontaktojmë sërish”, dhe ata nuk më kanë kontaktuar më”

Të burgosurit mund të mendojnë se është humbje kohe të bësh një kërkesë ose ankesë dhe mund të mos kenë besim tek mënyra se si kryhen procedurat, sidomos nëse ka raste që ata ose personat që ata njohin kanë bërë ankesa në të kaluarën të cilat nuk janë trajtuar mirë ose nuk janë zgjidhur në mënyrën e duhur.

Ata persona që duan të bëjnë kërkesa/ankesa gjithashtu mund të ngurrojnë ta bëjnë një gjë të tillë sepse nuk i besojnë konfidencialitetit të procesit. Kjo mund të jetë problematike sidomos nëse ankesa ka të bëjë me një të burgosur tjetër ose individ të veçantë të personelit, ose nëse individ i ndihet i turpëruar ose i sikletosur për kërkesën/ankesën e tij.

Çfarë mund të bëjnë administratat e burgjeve për ta lehtësuar këtë situatë?

- Të lejojnë të burgosurit të japin mendime për mënyrën se si janë krijuar dhe zbatuar mekanizmat e kërkesave/ankesave dhe të japin komente nisur nga përvojat e tyre të mëparshme në bërjen e kërkesave/ankesave.
- Të sigurojnë që të ketë transparencë rreth procedurave për kërkesat/ankesat dhe që të gjithë personave në burg u jepet informacion se si duhet të funksionojnë procedurat, përfshirë informacionin për afatet kohore për zgjidhjen e kërkesave/ankesave.
- Të sigurojnë që kërkesat/ankesat t’u shkojnë vetëm personave të cilëve u drejtohen.
- Të sigurojnë që të ketë procedura të cilat nuk lejojnë që ankesat të humbasin, të ngatërrohen ose të shpërfillen - për këtë duhet të sigurohet që ankesat të jenë në zarfe të mbyllura dhe që kutitë e ankesave janë plotësisht të sigurta.
- Të mbajnë të informuar personin në burg për ecurinë dhe ritmin kohor të kërkesës/ankesës së tij.
- Të sigurojnë që personeli të jetë plotësisht i trajnuar për tu marrë me kërkesat dhe ankesat dhe që të ketë mekanizma mbikëqyrës për të siguruar që kërkesat/ankesat trajtohen në mënyrë korrekte.
- Të sigurojnë që personat në burg të kenë qasje në mekanizmat e pavarur të ankesave nëse çështja nuk trajtohet/zgjidhet së brendshmi.
- Të identifikohen prirjet në ankesa dhe të merren masa përkatësisht.

3. Ndjesia se problemet në burg janë të pashmangshme

“Nuk ka kuptim të ankohesh për çdo gjë të vogël, thjesht bëji ballë vëlla sepse je në burg. Nuk të presin me lule kur vjen këtu.”

“Nuk ke çka të marrësh asgjë... Çfarëdo lloj ankese të kesh, merru vetë me të, je në burg”

Disa të burgosur mund të mendojnë se problemet me të cilat përballen në burg janë të pashmangshme, që janë thjesht pjesë e jetës në burg dhe se ata nuk duhet të kenë pritshmëri për të bërë kërkesa apo ankesa. Në disa prej nënkulturave të burgut mund të ketë të burgosur që kanë perceptimin se të bësh kërkesa/ankesa është një shenjë dobësie ose e pamundësisë për të përballuar jetën në burg.

Çfarë mund të bëjnë administratat e burgjeve për ta lehtësuar këtë situatë?

- Të sigurohen që të burgosurit të kenë marrë informacion për të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre.
- Të inkurajojnë diskutimet në grupe midis të burgosurve /grupet mbështetëse për të diskutuar të drejtat e tyre si të burgosur, përfshirë të drejtën e tyre për të bërë kërkesa/ankesa.
- Të bëjnë të qartë se çfarë lloj sjelljeje duhet të presin nga personeli i burgut dhe të burgosurit e tjerë, dhe çfarë lloj sjelljesh janë të papranueshme.
- Të flasin me individët për problemet e tyre (nëse ata ndihen mirë kështu) dhe t'i inkurajojnë të bëjnë kërkesa dhe ankesa joformale, ose të përdorin ankesat formale nëse problemi nuk mund të zgjidhet pa iu drejtuar procedurave formale.
- Të nxisin nismat që fuqizojnë personat në burg, t'i bëjnë të ndihen pjesë e një komuniteti dhe t'u mundësojnë të luajnë rolin e tyre në përmirësimin e mënyrës së drejtimit të burgut.
- Të bëjnë të qartë se zgjidhja e kërkesave/ankesave specifike mund të jetë në të mirën e të gjithë personave në institucion, dhe jo vetëm të individit në fjalë.

4. Procedurat burokratike dhe koha e ngadaltë e kthimit të përgjigjes

"A e dini pse nuk kam hedhur kurrë asnjë ankesë në letër? Sepse derisa të vinte koha që ata ndoshta do ta kishin parë, letra do më ishte bërë çarçaf."

"Mendoj se e gjithë ka të bëjë shumë me kohën dhe kur do vijë momenti që të dëgjohesh... Si me thënë, është si një tjetër gjë për të cilën duhet të presësh"

Natyra e ngadaltë, burokratike e proceseve të kërkesave/ankesave dhe koha e ngadaltë në kthimin e përgjigjes mund të jetë një dekurajues i madh për shumë nga personat në burg, sidomos për problemet që kërkojnë vëmendje të menjëhershme. Kjo mund të jetë akoma më problematike në kohë krizash, si pandemia COVID-19.

Shumë probleme me të cilat përballen të burgosurit do të jenë sfumuar ose do të jenë zgjidhur derisa të vijë koha që ankesa të fillojë të trajtohet. Kjo është arsyeja pse personat shpesh e marrin vetë situatën në duar ose i drejtohen të burgosurve të tjerë për ndërhyrje. Vonesat e konsiderueshme në procedurat e ankesave mund edhe të vënë në rrezik një individ.

Disa personave mund t'ju duket bërja e një kërkesë ose ankese thjesht si një tjetër proces burokratik me të cilin duhet të përballen, një tjetër formular për të plotësuar. Mungesa e përgjigjes, vonesa në përgjigje ose zgjidhja e pakënaqshme mund t'i bëjë të burgosurit të ndihen të pafuqishëm.

Çfarë mund të bëjnë administratat e burgjeve për ta lehtësuar këtë situatë?

- Të përcaktojnë një afat kohor të qartë për procesin, duke përfshirë kohën e përgjigjes. Nëse një ankesë nuk mund të trajtohet kurrësi në kohën e duhur, të dërgohet një përgjigje të përkohshme për të shpjeguar arsyen dhe të caktohet një afat i ri kohor.
- Të sigurojnë që afati kohor për t'iu përgjigjur kërkesave/ankesave lejon që çështjet të trajtohen në një mënyrë kuptimplote.
- T'i japin përparësi ankesave urgjente, sidomos në rastet kur një individ mund të jetë në rrezik. Ankesat urgjente duhet të shqyrtohen edhe gjatë fundjavave dhe festave zyrtare.

- T'i japin personave në burg konfirmimin se kërkesa/ankesa e tyre është marrë dhe është duke u shqyrtuar, dhe t'i përditësojnë për ecurinë dhe kohën e përgjigjes.
- Të sigurohen që kutitë e ankesave dhe platformat e tjera për marrjen e kërkesave/ ankesave kontrollohen çdo ditë.

5. Mosqasja në procedurat e ankesave/ kërkesave

“A nuk e kuptoni që shumë nga këta persona që vijnë në burg nuk ia kanë pasur haberin shkollës. Ata nuk mund të shkruajnë ankese, nuk mund të bëjnë gjëra, ata mbase as nuk mund të lexojnë ndoshta”

Disa të burgosur nuk bëjnë kërkesa/ankesa thjesht sepse u mungon informacioni për procesin e ankesave, duke përfshirë mënyrën se si të ankohen, kujt t'i ankohen, për çfarë mund të ankohen dhe çfarë duhet të bëjnë nëse ankesa nuk trajtohet.

Disa të burgosur mund ta kenë të pamundur të kenë qasje në procedurat e kërkesave dhe ankesave, ose sepse nuk janë fizikisht në gjendje të kenë qasje në mjetet për të bërë kërkesa/ankesa, ose sepse u mungon aftësia për të formuluar kërkesën/ ankesën, për shkak të pengesave gjuhësore, dallimeve kulturore, niveleve të arsimimit ose shkrim-leximit, ose kushteve të shëndetit fizik ose mendor.

Çfarë mund të bëjnë administratat e burgjeve për ta lehtësuar këtë situatë?

- Të sigurohen që të gjithë të burgosurit të dinë të bëjnë ankese dhe të kenë qasje në mjetet e nevojshme (p.sh. stilolaps dhe letër, pulla postare, kompjuterë).
- Të shmangin zhargonin, akronimet dhe gjuhën tepër teknike.
- Të sigurohen që të gjithë të burgosurit të kenë qasje në kutitë e ankesave, të cilat duhet të jenë të instaluar në vende të përshtatshme dhe të kyçura siç duhet.
- Të hartojnë procedura që të jenë të thjeshta dhe të përshtatshme për t'u përdorur, dhe t'ua shpjegojnë këto procedura të burgosurve në mënyrë të qartë.
- T'i kushtojnë vëmendje të veçantë grupeve të të burgosurve që mund të kenë vështirësi për të kuptuar ose përdorur procedurat e kërkesave/ankesave dhe t'i ofrojnë mbështetje sipas nevojës.
- Të sigurohen që në përgjigjet e dhëna përdoret një gjuhë e lehtë për t'u kuptuar dhe të kontrollojnë nëse të burgosurit e kuptojnë atë që thuhet në përgjigje.

6. ‘Ata kundër nesh’

“Por puna është se kur ti ankohesh për një oficer tjetër, ankesa më pas i shkon një tjetër oficeri, dhe kështu ata mbrojnë njëri-tjetrin”

“Është fjala jote kundër fjalës së tyre... fundja ne jemi akoma kriminelë apo jo, për këtë arsye jemi këtu sigurisht... ata thjesht na shohin si ato tipat e këqij”

Në shumë institucione të burgimit, ka mungesë besimi në objektivitetin e personelit; një perceptim se personeli do t'i dalë përkrah dhe do të mbrojë njërin ose tjetrin përkundër asaj që thuhet nga të burgosurit. Një kulturë e ashtuquajtur “ata kundër nesh”. Aty ku ekziston kjo lloj kulture - ose kur të burgosurit e perceptojnë një gjë të tillë - besimi tek procedurat e ankesave ka të ngjarë të jetë i ulët dhe përdorimi i procedurave të jetë i kufizuar.

Çfarë mund të bëjnë administratat e burgjeve për ta lehtësuar këtë situatë?

- T'ia bëjnë të qartë si personelit ashtu edhe të burgosurve se procedurat efektive të ankesave mund të jenë në të mirën e të gjithëve në institucion, duke sjellë edhe krijimin e një mjedisi më të sigurt pune për personelin.
- Të sigurojnë që të gjitha ankesat e pranuar dhe përgjigjet të regjistrohen siç duhet.
- Të kenë një qasje të orientuar drejt zgjidhjes së problemit kur merren me zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave - trajtoni problemin e vërtetë që është ngritur si dhe shkaqet që qëndrojnë pas këtij problemi.
- Të kenë procedura të qarta disiplinore për personelin që konstatohet se ka ndërhyrë ose ka injoruar kërkesat/ankesat.
- Të sigurojnë një sistem monitorimi të pavarur të mekanizmave, duke përfshirë cilësinë e përgjigjeve të marra.
- T'u ofrojnë të burgosurve mundësinë për të apeluar nëse mendojnë se kërkesa/ ankesa e tyre nuk është trajtuar në mënyrë të kënaqshme.

OPSIONALE

Le të rishikojmë se çfarë e bën të mirë një sistem kërkesash/ankesash:

- Jepuni personave në burg mundësinë për të treguar versionin e tyre të historisë.
- Trajtoni njerëzit me respekt dhe merrni seriozisht problemet e tyre.
- Sigurohuni që të gjithë të kenë qasje të barabartë tek procedurat.
- Jini të qartë dhe transparent në lidhje me procesin.
- Kërkojuni komente për të përmirësuar procesin.
- Sigurohuni që vendimmarrja të jetë në kohën e duhur, e drejtë dhe e paanshme.
- Trajtoni problemin ekzistues që po ngrihet dhe shqyrtoni shkaqet që qëndrojnë pas këtij problemi.
- Jepuni mundësinë për të diskutuar rezultatet dhe për të apeluar vendimet.
- Lejojini njerëzit të bëjnë kërkesa/ankesa pranë organeve të pavarura.
- Ndërtoni sisteme për të monitoruar dhe siguruar qëndrueshmërinë e vendimeve.

4.3 KONTAKTI ME BOTËN E JASHTME

40 MINUTA

NMR: 58 – 66, 68 – 70, 119 (2), 120

Në këtë seksion do të trajtohen kontaktet me familjen dhe miqtë, mundësia për të pasur një përfaqësues ligjor dhe qasja tek njoftimet.

Pse është kaq i rëndësishëm kontakti me botën e jashtme?

- Është i rëndësishëm për rehabilitimin dhe riintegrimin e suksesshëm të të burgosurve - i ndihmon ata të përgatiten praktikisht dhe psikologjikisht për jetën pas lirit nga burg.
- Kontakti me familjen ose të tjerët mund të ulë nivelet e stresit. Kontakti me familjen është i rëndësishëm sidomos për ata që janë prindër dhe kujdestarë të tjerë që ndodhen në burg. Për më tepër, kjo i ndihmon të pakësojnë ankthin për atë që u ka ndodhur fëmijëve të tyre.
- Kontakti me familjen kontribuon për një burg më të shëndetshëm dhe më të sigurt dhe përmirëson mjedisin e punës për personelin.
- Kontakti fillestar me familjen dhe persona të tjerë të rëndësishëm pas mbërritjes në burg ka mjaft rëndësi për të ulur nivelin e stresit.

- Shërben si një masë mbrojtëse e rëndësishme kundër torturës, keqtrajtimit të tjerë, ndalimit pa komunikim dhe shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut, si dhe u siguron personave të burgosur një rrugë për të raportuar rastet e abuzimit.
- Mund të motivojë personat në burg që të sillen më mirë, duke çuar në një mjedis më të sigurt për të gjithë.
- Ndhmon të burgosurit të ndihen pjesë e familjes së tyre dhe e shoqërisë më gjerë dhe u kujton atyre se kanë përgjegjësi jashtë burgut.
- U ndjeshin e izolimit dhe mërzisë, gjë e cila mund të çojë në përmirësimin e mirëqenies psikologjike dhe të ulë rrezikun e vetëdëmtimit dhe vetëvrasjes - vizitorët mund t'i dalin të dallojnë simptomat e hershme të depresionit ose shenja të tjera paralajmëruese.
- Ofron një shteg përmes të cilit të burgosurit mund të shprehin problemet, frikën dhe zhgënjimet e tyre, duke ulur potencialin për trazira në burg.
- Zvogëlon rrezikun e shkatërrimit të familjes si rezultat i burgimit dhe është i rëndësishëm për familjet, veçanërisht për mirëqenien e fëmijëve të të burgosurve.
- Për disa persona në burg, vizitat nga familja ose miqtë janë një burim i rëndësishëm për ushqime, pije, sende sanitare dhe ilaçe.
- Mundësia për të pasur avokat është një komponent themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë dhe sigurimin e barazisë para ligjit. Ata që marrin këshilla ligjore kanë më shumë gjasa të përfitojnë nga mundësia e alternativave ndaj paraburgimit ose masave të tjera që nuk përfshijnë arrestimin me burg.
- Qasja në media (gazeta, radio, TV etj.) u mundëson të burgosurve të lidhen me atë që po ndodh në komunitet dhe të ndihen pjesë e atij komuniteti. Qasja në media është e rëndësishme sidomos gjatë periudhave të krizave (p.sh., COVID-19).

Raste studimore

USHTRIM
20 MINUTA

Ndajini pjesëmarrësit në grupe më të vogla dhe jepini secilit grup një rast studimor. Kërkojuni grupeve të diskutojnë për sa më poshtë:

- Cilat nga rregullat e Nelson Mandelës dhe rregullat e Bangkokut, që lidhen posaçërisht me kontaktin me botën e jashtme, janë të rëndësishme për këtë situatë?
- Çfarë mund të bëjë personeli i burgut për të mbështetur këta individë?

→ Nëse jua lejon koha, grupi gjithashtu mund të shkëmbejë komente në forumin kryesor, por nëse jeni keq me kohën mund ta kapërceni këtë pjesë.

Në vijim mund të gjeni disa ide për përgjigjet që grupet mund të identifikojnë nën secilin skenar.

1. Një grua 50-vjeçare, shtetase e huaj, e dënua për trafikim narkotikësh nuk ka kontakt me familjen e saj, nuk flet gjuhën vendase dhe praktikon një fe tjetër. Ajo është diagnostikuar me depresion.

→ **RREGULLAT** - NMR 58: Kontakti me familjen dhe miqtë, 61(2): Qasja në përkthim, 62: Komunikimi me përfaqësuesit diplomatikë dhe konsullorë, 65: Qasja në përfaqësuesit fetarë; BKK 27: Kontakti me familjen, 25: Kujdesi ndaj shëndetit mendor

Parimi kryesor – Shtetasve të huaj duhet t'u sigurohet mbështetje shpirtërore për të kontaktuar familjet e tyre.

Çfarë mund të bëjë personeli për të lehtësuar kontaktin?

- Të sigurohet që të jenë në gjendje të komunikojnë me personin për të kuptuar situatën e tyre familjare.
- T'i ndihmojë ata për të komunikuar me përfaqësuesit e tyre diplomatikë, konsullorë ose autoritete të tjera.
- Të shohë nëse është e mundur që gruaja të kontaktojë familjen/miqetë e saj nëpërmjet telefonit, thirrjeve me video ose formave të tjera të komunikimit në distancë.
- T'i lejojë qasjen në një përfaqësues të kualifikuar të fesë së saj.

Masa të tjera për t'u marrë parasysh

- Përcaktoni nëse ekziston ndonjë mundësi që gruaja të transferohet në vendin e saj të origjinës, ose nëse ka një institucion tjetër që do ta bënte më të lehtë kontaktin me familjen/miqetë/përfaqësuesin konsullor.
- Përcaktoni nëse ka punonjës ose persona të tjerë në burg që ndajnë të njëjtën gjuhë me gruan për të lehtësuar komunikimin.
- Zbuloni nëse ka organizata të komunitetit lokal që mund të vizitojnë gruan në burg ose ta mbështesin atë në mënyra të tjera.
- Sigurohuni që ajo të marrë trajtimin dhe mbështetjen e duhur për shëndetin e saj mendor.

2. Një djalë 19-vjeçar, aktualisht në paraburgim për akuzën e vjedhjes, nuk ka asnjë familjar të afërt që ta vizitojë dhe nuk ka as avokat. Djali ka nivel të ulët shkrim-këndimi.

RREGULLAT – NMR 119 dhe 120: Qasja në këshillim ligjor për të paraburgosurit, **61:** Qasja në ndihmën ligjore, **58:** Kontakti me miqtë, **68:** Njoftimi i çdo personi tjetër kontakti për dënimin me burgim

Parimi kryesor: Përkufizimi i familjes dhe miqve duhet të interpretohet në mënyrë të gjerë, në mënyrë që edhe individëve pa familjarë të ngushtë t'u lejohen vizitorë. Të gjithë të burgosurit duhet të kenë mundësinë, kohën dhe lehtësirat e përshtatshme për t'u vizituar, për të komunikuar e për t'u konsultuar me një këshilltar ligjor sipas zgjedhjes së tyre ose një ofrues të ndihmës juridike falas.

Çfarë mund të bëjë personeli për të lehtësuar kontaktin?

- Gjeni nëse ai ka familjarë të tjerë përveç atyre të ngushtë, miq apo njerëz të tjerë me të cilët mund të jetë në kontakt dhe nëse ka, ndihmoheni të vihet në kontakt. Këtu mund të përfshihet çdo individ që ai dëshiron të takojë.
- Identifikoni çdo grup komuniteti që mund ta vizitojë dhe t'i ofrojë mbështetje.
- Sigurohuni që ai ka informacion dhe e kupton se si mund të marrë ndihmë juridike dhe se është në gjendje ta bëjë këtë.

Masa të tjera për t'u marrë parasysh

- Sigurohuni që ai është në gjendje të mësojë dhe të kuptojë informacione të tjera rreth jetës në burg.
- Shikoni nëse ka grupe mbështetëse brenda institucionit që mund ta mbështesin atë.
- Sigurohuni që kontakti me një përfaqësues ligjor të bëhet në konfidencialitet të plotë.

3. Një grua që vuan një dënim prej gjashtë muajsh për përdorim droge ka tre fëmijë të vegjël që mund ta vizitojnë çdo javë bashkë me gjyshen e tyre. Ajo ka kërkuar që të ketë kontakt fizik me ta gjatë vizitave. Gjyshja po kalon ca probleme shëndetësore dhe ka thënë se nuk e di nëse mund të vazhdojë t'i sjellë fëmijët çdo javë.

➔ **RREGULLAT** – NMR 58: Kontakti me familjen, BKK 26 dhe 43: Kontakti me familjen, BKK 28: Vizitat që përfshijnë fëmijët, BKK 45: Opsione të tilla si leje për qëndrim të përkohshëm në shtëpi etj., dhe 46: Planet e integritetit para lirit.

Parimi kryesor – Kontakti i grave me fëmijët e tyre duhet të inkurajohet dhe lehtësohet sa më shumë që të jetë e mundur.

Çfarë mund të bëjë personeli për të lehtësuar kontaktin?

- Shikoni nëse është e mundur të realizohen vizitat e kontaktit. Në këtë rast, nuk besohet të ketë ndonjë shqetësim sa i përket sigurisë rreth vizitave të kontaktit. Vizitat private mund të jenë gjithashtu një opsion.
- Gjithashtu, shikoni nëse mund të zhvillohen vizita më të gjata, për shkak të shëndetit të gjyshes, sidomos nëse vizitat janë të rralla.

Masa të tjera për t'u marrë parasysh

- Sigurohuni që të ketë një mjedis pozitiv në vizitat për fëmijët, duke përfshirë zonat e lojërave, dhe që personeli të shfaqë një qëndrim pozitiv ndaj vizitorëve fëmijë.
- Shikoni nëse mund të ketë opsione të tjera, si leje për qëndrim në shtëpi, në mënyrë që grua të kalojë kohë me familjen e saj, sidomos duke qenë me dënim të shkurtër.
- Zbuloni nëse ka ndonjë organizatë në komunitetin lokal që mund të ndihmojë me transportin e gjyshes dhe fëmijëve në burg, në mënyrë që të vazhdojnë vizitat e rregullta.

4. Një 40-vjeçar po vuan dënimin me 15 vjet. Gruaja dhe fëmijët e tij mund ta vizitojnë vetëm një herë në vit sepse jetojnë larg. Personeli është në dijeni të faktit se ky person është bullizuar kohët e fundit nga të burgosur të tjerë dhe duket i frikësuar, por nuk kanë folur me askënd për këtë gjë.

➔ **RREGULLAT** – NMR 58: Kontakti me familjen, 59: Transferimi afër shtëpisë, 56: Mekanizmat e ankesave

Parimi kryesor – Të burgosurit duhet të vendosen sa më afër familjes së tyre.

Çfarë mund të bëjë personeli për të lehtësuar kontaktin?

- Përcaktoni nëse ka ndonjë mundësi që burri të transferohet në një institucion më afër familjes së tij.
- Zbuloni nëse autoritetet ose organizatat e komunitetit kanë mjete financiare për të mbështetur familjen me transportin dhe akomodimin, në mënyrë që ata të mund ta vizitojnë më shpesh.
- Lejojeni familjen që të kalojë kohë më gjatë së bashku kur ata kanë mundësi të vizitojnë.
- Lejojeni të përdorë më shpesh telefonatat dhe mënyra të tjera komunikimi në distancë për të folur me fëmijët e tij.

Masa të tjera për t'u marrë parasysh

- Flisni me burrin se si ndihet ai, veçanërisht në dritën e dyshimeve të fundit për bullizim.
- Mendoni se çfarë masash të tjera mund të nevojiten për ta mbështetur atë.

5. Një grua 22-vjeçare, e sapoardhur në burg, me një foshnjë të vogël dhe një fëmijë dy vjeç në shtëpi, nuk ka kontaktuar ende me familjen e saj apo ndonjë përfaqësues ligjor. Ajo duket si në ankth dhe personeli mendon se mund të ketë qenë viktimë e abuzimit në familje.

RREGULLAT - NMR 119 dhe 120: Qasja në këshilla ligjore për të paraburgosurit, 61; Qasja në këshilla ligjore, 58: Kontakti me familjen dhe miqtë; BKK 26 dhe 43: Kontakti me familjarët dhe përfaqësuesit ligjorë, BKK 44: Kush lejohet të vizitojë.

Parimi kryesor –Vlerësimi fillestar i situatës së një individi është vendimtar për përcaktimin e nevojave të tyre, edhe në lidhje me vizitat familjare. Të gjithë të burgosurit duhet të kenë mundësinë, kohën dhe lehtësirat e përshtatshme për t'u vizituar, për të komunikuar e për t'u konsultuar me një këshilltar ligjor sipas zgjedhjes së tyre ose një ofrues të ndihmës juridike.

Çfarë mund të bëjë personeli për të lehtësuar kontaktin?

- Flisni me gruan për të kuptuar situatën e saj familjare, vendndodhjen e fëmijëve të saj dhe çdo shqetësim që mund të ketë rreth sigurisë së vet ose të fëmijëve të saj.
- Sigurohuni që ajo të jetë e përfshirë në çdo vendim rreth kujdestarisë së fëmijëve të saj, përfshirë nëse fëmijët duhet të qëndrojnë me të në burg.
- Konsultohuni me të se kush duhet të lejohet ta vizitojë atë nisur nga shqetësimet për abuzim në familje.
- Sigurohuni që ajo të dijë se si të ketë qasje në këshilla ligjore dhe se është në gjendje ta bëjë këtë.
- Sigurohuni që ajo të mund të bëjë telefonatën e parë me një familjar të besuar sa më shpejt të jetë e mundur.

Masa të tjera për t'u marrë parasysh

- Sigurohuni që ajo të mund të vizitohet nga një profesioniste të kujdesit shëndetësor sa më shpejt të jetë e mundur.
- Informojeni për të drejtat që ka për të ndërmarrë veprime në lidhje me çdo abuzim në familje.
- Vendoseni në kontakt me grupet e brendshme mbështetëse dhe OJQ-të që mund të ofrojnë mbështetje në lidhje me abuzimin e mundshëm në familje.
- Sigurohuni që kontakti me përfaqësuesin ligjor të bëhet në konfidencialitet të plotë.

6. Në vuajtje të dënimit 25-vjeçar, një 30-vjeçar, i cili po mbahet në një institucion të sigurisë së lartë, ka kërkuar një vizitë nga familja e tij, përfshirë dy fëmijët e tij. Vëllai i tij është kapur së fundmi duke futur drogë kontrabandë në burg për të gjatë një vizite familjare.

RREGULLAT – NMR 58: Kontakti me familjen, **60:** Kontrollat e vizitorëve, **43 (3):** Disiplina dhe kontakti me familjen

Parimi kryesor – Ndalimi i kontaktit me familjen nuk duhet përfshirë ndër sanksionet disiplinore - nëse duhet kufizuar kontakti me familjen, kjo duhet të ndodhë vetëm për një kohë të limituar dhe vetëm nëse është e nevojshme për ruajtjen e rendit dhe ligjit.

Çfarë mund të bëjë personeli për të lehtësuar kontaktin?

- Kryeni një vlerësim rreziku për vizitën për të përcaktuar nëse ka ndonjë arsye pse mund të kërkohej mbikëqyrje shtesë gjatë vizitës dhe çfarë lloj vizite do të jetë e mundur.
- Sigurohuni që të ketë procedura miqësore për fëmijët dhe një mjedis miqësor ndaj fëmijëve.

Masa të tjera për t'u marrë parasysh

- Sigurohuni që çdo kufizim për vizitat familjare që lidhet me kontrabandën e drogës të zbatohet vetëm për individët konkretë në fjalë.
- Nëse duhet kryer kontroll për vizitorët e zotërisë, atëherë kjo duhet bërë me ndjeshmëri, sidomos me vizitorët fëmijë.

PËRSËRITJE – Pikat kryesore: Çfarë mund të bëjë personeli?

- Të ndihmojë të burgosurit të kuptojnë vlerën e lidhjeve me njerëzit jashtë burgut.
- Të sigurohet që të gjithë të burgosurit të mund të informojnë familjen e tyre ose personin tjetër të kontaktit për burgosjen e tyre ose çdo transferim.
- T'i lejojë të informojnë familjet e tyre për çdo sëmundje apo lëndim. Familja gjithashtu duhet të ketë mundësinë të informojë personin në burg për sëmundje të rëndë ose vdekje të një anëtar të familjes ose të një personi tjetër të rëndësishëm.
- Të mundohet të kuptojë rrethanat individuale dhe të marrë vesh nëse personat po hasin ndonjë vështirësi në vendosjen e kontakteve të jashtme.
- Të sigurohen që informacioni për vizitorët dhe vetë vizitat të ofrohen njëlloj për të gjithë.
- Të jenë vigjilentë ndaj rasteve kur të burgosurit mund të përfitojnë nga kontaktet shtesë me botën e jashtme dhe përpiquni të vini re ndryshimet e humorit ose të sjelljes pas vizitave me familjen.
- Të lehtësojë kontaktin me botën e jashtme me të gjitha mjetet e mundshme dhe të sigurohet që vizitat lejohen me rregullsi të mjaftueshme dhe kanë kohëzgjatje të arsyeshme.
- T'u kushtojë vëmendje të veçantë personave në burg, të cilët mund të hasin probleme në vendosjen dhe mbajtjen e këtij kontakti.
- Të sigurohet që të burgosurit të kenë kohën dhe lehtësitë e duhura për të komunikuar me familjet, miqtë, përfaqësuesit ligjorë dhe individët/grupet e tjera.
- Të ndihmojë për t'i bërë vizitat në burg një përvojë pozitive për të gjithë, përfshirë vizitat me fëmijë.
- Të lejojë njëfarë fleksibiliteti në rregullat e vizitës në burg duke marrë parasysh rrethanat individuale.
- Të sigurohet që çdo kufizim dhe monitorim gjatë vizitave të jetë i informuar nga vlerësimet individuale të rrezikut dhe të jetë në proporcion me çdo shqetësim rreth sigurisë.

- Të sigurohet që kontakti me një përfaqësues ligjor mund të kryhet në konfidencialitet të plotë.
- Të sigurohet që të burgosurit të kenë qasje në media (gazeta, TV, radio etj.).

4.4
1 ORË 10 MINUTA–
PËRGJATË 2 DITËVE

NMR: 83, 84 AND 85

INSPEKTIMET DHE MONITORIMI (I BRENDSHËM DHE I JASHTËM)

Inspektimet e brendshme dhe monitorimi i jashtëm

Fillojeni këtë sesion me skenarin e materialit trajnues të UNODC-së për inspektimet e jashtme (skenari i trazirave në burgje dhe shpallja e një vizite monitoruese).

OBJEKTIVAT E PËRBASHKËTA

- Të sigurojnë që burgjet menaxhohen në përputhje me ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat ekzistuese.
- Të gjejnë problemet sistematike dhe të rekomandojnë masa për të parandaluar përsëritjen.
- Të mbrojnë të drejtat e personave në burg.
- Inspektimet e brendshme dhe monitorimi i jashtëm duhet të plotësojnë njëri-tjetrin. Të dyja janë të nevojshme për menaxhimin profesional të burgut. Mandatet e tyre mund të mbivendosen.

METODOLOGJITË E PËRBASHKËTA

- Të dyja strukturat duhet të kenë qasje në të gjithë informacionin përkatës rreth burgut, duke përfshirë numrin e të burgosurve dhe mjediset e privimit të lirisë.
- Të dyja duhet të kenë mundësinë të zgjedhin lirisht se cilat burgje duan të vizitojnë dhe cilët të burgosur duan të intervistojnë.
- Të dyja duhet të jenë në gjendje të kryejnë intervista private dhe plotësisht konfidenciale.
- Të dyjave duhet t'u lejohet të bëjnë vizita të paparalajmëruara.

INSPEKTIMET E BRENDSHME

- Inspektimet kryhen nga administratat qendrore të burgjeve për të monitoruar pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret
- Mund të mbulojnë një gamë të gjerë temash, si proceset e administrimit, sigurinë, financat ose trajnimin e stafit
- Fokusohen në aspektet teknike të menaxhimit të burgjeve
- Gjetjet nuk bëhen publike zakonisht

MONITORIMI I JASHTËM

- Duhet të jetë i pavarur nga administrata e burgut
- I përshtatur për të vlerësuar respektimin e të drejtave të njeriut dhe parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit të tjerë
- Fokusohet në zbatimin e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut
- Gjetjet shpesh bëhen publike

Organet e monitorimit të jashtëm mund të jenë pjesë e Mekanizmave Parandalues Kombëtarë (MPK) të krijuara sipas Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës (OPCAT). Këtu mund të përfshihen organe kombëtare, rajonale ose ndërkombëtare (siç është Nënkomiteti i OKB-së për Parandalimin e Torturës). Fokusi i këtyre organeve është parandalimi i torturës dhe keqtrajtimeve të tjera.

Megjithatë, monitorimi kryhet edhe nga organe që nuk janë pjesë e MPK-ve, duke përfshirë edhe vendet që nuk e kanë nënshkruar OPCAT-in. Këtu mund të përfshihen inspektimet nga organet gjyqësore, Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNJ-të), institucionet e Avokatit të Popullit, komisionet parlamentare, organet e inspektimit shëndetësor dhe OJQ-të.

Ka edhe organe të tjera rajonale ose ndërkombëtare të cilat kryejnë gjithashtu monitorimin e privimit të lirisë, si Procedurat Speciale të OKB-së, Komiteti i Këshillit të Evropës për Parandalimin e Torturës (KPT) dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK).

Është e rëndësishme të theksohet se detyrimi për të lejuar monitorimin e jashtëm është i zbatueshëm pavarësisht faktit nëse një shtet e ka ratifikuar OPCAT-in apo jo.

Organet monitoruese shpesh kryejnë vizita monitoruese të specializuara, duke u fokusuar në grupe të veçanta personash në burg ose në fusha të veçanta tematike.

USHTRIM
20 MINUTA

Monitorimi i burgjeve

Ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla dhe kërkojuni të marrin rolin e vëzhguesve të pavarur të burgjeve të ngarkuar me monitorimin e aspekteve të ndryshme të jetës në burg.

Grupi A - Përqendrohuni në strehimin e të burgosurve

Grupi B - Përqendrohuni në transferimet e të burgosurve

Grupi C - Përqendrohuni tek kërkesat dhe ankesat

Grupi D - Përqendrohuni tek qasja në ushqim, ujë dhe higjienë

Grupi E - Përqendrohuni kontakti me botën e jashtme

Shtroni pyetjet e mëposhtme për pesë grupet që t'u përgjigjen:

- Cilat janë rregullat kryesore të Nelson Mandelës dhe rregullat e Bangkokut që lidhen me vëzhguesit?
- Me kë do të flisnit dhe çfarë lloj pyetjesh do t'i bënit?
- Çfarë hapash të tjera mund të ndërmerreni për të kuptuar plotësisht çështjen e caktuar?
- A ka ndonjë grup të caktuar njerëzish ku do të përqendroheshit?

Kërkojini një përfaqësuesi nga secili grup të paraqesë idetë e tyre në një tabak të vendosur në tabelë.

➔ Më poshtë gjeni disa sugjerime përgjigjesh (jo shteruese).

GRUPI A - Strehimi i të burgosurve

- Cilat janë rregullat kryesore të Nelson Mandelës dhe rregullat e Bangkokut që lidhen me vëzhguesit?

NMR 12-17, BKK 5

- Me kë do të flisnit dhe çfarë lloj pyetjesh do t'i bënit?

Flisni me personat në burg rreth hapësirës që kanë në qelinë e tyre, nivelit të mbipopullimit, cilësisë së ajrit, ndriçimit, ngrohjes, ventilimit dhe pajisjeve sanitare.

- Çfarë hapash të tjera mund ndërmerrni për të kuptuar plotësisht çështjen e caktuar?

Vizitoni qelitë në secilin seksion të burgut, kryeni matje të përmasave të qelisë dhe përcaktoni numrin mesatar të personave që mund të qëndrojnë në atë qeli.

Sigurohuni që të inspektoni tualetet dhe zonat e dushit.

Vizitoni hapësira të tjera të përdorura nga të burgosurit, si sallat e trajnimit, hapësirat e punës dhe mjediset e kujdesit shëndetësor.

Pyesni personelin e burgut nëse marrin shumë ankesa për strehimin e të burgosurve. Kushtojini vëmendje pastërtisë së çdo hapësire.

Vini re nëse të burgosurit mund të rregullojnë vetë temperaturën, ndriçimin dhe ajrosjen .

- A ka ndonjë grup të caktuar njerëzish ku do të përqendroheshit?

Personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna dhe ata që kanë fëmijë të cilët jetojnë me ta në burg, ata që kanë marrë masa disiplinore/ata që mbahen në izolim, të paraburgosurit.

GRUPI B - Transferimet e të burgosurve

- Cilat janë rregullat kryesore të Nelson Mandelës dhe rregullat e Bangkokut që lidhen me vëzhguesit?

NMR 26 (2), 68 DHE 73

- Me kë do të flisnit dhe çfarë lloj pyetjesh do t'i bënit?

Të burgosurit që janë transferuar/transportuar kohët e fundit në gjykatë, spital etj., në lidhje me përvojat e tyre të transferimit/kalimit, duke përfshirë kushtet fizike;

Personelin përgjegjës për transportimin e të burgosurve.

- Çfarë hapash të tjera mund ndërmerrni për të kuptuar plotësisht çështjen e caktuar?

Inspektoni automjetet e përdorura për transportin e të burgosurve. Vini re nëse ka kamera sigurie të instaluar në automjetet e burgut.

Kontrolloni dosjet e të burgosurve për të parë nëse transferimet janë regjistruar siç duhet.

Monitoroni transferimin e të burgosurve nëse është e mundur.

- **A ka ndonjë grup të caktuar njerëzish ku do të përqendroheshit?**

Gratë, personat LGBTI në burg, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara.

GRUPI C – Kërkesat dhe ankesat

- **Cilat janë rregullat kryesore të Nelson Mandelës dhe rregullat e Bangkokut që lidhen me vëzhguesit?**

NMR 56 DHE 57, BKK 25

- **Me kë do të flisnit dhe çfarë lloj pyetjesh do t'i bënit?**

Të burgosurit për të folur rreth përvojës së tyre me mekanizmat e ankesave; familjarët dhe vizitorë të tjerë për të zbuluar nëse ara kanë bërë ankesa në emër të të burgosurve; personelin për të përcaktuar llojet më të shpeshta të ankesave që ata marrin në mënyrë joformale.

- **Çfarë hapash të tjera mund ndërmerrni për të kuptuar plotësisht çështjen e caktuar?**

Rishikoni të dhënat e kërkesave/ankesave të marra dhe përgjigjet.

Rishikoni dosjet e të burgosurve për të parë nëse kërkesat/ankesat e tyre janë futur në dosjen e tyre.

Shikoni informacionin që u jepet të burgosurve rreth mënyrës se si të bëjnë kërkesa/ ankesa. A kanë të gjithë qasje në këtë informacion?

Si mbliidhen ankesat? Për shembull, nëse ka kuti ankesash, a kanë të gjithë qasje në këto kuti?

- **A ka ndonjë grup të caktuar njerëzish ku do të përqendroheshit?**

Personat analfabetë ose me nivel të ulët shkrim-leximi, personat me probleme të shëndetit mendor, të rinjtë në burg, shtetasit e huaj.

GRUPI D - Qasja në ushqim, ujë dhe higjienë

- **Cilat janë rregullat kryesore të Nelson Mandelës dhe rregullat e Bangkokut që lidhen me vëzhguesit?**

NMR 20 AND 21, BKK 5

- **Me kë do të flisnit dhe çfarë lloj pyetjesh do t'i bënit?**

Të burgosurit për të marrë mendimet e tyre në lidhje me ushqimin, ujin dhe higjienën; personelin ose të burgosurit e përfshirë në ofrimin e ushqimit; profesionistët e kujdesit shëndetësor për të kuptuar pikëpamjen e tyre për cilësinë dhe sigurinë e ushqimit, ujit dhe niveleve të higjienës.

- **Çfarë hapash të tjera mund ndërmerrni për të kuptuar plotësisht çështjen e caktuar?**

Vëzhgoni përgatitjen e ushqimit.

Inspektoni zonat e kuzhinës dhe mjediset e ngrënies. Provoni ushqimin që u ofrohet njerëzve në burg.

Kushtojini vëmendje niveleve të pastërtisë në të gjitha mjediset e institucionit.

• **A ka ndonjë grup të caktuar njerëzish ku do të përqendroheshit?**

Gratë, përfshirë gratë shtatzëna dhe nënat gjidhënëse, personat me probleme mjekësore, të rinjtë në burg, personat me kërkesa të veçanta sa i përket regjimit ushqimor për arsye fetare, kulturore ose etike.

GRUPI E – Kontakti me botën e jashtme

• **Cilat janë rregullat kryesore të Nelson Mandelës dhe rregullat e Bangkokut që lidhen me vëzhguesit?**

NMR 58-66 DHE 68-70, BKK 26-28

• **Me kë do të flisnit dhe çfarë lloj pyetjesh do t'i bënit?**

Të burgosurit për të kuptuar përvojat e tyre nga vizitat në burg; vizitorët, duke përfshirë anëtarët e familjes, organizatat e komunitetit dhe përfaqësuesit ligjorë; personeli përgjegjës për mbikëqyrjen e vizitave në burg.

• **Çfarë hapash të tjera mund ndërmerrni për të kuptuar plotësisht çështjen e caktuar?**

Vëzhgoni disa vizita në burg (ato që nuk janë private).

Vëzhgoni mënyrën se si ndërvepron personeli me vizitorët e burgut.

Vlerësoni mjediset e vizitave dhe zonat e tjera të komunikimit (p.sh., a janë telefonat në gjendje pune?)

Studioni informacionin që u jepet personave në burg dhe vizitorëve të tyre për vizitat në burg.

Kontrolloni nëse dosjet e të burgosurve përmbajnë të dhënat e kontaktit për familjarët/miqetë, duke përfshirë kontaktet e urgjencës.

Cilat janë rregullat për vizitat bashkëshortore/intime? A lejojnë që këto vizita të ofrohen njësoj për partnerët intimë të pamartuar apo partnerët e të njëjtit seks?

• **A ka ndonjë grup të caktuar njerëzish ku do të përqendroheshit?**

Gratë, dhe veçanërisht ato me vizitorë fëmijë, personat me nevoja për kujdesin e shëndetit mendor, shtetasit e huaj, pakicat kombëtare dhe ata që vijnë nga anë të tjera të vendit.

OPSIONALE

Monitorimi me fokus personat LGBTI në burg

Shfaqni videon e mëposhtme.

Maria Clara De Sena, Mekanizmi Parandalues Lokal i Pernambuco, Brazil (anëtare transgjimore e MPK-së): <https://vimeo.com/130965803> (4:35 minuta)

PËRSËRITJE – Pikat kryesore: Çfarë mund të bëjë personeli?


- Të ndihmojë të burgosurit të kuptojnë vlerën e lidhjeve me njerëzit jashtë burgut.
- Të sigurohet që të gjithë të burgosurit të mund të informojnë familjen e tyre ose personin tjetër të kontaktit për burgosjen e tyre ose çdo transferim.
- T'i lejojë të informojnë familjet e tyre për çdo sëmundje apo lëndim. Familja gjithashtu duhet të ketë mundësinë të informojë personin në burg për sëmundje të rëndë ose vdekje të një anëtar të familjes ose të një personi tjetër të rëndësishëm.
- Të mundohet të kuptojë rrethanat individuale dhe të marrë vesh nëse personat po hasin ndonjë vështirësi në vendosjen e kontakteve të jashtme.
- Të sigurohet që informacioni për vizitorët dhe vetë vizitat të ofrohen njëloj për të gjithë.
- Të jenë vigjilentë ndaj rasteve kur të burgosurit mund të përfitojnë nga kontaktet shitesë me botën e jashtme dhe përpikuni të vini re ndryshimet e humorit ose të sjelljes pas vizitave me familjen.
- Të lehtësojë kontaktin me botën e jashtme me të gjitha mjetet e mundshme dhe të sigurohet që vizitat lejohen me rregullsi të mjaftueshme dhe kanë kohëzgjatje të arsyeshme.
- T'u kushtojë vëmendje të veçantë personave në burg të cilët mund të hasin probleme në vendosjen dhe mbajtjen e këtij kontakti.
- Të sigurohet që të burgosurit të kenë kohën dhe lehtësitë e duhura për të komunikuar me familjet, miqtë, përfaqësuesit ligjorë dhe individët/grupet e tjera.
- Të ndihmojë për t'i bërë vizitat në burg një përvojë pozitive për të gjithë, përfshirë vizitat me fëmijë. Mënyra se si personeli sillet dhe komunikon me vizitorët është një element i rëndësishëm këtu.
- Të lejojë njëfarë fleksibiliteti në rregullat e vizitës në burg duke marrë parasysh rrethanat individuale.
- Të sigurohet që çdo kufizim dhe monitorim gjatë vizitave të jetë i informuar nga vlerësimet individuale të rrezikut dhe të jetë në proporcion me çdo shqetësim rreth sigurisë.
- Të sigurohet që kontakti me një përfaqësues ligjor mund të kryhet në konfidencialitet të plotë.
- Të sigurohet që të burgosurit të kenë qasje në media (gazeta, TV, radio etj.).

Monitorimi - Përsëritje

Çfarë mund të bëjë personeli i burgjeve për të lehtësuar punën e inspektorëve dhe vëzhguesve të burgjeve?

- Të lehtësojnë hyrjen e tyre në të gjitha mjediset e institucionit.
- T'i lejojë që të intervistojnë çdo të burgosur që ata kërkojnë të takojnë dhe të sigurohen që kjo të bëhet privatisht dhe në konfidencialitet të plotë.
- T'i lejojë të kryejnë intervista private dhe plotësisht konfidenciale me personelin e burgut.
- T'i lejojë që të kenë qasje në çdo dokument ose informacion tjetër që kërkojnë.
- T'i përgjigjen me vërtetësi çdo pyetjeje.
- T'i trajtojnë të gjithë inspektorët dhe vëzhguesit me mirësjellje dhe respekt - personeli duhet të presë që inspektorët/monitoruesit t'i trajtojnë ata gjithashtu me respekt.
- T'i ndihmojë të burgosurit të kuptojnë qëllimin dhe rëndësinë e inspektimeve/monitorimit dhe t'i inkurajojë ata të bashkëpunojnë me inspektorët/monitoruesit.
- Të lexojë raportet dhe rekomandimet e bëra dhe të punojë me drejtuesit e burgut për të zbatuar rekomandimet.

Bëni një përmbledhje të përmbajtjes së modulit. Kërkojuni pjesëmarrësve të reflektojnë për llojin e masave mbrojtëse të vendosura në institucionin e tyre dhe të mendojnë se si personeli dhe mjedisin e përgjithshëm të burgut, si dhe njerëzit në burg përfitojnë nga këto masa mbrojtëse.



MODULI 5
PARANDALIMI I INCIDENTEVE
DHE REAGIMI NDAJ TYRE

5 PARANDALIMI I INCIDENTEVE DHE REAGIMI NDAJ TYRE

MATERIALET

- Stilolaps dhe bllok shënimesh
- Përkufizimet e sigurisë dinamike (afishuar në sallë)
- Faqe 43- 56 në PowerPoint
- Listë e materialeve/ burimeve të tjera
- Printimi i përkufizimeve të sigurisë dinamike (shih faqet 63–64)
- Grafiku i zgjidhjes së konfliktit (shih faqen 123)
- Grafiku i zinxhirit të përdorimit të forcës (shih faqen 132)
- Ushtrim “Plotëso çfarë mungon” (shih faqet 125–126)
- Printime për ushtrimet në grup (shih faqet 130–132)

10 MINUTA

HYRJE

Ky modul trajton mënyrat për të ruajtur dhe garantuar sigurinë në burgje, për të trajtuar shkeljet disiplinore dhe për të menaxhuar trazirat në një mënyrë të drejtë dhe njerëzore, duke siguruar një mjedis burgu të mirëorganizuar dhe të sigurt për të gjithë “përfshirë stafin e burgut” ndërsa respekton të drejtat e njeriut të të burgosurve dhe ndihmon në rehabilitimin e tyre. Kjo përfshin qasje dinamike të sigurisë që mund të parandalojë konfliktet ose të zgjidhë probleme para se ato të përshkallëzohen, si dhe zbatimin e mekanizmave të parandalimit të konfliktit, ndërmjetësimit dhe zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve. Moduli gjithashtu trajton masat mbrojtëse të nevojshme kur autoritetet detyrohen të përdorin metoda të tjera kontrolli, si përdorimi i kufizimeve, forcës dhe armëve.

OBJEKTIVAT MËSIMORË

Pas përfundimit të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë të aftë të:

- Përshkruajnë garantimin e sigurisë brenda ambienteve të IEVP-së, në respektim të parimeve të barazisë, drejtësisë dhe trajtimit me dinjitet njerëzor;
- Tregojnë ndërlidhjen dhe garantimin e njëkohshmëm të sigurisë efektive dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut kur vendet e vuajtjes së dënimit menaxhohen mirë;
- Shpjegojnë dallimet ndërmjet sigurisë fizike, sigurisë dinamike dhe asaj procedurale, rëndësinë e tyre dhe mënyrat se si plotësojnë njëra-tjetrën;
- Diskutojnë zbatimin e qasjeve ndaj sigurisë dinamike në praktikë në garantimin e një mjedisi pozitiv në burgje;
- Përshkruajnë metodat e ndryshme të zgjidhjes së konflikteve dhe rastet e përdorimit të tyre;
- Sqarojnë se kur përdoren kontrollet trupore dhe kontrollet e qelive, si dhe të zbatojnë garancitë e nevojshme për të mbrojtur privatësinë dhe dinjitetin e personave që kontrollohen;
- Kuptojnë se kur përdoret apo ndalohet përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik, i forcës dhe i armëve;

- Identifikojnë garancitë e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të personave në burgje, në rastet e përdorimit të mjeteve të kufizimit fizik, forcës apo armëve;
- Kuptojnë përgjegjësitë institucionale dhe detyrat përkatëse për të hetuar rastet e vdekjeve, lëndimeve të rënda dhe zhdukjeve në burgje; dhe
- Kuptojnë rolin e tyre në garantimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në kuadër të parandalimit dhe reagimit në rast incidentesh.

5.1 SIGURIA FIZIKE, PROCEDURALE DHE DINAMIKE

30 MINUTA

NMR: 76 (C)

Siguria fizike dhe siguria procedurale

Siguria fizike përfshin godinën e IEVP-së (burg, paraburgim, institucion i posaçëm, etj): planimetria i objektit, arkitektura, organizimi i brendshëm dhe sistemet e sigurisë. Ky është sistemi i sigurisë statike të objektit. Elementet e sigurisë fizike projektohen me qëllimin për të parandaluar arratisjet, shkelje të tjera të sigurisë, kryengritjet nga ana e personave në burg.

Kërkoni nga pjesëmarrësit të evidentojnë elementet e sigurisë fizike në institucionin ku punojnë.

→ Përgjigjet do të varen nga niveli i sigurisë së IEVP-ve ku punojnë pjesëmarrësit. Përgjigjet e mundshme janë (por mund të ketë edhe të tjera): muret dhe perimetri i sigurisë, dyert, hekurat e dritareve, kullat e vrojtimit, bravat, kamerat e sigurisë, projektorët e dritës, sistemet e alarmit, aparaturat e kontrollit, detektorët metalikë, sistemet e komunikimit në radio dhe të tjera, prangat dhe mjetet e tjera të kufizimit fizik, armët.

Siguria procedurale përfshin sistemet dhe procedurat që plotësojnë sigurinë fizike të godinës së institucionit. Këto procedura përdoren për të vlerësuar dhe trajtuar rreziqet e sigurisë dhe parandaluar arratisjet. Siguria procedurale duhet të jetë e lidhur ngushtë me analizën e rreziqut që paraqesin personat në burg dhe evidencat e duhura, dhe të garantojë procese të drejta dhe pa dallim. Siguria procedurale duhet të nërlidhet me sigurinë fizike dhe sigurinë dinamike.

Kërkoni nga pjesëmarrësit të evidentojnë elemente të sigurisë procedurale në institucionin ku punojnë.

→ Përgjigjet e mundshme (por mund të ketë edhe të tjera) kanë të bëjnë me procedurat që rregullojnë: kontrollet (e personave në burg, vizitorëve dhe qelive), politikat, rregullat, procedurat standarde të punës, urdhërat, mbikëqyrjen me kamera, listat e kontrollit të personelit, trajtimin e ankesave, procedurat për përdorimin e forcës dhe mjeteve të kufizimit fizik, procedurat në rast të urgjencave të çdo lloji, raportimin e incidenteve dhe procedurat disiplinore për personat në burg.

Siguria dinamike

“Siguria dinamike ka të bëjë me marrëdhëniet ndërmjet personelit të burgjeve dhe personave në burg. Çdo ndërveprim ndërmjet këtyre grupimeve ka një efekt kumulativ në kulturën e përgjithshme të menaxhimit të institucionit. Çdo ndërveprim ka mundësi të përmirësojë kulturën organizative të institucionit ose të dëmtojë përpjekjet e

përbashkëta për përmirësim.”¹²

Siguria dinamike bazohet tek cilësia e mirë e sigurisë fizike dhe procedurale, si dhe tek integriteti dhe profesionalizmi i personelit të burgjeve. Një aspekt i rëndësishëm i sigurisë dinamike është mbledhja e të dhënave dhe informacionit: marrëdhëniet pozitive dhe analiza e rrethanave u mundësojnë personelit të burgjeve të mbledhin informacione mbi rreziqet e mundshme që çenojnë sigurinë që në faza të hershme.

USHTRIM **Përdorimi i qasjeve të sigurisë dinamike në zgjidhjen e konflikteve**

Ky ushtrim synon të shpjegojë arsyet e ndryshme të sjelljes dhe veprimeve të personave në burgje. Ndani pjesëmarrësit në grupe më të vogla dhe shpërdani njërin nga skenarët më poshtë në secilin grup. Për çdo skenar kërkoni nga grupet të:

- Evidentojnë se çfarë mund të ishte bërë për të parandaluar problemin;
- Evidentojnë arsyet e mundshme që kanë shkaktuar problemin;
- Vendosin se cili duhet të jetë rezultati;
- Evidentojnë se çfarë mund të bëhet për të parandaluar përsëritjen e të njëjtit problem në të ardhmen; dhe
- Çfarë mund të bëjë personeli i burgjeve për shmangien e përshkallëzimit të problemit.

Skenarët

1. Në qelinë e një 25-vjeçari të dënuar për përdorim droge me 2 vjet heqje lirie, u gjet drogë e cilësisë A. Ai pretendon se disa të burgosur e kanë detyruar atë të fshehë drogën në qelinë e tij, me kërcënimin se do të rrihej nëse nuk pranonte. Ai refuzon të tregojë emrat e personave që e kanë kërcënuar.

Në këtë ushtrim nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara. Ky ushtrim shërben për t'i nxitur pjesëmarrësit të kuptojnë që sjelljet që çojnë në konflikt mund të zgjidhen me metoda të ndryshme.

Përgjigjet përfshijnë (por nuk kufizohen vetëm tek):

- Nëse ajo që thotë është e vërtetë, a rrezikohet ky person nga të burgosurit e tjerë për shkak të gjetjes së drogës?
- A mundet që ky person të ketë varësi nga droga? A ka tregues që mbështesin këtë hipotezë?
- A po i nënshtrohet personi ndonjë trajtimi rehabilitues ndaj përdorimit të drogës?
- A ka shfaqur ky person ndonjë ndryshim të sjelljes apo të marrëdhënieve me personat e tjerë në burg?
- A ka pasur raste bullizimi në burg?
- Çfarë personaliteti ka ky person? Ka persona në burg që mund të bullizohen më lehtë.
- A ka pasur vizita së fundmi, nga anëtarët e familjes/miqetë?
- A vuan nga ndonjë problem i shëndetit mendor?
- A ekziston kultura e bandave në burg?

¹² Raport i Task Forcës për Sigurinë, Shërbimet e sistemit penitensiar të Kanadasë, pika 5.

2. Në një qeli ku qëndrojnë të akomoduar 5 persona, dy prej tyre janë përplasur fizikisht, me shumë gjasë, për pozicionin e krevatëve në qeli. Njëri prej tyre pati lëndime të rënda.

➔ Përgjigjet përfshijnë (mund të ketë edhe të tjera):

- Si janë kushtet në qeli? Sa vend ka secili person në burg për të fjetur?
- Çfarë duhet bërë për të përmirësuar kushtet materiale dhe shpërndarjen në qeli në të ardhmen?
- A ka pasur ndonjëri prej personave në burg sjellje agresive? A kanë pasur këta dy persona edhe më parë probleme me njëri-tjetrin?
- Si janë dinamikat e zakonshme midis pesë personave në qeli?
- A kanë të gjithë, të njëjtin nivel sigurie?
- A kanë ngritur ndonjë shqetësim në vlerësimin e nevojave dhe rreziqeve?
- A ka ndonjë tregues se mund të kenë përdorur drogë apo alkool?
- A ka shfaqur ndonjëri prej personave të konfliktuar, probleme të shëndetit mendor?

3. Një grua 60-vjeçare u përpoq të sulmonte gardianen në momentin e kontrollit fizik të qelisë. Që nga ky incident, gruaja refuzon të dalë nga qelia dhe të ushqehet.

➔ Përgjigjet përfshijnë (por mund të ketë edhe të tjera):

- A ka ndonjë problem me mënyrën e kontrollit fizik të qelisë nga personeli i burgjeve? Pse u vendos të kontrollohej qelia?
- A ka arsye për të menduar se gruaja fsheh sende kontrabandë në qeli?
- A ka shfaqur shenja të dëmtimit të vetes apo simptoma depresioni?
- A vuan ajo nga probleme të shëndetit mendor?
- A ka pasur ndonjë ndryshim të dukshëm të sjelljes kohët e fundit?
- A është vizituar nga anëtarët e familjes apo nga përfaqësuesi ligjor?
- A ka pasur ndonjë ndryshim në situatën personale apo ligjore që e ka shtyrë të kryejë këtë sulm?
- A ka ndërveprim pozitiv me personat e tjerë në burg? A ka ndonjë shoqe më të afërt aty?
- Si sillet zakonisht gruaja me personelin e institucionit?

4. Një konflikt ndërmjet disa të burgosurve ka ndodhur në zonën e ngrënies. Kjo ngjarje u përshkallëzua në një kryengritje të vogël. Askush prej personave të përfshirë nuk ka treguar arsyen e konfliktit.

➔ Përgjigjet përfshijnë (por mund të ketë edhe të tjera):

- Sa ishte numri i personelit të institucionit në kohën e konfliktit? Pse nuk mundi personeli të ndalonte përshkallëzimin e dhunës?
- A ishte në rrezik personeli?
- Cilat janë ankesat kryesore të ngritura nga të burgosurit kohët e fundit? Ka mundësi që ndonjëri prej tyre të ketë shërbyer për të ndezur sherrin?
- Cili është profili i personave të përfshirë në konflikt? A mund të ketë qenë përplasja midis bandave?
- Pse ngurrojnë ata të tregojnë arsyet e sherrit?
- A kanë shfaqur ndryshim të dukshëm të sjelljes që prej sherrit?

5. Një grua 22-vjeçare e ardhur rishtazi në burg, kërcënon se do të kryejë vetëvrasje.

Përgjigjet përfshijnë (por mund të ketë edhe të tjera):

- A ka pasur kontakte me të afërmit/familjen që pas mbërritjes në burg?
- A ka fëmijë?
- Si sillet përgjithësisht? A qëndron e tërhequr apo ka sjellje të çorganizuar?
- A ka qenë përdoruese e drogës ose alkoolit?
- A ka pasur probleme të shëndetit mendor?
- A i është ofruar informacioni i nevojshëm në lidhje me burgun, përfshirë format dhe kërkesat për ndihmë ose mbështetje?
- A ka pasur ndërveprime pozitive me personelin/të tjerat në burg?
- A ka pasur mundësi të marrë pjesë në ndonjë veprimtari në burg që nga mbërritja?

USHTRIM Metodat e sigurisë dinamike – Çfarë mund të bëjë personeli i burgjeve?

Kërkoni ide nga grupi në lidhje me metodat e sigurisë dinamike. Pjesëmarrësit duhet t'i shkruajnë opinionet e tyre në letër *flipchart*.

Përgjigjet përfshijnë (por nuk kufizohen vetëm tek):

- Krijimi i marrëdhënieve pozitive me personat në burg;
- Trajtimi i të tjerëve në mënyrën që do të dëshironit t'ju trajtonin juve/ fëmijën tuaj/ anëtarët e familjes tuaj, nëse do të gjendeshin brenda burgut;
- Dëgjimi me kujdes dhe i pandërprerë apo pa kundërshtuar;
- Dhënia e shembullit vetjak me anë të sjelljes dhe veprimeve pozitive me personelin tjetër të burgut;
- Qëndrimi profesional. Personeli duhet të jetë miqësor, por jo të jetë miku i personave në burg;
- Motivimi i personave në burg të marrin pjesë në aktivitete dhe të angazhohen me të tjerët;
- Trajtimi i personave në burg në mënyrë të drejtë, por me vendosmëri. Mos lejoni të manipuloheni;
- Interesimi për mirëqenien e secilit të burgosur duke komunikuar me ta/to;
- Vëzhgimi dhe vlerësimi i sjelljeve dhe rutinave ditorë të personave në burg. Kjo e bën më të lehtë identifikimin e ndryshimeve në sjellje si tregues për problemet a konfliktet. Jini të vëmendshëm ndaj këtyre ndryshimeve;
- Kontrolli i rregullt i regjimit apo i mjedisit/eve për të cilat jeni përgjegjës;
- Krijimi i kushteve që personat në burg të marrin pjesë në veprimtari kuptimplota;
- Ndjekja e kërkesave brenda afateve të përshtatshme, mbajtja e fjalës së dhënë, dhe zgjidhja e problemeve;
- Komunikimi verbal korrekt me personat në burg, përsëritja individualisht dhe përdorimi i një fjalori të përshtatshëm;
- Vëmendja tek kontakti me sy, gjestet, toni i zërit dhe gjuha trupore janë të rëndësishme; dhe
- Ndarja e informacioneve që kanë të bëjnë me sigurinë dinamike me kolegët sa herë duhet.

Ky ushtrim mund të zhvillohet edhe në formën e një aktiviteti ku veprimet ndahen në 2 kolona: “Duhet” dhe “Nuk duhet”,

Përgjigjet mund të jenë si më poshtë (por nuk kufizohen vetëm tek):

Duhet

- Të silleni me qetësi
- Të mendoni për sigurinë tuaj dhe të të tjerëve
- Të flisni qartë dhe shkurt
- Të keni besim në vetvete dhe të jeni i prerë
- Të jeni gjithmonë i vëmendshëm
- Të krijoni gjuhë trupore neutrale
- T'i shikoni personat në sy
- Të përgatiteni edhe për përballje
- Të mos harroni qëllimin e përgjithshëm
- Të dëgjoni me vëmendje palët e përfshira në konflikt dhe të tregoni kujdes për ndjenjat e tyre
- Të pranoni të bisedoni me të tjerët
- Të menaxhoni nivelin e stresit dhe emocionet/ sjelljet vetjake
- Të reagoni në mënyrë konstruktive
- Të lexoni dhe të interpretoni komunikimet verbale dhe joverbale
- Të njihni dhe respektoni dallimet ndërmjet personave

Nuk duhet

- Të përfshihen nga paniku
- Të shfaqni sjellje agresive
- Të vendosni veten në rrezik
- Të injoroni palët në konflikt
- Të kërcënoni apo të frikësoni të tjerët
- Të përdorni forcën apo mjetet kufizuese pa qenë nevoja
- Të përdorni fjalë dhe të bëni veprime fyese
- Të lejoni që paragjykimet dhe opinionet tuaja personale të ndërhyjnë në veprimet tuaja profesionale
- Të ndërlikoni situatën duke shtuar çështje të tjera
- Të shfaqni ndjenja urrejtjeje ndaj askujt
- Të shpërqendroheni
- Të manipuloheni


5.2 ZGJIDHJA E KONFLIKTIT

40 MINUTA

NMR:38

Nisni këtë seancë me skenarin e trajnimit të UNODC-së për zgjidhjen e konfliktit (rasti i konfliktit midis dy të burgosurve) (moduli për sigurinë fizike të regjimit dhe të personit) (15min)

Figura e mëposhtme jep një ide të përgjithshme mbi faktorët e ndryshëm që ndikojnë tek sjelljet, fjalët, qëndrimet dhe pamja jonë e jashtme. Figura nuk është shteruese — mund të ketë edhe shumë faktorë të tjerë të padukshëm që ndikojnë tek sjelljet tona. Grafiku mund t'u paraqitet pjesëmarrësve për t'u dhënë disa ide për realizimin e ushtrimit. Cilët do të ishin disa faktorë të tjerë që mund të shtohen në figurë? Qëllimi është që personeli i burgjeve të analizojë shkaqet e mundshme të sjelljeve të caktuara.



- Për të zgjidhur konfliktet në mënyrë të efektshme, është e rëndësishme të kuptohen dhe analizohen shkaqet.
- Personeli mëson të dallojë shenjat e hershme paralajmëruese të konfliktit.
- Konfliktet mund të trajtohen dhe të zgjidhen në mënyra të ndryshme.
- Në disa raste mund të nevojitet përdorimi i kufizimit fizik dhe forca, por vetëm si mjet i fundit.
- Në disa situata mund të përdoren edhe procedura disiplinore zyrtare por, për konflikte të vogla, personeli duhet të dijë të bëjë paralajmërime jozyrtare.
- Problemet e ndërlikuara mund të copëzohen për arritjen e zgjidhjeve të mundshme.
- Personeli i burgjeve mund të kombinojë aftësitë për zgjidhjen e problemeve, negociimin dhe ndërmjetësimin për zgjidhjen e konfliktit.
- Personeli i burgjeve duhet të dijë të qetësojë dhe jo të përshkallëzojë situatat.
- Zgjidhja e konflikteve duhet të bëhet pjesë e programit të trajnimit bazë për personelin e burgjeve.

Parimet e proporcionalitetit, domosdoshmërisë dhe mosdiskriminimit

Ky është momenti për të theksuar se, gjatë shpjegimit për mënyrat e kryerjes së kontrolleve, përdorimit të forcës, armëve dhe mjeteve të kufizimit fizik, sanksioneve dhe procedurave disiplinore apo masave izoluese, vëmendja duhet të orientohet tek disa parime themelore që mbahen në konsideratë në çdo skenar të mundshëm: parimet e proporcionalitetit, ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe mosdiskriminimit.

Proporcionaliteti

Parimi i proporcionalitetit do të thotë se masat që ndërmerren duhet të jenë proporcionale në raport me arritjen e qëllimit të ligjshëm. Proporcionaliteti shpjegohet më qartë me anë të shprehjes “mos thyej arra me vare”.

→ Çdo popull ka një shprehje të ngjashme për të shprehur të njëjtën gjë. Mirë është të gjendet shprehja e vendit. Kërkoni ndihmë tek pjesëmarrësit.

Elemente për t'u marrë parasysh kur përcaktojmë proporcionalitetin e një veprimi:

- Pse konsiderohet ky veprim? / Cili është problemi që duhet trajtuar?
- A do të çojë ai në zgjidhjen e problemit?
- Është ky veprim pjesë e një procedure të përgjithshme, apo lejon trajtimin e rasteve të ndryshme në mënyra të ndryshme?
- Ka ndonjë alternativë tjetër më pak kufizuese?
- Janë konsideruar me kujdes të drejtat dhe interesat e palëve?
- A ka masa mbrojtëse që duhen respektuar?

Ligjshmëria

Në lidhje me kontrollet, me përdorimin e forcës, armëve dhe mjeteve të kufizimit fizik, me ndëshkimet dhe procedurat disiplinore dhe me izolimin, ligjshmëri do të thotë që zbatimi i tyre të ketë referenca në legjislacion apo procedurat në fuqi si dhe t'i shërbejë një qëllimi të ligjshëm në përputhje me ligjet përkatëse. Nga ana tjetër, këto ligje dhe procedura duhet të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Domosdoshmëria

Parimi i domosdoshmërisë ka tre elemente:

Cilësor: A është i domosdoshëm veprimi, apo qëllimi i ligjshëm mund të arrihet edhe me mënyra të tjera?

Sasior: Në cilin nivel duhet të jetë veprimi (forca, armët, mjetet e kufizimit fizik, kufizimi i të drejtave, masa disiplinore, etj.) për të arritur qëllimin? Çdo mjet duhet të përdoret në nivelin më të vogël të mundshëm në të cilin fillon të jetë efektiv.

Të përkohshëm: Veprimi duhet të përfundojë me t'u arritur qëllimi ose në momentin kur ky qëllim nuk arrihet për asnjë mundësi.

Mosdiskriminimi

Autoritetet kanë detyrën të mos diskriminojnë askënd me veprimet e tyre. Legjislacioni dhe politikat e brendshme duhet të përcaktojnë qartë se veprimet duhet të zbatohen pa asnjë diskriminim bazuar në racë, etni, besim fetar, identitet gjinor, përkatësi politike, etj. Për të shmangur diskriminimin duhen rregulla dhe garanci ligjore.

5.3 KONTROLLET

1 ORË E 5 MINUTA

NMR: 50-53, 60

BKK: 19-21

Këtë sesion niseni duke prezantuar dukshëm këto 3 parime:

- *Nevoja për të respektuar sigurinë e mjedisit dhe të jetës duhet të qëndrojë në ekuilibër me parimet e barazisë, drejtësisë dhe humanizmit.*
- *Kontrollet e personave në burg dhe kontrollet e qelive duhet të kryhen me mënyra që garantojnë rendin, duke respektuar dinjitetin dhe privatësinë e personave që kontrollohen.*
- *Kontrollet duhet të zhvillohen me mënyra që respektojnë dinjitetin dhe privatësinë që përcakton qenien njerëzore dhe në përputhje me parimet e proporcionalitetit, ligjshmërisë dhe domosdoshmërisë.*

USHTRIM 15
MINUTA

Plotësoni boshllëqet me 20 fjalët më poshtë nga NMR-të dhe BKK-të (pa parë tekstin e Rregullave)

Nëse jeni keq me kohën, mund t'a ndani këtë ushtrim në mënyrë që secili pjesëmarrës të ketë një listë fjalish me 10 vende bosh (jo 20).

- Kontrollet duhet të kryhen në një mënyrë që respekton dinjitetin njerëzor dhe _____ e individit që kontrollohet, si dhe parimet e proporcionalitetit, _____ dhe domosdoshmërisë.
- Kontrollet nuk duhet të përdoren për të ngacmuar, _____ ose për të ndërhyrë në mënyrë të panevojshme në privatësinë e një të burgosuri.
- Personeli i burgut duhet të mbajë _____ e duhura për kontrollet, në veçanti kontrollet intime, kontrollet e qelive, si dhe arsyet e kontroleve, _____ e atyre që i kanë kryer dhe çdo arsye lidhur me kontrollet.
- Kontrollet intime intruzive (me ndërhyrje në zonat intime), duhet të ndërmerren vetëm nëse janë absolutisht _____.
- Personeli i burgjeve duhet të inkurajohet të zhvillojë dhe përdorë _____ ndaj kontroleve intruzive.
- Kontrollet intruzive duhet të kryhen privatisht dhe nga personeli i trajnuar i _____ si i burgosuri.
- Kontrollet e zonave intime të trupit duhet të kryhen vetëm nga profesionistë të kualifikuar të _____ të ndryshëm nga ata që janë të ngarkuar me kujdesin e të burgosurit ose, së paku, nga personel i trajnuar siç duhet nga një profesionist mjekësor për standardet e _____, shëndetit dhe sigurisë.
- Duhet të merren masa efektive për të siguruar që dinjiteti dhe respekti i grave të burgosura të _____ gjatë kontroleve fizike personale, të cilat do të kryhen vetëm nga personel _____ i trajnuar siç duhet për metodat e kontrollit dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara.

- Duhet të zhvillohen metodat alternative të kqyrjes, si p.sh., skaneri, për të _____ kontrollet pa veshje dhe kontrollet intime, në mënyrë që të shmangët ndikimi i dëmshëm _____ dhe impakti i mundshëm fizik i kontrolleve intime trupore.
- Personeli i burgut duhet të tregojë kompetencë, profesionalizëm dhe _____ si dhe duhet të ruajë respektin dhe dinjitetin kur kontrollojnë fëmijët e një nëne në burg, apo fëmijët që _____ të burgosurit.
- Pranimi i vizitorëve në institucion varet nga _____ i vizitorëve për t'u kontrolluar. Vizitori mund të tërheqë pëlqimin e tij/saj në çdo moment/rast në të cilin personeli i burgut mund të refuzojë _____.
- Procedurat e kontrollit dhe hyrjes për vizitorët nuk duhet të jenë _____ dhe duhet të udhëhiqen nga parime po aq mbrojtëse sa ato të përshkruara në Rregullat 50-52. Kontrollet intime duhet të shmangen dhe nuk duhet të zbatohen tek _____.

degraduese, ndjeshmëri, kujdes shëndetësor, i nevojshëm, fëmijë, zëvendësim, së njëjtës gjini, ligjshmëri, pëlqim, gra, evidenca, vizita, privatësi, akses, alternativa, identitet, frikësuar, psikologjik, higjienë, i mbrojtur

→ Pjesa tjetër e sesionit mund të prezantohet përmes materialit në PowerPoint ose si USHTRIM — sesion ndërveprues ku pjesëmarrësit japin përgjigjet si dhe marrin pjesë në diskutime. Zgjidhni variantin që i përgjigjet më mirë dinamikës së grupit.

Pyetje për pjesëmarrësit – Kur flasim për arsyet e kontrolleve, cilat metoda mund të zëvendësojnë kontrollet ose të përdoren së bashku me to?

→ **Përgjigjet mund të jenë:**

- Metodatat e sigurisë dinamike
- T'u jepet mundësia personave të dorëzojnë objektet kontrabandë përpara nisjes së kontrollit
- Analiza e shkaqeve të kontrabandimit të sendeve
- Programet e rehabilitimit nga drogat
- Qasja në veprimtari kuptimplote
- Vlerësim i plotë i rreziqeve dhe nevojave
- Të marrim masa që personat në burg të njihen me pasojat e kontrabandimit të sendeve/ tregtisë së paligjshme/ vjedhjes/ dhe të shkeljeve të tjera të sigurisë.

SLIDE 49

Pse është e rëndësishme të parashikohet përdorimi dhe kryerja e kontrolleve?

- Kontrollet trupore mund të shkaktojnë frikë dhe poshtërim (veçanërisht kontrollet në zonat intime)
- Përbëjnë situatë me rrezik të lartë abuzimi
- Mund të përdoren për të shqetësuar, frikësuar apo ndëshkuar persona apo grupe të caktuara
- Për të parandaluar kontrollet diskriminuese
- Për të ruajtur marrëdhënie të mira ndërmjet personelit, personave në burg dhe vizitorëve
- Për t'u siguruar se kontrollet ushtrohen njëllëj dhe pa dallim

- Kontrollët mund të jenë posaçërisht të vështira për grupe të caktuara të personave në burg (më shumë hollësi gjatë sesionit)
- Kontrollët, veçanërisht kontrollët intime, mund të jenë të vështira edhe për personelin e burgjeve
- Kontrollët e qelive përfaqësojnë ndërhyrje në hapësirën dhe privatësinë personale dhe mund të çojnë në dëmtime të sendeve personale
- Për të shmangur kontrollët e përsëritura kur nuk është nevoja

Pyetje për pjesëmarrësit – Kontrollët trupore dhe kontrollët e qelive përbëjnë disa prej veprimeve më të vështira për personelin, personat në burg dhe vizitorët, dhe konsiderohen përvojat më traumatike për të burgosurit. Përveç kujdesit që të parashikohen sa më mirë, çfarë mund të bëjë personeli për të përmirësuar kontrollët?

→ Përgjigjet mund të jenë:

- Të sigurohemi që personat të njihen paraprakisht me procedurën
- Të shpjegohet qartë qëllimi i kontrollit
- Të kujdesemi për komunikimin verbal dhe gjuhën trupore
- Të bëjmë përpjekje për të minimizuar situatat e sikletshme

SLIDE 50 Masat që duhen marrë

- Kontrollët duhet të jenë të përshtatshme për arritjen e qëllimit të kontrollit dhe metoda e përdorur duhet të arrijë qëllimin me sa më pak ndërhyrje.
- Kontrollët duhet të zhvillohen nga personel i së njëjtës gjini, të cilët duhet të jenë trajnuar në mënyrën e duhur.
- Kur personeli i burgut që kontrollon qelinë e një gruaje është mashkull, ai duhet të shoqërohet edhe nga një punonjëse femër.
- Autoritetet duhet të mbajnë evidenca të sakta të kontrolleve, ku të shënohen arsyet e kontrollit, identiteti i kontrolluesve, si dhe rezultatet e kontrollit.
- Personat e kontrolluar duhet të kenë mundësi të shprehin mendimin e tyre, apo të ankohen në lidhje me mënyrën e kontrollit.
- Kontrollët me përzgjedhje rastësore mund të përdoren për të shmangur diskriminimin.
- Mbikëqyrja e rregullt dhe e pavarur e zbatimit të procedurave të kontrollit duhet të garantojë zbatimin e drejtë dhe pa dallim të rregullave.

SLIDE 51 Kontrollët trupore dhe kontrollët intime

- Kontrollët trupore dhe kontrollët intime duhet të zhvillohen vetëm kur janë të nevojshme dhe si mjet i fundit (kur ka rrezik real që dikush të ketë sende të ndaluara). Justifikimi për kontroll duhet të jetë objektiv dhe kontrolli duhet të jetë në përpjestim me rrezikun që kanoset.
- Nëse dikush ka fshehur ndonjë send në pjesët intime, por kjo nuk përbën rrezik të menjëhershëm për personin, mund të mjaftojë që personi të mbahet nën mbikëqyrje dhe të pritët që objekti të dalë vetë në rrugë natyrore.
- Kontrollët trupore dhe kontrollët intime duhet të zhvillohen në kushte që respektojnë privatësinë, larg syve të të burgosurve apo anëtarëve të tjerë të personelit, por jo në zonë të izoluar (pasi kjo mund të rrisë rrezikun për abuzim).

- Kontrollët trupore dhe kontrollët intime duhet të zhvillohen në bazë të vlerësimeve individuale të rrezikut.
- Personave nuk duhet t'u kërkohej që të heqin të gjitha veshjet menjëherë (kontrolli me dy faza).
- Kontrollët intime duhet të zhvillohen nga personel me aftësitë e nevojshme mjekësore për t'i kryer, pa shkaktuar dëmtime.
- Pas kontrolleve intime, të burgosurit duhet të vizitohen nga personeli mjekësor, i cili duhet t'u kushtojë vëmendje pasojave të mundshme fizike dhe psikologjike.
- Personeli duhet të jetë i vëmendshëm ndaj pasojave potenciale të kontrolleve intrusive, të sidomos në shëndet mendor, vetëdëmtim dhe vetëvrasje.

Pyetje shtesë për pjesëmarrësit

Kërkoni nga grupi të diskutojë në lidhje me kategoritë e personave, grupeve të burgosurve apo vizitorëve që kërkojnë masa të veçanta mbrojtëse në lidhje me kontrollët trupore.

→ Përgjigjet e mundshme janë (dhe nuk kufizohen vetë tek):

- Gratë (përfshirë edhe gratë shtatzëna)
- Fëmijët në konflikt me ligjin
- Foshnjat dhe fëmijët të cilët qëndrojnë në burg me prindin/kujdestarin
- Personat që u përkasin besimeve/kulturave të posaçme
- Personat me probleme të shëndetit mendor
- Personat që njihen si viktimë të dhunës seksuale dhe dhunës me bazë gjinore (DhBGj).
- Personat me aftësi të kufizuara
- Personat që i përkasin grupit LGBTI
- Të moshuarit

Gratë dhe vajzat

Raporti Corston¹³ përmbledh sondazhe me gratë e burgosura të cilat kanë deklaruar se kontrolli trupor i ka bërë të ndjehen “në siklet, pa integritet, të degraduara, të pambrojtura, të nëpërkëmbura, me turp, të dhunuara dhe të pisëta.”

- Gratë në burgje janë më të rrezikuara nga abuzimi gjatë kontrolleve dhe mund t'i përjetojnë më shumë, në formë poshtëruese, veçanërisht kur janë gjatë ciklit menstrual.
- Duhet ndaluar plotësisht përfshirja e pjesëtarëve meshkuj të personelit në kontrollët intime fizike të grave dhe vajzave.
- Gratë dhe vajzat shtatzëna nuk duhet t'i nënshtrohen asnjëherë kontrolli vaginal.
- Anëtarët meshkuj të personelit nuk duhet të jenë kurrë të pranishëm në dhomë kur kontrolli bëhet nga një anëtare femër e personelit.

¹³ Raporti Corston është një studim fokusuar tek gratë e cënueshme në sistemin britanik të drejtësisë penale (2006) nga Baronesha Jean Corston.
<https://webarchive.nationalarchives.gov.uk/ukgwa/20130128112038/http://www.justice.gov.uk/publications/docs/corston-report-march-2007.pdf>

- Nëse një anëtar mashkull i personelit kontrollon qelinë e një të burgosure femër, ai duhet të shoqërohet nga një anëtare femër e personelit.
- Duhet treguar ndjeshmëri e posaçme për ato gra dhe vajza, të cilat kanë qenë më parë viktime të DhSBGj-së.
- Gratë dhe vajzat mund të jenë më të prira për probleme mendore si dhe të dëmtojnë veten si pasojë e kontrolleve trupore intime.
- Trajnimi i stafit për procedurat e kontrollit duhet të përfshijë ndërgjegjësimin për ndjeshmëritë e grave dhe vajzave gjatë kontrolleve, si dhe duhet të ofrojë udhëzime specifike me ndjeshmëri gjinore për kontrollet personale të grave dhe vajzave.
- Kurdo është e mundur duhet të përdoren metodat alternative të këqyrjes. Kontrollet e zhveshura dhe kontrollet intime duhet të përdoren vetëm si masë e fundit.

Personat LGBTI në burg

Shfaqni tri videot SPS për kontrollet e transgjitorëve (afërsisht 15:00 minuta)

➔ Kjo video shërben si hyrje dhe ndiqet edhe nga 2 video të tjera – nëse keni kohë shfaqini të tria, ose vetëm të parën.

Kontrollet duhet të respektojnë normat fetare dhe kulturore

- Udhëzimet duhet të parashikojnë aspekte fetare dhe kulturore të kontrollit ndaj personave në burg.
- Duhet hartuar rregulla për kontrollin e kapeleve/mbulesave të kokës/flokëve me përmbajtje/ domethënie fetare ose kulturore, vellove, mbulesave të fytyrës ose llojeve të ndryshme të këtyre veshjeve.
- Gjithashtu, udhëzimet duhet të parashikojnë rregulla për kontrollin e sendeve të veçanta fetare ose kulturore.
- Udhëzimet për kontrolle me qen duhet të përfshijnë konsiderata fetare dhe kulturore.
- Duhet t'i kushtohet vëmendje përdorimit të kujdesshë të gjuhës verbale dhe gjuhës së trupit nga ana kulturore dhe fetare.
- Personeli duhet të trajnohet për kryerjen e kontrolleve të përshtatshme fetare dhe kulturore.
- Kurdo që është e mundur duhen përdorur metodat alternative. Kontrollet zhveshur dhe kontrollet intime duhet të përdoren si masë e fundit.

Personat me dëmtime apo paaftësi fizike

- Procedurat e kontrollit duhet të përfshijnë udhëzime për kontrollin e personave me aftësi të kufizuara fizike.
- Personeli duhet të shfaqë ndjeshmëri të posaçme gjatë këtyre kontrolleve.
- Personeli duhet të dijë se si ta përshtatë procedurën normale të kontrollit me dëmtimin/ paaftësinë e veçantë të personit.
- Personeli mund të ketë nevojë të këshillohet me punonjësit shëndetësorë të Institucionit nëse nuk është i sigurt nëse apo si ta kryejë kontrollin.
- Personeli duhet të verifikojë nëse kontrolli po i shkakton dhimbje të burgosurit. Nëse ka të ngjarë të shkaktojë dhimbje ose lëndim të tepërt, kontrolli nuk duhet të bëhet.

- Personeli duhet të trajnohet për kryerjen e kontrolleve në respekt të ndjeshmërive fetare dhe kulturore.
- Kurdo që është e mundur, të përdoren metodat alternative. Kontrollet zhveshur dhe ato intime duhet të përdoren si masë e fundit.

USHTRIM **Rregullorja e burgjeve për kontrollet**

Kërkoni nga grupet të hartojnë një rregullore burgu për kontrollet trupore dhe kontrollet e qelive. Sigurohuni që të përfshihen udhëzime se kur, si dhe nga kush mund të kryhen kontrolle të tilla.

Ata mund të përdorin si referencë:

- **RREGULLAT 19** dhe **20** të Rregullave të Bangkokut
- **RREGULLAT 50-53; RREGULLEN 60(2)** të Rregullave të Nelson Mandelës

OPSIONAL Kërkoni nga grupet të prezantojnë punën/ rregulloren e tyre dhe angazhoni të tjerët të japin mendimet e tyre.

Kërkoni nga pjesëmarrësit të diskutojnë në grupe të vogla se çfarë do të bënin në skenarët e mëposhtëm.

Lehtësuesit duhet të qarkullojnë për të siguruar që diskutimet të jenë në rrugën e duhur.

Sugjerimet që mund të jepen nga grupi jepen me ngjyrë vjollcë poshtë secilit skenar.

Skenari 1 - I burgosuri në moshë të re refuzon t'i nënshtrohet kontrollit intim

Stafi mund të:

- Bëjë përpjekje për të kuptuar arsyen e refuzimit të kontrollit intim.
- Përcaktojë nëse ekziston rrezik real për fshehjen e sendeve kontrabandë, apo nëse ka arsye të tjera për të refuzuar kontrollin. Sjellja e të burgosurit ndihmon në përcaktim.
- Rishikojnë dosjen e të burgosurit, në veçanti shkeljet e mëparshme, vlerësimet e rrezikut dhe informacione të tjera të rëndësishme, përfshirë çdo shqetësim për shëndetin mendor, rrezikun e vetëvrasjes/vetëdëmtimit.
- Shpjegojnë qartë qëllimin e kontrollit dhe ta lejojnë të bëjë pyetje dhe të shprehë çdo shqetësim që mund të ketë.
- Shpjegojnë masën disiplinore për fshehjen e sendeve.
- Japin mundësinë që ai të pranojë se ka fshehur sende përpara fillimit të kontrollit – ai mund të dorëzojë sendin/et kontrabandë për të shmangur kontrollin.
- Japin atij kohë për t'u menduar çfarë do bëjë dhe të negociojnë me të.
- Mbajnë nën mbikëqyrje të ngushtë dhe të presin që sendi i paligjshëm të dalë natyrshëm.
- Nëse e pranon kontrollin, sitë sigurohen që ai të kryhet në privatësi të plotë nga një punonjës i kujdesit shëndetësor ose personel i trajnuar siç duhet.
- Kushtojnë vëmendje të veçantë të burgosurit pas kontrollit për ndonjë pasojë fizike ose psikologjike.

Skenari 2 - Nuk ka punonjëse femra prezent për të kryer kontrollin e një gruaje të burgosur e cila sapo është kthyer nga një vizitë mjekësore jashtë burgut.

- Shqyrtoni nëse është rasti për kontroll trupor. A është vërtet i nevojshëm bazuar në vlerësimin e rrezikut të gruas?
- Shoqërohej nga një anëtar i stafit gjatë transportit për në takimin mjekësor? Ekziston rreziku real që ajo të fshehë sende kontrabandë?
- Sillni ndërmend rezultatet e kontrollit truport të grave në Institucion. Sa shpesh janë gjetur sende të paligjshme duke përdorur këtë metodë?
- Cilat metoda të tjera kontrolli mund të përdoren? Shpjegoni gruas se nëse ajo po fsheh ndonjë send, ka mundësi ta deklarojë përpara kontrollit, duke i shpjeguar edhe pasojat disiplinore të fshehjes.
- Nëse vendoset për kontroll, atëherë mendoni sa kohë duhet, që të vijë një anëtare femër e personelit.
- Nëse brenda një afati të arsyeshëm nuk mund të vijë asnjë anëtare femër e personelit, kontrolli nuk mund të kryhet.
- Autoritetet duhet të rishikojnë përbërjen e personelit për të siguruar praninë e përhershme të punonjëseve femra.

Skenari 3 – Vizitori nuk pranon të kontrollohet

- Sigurohuni që të gjithë vizitorët të njihen me procedurat e kontrollit, sendet e ndaluara dhe ndëshkimet e kufizimet me të cilat do të përballen nëse përpiqen të kontrabandojnë sende të ndaluara.
- Flisni me vizitorin për arsyet e refuzimit të kontrollit. Kanë pasur përvoja të mëparshme negative të kontrolleve në burg?
- Analizoni nevojën e kontrollit.
- Bëni kujdes me qëndrimin ndaj vizitorit dhe gjuhën verbale dhe gjuhën e trupit. Ka më shumë gjasa që vizitorët të pranojnë të kontrollohen, nëse komunikimi me personelin e burgut është pozitiv.
- Ruani qetësinë; shpjegoni qartë arsyet e kontrollit dhe mënyrën se si do të kryhet.
- Shpjegoni se vizitorët nuk mund të detyrohen t'i nënshtrohen kontrolleve, por se autoritetet kanë të drejtë të refuzojnë hyrjen nëse nuk pranojnë të kontrollohen.
- Jepuni kohë të mendohen për vendimin që do marrin dhe krijoni mundësinë për të dorëzuar sendet e ndaluara përpara se të fillojë kontrolli. Shpjegoni se cilat do të ishin pasojat e veprimit të tyre.
- Merrni parasysh ndikimin tek personi në burg nëse vizita refuzohet.
- Merrni parasysh ndryshimin e formatit të vizitave me qëllim shmangien e kontrollit (p.sh., vizita pa kontakt në vend të vizitave me kontakt).
- Nëse rezulton se kontrolli nevojitet për të garantuar sigurinë e objektit dhe se formati i vizitës nuk mund të ndryshohet, atëherë autoritetet mund t'i refuzojnë hyrjen vizitorit.
- Nëse vizitori pranon të kontrollohet, sigurohuni që kontrolli të kryhet në një mënyrë që respekton dinjitetin dhe privatësinë e tij.
- Nëse vizita refuzohet, personeli duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë mirëqenies së të burgosurit në ditët në vijim.

Skenari 4 – Autoritetet dyshojnë se personi në burg përdor fëmijët e tij (7 dhe 9 vjeç) për të futur drogë gjatë vizitave familjare.

- Përcaktoni se sa real është rreziku, bazuar në vlerësimin e rrezikut të të burgosurit.
- Shpjegoni qartë të burgosurit se vizitat e tij me fëmijët mund të kufizohen ose refuzohen nëse zbulohet se ai i përdor ata (fëmijët e tij) për të kontrabanduar drogë në burg.
- Shqyrtoni mundësinë e modifikimit të formatit të vizitave për bërë të mundur që vizita të bëhet pa pasur nevojë për kontrollin e fëmijëve – p.sh., vizita pa kontakt, mbikqyrje vizuale e vizitave.
- Kontrolloni të burgosurin pas vizitës, në vend që të kontrolloni fëmijët para vizitës.
- Mos bëni kontroll zhveshur, apo kontroll intim. Në këto raste mjafton kontrolli me prekje, dhe më pas kontrolli i personit në burg.
- Shpjegoni qartë arsyen e kontrollit fëmijëve dhe prindit/ kujdestarit ligjor dhe sigurohuni që prindi/ kujdestari ligjor të jetë i pranishëm gjatë kontrollit.
- Jepuni mundësinë që të dorëzojnë çdo send të ndaluar para kontrollit.
- Kontrollat duhet të kryhen nga një anëtar i stafit i së njëjtës gjini me fëmijën.

Skenari 5 – Një punonjës burgu refuzon të heqë maskën gjatë kontrollit rutinë në hyrje. Është vënë re se mbajtja e maskave ka lehtësuar kontrabandën e drogës në disa burgje.

- Kërkoni të kuptoni pse refuzon të heqë maskën. Nëse bëhet fjalë për shqetësime lidhur me sigurinë ndaj COVID-19, përdorni masa të tjera mbrojtëse (stafi që kryen kontrollin vendos maskën, ruan distancën fizike etj.).
- Raportoni shqetësimet tek eprori juaj.
- Referohuni tek protokollet e shkruara për kontrollin e personelit të burgut.
- Kujtoni punonjësit rregullat e kontrollit dhe pasojat e refuzimit.

5.4

1 ORË


NMR: 47, 48, 82

BKK: 24

PËRDORIMI I FORCËS, ARMËVE DHE MJETEVE TË KUFIZIMIT FIZIK

Përdorimi i forcës

Përsëritni parimin e proporcionalitetit, të domosdoshmërisë dhe të ligjshmërisë dhe theksoni se forca, e përdorur për zgjidhjen e situatave, është e panevojshme. Spektri i forcës është një mjet i dobishëm i cili tregon se si qasja e parë lidhet me praninë dhe komunikimin e personelit të burgut, me urdhërat verbalë, me teknikat e buta përpara se të kalohet në teknikat e ashpra dhe para përdorimit të armës si mjeti i fundit.



15 MINUTA **Mjetet e kufizimit fizik**

Kërkoni nga pjesëmarrësit të gjejnë Rregullat përkatëse të Nelson Mandelës dhe Rregullat e Bangkok-ut në dosjet e tyre.

Mjetet e kufizimit fizik përkufizohen si:

“Pajisjet e jashtme mekanike që synojnë kufizimin apo moslejimin e lëvizjes së trupit të një personi, tërësisht ose pjesërisht”

Pse është e rëndësishme të parashikohet përdorimi i forcës, armëve dhe mjeteve të kufizimit në vendet e privimit të lirisë?

Mjetet e kufizimit fizik

- Përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik është i nevojshëm në disa situata, por gjithmonë duke respektuar sigurinë dhe dinjitetin e personave në fjalë.
- Përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik paraqet rrezik të lartë për poshtërim, dhimbje, torturë, keqtrajttime të tjera dhe pasoja të mundshme shëndetësore.
- Personeli i burgut ka nevojë për udhëzime se kur dhe si të përdorë mjetet e kufizimit fizik. Personat në burg, gjithashtu, duhet të kuptojnë se kur dhe në çfarë rrethanash mund të përdoren këto mjete.
- Kur mjetet e kufizimit fizik përdoren rregullisht, mund të krijohet tension dhe mosbesim midis personelit dhe personave në burg. Rregulloret për përdorimin e këtyre mjeteve mund të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi më pozitiv në burgje.
- Rregullorja e përdorimit të mjeteve të kufizimit fizik mund të mbrojë personelin nga pretendimet për abuzim.
- Rregulloret janë, gjithashtu, të rëndësishme në dritën e kaq shumë mjete të kufizimit fizik; mjete të reja krijohen gjatë gjithë kohës dhe shkenca mjekësore vazhdon të identifikojë rreziqet e mundshme të llojeve të ndryshme që vijnë nga përdorimi i këtyre mjeteve.

Forca dhe armët

- Përdorimi i forcës dhe i armëve është i nevojshëm në disa situata, por duhet të balancohet me detyrimin për të respektuar sigurinë dhe dinjitetin e personave në fjalë.
- Përdorimi i tyre paraqet rrezik të lartë dëmtimi dhe mund të rezultojë në vdekje; ato mund të shkaktojnë dhimbje dhe poshtërim.
- Armët dhe forca shoqërohen nga rreziku i torturës dhe keqtrajtimit □ ndonjëherë ato përdoren për të abuzuar ose frikësuar qëllimisht personat në burg.
- Përdorimi i tyre mund të rrezikojë edhe personelin, ndaj rregulloret janë, gjithashtu, të rëndësishme për sigurinë e punonjësve të burgjeve.
- Nëse forca dhe armët përdoren rregullisht, kjo mund të krijojë frikë dhe mosbesim midis personelit dhe personave në burg. Rregulloret për përdorimin e tyre mund të ndihmojnë për të krijuar një mjedis më pozitiv në burgje.
- Ndonjëherë përdorimi i forcës dhe i armëve mund të çojë në përshkallëzimin e një situatë edhe ashtu të tensionuar dhe të dhunshme.
- Ato paraqesin rrezik të veçantë për personat me probleme të veçanta shëndetësore dhe sëmundje të shëndetit mendor.
- Personeli i burgut ka nevojë për udhëzime se kur dhe si të përdorin forcën dhe armët.

Personat në burg, gjithashtu ,duhet të kuptojnë se kur dhe në çfarë rrethanash mund të përdoren ato.

- Rregullorja e përdorimit të forcës dhe armëve mund ta mbrojë personelin nga pretendimet për keqpërdorimin e tyre.
- Rregulloret sigurojnë mbrojtje kundër përdorimit diskriminues të forcës dhe armëve.

USHTRIM
20 MINUTA

Masat mbrojtëse

Përdorni letër format “flipchart” për të renditur masat mbrojtëse gjatë përdorimit të mjeteve të kufizimit fizik. Kërkoni nga pjesëmarrësit të angazhohen me radhë për të shkruar një rregull poshtë njërit nga titujt, bazuar në tekstin e Rregullave.

➔ Përgjigjet duhet të përfshijnë:

- Mjetet e kufizimit fizik duhet të hiqen kur i burgosuri paraqitet përpara një autoriteti gjyqësor ose administrativ
- Duhet të përdoret metoda më pak invazive e nevojshme
- Përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik duhet të bazohet në nivelin dhe natyrën e rreziqeve që paraqiten. Përdorimi i tyre duhet të jetë proporcional, i nevojshëm dhe i justifikueshëm
- Vendosen vetëm për periudhën kohore të kërkuar
- Mjetet e kufizimit fizik hiqen sa më shpejt të jetë e mundur, kur rreziqet nuk janë më të pranishme
- Personeli i burgut duhet të trajnohet në përdorimin e teknikave të kontrollit
- Individit duhet të mbikqyret kur i janë vendosur mjetet e kufizimit fizik
- Menjëherë pas vendosjes së mjeteve të kufizimit fizik, duhet të njoftohet personeli mjekësor.

Në mbyllje të këtij sesi, ritheksoni ndalimin e përdorimit të mjeteve të kufizimit fizik tek gratë shtatzëna, gjatë apo menjëherë pas lindjes, duke vënë në dukje se kjo është e rrezikshme dhe poshtëruese si për nënën ashtu edhe për fëmijën. Përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik gjatë fazave të tjera të shtatzënisë duhet të përdoren vetëm si masë e fundit.

OPSIONAL

Shfaqni videon e SHBA-ve mbi shtatzëninë/lindjen dhe mjetet e kufizimit fizik [këtu](#) (6:33 min.)

Përdorimi i forcës dhe armëve

Përsëritni parimin e ligjshmërisë, të domosdoshmërisë dhe të proporcionalitetit dhe shpjegoni:

Ashtu si për përdorimin e mjeteve të kufizimit fizik, duhet treguar kujdes i veçantë kur përdoret forca dhe armët ndaj personave/ grupeve të veçanta të personave në burg, veçanërisht grave shtatzëna dhe fëmijëve, të moshuarve dhe personave me probleme specifike shëndetësore ose lëndime dhe paaftësi fizike apo sëmundje mendore.

➔ Ky seksion fokusohet në mënyrë të posaçme te personat me probleme të shëndetit mendor dhe përdorimin e forcës/armëve. Shpjegoni këtë tek pjesëmarrësit. Shumica e çështjeve të ngritura këtu rreth shëndetit mendor vlejné edhe për përdorimin e mjeteve të kufizimit fizik.

USHTRIM

Mendoni pse është e rëndësishme të mbahen parasysht në mënyrë të veçantë çështjet e përdorimit të forcës për personat me probleme të shëndetit mendor në burg.

➔ Përgjigjet mund të përfshijnë, por nuk duhet të kufizohen në sa vijon:

- Personat me probleme të shëndetit mendor mund të kenë më pak gjasa të kuptojnë dhe të ndjekin rregullat e burgut, ose të kuptojnë pasojat e shkeljes së tyre.
- Gjendja e tyre mund t'i shtyjë të demonstrojnë sjellje shpërthyes, agresion dhe dhunë.
- Personeli mund të keqinterpretojë simptomat e sëmundjeve mendore si provokime të qëllimshme ose shkelje me dashje të rregullave.
- Personat me probleme të shëndetit mendor mund të kenë më pak gjasa t'i përgjigjen përpjekjeve për përshkallëzim të situatës përmes ndërmjetësimit dhe formave të tjera të zgjidhjes së konflikteve.
- Për këto arsye, ata kanë më shumë gjasa të bëhen objekt i përdorimit të forcës dhe procedurave të tjera disiplinore.
- Stafi mund të mos jetë i trajnuar për trajtimin e personave me probleme të shëndetit mendor, ose për të kuptuar sëmundje të caktuara dhe mund të mendojë se përdorimi i forcës është alternativa e vetme.
- Personat me probleme të shëndetit mendor mund të mos e kuptojnë arsyen e përdorimit të forcës kundër tyre dhe mund të bëjnë rezistencë ose të kundërpërgjigjen.
- Ata, gjithashtu, mund të kenë vështirësi në komunikimin e nevojave të tyre gjatë përdorimit të forcës, duke çuar në dëmtime të mundshme ose komplikime të tjera shëndetësore.
- Ka lidhje ndërmjet shëndetit mendor dhe përdorimit të drogës, të cilat mund të çojnë në situata ku personeli i burgut duhet të përdorë forcën.
- Përdorimi i forcës mund të përkeqësojë gjendjen e shëndetit mendor dhe mund të shtojë rrezikun e vetëvrasjes dhe të vetëdëmtimit.
- Mund të ketë më pak të ngjarë që personat me probleme të shëndetit mendor të ankohen për përdorimin e forcës ose armëve kundër tyre.

Shpjegoni për pjesëmarrësit se video e radhës paraqet skena grafike të përdorimit të mjeteve të kufizimit fizik dhe forcës ndaj personave me probleme të shëndetit mendor, në burg në SHBA

[HRW video on the use of force against people with mental health conditions](#) (5:35 min.)

Kur ndalohet përdorimi i forcës dhe armëve?

- Përdorimi i tyre është i ndaluar kur qëllimi i vetëm është shkaktimi i dhimbjes, torturës dhe keqtrajtimeve të tjera.
- Lloje të caktuara të armëve nuk duhet të përdoren kurrë. Këtu përfshihen armët e zjarrit armët automatike, shkopinj të me thumba, shkopinj të prej hekuri, kamxhikët me shumë elementë dhe mjetet me thumba metalike.
- Mbajtja dhe përdorimi i armëve nga personeli duhet të ndalohet në institucionet korrektuese ku mbahen të miturit. (RREGULLAT E HAVANËS, 65)

Në çfarë rrethanash mund të autorizohet përdorimi i tyre?

- Si masë e fundit
- Në përputhje me parimet e ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit
- Kur mjetet e tjera të kontrollit janë përdorur por kanë rezultuar të paefektshme
- Në rrethana të jashtëzakonshme, kur është absolutisht e nevojshme për ruajtjen e sigurisë dhe rendit, ose kur rrezikohet siguria personale (p.sh. për vetëmbrojtje ose në rastet e tentativës për arratisje)
- Përdorimi i armëve të zjarrit mund të përdoret vetëm kur është e pashmangshme për të mbrojtur jetën

Cilat janë masat mbrojtëse?

- Mos përdorni më shumë forcë nga sa është absolutisht e nevojshme - ajo duhet të bazohet në nivelin dhe natyrën e rreziqeve të paraqitura
- Përdoreni për kohën më të shkurtër të nevojshme
- Përdoreni me synimin për të pakësuar rrezikun e lëndimeve
- Përdorimi i forcës dhe i armëve duhet të ndërpritet sapo të mos ketë më rrezik të dukshëm
- Stafi duhet të trajnohet në mënyrë të plotë për përdorimin e forcës dhe armëve, duke përfshirë trajnimin fizik për stafin për t'i aftësuar në trajtimin e personave të burgosur agresivë
- Autorizimi për përdorimin e tyre duhet t'i jepet vetëm personelit të trajnuar për këtë qëllim
- Punonjësit shëndetësorë duhet të vihen në dijeni për përdorimin e forcës dhe të armëve
- Përdorimi i forcës dhe armëve duhet të rregullohet rreptësisht dhe çdo ligj e procedurë duhet të jetë në dispozicion për të gjithë personat në burg
- Përdorimi i videove survejuese (vëzhguese) ose kamerave të trupit
- Pasojat për personelin që shkel rregullat e përdorimit të mjeteve të kufizimit fizik
- Duhet bërë kujdes i veçantë gjatë përdorimit të forcës/armëve ndaj personave në burg që raportohen si të sëmurë (kronikë ose jo) ose të lënduar, të moshuarve, personave me probleme të caktuara të shëndetit fizik dhe mendor, grave shtatzëna dhe fëmijëve në burg.

Përsëritje e sesioneve mbi përdorimin e forcës, armëve dhe mjeteve të kufizimit fizik

- Çdo përdorim i forcës, armëve dhe kufizimit fizik duhet të jetë në përputhje me parimet e ligjshmërisë, domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.
- Ato duhet të përdoren si masë e fundit kur metodat e tjera kanë dështuar.
- Kurdo që është e mundur, autoritetet duhet të përdorin metodat e ndërmjetësimit dhe zgjidhje alternative të mosmarrëveshjeve në vend të përdorimit të forcës, armëve dhe mjeteve të kufizimit fizik.
- Qasjet dinamike të sigurisë mund të ndihmojnë në pakësimin e ndjeshëm të numrit të situatave në të cilat personeli duhet të përdorë forcën, armët apo kufizimet fizike, sepse personeli do të jetë më i aftë për të zbuluar rreziqet në fazën e hershme, si dhe për të përdorur mjete të tjera ndërhyrjeje.

5.5 HETIMET

10 MINUTA

NMR: 8 (F), 71

Ky sesion ka të bëjë me hetimet që lidhen veçanërisht me vdekjet, lëndimet e rënda, zhdukjet dhe dyshimet për torturë ose keqtrajtime të tjera që ndodhin në kontekstin e burgut.

Rregullat e Nelson Mandelës nuk trajtojnë detajet se si duhet të kryhen hetimet, sepse hetimet duhet të drejtohen nga autoritetet dhe organet e pavarura, jo nga drejtuesit dhe personeli i burgut.

Në vend të kësaj, Rregullat e Nelson Mandelës ofrojnë udhëzime mbi detyrimet e autoriteteve dhe personelit të burgut në rastet e vdekjes, zhdukjes ose lëndimit të rëndë ose kur ka dyshime për torturë në institucionin e tyre.

Cilat janë përgjegjësitë e autoriteteve dhe personelit të burgjeve në rast vdekjeje, lëndimi të rëndë apo zhdukjeje?

- Incidente të tilla duhet t'i raportohen menjëherë organeve të drejtësisë ose një autoriteti tjetër kompetent që është i pavarur nga personeli i burgut, i mandatuar për të kryer hetime për rrethanat dhe shkaqet e rasteve të tilla.
- Administratat dhe personeli i burgut duhet të mbledhin dhe ruajnë çdo provë, duke përfshirë pamjet e kamerave të sigurisë (ruajtja e filmimeve të tilla duhet të jetë e sigurt dhe e rregulluar siç duhet, veçanërisht sa i takon kohës së ruajtjes dhe aksesit).
- Ata, gjithashtu, duhet të sigurojnë që të mos ketë ndërhyrje në hetim.
- Gjithashtu, autoritetet kanë përgjegjësinë të mbrojnë viktimën e supozuar dhe çdo dëshmitar.
- Autoritetet duhet të bashkëpunojnë dhe të mbështesin organin hetimor, duke i dhënë akses në çdo informacion që ata kërkojnë.
- Personeli i burgut i implikuar potencialisht në torturë ose keqtrajtime të tjera duhet të pezullohet, ose, së paku, të largohet nga çdo përgjegjësi që përfshin kontakt të drejtpërdrejtë me personat në burg.
- Personat në burg (viktima ose dëshmitarë të supozuar) duhet të ndahen ose transferohen nëse është e nevojshme për mbrojtjen e tyre.
- Informacioni për lëndimet dhe vdekjen (përfshirë destinacionin e eshtrave) duhet të futet në dosjen individuale të të burgosurit.

Cilat raste duhet të raportohen dhe hetohen?

- Këtu duhet të përfshihen lëndimet e marra përpara pranimit në burg, edhe ato të marra gjatë arrestit dhe kohës së qëndrimit në mjediset policore.
- Duhet të përfshihet çdo akt torture ose trajtim apo ndëshkim tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues, përfshirë lëndimet e shkaktuara nga dhuna seksuale dhe dhuna me bazë gjinore.
- Duhet të raportohen edhe lëndimet e shkaktuara nga përdorimi i forcës dhe armëve të zjarrit.
- Duhet të raportohen të gjitha vdekjet, jo vetëm ato që konsiderohen të dyshimta, por edhe ato që mendohet se kanë ardhur për shkaqe natyrore ose vetëvrasje.
- Raportimi duhet të përfshijë edhe lëndimet serioze të shkaktuara nga tentativat për vetëvrasje ose vetëdëmtim.

- Duhet, gjithashtu, të raportohet dhe të hetohet vdekja, lëndimi i rëndë ose zhdukja e ndonjë anëtari të stafit në krye të detyrës, vizitorit ose ofruesit të shërbimit në burg.

USHTRIM **Përmbledhje e modulit 5**

Kërkoni nga pjesëmarrësit të reflektojnë mbi përvojën e tyre në parandalimin/reagimin ndaj incidenteve dhe reagimin ndryshe. Kërkoni të reflektojnë se cilat qasje afatgjata të sigurisë dinamike ose nisma të tjera të reformës së burgjeve mund të kishin ndihmuar, në radhë të parë, në parandalimin e situatës.

BURIME TË TJERA

UNODC

Manual mbi Sigurinë Dinamike dhe Inteligjencën e Burgjeve ([Handbook on Dynamic Security and Prison Intelligence](#))

Burimet e Fondacionit Kërkimor OMEGA ([OMEGA Research Foundation resources](#))

OMEGA, Ulja e rrezikut - Kufizimi i përdorimit të irrituesve kimikë gjatë Pandemisë COVID-19, veçanërisht në vendet e ndalimit ([OMEGA, Lowering the risk - Curtailing the use of chemical irritants during the COVID-19 Pandemic and specifically in places of detention](#))

Kodi i Sjelljes së OKB-së për Zyrtarët e Zbatimit të Ligjit ([UN Code of Conduct for Law Enforcement Officials](#))

Parimi themelor i OKB-së për përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit ([UN Basic Principle on the Use of Force and Firearms](#))

A black and white photograph of a person lying on a bed, looking out a window with vertical bars. The person is wearing a dark shirt and has their head resting on their hand. The window is in the background, and the bars are visible. The overall mood is contemplative and somewhat somber.

MODULI 6
KUFIZIMI FIZIK, DISIPLINA
DHE NDËSHKIMET

6 KUFIZIMI FIZIK, DISIPLINA DHE NDËSHKIMET

MATERIALE

- Stilolaps dhe bllok
- Faqe 57–61 në PowerPoint
- Lista e leximeve/ burimeve shtesë
- Fletët e skenarit (shih faqet 143–145)

10 MINUTA **HYRJE**

Ky modul analizon dhe shpjegon përdorimin e kufizimeve, masave disiplinore dhe sanksioneve në burgje, me fokus zbatimin në mënyrë të drejtë, pa dallim dhe me transparencë, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Moduli tregon se si masat tepër ndëshkuese mund të jenë të dëmshme për sigurinë e përgjithshme të një burgu dhe analizon llojin e masave mbrojtëse që duhet të zbatohen, kur nuk ka asnjë alternativë tjetër përveç kufizimeve, masave disiplinore, ose ndëshkimeve. Moduli, gjithashtu, analizon Rregullat e Nelson Mandelës që trajtojnë izolimin.

OBJEKTIVAT MËSIMORE

Në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë se si mund të ruhet disiplina dhe rendi në një institucion pa tejkalluar përdorimin e tepërt të kufizimeve për ruajtjen e sigurt të personave në burg, funksionimin e sigurisë së burgut dhe jetën e rregullt në komunitet;
- Shtjellojnë ndikimin e mundshëm të llojeve të ndryshme të kufizimeve, disiplinës dhe sanksioneve, duke përfshirë ndikimin tek grupet ose personat potencialisht të cënueshëm;
- Qartësojnë se cilat masa duhet të autorizohen me ligj ose rregullore;
- Shqyrtojnë përdorimin e teknikave alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve;
- Përcaktojnë kur është i nevojshëm përdorimi i kufizimeve, disiplinës dhe sanksioneve;
- Identifikojnë se cilat masa nuk mund të përdoren si ndëshkime disiplinore dhe kuptojnë arsyen pse;
- Diskutojnë procedurat dhe masat mbrojtëse që duhet të ekzistojnë kur përdoren sanksionet disiplinore dhe masat kufizuese;
- Shpjegojnë kufizimet dhe ndalimin e izolimit dhe masat mbrojtëse specifike që duhet të ekzistojnë kur përdoret izolimi; dhe
- Kuptojnë rolin e tyre në zbatimin e kufizimeve, masave disiplinore dhe ndëshkimore pa harruar të drejtën e ankimit kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut.

6.1 MASAT DHE PROCEDURAT DISIPLINORE

1 ORË 5 MINUTA

15 MINUTA
NMR: 36-43,
BKK: 22-23

Filloni sesionin me the UNODC online scenario mbi procedurat disiplinore (procedurat e masave kundër të burgosurve të akuzuar për sulm personal)

Përpara trajnimit është e rëndësishme të njiheni me llojet e masave disiplinore të përdorura në institucionin/ juridiksionin/ vendin e pjesëmarrësve në trajnim.

USHTRIM
10 MINUTA

Pse është e rëndësishme të rregullohet përdorimi i sanksioneve disiplinore?

Kërkoni nga pjesëmarrësit të lëvizin nëpër dhomë dhe të diskutojnë (në grupe dyshe) arsyet e ndryshme pse është e rëndësishme të rregullohet përdorimi i sanksioneve disiplinore. Kërkoni nga pjesëmarrësit të reflektojnë mbi diskutimet në sesionet e mëparshme (p.sh., rregullorja e përdorimit të kufizimeve, forcës dhe armëve) për të identifikuar arsyet pse është kaq e rëndësishme të rregullohet përdorimi i sanksioneve disiplinore.

Sanksionet disiplinore janë qartësisht të nevojshme në disa situata për të siguruar një mjedis burgu të sigurt, pa rrëmuja dhe të rregulluar mirë. Lloje/nivele të ndryshme sanksionesh janë të disponueshme në varësi të natyrës së shkeljes. Masat disiplinore duhet të jenë rreptësisht të përcaktuara, pasi ekziston mundësia që ato të keqpërdoren.

Përgjigjet në linjat e pikave të mëposhtme:

- Ekziston rreziku i torturës dhe keqtrajtimit të tjera.
- Mund të jenë të dëmshme për shëndetin fizik dhe mendor.
- Pa rregullore, ato mund të përdoren me qëllim kundër personave të caktuar.
- Menaxhimi pa mëdyshje duhet të kundërpeshohet me nevojën për të respektuar dinjitetin e personit.
- Rregullorja parandalon përdorimin e panevojshëm, arbitrar, jokonsistent ose diskriminues të sanksioneve.
- Rregullorja ndihmon për mbrojtjen e personelit nga akuzat e padrejta për keqpërdorim të sanksioneve.
- Përdorimi i shpeshtë i sanksioneve të ashpra mund të krijojë frikë dhe mosbesim midis të burgosurve dhe personelit dhe të çojë në tensionimin e situatës.
- Rregullorja është e rëndësishme për të parandaluar zhvillimin e sistemeve joformale të ndëshkimit nga personeli ose personat në burg.
- Rregullorja e sanksioneve disiplinore kërkon që masat ndëshkimore të pasqyrohen në një regjistër të posaçëm.

Cilat janë masat mbrojtëse?

- Sanksionet disiplinore duhet të përdoren në përputhje me parimet e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit.
- Mund të vendosen vetëm sanksionet që parashikohen nga ligji dhe rregullorja.
- Vendimet për sanksionet duhet të merren rast pas rasti, duke marrë parasysh vlerësimet individuale të rrezikut dhe nevojave, si dhe rrethanat e shkeljes.
- Personave në burg duhet t'u jepet informacion i plotë, i aksesueshëm për të gjithë,

për veprimet që konsiderohen shkelje disiplinore, sanksione shoqëruese, si dhe informacion i plotë për rregullat dhe procedurat që rregullojnë përdorimin e masave disiplinore.

- Personeli i burgut duhet të ketë udhëzime të plota dhe të përditësuara për përdorimin e sanksioneve disiplinore, si dhe të jetë plotësisht i trajnuar për vendosjen e këtyre masave.
- Stafi duhet të jetë i trajnuar për teknikat parandaluese dhe shpërndarëse.
- Personat në burg duhet të informohen menjëherë dhe në një format të kuptueshëm për ta për çdo akuzë ndaj tyre
- Personave në burg duhet t'u jepen koha dhe lehtësitë e duhura për të përgatitur mbrojtjen e tyre; ata duhet të kenë të drejtën t'i drejtohen gjykatës për çdo masë disiplinore. Kjo e drejtë mund të përfshijë edhe ndihmën ligjore për rastet e akuzave të rënda disiplinore.
- Të burgosurit objekt i masave disiplinore duhet të mbikëqyren, përfshirë nga personeli mjekësor.
- Të gjitha sanksionet disiplinore duhet të regjistrohen në dosjen e të burgosurit.
- Të burgosurit nuk duhet të ndëshkohen kurrë dy herë për të njëjtën shkelje.
- Përdorimi i sanksioneve disiplinore duhet të monitorohet me kujdes për të zbuluar çdo përdorim diskriminues ose të tepruar të tyre.
- Organeve monitoruese duhet t'u jepet akses i plotë në të dhënat për vendosjen e sanksioneve disiplinore.

USHTRIM

Ndani pjesëmarrësit në grupe me tre persona. Njëri merr rolin e një personi në burg, tjetri merr rolin e një roje burgu dhe i treti merr rolin e drejtorit të burgut. Secili grup merr dy karta - njëra për “personin në burg” dhe tjetra për “rojen e burgut”. Të dy kanë të njëjtën shkelje disiplinore të shkruar në kartën e tyre. “Drejtori i burgut” nuk është në dijeni të shkeljes disiplinore, prandaj “personi në burg” dhe “personeli i burgut i burgut” duhet t'u shpjegojnë çfarë ka ndodhur.

Ky ushtrim është krijuar për t'i bërë pjesëmarrësittë mendojnë rreth arsyeve të ndryshme pse personat veprojnë në një mënyrë të caktuar. Nëse grupi është veçanërisht dinamik, mund të mos ketë nevojë të jepni sugjerimet në kartë. Pjesëmarrësit mund të jenë në gjendje të mendojnë vetë për arsyet e mundshme.

Kërkoni nga “personi në burg” të mendojë se si t'i mbrojë veprimet e tij tek drejtori i burgut; ai mund të zgjedhë çdo skenar që dëshiron, i cili sipas tyre justifikon veprimin që ka kryer, por gjithashtu mund të përdorë ndonjë nga sugjerimet që shkruhen në kartë. Pjesëmarrësit duhet të reflektojnë mbi atë që kanë mësuar gjatë kursit se përse të burgosurit ndonjëherë veprojnë ashtu siç veprojnë.

“Rojet e burgut” po përpiqen të përballen me shkeljen disiplinore. Nga vlerësimi i rrezikut të të burgosurit, ata dinë se personi në burg ka një histori sjelljeje të ngjashme dhe se nuk ka asnjë justifikim të arsyeshëm për mënyrën se si ka vepruar. Ata duhet t'ia shpjegojnë këtë drejtorit të burgut, duke përdorur cilindo nga sugjerimet që shkruhen në kartë, ose të dalin me arsyet e tyre.

Palët duhet të diskutojnë situatën që duhet të trajtojnë. Nuk pritet që ata të arrijnë një zgjidhje, por vetëm të shprehin këndvështrime të ndryshme.

Në varësi të numrit të pjesëmarrësve, pavarësisht numrit të çifteve, atyre mund t'u jepet e njëjta shkelje disiplinore.

1. Përdorimi i gjuhës abuzuese ndaj një anëtari të personelit të burgut

Karta 1 (personi në burg) – Arsyet e mundshme për sjelljen (pjesëmarrësit mund të mendojnë për arsye të tjera)

- E shava punonjësin e burgut, sepse më ka bullizuar.
- Disa të burgosur më thanë ta shaja dhe kisha frikë të kundërshtoja.
- Nuk e kuptova që ajo që po thosha ishte fyese.
- Kam probleme të shëndetit mendor dhe jo gjithmonë mund ta kontrolloj atë që them.
- Isha shumë i stresuar atë ditë, sepse ata të shtëpisë nuk kanë ardhur të më takojnë kohët e fundit.

Karta 2 (roja e burgut) – Informacioni vjen nga vlerësimi i rrezikut (pjesëmarrësit mund të mendojnë për të tjera shkaqe)

- I burgosuri njihet si racist dhe anëtari i personelit në fjalë është i huaj.
- Individit në fjalë ka sulmuar fizikisht anëtarët e stafit edhe në të kaluarën.
- Që nga incidenti, individit në fjalë ka vazhduar me kërcënimet ndaj anëtarit të stafit.

2. Në qeli gjendet një celular kontrabandë

Karta 1 (personi në burg) – Arsyet e mundshme për sjelljen (pjesëmarrësit mund të mendojnë për të tjera arsye)

- Më duhej të flisja më shpesh me familjen, pasi kam nënën sëmurë.
- Nuk e dija që ishte aty. Mendoj se e ka sjellë ndonjë nga të burgosurit ose nga personeli.
- Ma dha një i burgosur tjetër që ta fshihja dhe më kërcënoi po të mos isha dakord.
- Ma shiti një punonjës i burgut, prandaj mendova se telefonat lejoheshin.
- Është thjesht një telefon. Është gjëja e parë që fus në burg. Kisha në plan t'ia shisja dikujt tjetër, sepse më duhen paratë për të shlyer borxhet ndaj të burgosurve të tjerë.

Karta 2 (anëtari i stafit) – Informacioni vjen nga vlerësimi i rrezikut (pjesëmarrësit mund të mendojnë për të tjera informacione)

- Ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se personi është i përfshirë në aktivitete kontrabande në shkallë të gjerë, pasi kohët e fundit është parë duke shkëmbyer para me njerëz të tjerë në burg.
- Personi në fjalë dihet se është i lidhur ngushtë me një bandë në burg që më parë është marrë me kontrabandë.
- Kohët e fundit, individit ka përbërë shqetësim për stafin e burgut dhe ka arsye për të menduar se mund të jetë përfshirë në një tentativë arratisjeje.

3. Goditja e një të burgosuri tjetër

Karta 1 (personi në burg) – Arsyet e mundshme për sjelljen (pjesëmarrësit mund të mendojnë për të tjera arsye)

- Kam vepruar në vetëmbrojtje.
- I burgosuri tjetër më ngacmonte prej kohësh. E sulmova sepse nuk durova dot më.
- Që kur jam burgosur, kam filluar të vuaj nga probleme të shëndetit mendor. Ndonjëherë nuk arrij ta kontrolloj zemërimin - mendoj se kam nevojë për mjek.
- Disa të burgosur më thanë ta goditja dhe kisha frikë t'u thosha jo.

Karta 2 (punonjës burgu) – Informacioni është marrë nga vlerësimi i rrezikut (pjesëmarrësit mund të mendojnë për të tjera gjëra)

- Individit ka një histori sjelljeje të dhunshme në burg.
- Prej disa kohësh ka pasur tension të qartë mes dy të burgosurve.
- Personi tjetër është me paaftësi intelektuale dhe rregullisht ka qenë subjekt bullizimi nga të tjerët.

4. Analiza e urinës zbulon përdorimin e drogës

Karta 1 (personi në burg) – Arsytet e mundshme për këtë (pjesëmarrësit mund të thonë të tjera)

- Jam i varur nga droga. Nuk di si të ndalem.
- Të gjithë marrin drogë. Është normale këtui. Unë thjesht po përpiquesha të bëja si të gjithë.
- Është e vetmja mënyrë për mua që të përballoj jetën në burg.

Karta 2 (punonjës burgu) – Informacioni është marrë nga vlerësimi i rrezikut (pjesëmarrësit mund të mendojnë për të tjera gjëra)

- Ka shenja se ky punonjës është marrë me kontrabandën e drogës në shkallë të gjerë në burg.
- Individit është kapur më parë duke tentuar t'u shesë drogë të tjerëve.

5. Vjedhja e ushqimit dhe cigareve nga shoku i qelisë

Karta 1 (personi në burg) – Arsytet e mundshme për sjelljen (pjesëmarrësit mund të japin arsye të tjera)

- Ishin të miat. Shoku i qelisë m'i kishte vjedhur më parë.
- Personeli i kuzhinës nuk më ka dhënë ushqim të mjaftueshëm. Isha shumë i uritur dhe kisha nevojë për cigare për të menaxhuar stresin.
- Shoku i qelisë m'i dha vetë ushqimin dhe cigaret. Pastaj më akuzoi se ia vodha. Nuk e kuptoj.

Karta 2 (anëtari i stafit) – Informacion nga vlerësimi i rrezikut (pjesëmarrësit mund të mendojnë për të tjerët)

- Individit në fjalë ka qenë më parë në grindje me shokët e qelisë për vjedhjen e pasurisë.
- I burgosuri tjetër ka probleme të shëndetit mendor dhe ka qenë shpesh subjekt i bullizimit.
- Bëhet tregti me mallra të vjedhura brenda objektit dhe dihet se personi në fjalë ka qenë i përfshirë në të kaluarën.

6. Mos-zbatimi i urdhrit verbal të punonjësit të burgut

Karta 1 (personi në burg) – Arsytet e mundshme për këtë sjellje (pjesëmarrësit mund të mendojnë për të tjera arsye)

- Nuk e kuptova çfarë po më thoshte roja i burgut, sepse nuk e kuptoj gjuhën.
- Anëtari i stafit po sillej keq me mua. Po më fyente, prandaj dhe unë nuk u binda.
- E kam të vështirë t'i kuptoj rregullat – nuk m'i sqaroi gjërat.

Karta 2 (punonjës burgu) – Informacioni vjen nga vlerësimi i rrezikut (pjesëmarrësit mund të mendojnë për gjëra të tjera)

- Individit në fjalë ka një histori të mosbashkëpunimit me kolegët/ punonjës të institucionit.
- Individit shfaq shpesh sjellje dhe gjuhë agresive ndaj stafit.
- Të burgosurit e tjerë janë ankuar për sjelljen e tij kohët e fundit.

7. I burgosuri kapet në një zonë të ndaluar të burgut

Karta 1 (personi në burg) – Arsytet e mundshme për këtë sjellje (pjesëmarrësit mund të thonë të tjera)

- Nuk e dija që nuk më lejohet të jem në këtë pjesë të objektit. Rregullat nuk thoshin gjë.
- Humba. Nuk e dija ku isha dhe nuk i lexoja dot tabelat në mur.
- Kërkoja dikë. Rojet më thanë se mund të vija këtu.

Karta 2 (punonjës burgu) – Informacioni është marrë nga vlerësimi i rrezikut (pjesëmarrësit mund të mendojnë për gjëra të tjera)

- Individit në fjalë ka qenë i përfshirë më parë në tentativa arratisjeje. Ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se mund të jetë duke përgatitur një tentativë tjetër.
- Në mure ka njoftime në gjuhë të ndryshme se të burgosurve u ndalohet të hyjnë aty. Individit në fjalë di të lexojë shumë mirë.
- Individit ka një histori shkeljesh.

Ndëshkimet dhe kufizimet e ndaluara

NMR: 43,
BKK: 22, 23

Përpara prezantimit, kërkon nga pjesëmarrësit të gjejnë dhe lexojnë rregullat përkatëse në Rregullat e Nelson Mandelës dhe Rregullat e Bangkok-ut, të cilat përmendin sanksionet dhe kufizimet e ndaluara.

Sanksionet dhe kufizimet e ndaluara janë:

Kufizimet dhe sanksionet disiplinore që përbëjnë torturë ose trajtim apo dënim tjetër mizor, çnjerëzor ose poshtërues; kjo mund të përfshijë një kombinim masash të cilat, nëse përdoren së bashku, ose në vazhdimësi, mund të përbëjnë torturë ose keqtrajtim:

- Izolim pa afat
- Izolim i zgjatur
- Vendosja e të burgosurit në një qeli të errët ose vazhdimisht të ndriçuar
- Ndëshkimi trupor ose pakësimi i dietës apo ujit të pijshëm
- Ndëshkimi kolektiv
- Përdorimi i mjeteve të kufizimit fizik si masë për shkeljet disiplinore
- Ndalimi i kontaktit me familjarët, veçanërisht me fëmijët (sanksioni i kufizimit të kontakteve me familjarët mund të vendoset vetëm për një periudhë të shkurtër kohore dhe vetëm nëse është i domosdoshëm për ruajtjen e sigurisë dhe rendit)
- Vendosja në një vend të mbyllur, apo izolimi disiplinor për gratë shtatzëna, gratë me foshnja dhe nënat me fëmijë në gji në burg.

6.2 VENDOSJA NË ISOLIM

45 MINUTA

NMR: 38, 44-46

Termi “mbajtja në vetmi” shpesh përdoret në mënyrë të ndërsjellë me termat “izolim” dhe ‘segregim’. Në vende të ndryshme përdoren terma të ndryshëm.

Prezantoni përkufizimin e mbajtjes në vetmi dhe izolimit dhe më pas, në një pozicion të dukshëm në sallë gjatë gjithë kësaj seance, shfaqni:

‘Izolimi’ përkufizohet si:

“Qëndrimi i të burgosurve për 22 ORË ose më shumë në ditë pa kontakt njerëzor kuptimplotë”

Izolimi i zgjatur përkufizohet si:

“Qëndrimi në izolim për më shumë se 15 ditë rresht”

Paraqisni gjithashtu përkufizimin e Essex-it për “kontaktin njerëzor kuptimplotë” që në fillim të këtij sesi:

“Kontakt njerëzor kuptimplotë”

Termi përdoret për të përshkruar sasinë dhe cilësinë e ndërveprimit social dhe stimulimit psikologjik që u nevojitet qenieve njerëzore për shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore. Një ndërveprim i tillë kërkon që kontakti njerëzor të jetë ballë për ballë dhe i drejtpërdrejtë (pa barriera fizike) dhe të mos jetë kalimtar ose i rastësishëm, duke mundësuar një komunikim empatik ndërpersonale. Kontakti nuk duhet të kufizohet në ato ndërveprime që përcaktohen nga rutinat e burgut, rrjedha e hetimeve (penale) ose nevojat mjekësore.

USHTRIM
15 MINUTA

Implikimet e mundshme fizike dhe psikologjike të izolimit

Në një kuti ku gjenden letra të palosura, përshkruhen forma të ndikimit të mundshëm fizik ose psikologjik që shkakton izolimi, siç përcaktohet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Kërkoni nga pjesëmarrësit të zgjedhin nga një letër, ta lexojnë dhe më pas ta ngjitin në tabelën e duhur në sallën e trajnimit. Tabelat përmbajnë ndikimet si më poshtë:

Fiziologjike

- probleme gastro-intestinale dhe gjenito-urinar
- djersitje
- pagjumësi
- përkeqësim i shikimit
- letargji, dobësi ose lodhje e thellë
- ndjesi të të ftohtit
- rrahjet e zemrës
- dhimbje koke nga migrena
- dhimbje të shpinës dhe kyçeve
- mungesë oreksi, humbje peshe, diarre
- dridhje trupi
- përkeqësimi i problemeve mjekësore ekzistuese.

Psikologjike

- ankthi, duke filluar nga të qenurit i tendosur deri tek krizat e panikut
- depresioni, që varion nga mungesa e humorit e deri tek depresioni klinik
- zemërimi, duke filluar nga nervozizmi deri tek shpërthimet
- probleme me të menduarit, duke filluar nga mungesa e përqendrimit deri te gjendjet konfuze
- shtrembërime të perceptimit, duke filluar nga mbindjeshmëria deri te halucinacionet
- paranoja dhe psikoza, duke filluar nga mendimet obsesionale deri te psikozat e plota
- vetëlëndimi dhe vetëvrasja

→ Kjo listë nuk është shtruese. Pyetni pjesëmarrësit nëse ka implikime të tjera. Nxitini ata të ndajnë shembuj nga përvojat e tyre.

Vini në dukje se ndikimi i izolimit mund të jetë afatgjatë. Prezantoni konceptin e 'sindromës së izolimit' që mund të përfshijë ankthin, depresionin, zemërimin, problemet me të menduarin, shtrembërimet e perceptimit, paranojën, vetëdëmtimin dhe vetëvrasjen, dhe që mund të shkatërrojë personalitetin e një personi. Thëksioni gjithashtu se, në disa rrethana, izolimi mund të arrijë deri në trajtim ose ndëshkim mizor, çnjerëzor ose poshtëruar, apo edhe torturë.

Masat mbrojtëse dhe zbutëse

Masat mbrojtëse janë të rëndësishme për shkak të efekteve të dëmshme të izolimit tek qeniet njerëzore si dhe për të garantuar mbrojtje nga abuzimi me izolimin. Masat mbrojtëse duhet të ekzistojnë pavarësisht arsyes së izolimit (p.sh., nëse përdoret si masë disiplinore, për të izoluar personat në burg gjatë vazhdimin të hetimeve penale, si mjet administrativ për të menaxhuar grupe të veçanta të burgosurish, apo si dënim gjyqësor)

- I burgosuri mund të ndahet nga popullata e përgjithshme vetëm në rastet kur lejohet me ligj. Ligjet dhe rregulloret duhet të përcaktojnë qartë ndalimet dhe kufizimet për përdorimin e izolimit.
- bazuar në vlerësimet e rrezikut dhe nevojave, duhet të merret parasysh ndikimi i mundshëm tek individit përpara se të merret vendimi për izolimin e tij.
- Duhet të përdoret në rrethana të jashtëzakonshme, si mjeti i fundit, pasi të jenë përdorur metodat e tjera dhe të kenë dështuar.
- Duhet të përdoret për një kohë sa më të shkurtër të jetë e mundur dhe t'i nënshtrohet rishikimit të pavarur.
- Punonjësit e shëndetësisë duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë shëndetit të personave që mbahen në çfarëdo forme të ndarjes së pavullnetshme, duke përfshirë vizitat ditore ndaj tyre dhe ofrimin e ndihmës dhe trajtimit të menjëhershëm mjekësor, me kërkesën e tyre ose me kërkesën e personelit të burgut.
- Kur personat vendosen në izolim, autoritetet duhet të marrin masa për të lehtësuar efektet e mundshme të dëmshme.
- Izolimi nuk duhet të jetë kurrë pjesë e dënimit që jepet për të burgosurin.
- Personat në burg duhet të kenë të drejtën të kërkojnë rishikimin e pavarur të vendimit për t'i vendosur në izolim.

- Personat në burg duhet të kenë të drejtën të mbrohen kundër vendimit të izolimit duke përdorur ndihmën ligjore.
- Organet monitoruese duhet të kenë akses të plotë në ambientet e izolimit dhe personat që mbahen në to. Ata gjithashtu duhet të kenë akses në dokumentacionin përkatës për izolimin.
- Përdorimi i izolimit duhet të dokumentohet në dosjen e të burgosurit.

USHTRIM **Si të ‘zbutim ndikimin e dëmshëm të izolimit’**

RREGULLA 38 (2) e RREGULLAVE të NELSON MANDELËS thotë: “Për të burgosurit që janë ose kanë qenë të ndarë, personeli i burgut duhet të marrë masat e nevojshme për të zbutur efektet e dëmshme të mundshme të izolimit tek ta dhe në komunitetin e tyre pas lirimit të tyre nga burgu.”

Kërkoni nga grupi të shprehë mendimet, duke u ngritur në këmbë dhe në grupe dyshe, se si bëhet kjo, përfshirë identifikimin e grupeve ose personave që mund të ndikohen më negativisht nga izolimi (p.sh., ata me probleme të shëndetit mendor, të moshuarit, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuara, personat LGBTI)

Idetë mund të përfshijnë, por nuk duhet të kufizohen tek:

- Sigurimi i kontakteve sociale
- Krijimi i mundësive që personat të marrin pjesë në aspekte të tjera të jetës në burg (p.sh., puna, arsimimi)
- Rritja e kontaktit me botën e jashtme
- Sigurimi i aktiviteteve që mund t'i bëjnë vetë (p.sh., arte dhe punime artistike, materiale leximi, muzikë, lojëra në formën e enigmave për zgjidhje)
- Krijimi i mundësive për aktivitete fizike
- Biseda të stafit me personat dhe vizita të rregullta nëpër dhoma

Nëse koha lejon, përfundoni këtë sesion me videon e National Geographic “Histori të jetës në izolim” (nga SHBA) (5:26 MINUTA)

Dhe videoja e Rick Rameish (Kolorado) (2:15 MINUTA)

Në fund të këtij moduli, kërkoni nga pjesëmarrësit të reflektojnë mbi ndikimin e masave disiplinore dhe izolimit tek personat në burg, dhe se si këto masa mund të ndikojnë edhe në marrëdhëniet midis të burgosurve dhe personelit të burgut.

BURIME TË TJERA

The Istanbul Statement on the use and effects of solitary confinement (the Istanbul Statement)



MODULI 7

KUJDESI SHËNDETËSOR

7 KUJDESI SHËNDETËSOR

MATERIALET

- Stilolasp dhe bllok
- Faqet 62–64 në PowerPoint
- Listë e leximeve/burimeve shtesë
- Listë e parimeve themelore (shih faqet 151–153)

10 MINUTA

HYRJE

Ky modul mbulon parimet themelore të ofrimit të kujdesit shëndetësor në burg, përfshirë mënyrën e organizimit të këtij shërbimi. Seksioni përmbledh detyrat dhe përgjegjësitë specifike të personelit të kujdesit shëndetësor, por fokusi kryesor është në rolin e personelit jomjekësor të burgjeve në ofrimin e kujdesit shëndetësor, përfshirë grupet e personave në burg që mund të kenë nevoja për kujdes shëndetësor të veçantë. Moduli trajton me përparësi veprimet që mund të ndërmarrë personeli i burgut për të mbrojtur mirëqenien mendore të personave në burg, si dhe rolin e tyre në dokumentimin dhe raportimin e shenjave të torturës. Gjithashtu, moduli i kushton kujdes ndikimit që mund të ketë puna me të burgosurit tek shëndeti i personelit të burgut dhe çfarë mund të bëhet për të mbrojtur shëndetin dhe mirëqenien e këtyre të fundit.

OBJEKTIVAT MËSIMORE

Në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë parimet themelore të kujdesit shëndetësor në burg;
- Përshkruajnë se si personeli jomjekësor i burgut mund të ndihmojë për të siguruar respektimin e këtyre parimeve;
- Dallojnë qartazi rolin e personelit të kujdesit shëndetësor dhe rolin e personelit jomjekësor të burgjeve në ofrimin e kujdesit shëndetësor;
- Shtjellojë se si personeli jomjekësor i burgjeve lidhet me profesionistët e kujdesit shëndetësor gjatë punës së tyre;
- Diskutojnë rëndësinë e ofrimit të kujdesit shëndetësor të pavarur dhe cilësor në burgje dhe kuptojnë si mund të arrihet kjo;
- Përshkruajnë se si personeli i burgut mund të ndihmojë në mënyrë më efektive personat me nevoja për kujdes shëndetësor të veçantë, përfshirë ata me probleme të shëndetit mendor;
- Kenë të qartë rolin e personelit të burgut në dokumentimin dhe raportimin e shenjave të torturës; dhe
- Shpjegojnë ndikimin e punës në burg në shëndetin fizik dhe mendor të personelit të burgut dhe çfarë mund të bëhet për t'i mbështetur ata.

7.1

1 ORË

KUJDESI SHËNDETËSOR

USHTRIM

20 MINUTA

NMR: 24–35

Parimet themelore të ofrimit të kujdesit shëndetësor në burgje.

Sigurohuni që parimet e mëposhtme (me shkronja të zeza) të shkruhen në tabakë letrash të ngjitura në mur. Kërkoni nga pjesëmarrësit të gjejnë pjesën/ët e dispozitave

të Rregullave të Nelson Mandelës që lidhen me fushën e caktuar. Ata duhet t'i referohen kopjes së Rregullave që u është dhënë me paketën e materialeve, të shënojnë numrin e Rregullës në një letër ngjitëse dhe ta ngjisin në krahë. Vini në dukje se mund të ketë më shumë se një Rregullë për secilin rast.

- **Përgjegjësia për kujdesin shëndetësor në burgje**
- **Vazhdimësia e kujdesit**
- **Konfidencialiteti / Fshtësia**
- **Pavarësia**
- **Ekuivalenca e kujdesit**
- **Pëlqimi i informuar**
- **Mosdiskriminimi**

Në fund të sesionit, kërkoni vullnetarë për të lexuar pjesën përkatëse të Rregullës/ve. Më pas ofroni kontekst shtesë për secilën pikë (të detajuar në kutinë më poshtë).

→ Nëse koha lejon, pyetini pjesëmarrësit pse u pëlqen ky Rregull, pse u tërheq vëmendjen, ose cili është kuptimi i tij në praktikë?

Përgjegjësia për kujdesin shëndetësor në burgje

(RREGULLA 24) – “Ofrimi i kujdesit shëndetësor për të burgosurit është përgjegjësi e shtetit”.

Kur një shtet i heq lirinë një personi, ai merr përsipër përgjegjësinë për t'u kujdesur për shëndetin e tij, përfshirë kushtet e ndalimit, parandalimin dhe trajtimin e çdo sëmundjeje. Ata kanë “detyrë të kujdesen” për të burgosurit. Shumica e të burgosurve nuk kanë alternativë tjetër veçse të mbështeten tek autoritetet e burgut për të mbrojtur dhe trajtuar shëndetin e tyre.

Vazhdimësia e kujdesit

(RREGULLA 24 (2)) – “Shërbimet e kujdesit shëndetësor organizohen në marrëdhënie të ngushtë me administratën e përgjithshme të sistemit të shëndetit publik dhe në një mënyrë që garanton vazhdimësinë e trajtimit dhe kujdesit.”

Kjo është e rëndësishme në momentin e pranimit në burg, transferimit në një institucion tjetër dhe, po ashtu, në kohën e lirit. Këtu përfshihet kërkesa për të menaxhuar dhe transferuar siç duhet dosjen/t mjekësore të të burgosurit.

Fshtësia

(RREGULLA 26 (1)) – “Shërbimi i kujdesit shëndetësor duhet të përgatisë dhe të mbajë dosje individuale mjekësore të sakta, të përditësuara dhe konfidenciale për të gjithë të burgosurit.”

(RREGULLA 31) – “Të gjitha ekzaminimet mjekësore duhet të kryhen në fshtësi të plotë”.

(RREGULLA 32 (C)) – [standardet etike dhe profesionale] “Fshtësia e informacionit mjekësor, përveç rasteve kur ruajtja e një konfidencialiteti të tillë do të rezultonte në një kërcënim real ose të menjëhershëm për pacientin ose të tjerët.”

RREGULLA 26 [2] – “Dosjet mjekësore dërgohen tek shërbimi shëndetësor i institucionit pritës ku transferohet i burgosuri dhe i nënshtrohen konfidencialitetit mjekësor”.

Personat në burg duhet të kenë mundësi të aksesojnë shërbimet e kujdesit shëndetësor në siguri dhe konfidencialitet të plotë, ashtu siç ndodh për të gjithë në komunitet. Kjo do të thotë, gjithashtu, se të burgosurit nuk duhet të kalojnë nga personeli i burgut për t'u lidhur me mjekun dhe as të tregojnë arsye pse kërkojnë kujdes mjekësor. Personeli i burgut nuk duhet të jetë i pranishëm gjatë vizitave mjekësore, përveç rasteve kur kjo kërkohet për arsye sigurie; (në këto rrethana të jashtëzakonshme), ata duhet të qëndrojnë në largësi ku nuk dëgjohet.

Rregulla kërkon që vizitat tek mjeku të zhvillohen në privatësi dhe konfidencialitet të plotë dhe që dosjet mjekësore të mbahen në konfidencialitet të plotë dhe veçmas dosjes së vuajtjes së dënimit. Vetëm punonjësit e kujdesit shëndetësor dhe pacienti duhet të kenë mundësi të shohin dosjen.

Pavarësia

RREGULLA 25 (2) – “Shërbimi i kujdesit shëndetësor përbëhet nga një ekip ndërdisiplinor me personel të mjaftueshëm të kualifikuar që vepron në pavarësi të plotë klinike”.

Punonjësit e kujdesit shëndetësor duhet të kenë mundësi të veprojnë në pavarësi të plotë klinike. Ata kanë të njëjtin nivel pavarësie si personeli i kujdesit shëndetësor që punon në komunitet. Detyra e tyre e parë është shëndeti i pacientëve. Vendimet klinike duhet të merren vetëm për arsye mjekësore dhe personeli i burgut nuk duhet të ketë mundësi të ndërhyjë ose të injorojë vendimet e personelit mjekësor. Personeli shëndetësor nuk duhet të përfshihet në marrjen e masave disiplinore.

Ekuivalenca e kujdesit

(RREGULLA 24 (1)) – “Të burgosurit duhet të gëzojnë të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor që zbatohen edhe në komunitet.”

Kujdesi shëndetësor që ofrohet në burg duhet të jetë të paktën i të njëjtit standard me atë që ofrohet për komunitetin. Kjo do të thotë që personeli mjekësor i burgjeve duhet të jetë i kualifikuar në të njëjtin nivel si personeli mjekësor që shërben në komunitet.

Pëlqimi i informuar

(RREGULLA 32 (B)) – [standartet etike dhe profesionale] “Respektimi i autonomisë së të burgosurve në lidhje me shëndetin e tyre dhe pëlqimi i informuar në marrëdhëniet mjek-pacient”.

RREGULLA 32 (2) – “Të burgosurit mund të lejohen, me pëlqimin e tyre të lirë dhe të informuar dhe në përputhje me ligjin në fuqi, të marrin pjesë në provat klinike dhe kërkime të tjera në fushën e shëndetit ”

Parimi i pëlqimit të lirë dhe të informuar lidhur me trajtimin dhe mjekimin duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë edhe në rastin e personave të privuar nga liria.

Mosdiskriminimi

(RREGULLA 24 (1)) - Të burgosurit “duhet të përfitojnë shërbimet e nevojshme të kujdesit shëndetësor pa pagesë dhe pa diskriminim, bazuar në statusin e tyre ligjor”.

(RREGULLA 2) është i zbatueshëm edhe për kujdesin shëndetësor - “Nuk do të ketë diskriminim në bazë të racës, ngjyrës, seksit, gjuhës, fesë, opinionit politik ose të ndonjë lloji tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, pronës, prejardhjes në lindje ose ndonjë statusi tjetër.”

Kjo nuk do të thotë që të gjithë personat në burg duhet të kenë të njëjtin trajtim. Do të thotë se ata duhet të marrin kujdesin e duhur bazuar në nevojat e tyre. Kujdesi shëndetësor për ta do të jetë falas.

Kur një shtet i heq lirinë një personi, ai merr përsipër përgjegjësinë për t'u kujdesur për shëndetin e tij, përfshirë në lidhje me kushtet e ndalimit dhe parandalimin dhe trajtimin e çdo problemi shëndetësor. Ata kanë një ‘detyrën të kujdesen’ për të burgosurit. Shumica e të burgosurve nuk kanë alternativë tjetër veçse të mbështeten tek autoritetet e burgut për të mbrojtur dhe trajtuar shëndetin e tyre.

Pse është kaq i rëndësishëm kujdesi shëndetësor në burg?

- Personat që hyjnë në burg zakonisht kanë një profil më të dobët shëndetësor në krahasim me komunitetin e përgjithshëm, përfshirë një prevalencë më të lartë të sëmundjeve serioze dhe problemeve të shëndetit mendor (përfshirë tendencat për vetëvrasje/vetëdëmtime).
- Shumë prej tyre kanë probleme shëndetësore të mëparshme ose të patrajtuara.
- Personat në burg shpesh janë me prejardhje të varfër dhe të marginalizuar – për shkak të kësaj, ata mund të kenë qenë më të ekspozuar ndaj sëmundjeve të transmetueshme dhe kequshqyerjes.
- Shumë persona në burg paraqesin histori sjelljeje me rrezik të lartë (përdorim droge, tatuazhe, seks i pambrojtur) dhe abuzime/varësi nga substancat.
- Shumë persona në burg kanë një histori abuzimi, përfshirë dhunën seksuale dhe dhunën në familje, veçanërisht në radhët e grave të burgosura.
- Burgimi ka të ngjarë të përkeqësojë problemet para-ekzistuese të shëndetit fizik ose mendor.
- Mjedisi i burgut, përfshirë mbipopullimin, është veçanërisht i favorshëm për përhapjen e sëmundjeve infektive – diagnostikimi i hershëm e zvogëlon këtë rrezik.
- Prekja e personave të privuar nga liria nga një sëmundje e rëndë për shkak të mungesës së masave mbrojtëse ose kujdesit të duhur mund të çojë në keqtrajtim apo edhe torturë.
- Mbajtja në burg mund të shkaktojë probleme shëndetësore edhe te personat e shëndetshëm. Kjo mund të ndodhë për shumë arsye, përfshirë mungesën e ushqimit të mjaftueshëm dhe me vlera ushqyese, ujin e pijshëm të pasigurt, kushtet e këqija sanitare, mungesën e dritës së diellit, ajrit të pastër, ngrohjes ose ajrosjes apo mundësive të pamjaftueshme për ushtrime fizike.
- Problemet shëndetësore që lihen të patrajtuara ose që nuk trajtohen në mënyrën e duhur pengojnë shanset e individit për rehabilitim të suksesshëm. Anasjelltas, ofrimi i kujdesit të mirë shëndetësor ndihmon në rehabilitimin dhe riintegrimin e personit.

- Punonjësit e kujdesit shëndetësor luajnë një rol kyç në zbulimin e shenjave të torturës ose keqtrajtimeve të tjera në burgje.
- Punonjësit e kujdesit shëndetësor luajnë, gjithashtu, një rol kyç në identifikimin e shenjave të hershme dhe tendencave për vetëvrasje/vetëdëmtim.
- Nëse nuk trajtohet, shëndeti i personave në burg do të ndikojë në shëndetin e komunitetit kur ata të lirohen.
- Sigurimi i një kujdesi efektiv shëndetësor në burgje, në analizë të fundit, kursen para dhe burime njerëzore.

Roli i punonjësit shëndetësor

- Të ofrojë ekzaminime mjekësore sa më shpejt të jetë e mundur pas pranimit në burg;
- Të identifikojë çdo shqetësim shëndetësor, duke përfshirë shqetësimet e shëndetit mendor dhe rrezikun e vetëvrasjes/vetëdëmtimit dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për trajtim, përfshirë sigurimin e mjekimeve të mjaftueshme dhe të përshtatshme;
- Të kontribuojë në vlerësimin e rrezikut dhe nevojave të personit në burg, përfshirë varësinë nga droga dhe alkooli;
- Të identifikojë çdo nevojë për kujdes shëndetësor të veçantë gjatë qëndrimit në burg, duke përfshirë çështjet e aksesit që lidhen me paaftësitë fizike, mendore, intelektuale ose shqisore;
- Të përcaktojë aftësinë e të burgosurve për të punuar, për t'u ushtruar dhe për të marrë pjesë në aktivitete të tjera;
- Të identifikojë dhe raportojë çdo akt torture dhe keqtrajtimi të çdo lloji që mund të ketë ndodhur përpara pranimit në burg ose gjatë qëndrimit të një personi në burg;
- Të ofrojë shërbime të vazhdueshme të kujdesit shëndetësor për të gjithë të burgosurit, gjatë gjithë kohës së qëndrimit në burg;
- Të mbajë lidhje të përditshme me të gjithë të burgosurit e sëmurë, të gjithë ata që ankohen për probleme të shëndetit fizik ose mendor, apo për dëmtime, si dhe me çdo të burgosur që ka nevojë për vëmendjen e tyre të posaçme;
- T'i kushtojë vëmendje të veçantë shëndetit të çdo të burgosuri të vendosur në izolim, apo atyre që kanë qenë objekt i përdorimit të forcës, armëve apo kufizimeve fizike, dhe t'i raportojë drejtorit të burgut për çdo efekt negativ të ndëshkimeve disiplinore ose masave të tjera kufizuese;
- Të rekomandojë ndryshime në kushtet në të cilat mbahen të burgosurit, duke përfshirë izolimin, nëse vërejnë ndonjë ndikim negativ në shëndetin e të burgosurve;
- Të mbajë dosje të sakta, të përditësuara dhe konfidenciale mjekësore për të gjithë personat në burg;
- T'i referojë personat tek specialisti apo tek shërbimi i urgjencës, sa herë është nevoja; dhe
- Të inspektojë dhe këshillojë drejtorin e burgut për sasinë dhe cilësinë, përgatitjen dhe servirjen e ushqimit; higjienën dhe pastërtinë e institucionit dhe të të burgosurve; shëndetin, temperaturën, ndriçimin dhe ajrosjen e burgut; përshtatshmërinë dhe pastërtinë e veshjeve dhe shtretërve të të burgosurve, si dhe respektimin e rregullave në lidhje me edukimin fizik dhe sportin.

Mbështetja e punës së punonjësve të shëndetësisë

Ndonëse personeli i burgut nuk është drejtpërdrejt përgjegjës për ofrimin e kujdesit shëndetësor (shih përgjegjësitë e personelit të kujdesit shëndetësor më lart), ka shumë gjëra që ata mund të bëjnë për të mbështetur punën e stafit mjekësor.

Për t'i ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë rolin e tyre në drejtim të kujdesit shëndetësor, kërkon nga secili pjesëmarrës të lexojë thëniet e mëposhtme dhe të shënojë ato që mendojnë se vlejnë për punën personale. Pasi të gjithë pjesëmarrësit të kenë plotësuar fletën, vini në dukje thëniet që nuk vlejnë për punën e tyre dhe shpjegoni pse.

1. Informoni menjëherë personelin e kujdesit shëndetësor në rast urgjence mjekësore.
2. Raportoni tek personeli i kujdesit shëndetësor nëse keni shqetësime specifike për shëndetin fizike ose mendore të një personi.
3. Shikoni dosjen mjekësore të një të burgosuri nëse jeni të shqetësuar se ai mund të kryejë vetëvrasje.
4. Mbështetni vendimet e marra nga personeli shëndetësor për çështje që kanë lidhje me shëndetin.
5. Pyetni një punonjës shëndetësor nëse vendosja në izolim mund t'i shkaktojë probleme shëndeti të burgosurit.
6. Lehtësoni qasjen e personelit mjekësor tek të gjithë të burgosurit e sëmurë.
7. Kërkojini personelit shëndetësor të vizitojë një të burgosur me masën e kufizimit fizik për të parandaluar arratisjen.
8. Mos ndërhyrni në një situatë emergjente shëndetësore. Lajmëroni personelin e kujdesit shëndetësor dhe prisni që ata të vijnë.
9. Flisni me personelin shëndetësor nëse keni shqetësime lidhur me cilësinë dhe sigurinë e ushqimit të burgut.
10. Ofroni informacion lidhur me aftësinë e një të burgosuri për punë.
11. Izoloni menjëherë një të burgosur që gjendet në një qeli të përbashkët nëse dyshoni se ka një sëmundje ngjitëse.

➔ **Thëniet e mëposhtme nuk zbatohen në rastin e personelit të burgjeve:**

1. Personeli i burgut nuk duhet të ketë akses në dosjet mjekësore të të burgosurve. Vetëm personeli i kujdesit shëndetësor dhe individit në fjalë duhet të kenë akses në dosje. Drejtuesit e burgut duhet t'i konsiderojë dosjet mjekësore si "të dhëna personale të ndjeshme" dhe të sigurojnë që ato ruhen në mënyrë të sigurt.
5. Stafi shëndetësor nuk duhet të luajë asnjë rol në vendosjen e masave disiplinore apo masave të tjera kufizuese.
1. Stafi duhet të trajnohet në dhënien e ndihmës së parë kur personeli shëndetësor nuk gjendet në punë, përfshirë situatat emergjente shëndetësore kur është e nevojshme.
12. Vendimet për izolimin klinik të personave duhet të jenë përgjegjësi e personelit të kujdesit shëndetësor.

Nevojat për kujdes shëndetësor të grupeve të veçanta

Mbani parasysh se personeli i burgut, si dhe punonjësit mjekësorë, duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë situatës së shëndetit fizik dhe mendor të të burgosurve me nevoja për kujdes shëndetësor të veçantë. Këto grupe mund të përfshijnë:

- Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në gji
- Fëmijët, në burg me prindin/kujdestarin e tyre
- Fëmijët në konflikt me ligjin
- Të moshuarit në burg
- Personat me probleme të veçanta fizike
- Personat me probleme të shëndetit mendor
- Personat me aftësi të kufizuara intelektuale
- Të burgosurit me paaftësi të ndryshme
- Të sëmurët me sëmundje të pashërueshme në burg
- Shtetasit e huaj

USHTRIM
10 MINUTA

NMR: 28,29
BKK: 5–18,
38, 39, 48

Shërbimet shëndetësore të posaçme bazuar në gjini dhe moshe (fëmijët).

Kërkoni nga pjesëmarrësit të gjejnë rregullat që lidhen me kujdesin shëndetësor të grave, fëmijëve dhe vajzave në burg në Rregullat e Nelson Mandelës dhe në Rregullat e BKK-së. Kërkoni ta përmbledhin informacionin më të rëndësishëm.

Shfaqni [videon](#) këtu të PRI-së për kujdesin shëndetësor ndaj grave në Kenia, (2:24 MINUTA)

→ Ka pesë video në këtë seri – numri 3 i kushtohet kujdesit shëndetësor

7.2
45 MINUTA

USHTRIM
10 MINUTA

SHËNDETI MENDOR I TË BURGOSURVE

Roli i personelit jomjekësor

Ky ushtrim kryhet me 8 tabakë letre dhe 4 grupe, që qarkullojnë në sallë duke shkruar mendimet e tyre në secilën letër në përgjigje të secilës prej pyetjeve të mëposhtme (me shkronja të zeza). Pjesëmarrësit duhet të mbajnë parasysh teknikat e sigurisë dinamike dhe atë që kanë mësuar në modulet e mëparshme.

→ Përdorni më pak pyetje nëse nuk keni kohë të mjaftueshme.

1. Çfarë duhet të bëjë personeli i burgut nëse dyshon se një i burgosur ka probleme të rënda të shëndetit mendor që kërkojnë vëmendje të menjëhershme? Çfarë NUK duhet të bëjë?

- Të informojë personelin shëndetësor të burgjeve dhe drejtuesit e tyre.
- Të komunikojë informacionin e nevojshëm tek anëtarët e tjerë të stafit.
- Të marrë masa mbrojtëse urgjente nëse ka rrezik për individin ose për të tjerët.
- Të flasë me individin në përpjekje për të kuptuar situatën e tyre.
- Të mos përdorë forcë ose masa kufizuese nëse nuk është absolutisht e nevojshme.
- Të mos e vendosë individin në izolim.

2. Çfarë mund të bëjë personeli i burgut për të mbështetur personat në burg që vuajnë, për shkak të ndërprerjes së substancave?

- Të sugjerojnë që ata të flasin me punonjësit shëndetësorë dhe specialistët e shëndetit mendor (nëse ka) për çdo simptomë që përjetojnë.
- T'i kontrollojnë rregullisht dhe të flasin me ta për gjendjen e tyre; nëse nuk duan të flasin me të, të zbulojnë nëse kanë ndokënd me të cilin do të dëshironin të flisnin.
- Të marrin masa që t'u jepet informacion i qartë në lidhje me përdorimin e drogës dhe trajtimet që mund të marrin (aty ku është e mundur).
- Nëse është hartuar plani i kujdesit, të bisedojnë me ta për nevojat që përmban plani dhe synimet e rehabilitimit.

3. Çfarë duhet të bëjë menjëherë një punonjës i burgut nëse dyshon se një i burgosur rrezikon të vetëvritet apo vetëdëmtohet? Çfarë NUK duhet të bëjë?

- Të sigurojë zonën dhe të japë ndihmën e parë të nevojshme.
- Të heqë çdo send që mund të përdoret për vetëvrasje ose vetëdëmtim.
- Të informojë menjëherë punonjësit e shëndetësisë apo drejtuesit e burgut.
- Të sigurojë mbikëqyrjen e individit.
- T'i sigurojë atij kontakte me njerëz.
- Të informojë anëtarët e tjerë të stafit për situatën.
- Të mos e vendosë individin në izolim.

4. Cilët faktorë mund të çojnë në përkeqësimin e gjendjes së shëndetit mendor të një personi? (përfshi faktorët personalë dhe faktorët e drejtësisë penale)

- Sëmundja ose vdekja e anëtarëve të familjes/miqve
- Prishja e martesës apo probleme të tjera në familje
- Ngjarje të rëndësishme familjare
- Festat e mëdha publike ose fetare.
- Shqetësimet/borxhet financiare
- Dhuna dhe bullizmi në burg
- Ndërprerja e substancave narkotike
- Dhënia e vendimit të dënimit
- Rezultati i sesionit për lirimin me kusht
- Vendimet e transferimit
- Koha e mbetur deri në lirim

5. Cilat grupe mund të jenë më të rrezikuara nga problemet e shëndetit mendor në burg?

- Gratë
- Fëmijët/të rinjtë
- Shtetasit e huaj
- Personat LGBTI
- Të moshuarit
- Të burgosurit me aftësi të kufizuara fizike
- Personat me dënime të pasigurta ose të papërcaktuara
- Të paraburgosurit
- Personat që vendosen në izolim

6. Çfarë mund të bëjë stafi për të lehtësuar ndikimin negativ të burgosjes dhe për të shmangur reagimet e zakonshme psikologjike, të tilla si depresioni dhe ankthi?

- Të vendosë marrëdhënie me të burgosurit
- Të bëjë biseda domethënëse me ta
- Të dëgjojë problemet dhe shqetësimet e tyre
- Të përdorni një gjuhë pozitive, verbale dhe trupore
- Të marrë masa që ata të kenë mundësi për aktivitete domethënëse
- Të promovojë shëndetin fizik
- T'u japë informacionin dhe mbështetjen që u nevojitet
- Të lehtësojë kontaktet me familjarët

7. Çfarë mund të bëjë personeli i burgut për të kuptuar shkaqet dhe pasojat e problemeve mendore?

- Të bisedojë me personelin shëndetësor dhe specialistët e shëndetit mendor të burgut
- Të lexojë rreth shëndetit mendor të të burgosurve
- Të bisedojë me personat në fjalë
- Të kërkojë trajnime për shëndetin mendor

8. Cilat aspekte të regjimit/situatave të burgut mund të paraqesin rreziqe të veçanta për shëndetin mendor?

- Kushtet fizike të burgut
- Izolimi
- Mungesa e kontaktit me familjen/miqetë
- Ngacmimi dhe dhuna
- Diskriminimi dhe stigma
- Procedurat e kontrollit
- Masat disiplinore, duke përfshirë izolimin
- Përdorimi i kufizimit fizik dhe forcës

15 MINUTA

Përmbledhje

Në përmbledhje të mësimet të deritanishëm në këtë modul dhe për të mbyllur këtë sesion, trajnuesi tani mund të shfaqë një skenar nga [UNODC online training on health](#) (trajnimi online për shëndetin)

UNODC-u ka zhvilluar 5 skenarë për kujdesin shëndetësor për programin e tyre të trajnimit (vizitat mjekësore në momentin e pranimit, mbikëqyrja e vizitave, aksesit në kujdesin shëndetësor, vendimet klinike, nevojat për kujdes shëndetësor mendor). Zgjidhni njërin prej tyre që ju duket më e dobishme, bazuar në mënyrën se si ka shkuar trajnimi/cila fushë ka nevojë për më shumë fokus. Nëse keni kohë, shfaqni më shumë se një skenar.

BURIME
TË TJERA

Istanbul Protocol, Manual on the Effective Investigation and Documentation of Torture and Other Cruel, Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (2022 edition)

(Protokolli i Stambollit, Manual për Hetimin dhe Dokumentimin Efektiv të Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (botimi 2022))

PRI short guide: Mental health in prison

Udhëzues i shkurtër i PRI-së: Shëndeti mendor në burg

PRI Women and prison – Mental health and well-being: A guide for prison staff

PRI Gratë dhe burgjeve - Shëndeti dhe mirëqenia mendore: Një udhëzues për personelin e burgjeve

WHO Europe – Prisons and health

OBSH Evropë - Burgjet dhe shëndeti



MODULI 8
REHABILITIMI I TË BURGOSURVE
DHE PËRGATITJA PËR LIRIM

8 REHABILITIMI I TË BURGOSURVE DHE PËRGATITJA PËR LIRIM

MATERIALET

- Stilolaps dhe bllok
- Faqet 65–70 në PowerPoint
- Listë e leximeve/burimeve shtesë
- Studimet e rastit Hap para/Hap mbrapa (shih faqet 165–166)

10 MINUTA

HYRJE

Moduli shqyrton mënyrën e mbështetjes së rehabilitimit dhe riintegritimit të personave në burg nga ana e personelit të burgut– për garantimin e mbrojtjes së shoqërisë nga krimi dhe për uljen e shkallës së recidivizmit, si qëllimi kryesor i privimit të lirisë.

Funksioni rehabilitues i burgjeve është trajtuar si faktor i rëndësishëm në modulet e mëparshme tematike, pasi të gjitha aspektet e jetës në burg mund të kontribuojnë në suksesin e rehabilitimit, por ky modul fokusohet posaçërisht në programet e arsimit, formimit profesional dhe punësimit, si dhe formave të tjera të ndihmës praktike që autoritetet mund të ofrojnë për të ndihmuar rehabilitimin. Moduli, gjithashtu, trajton çfarë mund të bëjnë autoritetet dhe personeli i burgut për t'i pajisur personat në burg me aftësi për jetën pas lirit.

OBJEKTIVAT MËSIMORE

Në fund të këtij moduli, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Të përshkruajnë se si aspekte të ndryshme të jetës në burg mund të shtojnë (ose ndikojnë negativisht) ndikimin për rehabilitim të suksesshëm;
- Të shpjegojnë rolin specifik të personelit të burgut në ndihmën për rehabilitimin dhe riintegrimin me sukses të të burgosurve;
- Të njohin rëndësinë e klasifikimit dhe individualizimit gjatë përcaktimit të programeve të duhura rehabilituese;
- Të diskutojnë për llojet e ndryshme të programeve të trajnimit, punës dhe edukimit që mund të ofrohen;
- Të identifikojnë se cilat lloje të tjera të mbështetjes mund të ndihmojnë në rehabilitimin me sukses në përputhje me nevojat individuale; dhe
- Të identifikojnë se çfarë masash mund të marrin administrata dhe personeli i burgjeve për t'i përgatitur personat për lirim dhe për t'u mundësuar një jetë të sigurt, në respekt të ligjit dhe aftësitë për jetën pas lirit.

8.1

35 MINUTA

AKTIVITETET, TRAJNIMI, EDUKIMI DHE PUNËSIMI I TË BURGOSURVE

VIDEO - UNODC disponon shumë [video nga vendet / raste studimore lidhur me rehabilitimin](#) - shfaqni një prej tyre në fillim të sesioni dhe një VIDEO në fund.

Pse janë kaq të rëndësishme programet e rehabilitimit dhe riintegritimit social??

Kjo mund të bëhet në formën e prezantimit, ose të një ushtrimi në grup, ku secili grup trajton një çështje të vetme dhe më pas bëhet një prezantim i shkurtër për të gjithë pjesëmarrësit

NMR: 91, 92, 95 –105
BKK: 45-47

- Ofrimi i mundësisë për t'u pajisur me aftësi të reja dhe për të fituar përvojë pune, i ndihmon të burgosurit të qëndrojnë larg krimit pas lirit. Ky kontribut forcon sigurinë e komuniteteve.
- Duke i mbajtur të burgosurit të angazhuar, zvogëlohet varësia e tyre nga autoritetet, si dhe përgatiten për punësim dhe jetesë të pavarur pas lirit.
- Personat në burg që janë të angazhuar në aktivitete konstruktive mund të kenë ndikim pozitiv tek të burgosurit e tjerë duke çuar në uljen e problemeve të sigurisë.
- Aktivitetet edukuese në burg pakësojnë dallimet midis jetës së burgut dhe jetës në komunitet. Këto aktivitete ndihmojnë në lehtësimin e ndjenjës së izolimit, pafuqisë dhe rrezikut të problemeve mendore.
- Programet e arsimit, trajnimit profesional dhe punësimit në burgje mund të ndihmojnë që burgjet të bëhen vende më të sigurta dhe më të rregullta, sepse ata që merren me aktivitete konstruktive kanë më pak gjasa të shfaqin sjellje agresive, ose të dhunshme.
- Puna mund të gjenerojë, gjithashtu, burime financiare dhe të llojeve të tjera për personat dhe institucionin.

Cilat aktivitete specifike mund të përfshihen në një program rehabilitimi të të burgosurve?

Rehabilitimi i të burgosurve duhet të përfshijë një gamë të gjerë programesh, ku përfshihet:

- Kujdesi për shëndetin fizik dhe mendor
- Programet kundër abuzimit me substancat
- Aktivitetet fizike
- Këshillimi, përfshirë këshillimin për krijimin e marrëdhënieve të shëndetshme
- Mbështetja psikosociale
- Programe për të trajtuar qëndrimet dhe sjelljet (p.sh., programet e reduktimit të dhunës)
- Arsimi
- Kurse të formimit profesional
- Aktivitete krijuese
- Aktivitete kulturore
- Mundësi pune
- Këshillim për punësimin
- Qasje në një bibliotekë të pajisur mirë
- Programet e gjuhëve të huaja

Parimet për programe të suksesshme rehabilitimi

- Programet duhet të përmbushin gamën e plotë të nevojave të personave që mbahen në burg
- Ato duhet të bazohet në vlerësimet individuale
- Të ofrohen për të gjithë personat në burg
- T'u përgjigjen nevojave gjinore
- Të jenë financuara mirë dhe të pajisura me mjetet e nevojshme
- Të jenë në përputhje me kontekstin lokal dhe të marrin parasysh nevojat e komunitetit vendas

- Të hartohen bazuar në konsultimet me personat në burg dhe ata që janë liruar
- Të përfshijnë programe/aktivitete që drejtohen nga bashkëvuajtës
- Të kenë mbështetjen e personelit dhe drejtuesve të burgut
- Të motivojnë personat në burg për të mësuar
- Të përfshijnë qasje tërësore dhe terapeutike
- Të jenë të qëndrueshme dhe të bazohen në të dhëna

USHTRIM **Barrierat për rehabilitimin e grupeve të veçanta të personave në burg**

Disa prej të burgosurve mund të përballen me pengesa të shtuara për rehabilitimin e tyre, në krahasim me të tjerët. Kjo mund të jetë për shkak të prejardhjes së tyre ose rrethanave individuale. Por kjo mund të ketë lidhje edhe me kushtet e burgut ose me përvojat e tyre brenda burgut. Disa mund të mos kenë mundësi të ndjekin programe specifike për një sërë arsyes. Pra, shumë persona në burg përballen me pengesa për rehabilitimin e tyre pas lirit. Kërkoni nga pjesëmarrësit të sugjerojnë se cilat grupe ose persona mund të përballen me më shumë pengesa dhe pse.

→ Kërkoni nga pjesëmarrësit të diskutojnë për secilin nga grupet, bazuar në përvojën e tyre profesionale.

Ky diskutim mund të jetë një mundësi e mirë për të diskutuar mbi impaktin e COVID-19 në rehabilitimin e të burgosurve.

Grupet ose personat që mund të përballen me më shumë pengesa përfshijnë:

Të rinjtë (veçanërisht vajzat)

Arsyet mund të përfshijnë: mungesën e përvojës në arsimin formal, analfabetizmin ose aftësitë e pakta në shkrim-lexim, bullizimin, historinë e dhunës në familje, ndarjen dhe abuzimin, mungesën e programeve të përshtatshme për të rinjtë në burg.

Të rinjtë (djemtë)

Arsyet mund të përfshijnë: mungesën ose përvojat e këqija në arsimin formal, mungesën e mbështetjes pas lirit, presionin e bashkëmoshatarëve, kulturën e të fortit të burgut, bullizimin në burg.

Gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë në burg

Arsyet mund të përfshijnë: përjashtimin nga programet e rehabilitimit, mungesën e kohës për të marrë pjesë në programe specifike për shkak se burgu nuk ofron kujdes për fëmijët, problemet e shëndetit mendor, mungesën e programeve të përshtatshme për gratë shtatzëna, mungesën e mbështetjes familjare).

Shtetasit e huaj në burgje

Arsyet mund të përfshijnë: pengesat gjuhësore, mungesën e kontaktit me familjen dhe miqtë, pasigurinë e situatës pas lirit, problemet e shëndetit mendor, mungesën e aktiviteteve domethënëse.

Pakicat etnike dhe racore dhe indigjenët në burg

Arsyet mund të përfshijnë: barrierat gjuhësore, marginalizimin social dhe ekonomik, rëndësinë e programeve ekzistuese të rehabilitimit, bullizimin në burg, diskriminimin.

Personat me probleme të shëndetit mendor

Arsyet mund të përfshijnë: pamundësinë e ndjekjes/ papërshtatshmërinë e programeve rehabilituese, mungesën e kujdesit të duhur për shëndetin mendor, bullizmin, diskriminimin, stigmatizimin.

Personat me aftësi të kufizuara fizike

Arsyet mund të përfshijnë: pengesat infrastrukturore dhe mungesën e programeve specifike të rehabilitimit, problemet e shëndetit mendor, bullizimin, diskriminimin.

Personat LGBTI në burg

Arsyet mund të përfshijnë: ngacmimin, diskriminimin, dhunën dhe abuzimin, problemet e shëndetit mendor, mungesën e kontaktit me familjet.

→ Nëse keni kohë, kërkoni nga pjesëmarrësit të reflektojnë mbi ato që kanë mësuar në modulet e mëparshme në funksion të mbledhjes së ideve lidhur me hapat praktikë që mund të ndërmarrë personeli i burgut për të ndihmuar në kapërcimin e disa prej këtyre pengesave ndaj rehabilitimit.

8.2 PËRGATITJA PËR LIRIM DHE MBËSHTETJA PAS LIRIMIT

30 MINUTA

NMR: 106 – 108

BKK: 45 – 47

- Përgatitja për lirim duhet të fillojë sapo personi të vendoset në burg.
- Përgatitja për lirim është e rëndësishme për të gjithë të burgosurit, si për ata që vuajnë dënime shumë të shkurtra dhe ata që vuajnë dënime shumë të gjata.
- Është e rëndësishme të dimë se lloji i përgatitjes dhe mbështetjes së nevojshme do të varet nga rrethanat individuale.
- Për gratë e burgosura duhet të ketë programe që trajtojnë nevojat e ndryshme dhe kërkesat shtesë për mbështetje ndaj tyre.
- Për shtetasit e huaj nevojiten strategji të ndryshme, në varësi të faktit nëse ata do të deportohen/qëndrojnë në vend/janë në pritje të vendimeve të emigracionit.
- Përgatitja për lirim përfshin koordinim të ngushtë me agjenci të jashtë sistemit të burgjeve - kjo mund të përfshijë punonjësit socialë, shërbimin e provës, OJF-të, organizatat fetare dhe të tjera subjekte që mund të përfshihen në kujdesin pas lirimit.
- Përgatitja për lirim përfshin përgatitjen psikologjike dhe emocionale (përmirësimin e vetëbesimit dhe vetëvlerësimit, pavarësinë, aftësitë e komunikimit, aftësitë për të krijuar marrëdhënie) si dhe mbështetjen me njohuri praktike (transporti pas lirimit, aftësitë për gjetjen e punës dhe paraqitjen në intervistë, ku të drejtohen për gjetjen e strehimit, etj.)
- Personave në burg duhet t'u jepet informacion i qartë, së bashku me adresat ku mund ta gjejnë, për veprimet që duhet të bëjnë pas lirimit, si dhe informacion praktik për mbështetjen që mund të marrin.

- Këtu duhet të përfshihen të dhënat e kontaktit për agjencive përkatëse të ndihmës dhe informacion për mirëqenien sociale, shëndetin, strehimin, punësimin dhe mbështetjen ligjore pas lirimit.
- Si pjesë e përgatitjes për lirim, të burgosurit mund të lejohen të largohen nga burgu për periudha të shkurtra përpara datës së lirimit për të ndenjur me familjet e tyre, për të ndjekur kurse trajnimi, për të kërkuar punë, etj.
- Personave në burg duhet t'u jepet mundësia të diskutojnë për përjetimet që kanë lidhur me lirin, duke përfshirë frikën, pritshmëritë dhe mbështetjen e veçantë që do t'u nevojitet.
- Familjet e personave në burg gjithashtu mund të kenë nevojë për mbështetje, veçanërisht familjet që kanë qenë të ndara për një kohë të gjatë.

Shqetësimet pas lirimit:

- Recidivizmi
- Kthimi në një mjedis të pasigurt/rreziku i dhunës (veçanërisht i izolimit nga familja/komuniteti)
- Varfëria
- Humbja e kontakteve me familjet
- Mungesa e strehimit
- Papunësia
- Problemet e shëndetit mendor
- Mungesa e mundësive për arsim/trajnim profesional
- Mungesa e kujdesit mjekësor dhe vazhdimësisë së këtij kujdesi
- Abuzimi me substancat në periudhën pas lirimit

USHTRIM
20 MINUTA

Përmbledhje

Ky ushtrim është krijuar për të përmbledhur njohuritë nga programi lidhur me kontributin e personelit të burgut në rehabilitimin e të burgosurve gjatë qëndrimit në burg. Nga pjesëmarrësit, caktoni dy ose tre persona të marrin rolin e një personi në burg. Ngjarjet/skenarët specifikë që ndodhin në burg shkruhen në copa letre dhe më pas palosen dhe vendosen në një kuti. Disa nga këto janë pozitive dhe lejojnë që personi në burg të bëjë një hap përpara drejt rehabilitimit me sukses; të tjerat janë negative dhe e detyrojnë personin në burg të bëjë një hap prapa. Shënoni një vijë starti dhe fundi në sallën e trajnimit dhe shikoni se cili person arrin i pari në vijën e finishit/ rehabilitimit. Pjesëmarrësit e mbetur zgjedhin rastësisht letrat e palosura dhe i lexojnë ato me radhë.

Idetë për letrat “hap përpara” dhe “hap prapa” janë dhënë më poshtë (mund të shtoni më shumë letra për hapat përpara nëse është e nevojshme dhe ushtrimi po zgjat).

Hap përpara

- Autoritetet e burgut më lejuan një takim të gjatë dhe privat me fëmijët e mi.
- Kam dhënë provimin e një gjuhe të huaj.
- Jam transferuar në një objekt të sigurisë më të ulët për shkak të sjelljes së mirë.
- Jam transferuar në një objekt më afër familjes sime.

Hap mbrapa

- Qelia ime është mbipopulluar shumë dhe natën e kemi të vështirë të flemë.
- Kam bërë ankesë për cilësinë e ushqimit shumë kohë më parë, por ende nuk kam marrë përgjigje.
- Vizitat me familjen zgjasin vetëm 10 minuta.
- Punonjësit e burgut më bërtisnin kur ankohesha për zhurmat gjatë natës

Hap përpara

- Ankesa ime për pastërtinë e objektit u mor seriozisht dhe u zgjidh.
- Më transferuan në një qeli me njerëz të moshës sime që ndajnë të njëjtat interesa.
- Patëm një diskutim në grup për shqetësimet tona për jetën pas lirim.
- Ushqimi në objekt është përmirësuar.
- Më dhanë një ditë leje në shtëpi për të ndenjur me familjen.
- Kam përdorur shpesh bibliotekën e burgut.
- Autoritetet e burgut më treguan se si të aplikoja për ndihmë juridike.
- Kam filluar të ushtrohem më rregullisht.
- MKPT-ja organizoi një anketë – munda të shpreh shqetësimet e mia në mënyrë konfidenciale

Hap mbrapa

- Nuk kam mundur të flas me askënd për shëndetin tim mendor.
- Jam në qeli me dikë që ka kryer një krim shumë më të rëndë se i imi.
- Nuk kam mundësi të marr pjesë në asnjë aktivitet trajnimi sepse duhet të kujdesem për fëmijën tim.
- Familja ime nuk ka mundësi të më vizitojë.
- Nuk e di si do të shkoj në shtëpi kur të lirohem.
- Nuk kam asnjë informacion për rregullat e burgut.
- Jam rrahur nga shoku i qelisë, por personeli i burgut nuk ka marrë asnjë masë.
- Personeli i burgut nuk bisedon kurrë me mua
- Më kanë thënë se nuk ka mundësi pune për mua.

- | | |
|---|---|
| • Personeli shëndetësor kontrollon rregullisht shëndetin dhe mirëqenien tonë. | • Jam mbajtur në izolim për 10 ditë dhe nuk kam pasur asnjë kontakt me familjen time gjatë asaj kohe. |
| • Kam filluar të punoj në kuzhinën e burgut. | • Nuk më lejohet të shoh dosjen time si i burgosur. |
| • Na lejohet të telefonojmë familjet tona më shpesh. | • Nuk e kam marrë mjekimin këtë javë. |
| • Punonjësit e burgut janë interesuar për familjen time dhe kemi folur për planet e mia pas lirit | • Nuk kam asnjë informacion në lidhje me shërbimet mbështetëse që mund të përfitoj pas lirit |
| • Autoritetet kanë filluar një iniciativë kundër bullizmit në burg. | |
| • Sot më vizitoi përfaqësuesi im konsullor. | |

➔ Në fund të modulit, për ta përmbledhur mund të zhvilloni një diskutim se çfarë mund të bëjë një punonjës i burgut për të ndihmuar në lehtësimin ose parandalimin e këtyre skenarëve.

BURIME TË TJERA UNODC - Udhërrëfyes për zhvillimin e programeve të rehabilitimit në burg

45 MINUTA **Përmbyllja dhe përfundimet**

Në mbyllje, shfaqni këtë video emocionuese/motivuese për rolin e personelit të burgut <https://www.marketing-interactive.com/the-singapore-prison-service-spotlights-the-importance-of-prison-officers> (2:29 mins)

Fjala e mbylljes

Certifikatat duhet të jepen tani nëse keni planifikuar t'i shpërndani personalisht.

Sesioni për mbledhjen e opinioneve

- Kjo mund të bëhet si një ushtrim duke vendosur në muret e sallës katër fletë të mëdha letre, secila me një nga titujt më poshtë. Kërkoni nga pjesëmarrësit të bëjnë komente në çdo tabelë.
- pikat e forta kryesore
- dobësitë kryesore
- E ka ndryshuar trajnimi mënyrën se si e perceptoni rolin tuaj si personel i burgut?
- Do të ndryshoni ndonjë gjë në punën juaj si rezultat i këtij trajnimi?

ANEKSI 1

Informacion i dobishëm për vlerësimin para trajnimit

- Numri i burgjeve në vend, sipas llojit të objektit (p.sh., për gra, fëmijë, paraburgim, nivel sigurie etj.).
- Popullsia totale e burgjeve në vend, e ndarë në kategori aty ku është e mundur dhe statistikën për çdo institucion.
- Raporti personeli/i burgosur.
- Një kopje e ligjit për burgjet dhe ligjeve/rregulloret të tjera përkatëse.
- Struktura organizative e shërbimit të burgjeve.
- Njohja e kushteve bazë të burgjeve në vend dhe çështjeve që mund të ngrihen si fusha problematike.
- Shqetësimet kryesore të të drejtave të njeriut ose çështje të tjera që lidhen me shërbimin e burgjeve.
- Në vendet ku statistikën e ankesave janë të disponueshme (p.sh., nëpërmjet shërbimit të burgjeve, zyrës së Avokatit të Popullit, ose organeve të tjera monitoruese) përpikuni të merrni një kopje përpara trajnimit.
- Informacion mbi klasifikimin në vend (d.m.th., bazuar në cilat vlerësime të rreziqeve/nevojave).
- Llojet e armëve dhe mjeteve të kufizimit fizik që përdoren në burgje.
- Llojet e masave disiplinore që përdoren në objektin/vendin e caktuar.
- Llojet e vizitave që lejohen në vend (duke pranuar që kjo mund të jetë e ndryshme nga një objekt në tjetrin)
- Llojet e organeve për monitorimin e brendshëm/jashtëm që ekzistojnë në vend, duke përfshirë ato që janë pjesë e MKPT-së dhe organe të tjera.
- Niveli i ofrimit të kujdesit shëndetësor në burgje.
- Masat e marra për COVID-19 në burgje dhe shqetësimet lidhur me të drejtat e njeriut.

ANEKSI 2

Pyetësori i para-trajnitimit për t'ua dërguar pjesëmarrësve

1. Emri:
2. Gjinia: Femër/Mashkull/Tjetër/Preferoj të mos e them
3. Titulli dhe grada (duke përfshirë hollësitë e funksioneve mbikëqyrëse):
4. Emri, lloji dhe vendndodhja e institucionit ku punoni (siguri e ulët, e mesme, e lartë, për shembull). Nëse nuk punoni në një institucion, ku punoni kryesisht?
5. Sa kohë keni në shërbimin e burgjeve?
6. Çfarë lloj eksperience keni nga puna brenda burgjeve? A keni ndonjë fushë ku jeni specializuar në shërbimin e burgjeve?
7. A keni marrë pjesë në një kurs trajnimit për të drejtat e njeriut apo të lidhura me të në të kaluarën? Nëse po, çfarë mbulonte?
8. Për cilat fusha tematike të Rregullave të Nelson Mandelës do të dëshironit të mësoni më shumë? (Zgjidh të paktën 3)
 - Menaxhimi i dosjeve të të burgosurve (RREGULLAT 6-10)
 - Ndarja në kategori (RREGULLA 11)
 - Akomodimi (RREGULLAT 12-17)
 - Higjiena personale (RREGULLA 18)
 - Veshjet dhe shtrati (RREGULLAT 19-21)
 - Ushqimi (RREGULLA 22)
 - Ushtrimet dhe sportet (RREGULLA 23)
 - Shërbimet e kujdesit shëndetësor (RREGULLAT 24-35)
 - Kufizimi fizik, disiplina dhe ndëshkimet (RREGULLAT 36-46)
 - Mjetet e kufizimit fizik (RREGULLA 47-49)
 - Kontrollat e të burgosurve dhe qelive (RREGULLAT 50-53)
 - Informacioni për të burgosurit dhe ankesat e tyre (RREGULLAT 54-57)
 - Kontakti me botën e jashtme (RREGULLAT 58-63)
 - Librat (RREGULLA 64)
 - Feja (RREGULLA 65)
 - Ruajtja e sendeve të të burgosurve (RREGULLA 67)
 - Njoftimet (RREGULLAT 68-70)
 - Hetimet (RREGULLAT 71-72)
 - Largimi i të burgosurve (RREGULLA 73)
 - Personeli institucional (RREGULLAT 74-82)
 - Inspektimet e brendshme dhe të jashtme (RREGULLAT 83-85)
9. Ju lutemi shënoni tre gjëra që ju pëlqejnë në punën tuaj.
10. Ju lutemi shënoni tre gjëra që ju duken sfiduese në punën tuaj.
11. Çfarë shihni si disa nga çështjet e reja ose në zhvillim në vendin tuaj në lidhje me zbatimin e Rregullave të Nelson Mandelës?

ANEKSI 3

Pyetësori i vlerësimit pas trajnimit

1. Emri (opsionale):
2. Gjinia: Femër/Mashkull/Tjetër/Preferoj të mos e them
3. Pozicioni (opsionale):
4. Objektivat e trajnimit:
 - a. ishin të qarta: ☐ po ☐ jo ☐ i pasigurt
 - b. u arritën: ☐ po ☐ jo ☐ i pasigurt
5. Shënoni kutinë që vlerëson më mirë njohuritë dhe aftësitë tuaja para dhe pas trajnimit:

Para trajnimit					SHKALLA E VLERËSIMIT: 1 = E ULËT; 3 = E MESME; 5 = E LARTË	Pas trajnimit				
1	2	3	4	5		1	2	3	4	5
					Moduli 1: Rregullat e Nelson Mandelës					
					Moduli 2: Të burgosurit dhe kushtet e burgut					
					Moduli 3: Organizimi dhe administrimi i burgut					
					Moduli 4: Masat mbrojtëse					
					Moduli 5: Parandalimi dhe reagimi ndaj incidenteve					
					Moduli 6: Kufizimet, disiplina dhe sanksionet					
					Moduli 7: Kujdesi shëndetësor					
					Moduli 8: Rehabilitimi i të burgosurve dhe përgatitja për lirim					

6. Cilat fusha tematike të Rregullave të Nelson Mandelës ju duken më të dobishme dhe do të donit të mësonit më shumë? (Ju lutemi, shënoni 3 më të dobishmet)

- Menaxhimi i dosjeve të të burgosurve (RREGULLAT 6-10)
- kategorizimi (RREGULLA 11)
- Akomodimi (RREGULLAT 12-17)
- Higjiena personale (RREGULLA 18)
- Veshjet dhe shtrati (RREGULLAT 19-21)
- Ushqimi (RREGULLA 22)
- Ushtrimet dhe sportet (RREGULLA 23)
- Shërbimet e kujdesit shëndetësor (RREGULLAT 24-35)
- Kufizimi fizik, disiplina dhe ndëshkimet (RREGULLAT 36-46)
- Mjetet e kufizimit fizik (RREGULLA 47-49)
- Kontrollat e të burgosurve dhe qelive (RREGULLAT 50-53)
- Informacioni për të burgosurit dhe ankesat e tyre (RREGULLAT 54-57)
- Kontakti me botën e jashtme (RREGULLAT 58-63)
- Librat (RREGULLA 64)
- Feja (RREGULLA 65)

- Ruajtja e sendeve të të burgosurve (RREGULLA 67)
- Njoftimet (RREGULLAT 68-70)
- Hetimet (RREGULLAT 71-72)
- Largimi i të burgosurve (RREGULLA 73)
- Personeli institucional (RREGULLAT 74-82)
- Inspektimet e brendshme dhe të jashtme (RREGULLAT 83-85)

7. A ka ndikuar trajnimi në mënyrën se si e perceptoni rolin tuaj si personel i burgut?

Po/në disa mënyra/jo/nuk jam i sigurt

Ju lutemi shpjegoni

8. A planifikoni të ndryshoni ndonjë aspekt të punës suaj si rezultat i trajnimit? Po/po por nuk është e mundur/nuk ka nevojë të ndryshohet/nuk jam i sigurt

Ju lutem shpjegoni

9. Ju lutemi vlerësoni sa vijon (5 është më e larta):

1	2	3	4	5	
					Metodat e trajnimit
					Kohëzgjatja e trajnimit
					Përbërja e grupit
					Logjistika dhe organizimi

10. Sipas mendimit tuaj, cilat ishin pikat e forta kryesore të trajnimit?

11. Sipas jush, cilat ishin dobësitë kryesore të trajnimit?

12. Ç'lloj mbështetjeje apo trajnim i mëtejshëm do t'ju ndihmonte ta bëni më mirë punën tuaj?

